

BIBLIOTEKA
SHTETIT

814-9
H24



LUTFI HANKU

**NEPER
GJURMET
E HEROIT**

814-9

H24

LUTFI HANKU

R

NËPËR GJURMËT E HEROIT

(Kushtuar Heroit të Popullit
Nazmi Rushiti)



34842

SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»

PRINDËRIT DHE «SHKOLLA» E VARFËRISË

I dërmuar shpirtërisht, Rushit Shaqiri hodhi sytë nga masivi i maleve të Kërçinit, në këmbë të të cilit shtrihej qyteti i Dibrës. Hëna po nusëronte për të dalë plot shkëlqim e të derdhte dritën e argjendtë mbi fushat e luginat e Dibrës. Kjo pamje ia treti mendimet Rushitit në gjurmë të hershme...

...Malësorët dibranë, sipër ku përziejnë ujërat e tyre Radika me Drinin, po lëronin ato copat e vogla gurore, brinjë malit. Papritur një zë sikur doli nga zemra e malit dhe shtangu njerëzit që po lëviznin me shpejtësi shetërit.

— Heee-heee! Hasmi, mor hasmi!

Ata qëndronin si të shtangur e s'po lëviznin.

— A dëgjuat apo jo, mor heeej! Hajdutët po na djegin e po na vrasin, mor, heeej! — vazhdonte zëri.

Fshatarët i përfshiu urrejtja. U mblodhën kokë më kokë dhe vështronin njëri-tjetrin me dëshpërim.

— Burra, me ç'kemi në duar, t'u dalim përpara qenve! Ose ne, ose ata! — bëri zë Shaqiri, i ati i Rushitit.

Kur arritën në fshat, ata ishin larguar duke djegur disa shtëpi dhe duke marrë me vete dhe tre burra, të cilët i therën qysh të nesërmen.

Një ditë tjetër Shaqirit i vajtën në shtëpi taksidarët.

— ... Epo, na jep dhinë atëhere.

— Më mbeten fëmijët barkthatë.

— Shkurtoje gjuhën! — iu kanos xhandari.

Taksidari dhe dy xhandarët i hynë përdhunisht në shtëpi dhe i morën dhinë e vetme. I ndezur nga kjo padrejtësi, Shaqiri mori thikën e madhe, me të cilën grinte duhan dhe u doli grabitësve qeveritarë përpara.

— Ju më morët dhinë, por unë do t'ju marr shpirtin!

Taksidari dhe xhandarët u zunë ngushtë.

— E paske kapur me të egër. Nuk besuam se do të arrije deri këtu, të ngresh dorë kundër krajlit të madh. Dhinë, merre, jotja është... Por...

*
* *

Një ditë vjeshte, malësorët e tjerë i uruan Shaqirit fatbardhësi në jetë, kur ky familjarisht, u largua për në qytetin e Dibrës së Madhe. Bashkë me të birin, Rushitin, merreshin me regjien e lëkurëve. Por Shaqiri, i munduar nga puna e rëndë, vdiq i ri. Barra e shtëpisë mbeti mbi shpatullat e Rushitit. Vazhdoi edhe ky të merrej me regjien e lëkurëve, të cilat i dërgonte te tregtari i qytetit e, ky i fundit, i niste për Shkup e Ohër. Ditë e natë nuk pushonte së punuari. Një ditë

shkoi te tregtari trashaluq, me atë bark si fundi i një mullari.

— Mirë bërë që erdhe, të shikojmë pak llogarinë, — tha tregtari. Ai hapi fletoren dhe sa me laps, sa me gishta, i tregoi llogarinë, duke ngritur kokën lart, e duke mbyllur ata sytë e tij si të mizës.

— Nuk e ke bërë mirë llogarinë, — i tha Rushiti.

— Po sa thua ti? — e shikoi tjetri me inat.

Rushiti ia numëroi një për një.

— Ti dukesh që je i pamësuar në zanat. Je i ri në shehër! — u ngërdhesh tregtari.

— Usta, këtu bëhet fjalë për hesapin që më takon! — e ngriti zërin Rushiti. Njerëzit kuështarë u mblodhën rreth tyre.

— I paska hasur sharra në gozhdë tregtarit, — foli njëri.

— E di ç'ke ti? Merr hesapin dhe m'u hiq dere! — shfryu tregtari tërë nerva.

Rushiti shtrëngoi grushtat fort, por një mendim i lidhi duart dhe i tha me një zemërim të papërmbajtur:

— Ju, tregtarët, na e rripni lëkurën.

— Heu, na qenke bërë edhe politikan, or zoti Rushit! Të kruheshka kurrizi, ë?

Rushiti nuk mori më asgjë parasysh. Nxori thikën dhe e nguli me vrull mbi trupin e majmur të tregtarit, i cili u lëshua si thes para këmbëve të tij.

Rushiti doli kaçak. Xhandarmëria serbe e ndoqi. Atëhere ai u arratis në Greqi. Dy vjet që-

ndroi atje. Më 1922 u kthye fshehtazi në Dibër të Madhe, kaloi kufirin familjarisht dhe erdhi përgjithmonë në Shqipëri.

*

* *

Ai u kthye nga ara gjithë helm. I hodhi duke i përplasur me forcë ato dy-tri kashta në të hyrë të shtëpisë dhe u fut brenda. Kishte ndryshuar shumë. Dukej më i ligur, me sy të shuar e të bren-gosur. U hodhi një vështrim të heshtur fëmijëve, tundi kokën e lodhur dhe u ul. I trishtuar dhe i ndrojtur, Nazmiu iu afrua të atit, duke pritur përkëdheljet e ëmbla prindërore. Tre fëmijët e tjerë u strukën edhe ata pranë tij.

«Si do t'i rris këta? Eh, kjo jetë e shkretë!» — psherëtiu Rushiti.

— Hë, more burrë, si duket ara? — pyeti Nebija me gjysmë zëri.

— Thatë, mos iu lidhtë kokrra, mos iu lidhtë! — shfryu Rushiti.

Nebija uli kokën dhe u largua që të fshihte dëshpërimin.

Fëmijët vështruan të atin në sy. Ata nuk luajtën atë natë, as përralla nuk kërkuan t'u tregonte e ëma. Duke i përkëdhelur të birit flokët, i erdhi ndër mend lindja e Nazmiut në lagjen Tigvarc të qytetit të Dibrës, më 13 gusht 1919, dhurata e hallës, një djep me dru mali të gdhendur ku ishte urimi: «Me jetë e i fortë sa malet».

Rushiti vështroi me pikëllim duart e tij të nxira, si toka nga vapa e korrikut. Agai priste t'i dërgonte «qesimin» e tokës. Por toka vetëm kashta

për lopët kishte rritur. Donte të hante vetë me fëmijët, donte të hante edhe agai. Sa ngushtë e kishte futur kjo jetë Rushitin! Ai ishte grindur me gehajanë e agait atë ditë.

— Natën ua hoqe kallingjtë misrave, bre Rushit? — e kishte pyetur ai me ironi.

— Paske oreks për të qeshur ti, lum miku, — ia kishte kthyer Rushiti duke përplasur një grumbull kashte për tokë.

Ai bloi nën vete mendimet, sepse agai e kishte porositur të mos kthehej bosh në konak.

— Një herë ngule shatë në tokë të agait, e gjë nuk nxore në krye, — i foli Rushitit.

— Po ç't'i bësh nëmës së perëndisë, mor mik? As për ne e as për aga nuk ka dhënë kjo e shkretë! — tha Rushiti duke menduar se u mor vesh me të.

— Nuk do të dijë agai. Ai me ty ka biseduar. e jo me tokën, o Rushit! Ai kërkon qesimin. Prej tokës a prej botës, se ku e merr ti, ai këtë hesap nuk e vë në kandar.

Bëri ç'bëri Rushiti, duke u rropatur poshtë e përperjetë, agait i pagoi qesimin dhe e braktisi punën në arat e tij.

Ca kohë ndenji në fshatin Kurtbeg, pastaj, me ndihmën e prindërve të Nebijes, bleu më pak se tre dylim tokë në Dovalan, një fshat në anën e djathtë të Drinit të Zi, dhe ndërtoi një shtëpi të vogël përdhese. Në atë pak tokë mbillte duhan dhe e shiste në qytetin e Dibrës së Madhe dhe në Peshkopi.

*
* *

Një ditë, tek po luante në të dalë të fshatit, Nazmiu pa një shokun e tij që ishte nisur për në shkollën e Kastriotit. Sa zili e pati atë! U sul me vrap në shtëpi dhe e zuri të ëmën nga duart.

— Nënë, edhe unë dua të shkoj në shkollë, — dhe lotët i mbuluan sytë.

— Çfarë shkolle, more shpirti i nënës. Ne...

— Jo, unë do të shkoj! — nguli këmbë ai.

Nebija e uli në prehër, ia mori kokën në gji dhe filloi ta përkëdhelte.

Atë ditë në Dovalan, hoxha i fshatit hapi një shkollë turqisht, që të pregatiste hoxhallarë të ardhshëm. Në mes këtyre nxënësve ishte edhe Nazmiu tetëvjeçar. Sa i gëzuar ndjehej atë ditë!

*
* *

— Si u ndave me again kësaj vjeshte? — e pyeti një dovalanas Rushitin, kur po ktheheshin nga pazari i Peshkopisë me nga një trastë me misër mbi shpinë.

— «Lëro e këndo, mbill e vajto», — thoshte im atë. — Edhe ne kështu po e ngrysim këtë jetë!

Si ecën edhe pak, panë hoxhë efendinë, që po pushonte ku zbret rruga për Dovalan.

— Apo jo, hoxhë efendi? — e lidhi fjalën dovalanasi. — Me hile është ndërtuar kjo dynja: shumë qajnë e pak qeshin.

Hoxha kruajti zverkun, sikur të kërkonte mendimin që s'po i vinte, dhe tha:

— Kështu e ka kurdisur allahu, secili qysh në lindje e ka të shkruar në ballë fatin e tij.

— Si shkon ai çuni im me shkollën? — e ktheu fjalën Rushiti. — A ka filluar të mësojë ndonjë fjalë nga turqishtja?

— Keni një djalë, që, zoti e sjelltë në rrugë të mbarë, o Rushit. Tetë vjeç është e me qenë dreq, elhamdurilah! Le vetë që nuk mëson, por... A e di se ç'bëri një ditë në mëngjez? Sa hyri në mësim, unë u thashë: «Selah alekim». E ai u përgjegj: «Unë turçen nuk e mësoj!». Hej, stafkurullah, djallë të tillë, të dalë udhës së hakut, nuk kam parë! — e mbaroi fjalën efendiu, duke vënë dorën në zemër. Atë ditë ishte prishur mësimi.

Hoxha kishte gjetur belanë nga Nazmiu dhe disa nga shokët e tij. Një ditë, ai, për të vendosur qetësinë mes «hoxhallarëve të vegjël», deshi të përdorte shkopin, por Nazmiu ia kishte prerë hovin:

— Ne na ushqejnë prindërit tanë, dhe jo ju!

Hoxha uli shkopin duke murmuritur ca fjalë të pakuptueshme.

Të nesërmen e kësaj ndodhie, Nazmiu nuk e pa hoxhën më me sy. Atëhere ishte vjeshta e vitit 1927.

*
* *

I shtrënguar nga varfëria, Rushiti në pranverën e vitit 1928, mori të birin përdore dhe u nis për në qytetin e Dibrës së madhe. Si nuk gjeti punë tjetër për të, u ndal te dyqani i riparimit të këpucëve të Ganiut, në atë qoshe pazari. Aty punonin edhe tre të rinj të tjerë si këpucarë. Rushiti ma-

llëkonte pa pushim që detyrohej të fuste të birin në punë qysh në moshën nëntëvjeçare, kur ai duhej të shkonte në shkollë. I zoti i dyqanit u bind më në fund që ta pranonte Nazmiun si shegert.

Në dyqan, këpucarët punonin pa orar që kur zbardhte dita e deri kur qytetin e mbulonte errësira e plotë. Këtij regjimi iu nënshtrua edhe shegerti i njomë. Veç kësaj, Nazmiu kryente dhe ca punë të tjera në shtëpinë e Ganiut. Shpërblimi për mundin ishte fare i paktë. Kishte filluar një periudhë tjetër jete.

Nazmiun e donin shumë të tre këpucarët, se ishte i urtë, punëtor dhe i respektueshëm. Në darkë, si linin punën, fillonin të mësonin shkrim e këndim shqip.

Për pak muaj, duart e tij të njoma filluan të qepnin opinga dhe të riparonin këpucë.

Dimri erdhi me ngrica. Bora e imët, sikur të fshihej nga era e tërbuar, futej edhe në dyqanin ku punonin katër shokët. Nazmiut nuk i punonin duart nga të ftohtit. Ganiu hyri në dyqan dhe i foli ashpër pse nuk punonte dhe pse i ishin derdhur ca thumba për tokë.

— Është fëmijë ai, zoti Gani. Ne do ta bëjmë punën e tij, — ndërhyri këpucari më i moshuar.

— Ti ule kokën aty! — iu kërcënua Ganiu. — Mos i dilte për zot punës kur nuk ka kryqe!

Nazmiu përplasi çekiçin dhe këpucën e vjetër me inat, u ngrit pa folur, mblodhi teshat, u përshëndet me lot në sy me tre shokët, i hodhi një vështrim përbuzës e revoltues Ganiut dhe... doli nga dyqani. Në dyqan sundoi heshtja.

Tri orë eci mes borës dhe erës. Në shpinë mbante torbën e teshave, mes të cilave kishte fu-

tur edhe abetaren. Kur arriti në Dovalan, ishte bërë natë. Lodhjen nuk e ndjente fare, sepse i dukej vetja i lirë: larg mundit dhe sjelljes së egër të të zotit të dyqanit. Nebija e priti e gëzuar, kurse Rushiti ftohtë e me vështrim qortues.

— Unë nuk mund të duroja, baba! — zëri i përvojshëm i të birit e bëri të ëmën të qante. Rushiti u qetësua pak. Atë natë Rushiti dhe Nebija folën për hallet e shtëpisë. Nazmiut i vinte se ata po e qortonin që tani nuk po i vinte në ndihmë familjes. Që të nesërmen ai filloi ta ndihmonte Rushitin në punë të ndryshme. Kjo i pëlqente të atit, sepse deshi që i biri të edukohej dhe ta donte punën. Kur kishte kohë të lirë, Nazmiu kapte librin. Nebija, duke parë vullnetin dhe dëshirën e të birit, i lutej të shoqit:

— Nuk do të vdesim pa bukë. Le t'i japim djalit shkollë!

Rushiti nuk i kthente përgjegje, vetëm pshe-rëtinte. Ai e dinte sa krahë të dobët kishte për këtë punë. Duheshin para dhe miq. Megjithatë i shëtiti zyrat e prefekturës së Peshkopisë, por asnjë shpresë nuk i dhanë zyrtarët e regjimit.

Erdhi përsëri shtatori i vitit 1929. Shkollat u hapën. Por Nazmiu filloi jo shkollën po një punë të re: kamerier në kafenenë e Tafës në Peshkopi. Gati një vit shërbeu aty. Punonte deri natën vonë. Pastaj sakrifikonte gjumin dhe, nën dritën e një kandili, mësonte të shkruante e të lexonte.

Vetëm në vitin shkollor 1929-1930, pas shumë përpjekjesh e ndërhyrjesh, Nazmiu u pranua në konviktin e shkollës së Kastriotit.

Kushtet në të cilat u rrit dhe u edukua në fëmijëri Nazmiu, ndikuan shumë në formimin e karakterit të tij.

Në të parë dukej si i trembur, por ishte guximtar, i zgjuar, i shkathët dhe i drejtë. Me sjelljen dhe edukatën e tij, urtësinë dhe pregatitjen e zellshme në mësim, tërhoqi vëmendjen, respektin dhe dashurinë e mësuesve dhe shokëve të tij. Shkolla e Kastriotit në shumicën dërmuese përbëhej nga nxënës bij bajraktarësh, bejlerësh dhe agallarësh dibranë. Këta përbuznin nxënësit e varfër dhe shpesh i ofendonin.

Ato ditë kishin filluar mësimet. Në klasën e Nazmiut erdhi edhe një fëmijë i varfër. Rrinte si i trembur. Atë e caktuan të rrinte afër djalit të bajraktarit.

— Pse na e afruan këtu këtë rreckaman! — tha i zemëruar e me mendjemadhësi bajraktari i vogël.

— Ti mbylle gojën! Po s'të pëlqeu, shko e gjej një bankë tjetër! — iu përgjegj Nazmiu, duke i dalë krah të varfërit.

Bajraktari i vogël u ngrit si kapadai dhe u mat ta qëllonte Nazmiun, duke gjetur përkrahjen e shokëve të vet, por Nazmiu i zuri dorën. Shokët e Nazmiut, ata pak fëmijë të varfër, i thërrisnin:

— Me pëllëmbë! Krisja me pëllëmbë!

Atë çast hyri mësuesi dhe secili shkoi në vendin e tij. Si mbaroi ora e mësimi, Nazmiu ia tregoi mësuesit ngjarjen.

— Veprimi është i drejtë, por kujdes Nazmi. Sot ai është i fortë, ka pasuri e qeveri, por...

Kjo bisedë u bë shkak që me mësuesin ta lidhte një dashuri prindërore. Shpejt u dallua ndër nxënësit më të mirë të klasës në sajë të vullnetit të fortë, seriozitetit dhe kërkesave ndaj vetes në mësim. Këto cilësi i hapën rrugë zhvillimit të tij.

Mësuesit, duke parë aftësitë e Nazmiut në mësim, e ndihmuan atë që ta mbaronte shkollën në tre vjet. Kështu, ai, katër klasë i mbaroi në dy vjet, kurse të pestën, që kishte provime lirimi, e vazhdoi rregullisht. Dëftesën e liritimit e mori me notat shumë mirë. Kështu, në vitin 1932-1933 mbaroi shkollën e Kastriotit.

NË RRUGËN E FORMIMIT

Atë verë, i ati u sëmur rëndë. Kështu, nuk pati mundësi të përpiqej që i biri të vazhdonte shkollën e mesme. U përpoqën mësuesit e shkollës së Kastriotit, por atyre nuk u piu ujë fjala. Kjo e tronditi pa masë Nazmiun, se po i merreshin nëpër këmbë ëndërrat për të mësuar. Prandaj ai, aty nga nga gushti i vitit 1933, doli nga shtëpia për të çarë vetë në jetë. Me një trajse të vogël me bukë dhe me dëftesën e lirimt mbështjellë me kujdes në xhep, i veshur dibrance, afër Klosit të Sipërm u ngjit pas disa qeraxhinjve nga Dibra e Poshtme. Për herë të parë ato këmbë të njoma shkelnin ato rrugë të vështira e të largëta që të shpinin në Tiranë.

— Për ku kështu, mor trim? — e pyeti me dashamirësi më i moshuari i qeraxhinjve.

— Për Tiranë, mor xhajë.

— Hyzmeqar te ndonjë zotni, apo për të fituar ndonjë zanat?

— Për shkollë, mor xhajë, për shkollë.

Qeraxhinjtë e tjerë kthyen kokat të habitur. Dy ditë eci. Këmbët iu bënë plagë. Nata i zuri kur u futën në Rrugën e Dibrës në Tiranë. Njerëzit e shumtë, karrot me kuaj, ndërtesat e turbu-

lluan dhe e lodhën më tepër Nazmiun. Ku do ta kalonte natën? Njeri nuk njihte. Qeraxhinjtë u ndalën te hani i Kallmetit, ndërsa ai eci.

«Edhe këtu paska fëmijë të zbathur e me rroba të grisura. Shiko? Madje edhe burra!» — çuditej ai dhe ecte duke shikuar andej-këtej, sikur po kërkonte njeri. U këput nga lodhja. Njerëzit u rralluan. Ai u ul buzë një trotuari dhe vuri në prehër trajsën me bukë e gjizë...

Të nesërmen filloi të trokiste në dyer të ndryshme. Njerëzit burokratë të regjimit vetëm ngrinin supet përpara kërkesës së Nazmiut, i cili largohej duke mbyllur dyert e zyrave i dëshpëruar dhe i inatosur. Lëvizti të gjithë gurët, por në kot, as njeri nuk i dha as shpresën më të vogël.

Ato ditë kishte arritur në Tiranë edhe mësuesi i tij i dashur. Ai e mësoi se ku duhej të shkonte, si të kërkonte të drejtë studimi dhe si të arsyetonte. U futën bashkë deri te autoritetet më të larta të Ministrisë së Arsimit.

— Ç'është kështu, zoti mësues? Një herë më kërkuan shkresë nga prefekti i Dibrës, pastaj më pyetën hollë për gjendjen ekonomike. «Duhet ta kesh dëftesën e lirimimit me nota shkëlqyeshëm» — më thanë. Unë ua dhashë. Ata ngritën përsëri supet, — i fliste përvajshëm Nazmiu.

— Duhet të jesh bir bajraktari, Nazmi, që t'i kesh të hapura dyert e shkollave, — i foli mësuesi. — Po ti mos u mërzit! — i dha ai kurajo.

Mësuesi lëvizti gurin e fundit. Ai iu lut një mi-kut të tij që e kishte patur shok shkolle e tani punonte në Ministrinë e Arsimit. Ky e rregulloi, me kusht që të paraqitej në konkurs. Madje në konkurs



duhej të fitonte patjetër notën «shkëlqyeshëm» për t'u pranuar në shkollë me bursë. Kjo e gëzoi pa masë dhe i dha kurajo.

Gjithë atë muaj, vetëm për bukën e gojës, u pajtua shërbyes te një tregtar tiranas.

Në shtator të vitit 1933 u hap konkursi. Nazmiu priste me ankth te dera e provimit. Kishte edhe shumë nxënës të moshës së tij, të cilët e shikonin me përçmim. Shumica e tyre ishin djem të veshur e të mbajtur mirë. Në këtë ambient, Nazmiu rrinte i veçuar. Të gjithë hynë në provim. Në fund fare, njëri nga shokët e komisionit thirri emrin e tij. Mësuesit e pyesnin, ai u përgjegjej pa u ngatërruar, gjakftohtë dhe me përpikmëri. Iu nënshtrua edhe një provimi me shkrim në aritmetikë. Komisioni u detyrua të shkruante në fletën e provimit: «Gjykim i mprehtë».

Nazmiu ecte serbes rrugëve të Tiranës, bashkë me mësuesin e tij, kur i komunikuan të drejtën e vazhdimit të shkollës së mesme. Plot pasion e dëshirë, ai, në shtator të vitit 1933, filloi mësimet në gjimnazin e Tiranës.

*
* * *

Në gjimnazin e Tiranës, Nazmiu ishte më i rritur me shtat, por në pamjen e tij të zbetë e të imët, dukeshin gjurmët e një mundimi të parakohshëm. Ai në gjimnaz s'e kishte më atë drojtjen fëminore, po ishte më i çelur. Zgjuarësia dhe shkathtësia e të kapurit shpejt të mësimëve, kujdesi dhe përpikmëria në studim, e bëri Nazmiun të njohur mes sho-

kësh. Që në muajt e parë u miqësua me Irfan Hajrullain dhe Demir Gashin, megjithëse këta studjorin në shkollën teknike. Thjeshtësia dhe sinqeriteti e afronin me shokët. Por edhe shokët i zgjidhte. U miqësua me Vasil Shanton, Xhezmi Dellin e shokë të tjerë. Nuk shoqërohej, madje i urrente, disa bashkëshkollarë që jepeshin pas luksit e qejfeve, aventurierë me kokat bosh, sepse në gjimnazin e Tiranës studjorin fëmijët e deputetëve, të ministrave, të bejlerëve e tregtarëve. Nazmiu bëri shokë nxënësit e sjellshëm, studjuesit dhe ata që kishin prirje për të kapur çdo gjë përparimtare. Nxënësit e klasesave më të larta e afronin «dibranin e zellshëm», bisedonin me të për gjendjen e mjeruar të malësorëve dibranë, i jepnin libra jashtëshkollore për të lexuar.

— Këtë lexoje fshehtas, se mbreti e ka ndaluar! — e kishte porositur një shok më i rritur kur i kishte dhënë një libër. Ky ishte Vasil Shantoja, i cili e afroi që vitin e parë.

Vasili ditën vazhdonte mësimet, ndërsa natën punonte tek furra në rrugën e Kavajës. Po nga vështirësitë ekonomike e braktisi shkollën dhe ndihmoi të atin, Petrushin, në furrë, si bukëpjekës.

Nazmiu habitej. Pse mund t'i ndalonte mbreti librat?! Pasi përgatiste me kujdes mësimet, lexonte me endje të madhe libra që i hapnin çdo ditë e më tepër horizontin e të kuptuarit të jetës. Këto i krijonin botën e emocioneve. Të dielave, në pazar, shikonin qindra malësorë që ktheheshin me nga një torbë lëkure, apo thes me misër. Tek ata diktonte mjerimin dhe shpirtin e revoltuar. I bënte përshtypje turma e lypsave, hamejve, shegertëve, turma e të papunëve. Atëhere kujtonte jetën e tij në

fëmijëri, vuajtjet e fshatarëve të vet. Për këta njerëz lexonte edhe në libra.

— Jo, vëllezër, ne na duhet ende të studjojmë, — u thoshte ai shokëve, kur nuk mund t'u jepnin përgjegje të plotë pyetjeve që u dilnin përpara.

Si mbaroi vitet e para të gjimnazit me nota shumë të mira, filloi t'i hynte në thelb jetës. Tani vinte re se njerëzit më të mirë e të drejtë vuanin dhe persekutoheshin nga regjimi. Dredhia, gënjeshtër e dhuna triumfante mbi arsyen. Librat, jeta përreth dhe shokët i zgjuan Nazmiut ndërgjegjen e revoltës dhe dëshirën për të gjetur të vërtetën, për të kuptuar se ku qëndronte shkalla e mjerimit të popullit.

Rëndësi u vuri mësimit të gjuhëve të huaja, pa të cilat nuk mund të ecte. Me kërkesa të vazhdueshme ndaj vetes, çeli një rrugë të ndritur si gjithë brezi i tij përparimtar.

Libri që tregoi të vërtetën

Vjeshtë e vitit 1934. Natë. Nazmiun nuk po e merrte gjumi. Era përplaste me forcë pikat e shiut mbi dritaren e fjetores.

Të gjithë i kishte zënë një gjumë i thellë. Ai shtriu dorën nën jastëk dhe kapi ca fletë të shaptilografuara të romanit «Nëna», që ia kishte dhënë Xhezmi Delli. Ishte errësirë. Të ndizte dritën, do të zgjonte shokët. Nga ana tjetër, roja e natës do të vinte menjëherë. Por libri duhej të qarkullonte. «Ai na porositi t'i lexonim e t'i shpërndanim pa rënë në sy, se mbreti i burgos librat», — mendonte Nazmiu. Në errësirë, pranë krevatit, një zë i pëshpëriti:

— Nazmi, o Nazmi!

— Ti je, Irfan? Ç't'u tek në mes të natës?

Irfan Hajrullai ishte shok i mirë i konviktit, që nuk rrinte i mënjanuar nga shokët, mjaft i gjallë dhe kureshtar. Ai kishte hetuar disa marrëdhënie të fshehta mes disa shokësh. E kuptonte se në konvikt diçka po lëvizte. Edhe në orët e studimit e kishte vënë re Nazmiun që ngulej duke lexuar disa fletë, e nuk i bënte përshtypje asnjë zhurmë.

— Nazmi, jemi shokë?

— Përse e vë në dyshim këtë, Irfan, gjithmonë shokë jemi.

Irfani u ul mbi krevatin e Nazmiut dhe kërkoi të dinte atë diçka të madhe e shqetësuese që mendonte ai.

— Përse i lexon fshehtas ato fletët ti, apo...

Nazmiu mendoi: «Fundja, ndonjë sekret i madh s'është. Veç mos të na diktojnë!» — Dhe pastaj iu kthye shokut:

— Ky është një libër shumë i bukur, që u tregon njerëzve të vërtetën, — i foli me një zë të ulët.

Pranë krevatit të Nazmiut ishin afruar edhe tre-katër të rinj të tjerë, mes të cilëve dhe Demir Gashi.

— Pse të vërtetën? Po gënjeshtër ku qëndron në këtë mes? — pyeti Demiri.

— Si t'jua shpjegoj unë? Një pakicë njerëzish majmen në kurriz të të varfërve. Libri i mëson të varfërit si të ngrihen e të luftojnë kundër pasanikëve...

Ata po mendoheshin. Këto ishin fjalë të reja për ta, fjalë që nuk arrinin t'i kuptonin.

— Mirë, po përse është i ndaluar? — pyeti njëri nga nxënësit, me atë naivitetin e një të riu të pa-

rrahur në jetë. — Derisa thotë të vërtetën, përse nuk e lënë të lirë?

— Si mor, përse? Këtu, në vendin tonë, kush sundon dhe e rrjep popullin? Një grusht njerëzish feudalë, borgjezë, bejlerë e agallarë, me në krye mbretin. Më shqip, ky libër na tregon rrugën e vërtetë se si mund t'i zhdukim këta! A e kuptoni? Nuk lejon mbreti që të thuash e të përhapësh të vërtetën.

— Kuptuam, — ia kthyen shokët, duke u munduar të kërkonin ato pikëpyetje të errëta që u lindnin e u humbisnin aty për aty.

Biseduan edhe më në mes errësirës, tani për shoqërinë «Jeta e re». Kur roja e natës, bashkë me kujdestarin, filluan të ngjisnin shkallët për kontroll, Demir Gashi, që kishte dalë të ruante, dha sinjalin. Shokët u shtrinë në krevat, po nuk i merrte gjumi. Mendonin për ato gjëra të reja që mësuan në libër.

Ky libër edukoi me ndjenja revolucionare Nazmiun dhe gjithë rininë përparimtare. Ai shikonte te «Nëna» jo vetëm shtypjen dhe varfërinë e vegjëlisë ruse, por edhe të asaj shqiptare. Rreth tij shikonte po ata shfrytëzues të egër dhe njerëz të pashpirt të mbretit, që haste në faqet e romanit. Ai e kuptoi se ç'forcë të madhe kishte proletariati, kur te ky futej ndërgjegjia komuniste. Heroi i romanit, Pavël Vllasovi, u bë hero i ideal dhe më i dashur i tij. Ky hero e mësoi cilët ishin shkaktarët e vuajtjeve të popullit, si mund të vihej në shërbim të masës së varfër, cilat ide do ta pregatisnin për t'u ndeshur me botën e vjetër të padrejtë, që populli të vendoste vetë për fatet e tij. Atë kohë kryefjala e bisedës së të rinjve përparimtarë u bënë problemet e romanit «Nëna» dhe idetë komuniste. Natyrisht, për vetë moshën dhe pjekurinë shkencore, ana thelbësore e

tyre nuk kuptohej sa duhej dhe menjëherë. Shpesh kishte diskutime të errëta. Prandaj Nazmiu me shokë mendohej që t'i zbërthente përmes bisedave të shumta. Secili në këto rrethe bisedash mendohej të tregonte diçka mbi Bashkimin Sovjetik, mbi gjendjen e popullit tonë, mbi idetë komuniste. Veç për një gjë ishin të bindur, që komunizmi është lumtëria për gjithë shoqërinë. Prandaj, rreth saj thurnin njëmijë ëndërra.

Në «Lëndinën Syverdhë»

Me Irfan Hajrullanë hynë në dhomën e fjetjes. Nazmiu vuri re se kyçi i valixhes së tij prej dërrase ishte thyer.

— Edhe këtu i paskan futur hundët? — i tha Irfanit dhe hapi kapakun. Teshat dhe librat ishin bërë lëmsh.

— Kujdestarët të kenë guxuar?

— Nuk besoj. Për fat, dje ia dorëzova Vasilit broshurat «e ndaluara». Jo, u gënjeva. E paskan marrë kapitullin e demonstratës së «Nënës».

— Atë që shkrojte me dorë?

— Po.

— U bënë më keq se xhandarët.

— Ata me siguri janë të shtyrë nga qarkkomandanti, për të sqaruar dyshimet e spiunëve.

Dualën nga konvikti i Teknikës. Të shtunave, në kohën e liridaljes, takohej me Vasilin, tek furra e xha Petrushit. Kështu i thërrisnin shokët e Vasilit të atit të tij.

Këtë të shtunë Nazmiu e gjeti Vasilin me Xhezmi Dellin të ulur mbi një thes mielli, në këndin e

errët të furrës. Këtu biseduan dhe rrahën mendime për shpërndarjen e literaturës nëpër shokët e gjimnazit, sidomos rreth romanit «Nëna», për rolin që duhej të luante shoqëria «Fryma e re» në bashkimin e të rinjve përparimtarë përmes aktiviteteve jashtë-shkollore.

— Suksesi ynë do të jetë, në qoftë se «Frymën e re» e bëjmë të pavarur nga drejtoria, — tha Vasili.

— Duhet patur kujdes nga profesor Gogoja. Kam frikë se ai do të jetë spiun i oborrit të mbretit, — shtoi Xhezmiu.

Ata vazhduan gjatë diskutimin.

Nazmiu më tepër dëgjonte. Xha Petrushit gatuante. Nganjëherë ngrinte kokën dhe hidhte nga një fjalë për të qeshur.

Nata ra. Në derë të furrës, Vasili u shtrëngoi duart dy shokëve, duke u thënë:

— Idetë tona duhet t'i konkretizojmë, vëllezër, por aq sa na lejojnë kushtet. Atëhere «Frymën e re» do ta kemi krejt tonën. Dhe çdo spiuni do t'i pritët gjuha e dora. Por duhet kujdes. Akti i kontrollit në konvikt, që na informoi Nazmiu, nuk është i rastit...

Duke u ndarë, Vasili u kujtoi edhe një herë: Nesër në «Lëndinën Syverdhë» (Kështu e quanin vendin ku mblidheshin të rinjtë përparimtarë).

Në furrën e xha Petrushit ishte hapur një klasë e re, ku mësonte edhe Nazmi Rushiti.

*
* *

Nazmiu ecte me një grup shokësh asaj të diele pranvere, të tridhjetëepesës. Kaluan rrugën e zhveshur jashtë qytetit dhe u futën buzë lumit të fres-

kët e plot hije. Nën rrezet e diellit, gjithçka shkëlqente: arat qilizëm, gruri me shtat të shëndetshëm, bari i gjelbër i livadheve, me mijëra lule të ngjyrave të ndryshme, qielli i kaltër ku vozisnin ca re të holla, borë të bardha. Kaluan kështu Zallin e Tiranës dhe u ulën në një lëndinë mes luleshqerave syverdha. Aty u shtrinë dhe pushuan.

Biseda që hapi Vasil Shantoja ishte bërë aq tërheqëse, sa ata nuk e vunë re mbarimin e ditës. Secili kishte lexuar diçka nga literatura politike e artistike. Secili shfaqte mendimin e tij. Kjo ngjallte polemika mes tyre. Biseda herë merrte zjarr, herë dukej sikur shuhej, por aty për aty ndizej përsëri, kur mendimet piqeshin e shpërthenin.

— Lufta, kjo e sjell fitoren. Nuk duhet ndenjor në një vend, duarkryq. Nga qielli dhe nga mbreti nuk vjen asnjë e mirë! — e theu prapë heshtjen Nazmiu. — Nuk duhet vajtuar gjendja, por duhet luftuar! — dhe hodhi vështrimin e tij të ëmbël mbi shokët. Ata e shikuan. Njëri, me pamje të ashpër, që fliste më shpesh në këtë bisedë, u ngrit në bërryl nga ku ishte shtrirë, dhe tha:

— Të luftosh, po! Por si duhet luftuar kundër këtij sistemi të padrejtë? — dhe duke thënë këto fjalë, sytë i nguli në horizontin e përflakur të asaj mbasditeje të vonë. Pastaj vazhdoi:

— Në çdo anë, mbreti satrap ka shpërndarë spiunë, xhandarë e provokatorë të fëlliqur për të ndjekur çdo njeri me mendime përparimtare!

— Atëhere, çfarë mbetet? — pyetën dy të rinj, me një zë.

Nazmiu mbështeti ballin e nxehtë mbi pëllëmbët e duarve dhe pastaj u ngrit në këmbë. Ai mund t'ia jepte shpjegimin kësaj pyetjeje, por donte njëko-

hësisht edhe t'i linte krah të lirë këtij diskutimi. Kur pa se biseda nuk po shkonte më tej, u përgjigj:

— Që të luftosh, duhet, në radhë të parë, të gjesh guximin, forcën për të luftuar e përmbysur botën e varfërisë e të mjerimit. Këtu është nyja e zgjidhjes së kësaj pyetjeje.

— Këtë po kërkojmë. Ku ta gjesh këtë forcë? — u hodh njëri.

— Prit, mos u ngut, — foli Nazmiu urtë-urtë. — Edhe nëpër libra e kemi lexuar. Në vendin tonë kjo forcë ka lindur dhe është në rritje. Shpejt ajo do të shpërthejë zemërimin që i është grumbulluar në gji e do të shembë çdo padrejtësi e ligësi: feudale, bejlerë, tregtarë, dhe vetë mbretin. Kjo forcë e ligjshme është populli.

Vasili e shikonte me buzë në gaz dhe tundte kokën në shenjë aprovimi.

Biseda vazhdoi edhe ca, derisa mugëtira zbriti çalë-çalë luginës së lumit, nga ku vinte një freski e këndshme. Një këngë me shumë zëra, e ngadalshme dhe e harmonishme, përhapej gëzueshëm në këtë buzë mbrëmje.

Në syrin e xhandarmërisë

Dy agentë të regjimit të mbretit, të veshur civila, trokitën në mëngjez herët në derën e zyrës sekrete. Por shefi ishte vonuar. E kishte thirrur ministri i Punëve të Brendshme. Kur u kthye, i gjeti në hyrje të zyrës së tij. Ministri e kishte qortuar keq për informacionin jo të rregullt lidhur me «rrezikun bolshevik» në Shqipëri, aq më tepër për infeksionin në shkollat e mesme të kryeqytetit.

— Dhe i thoni vetes «të karrierës»! Atëhere kur bën mu e dëgjojmë të gjithë, por marifeti është ta nuhasësh para të tjerëve, t'ia lexosh mendjen atij tjetrit, t'i vësh gishtin e ta zësh për gryke!

Dy spiunët mbetën gojëmyllur, me sytë mbi dosjen blu që e sollën nga zyra e ministrit.

— Nuk ka kohë për llafe! Brenda ditës kërkoj prej jush listën e nxënësve me ndjenja bolshevike!

Dy spiunët dolën si minjtë, njëri pas tjetrit. Edhe qarkkomandanti i xhandarmërisë së Tiranës ishte tërë nerva. Ai shkoi te shefi i zyrës sekrete. Sa dualën dy spiunët, e gjeti shefin me kokën e futur mes dy duarve.

— Edhe ti, me ata xhandarët tuaj «na e zbardhe faqen!» — iu drejtua shefi qarkkomandantit dhe lëvizi kokën me keqardhje, duke treguar me këtë, pakënaqësinë e tij.

— Analizat i bëjmë më vonë, zoti shef. Të shikojmë ç'kemi përpara...

— Ja, ç'kemi përpara! Nën hundët e tua, bolshevikët s'duan t'ia dinë se jemi gjallë! Nxënësit janë bërë të tërë bolshevikë! Kudo vazhdojnë të futen libra të ndaluara në Shqipëri. Kjo është më e rrezikshme se sa veprimtaria e disa njerëzve. Se njerëzit i ndjek e i shikon me sy, ndërsa librat i fsheh me njëmijë mënyra. E di ti se ç'kishin bërë këta të pafetë, nxënësit? Librave bolshevike u kishin vënë kopertinat e librave shkollore! Pastaj, çfarë ka libri e fusin në tru dhe eja i lexo mendjen tjetrit!

Shefi i zyrës sekrete ishte shumë i indinjuar. Një cehre e zezë i kishte rënë në fytyrë. Ndërsa qarkkomandanti i xhandarmërisë, me trupin e ngja-

llur e me fytyrën si të pickuar nga bletët, nuk ndjente ndonjë shqetësim të madh nga fjalët e shefit.

— Qenkeni i alarmuar shumë, zoti shef, — dhe qeshi duke shtrirë trupin si buall mbi kolltuk. — Po unë këtu i kam këta çiliminj, — dhe hapi e mbylli pëllëmbën e dorës. — Kur të dua, ua nxjerr gur-mazin! Ja emrat e nxënësve me ide komuniste! — dhe e hodhi listën mbi tavolinë, sipër dosjes blu.

Shefi vuri syzat. Përbri çdo emri ishin shënuar edhe gjeneralitetet. Lexoi emrat me radhë. Ndërmjet tyre shqiptoi edhe emrin e Nazmi Rushitit dhe murmuriti i zemëruar: «Njerëzit e mësuar janë varri i mbretërisë».

...Edhe drejtori i shkollës kishte rënë në gjurmë të Nazmi Rushitit, po mbajti rezerva që mos të «diskreditonte shkollën para autoriteteve...» Ai kishte vënë re se pikërisht ky djalë i imët e thatim, kishte sharë mbretin... Dhe nuk gabonte drejtori. Kështu ishte: një ndër autorët e turbullirave ishte edhe Nazmi Rushiti.

— Këto punë rregullohen shpejt, — ndërhyri shefi. — Tani t'i japim fund! Shkollarët të jenë nën vështrimin tonë.

Kështu, para se të mbyllej viti shkollor 1935-1936 drejtorisë së gjimnazit dhe teknikes, u vajtën listat sekrete të nxënësve «turbullues». Një ndër ta ishte edhe Nazmi Rushiti, në vitin III të kursit të ulët, i cili, bashkë me ca të tjerë, u transferuan në Gjimnazin e Shkodrës.

MIDIS SHOKËVE TË KLASËS

— ... Ne nuk jemi vetëm shokë shkolle, por...
— ... Sekret i është i domosdoshëm.
— ... Përsëri ky mësues i mërzitshëm?
— ... Futin në shpirtin e rinisë vetëm frikën e mendimit të lirë e përparimtar...

— Ohu, dhe ti. Ç'më zë në gojë mësimit...

— Papunësi...

— Duan vetëm policë e shërbëtorë të bindur...

Këto shprehje e diskutime të shkëputura vinin deri te Nazmiu, ndonëse me zë të ulët e të thellë nga tre nxënës që rrinin kokë më kokë, pak më tej, në fund të oborrit të gjimnazit në ditët e para të shtatorit të tridhjetegjashtës, në Shkodër. Këto i bënë shumë përshtypje Nazmiut.

«Mos janë shokët? Kush tjetër mund të flasë me një gjuhë të tillë? Ja, ai me syza. Pastaj, edhe ditët e tjera vetëm bashkë rrinë» — thoshte me vete.

Në sfond të hyrjes së gjimnazit një grumbull i madh nxënësish flisnin e qeshnin me të madhe. Këta ishin bijtë e bajraktarëve dhe të tregtarëve. Nazmiu i shikonte me neveri. Shumë u mërzit ato ditë. Mendohej të ishte i lumtur, por ndjente një boshllëk të madh në krahëror. Mbi të gjitha e mërziste vargu i këmbanave të kishave dhe thirrjet nga

minaretë e xhamive që i mbanin ison jetës së padrejtë.

Sa herë që shkonte në konviktin «Malet tona», i ndjente këta tinguj të trishtuar që jehonin e therrnin plot brengë zemrën e Nazmiut. Atëhere fytyra i vishej me një pamje zemërimi. Dhe ashtu, i nisur nga pasioni, për t'u hyrë sa më thellë gjërave dhe për të zbuluar e për të kuptuar çdo problem shoqëror, gjente cakun e fshehtë në sallën e studimit dhe lexonte. Emin Durakut, Hajdar Dushit, Sadik Bekteshit dhe shokëve të tjerë u bëri përshtypje qëndrimi i këtij dibrani. Krah për krah, biseduan me zë të ulët:

— Ai dibrani që ka ardhur nga Gjimnazi i Tiranës, duhet të jetë yni, — e hapi fjalën Emini, duke kërkuar në këtë mes edhe mendimin e shokëve.

— Me të vërtetë, edhe mua më ka rënë në sy temperamentin e serioz të tij.

— Çdo ditë e kam vënë re në sallën e studimit. Më duket se lexon literaturë «të ndaluar». Pardje ishim bashkë, apo jo Sadik? Ai lexonte e vërente anash, se mos e shikonte njeri.

— Ne na sodiste me dyshim.

— Unë mendoj që Sadiku «ta zbulojë» e t'i shfaqet atij. Edhe ai na kërkon ne...

— Në gjurmë, them se na ka rënë, por nuk ka gjetur rastin.

* *

Të nesërmen, Sadiku u fut në sallën e studimit të konviktit. Menjëherë i zunë sytë Nazmiun. U ul përballë tij. Nazmiu nuk ia ndante sytë e mprehtë

e të shkathët shokut. Ai kapte çdo lëvizje dhe vinte buzën në gaz.

«Zemrat na flasin, goja hesht» — mendoi Nazmiu. Sadiku u afrua.

— Ç'e ke atë libër, Nazmi? — guxoi i pari e foli Sadiku, ndërsa sytë takuan mbi kopertinën e librit «Komunistë e proletarë» të Manifestit të Partisë Komuniste, shkruar në italisht.

Nazmiu i shikonte me sy hetues. Një gëzim të madh ndjente. Ndërkaq u afrua dhe Emini.

— Po lexoj një libër, — foli Nazmiu, duke ndjerë një gjallëri në tërë qenien e tij. — Ja, se ç'thotë, — dhe ua afroi edhe më tepër broshurën gjithë nënvizime me laps të kuq.

Ata vështruan njëri-tjetrin si të qenë zënë ngushtë dhe qeshën. Dy shokët deshën ta nxirrnin gëzimin e fshehtë, ta përqaфонin fort Nazmiun, ashtu si edhe ky ata. Por brenda në sallë u futën duke përplasur derën Mëhilli e Marku. Sadiku ia bëri me sy Nazmiut, si të desh t'i thoshte: «Të ndaloj çdo bisedë me ta! Nuk janë tanët!». Mëhilli e Marku hodhën një vështrim mospërfillës e kapadai nëpër sallë. Salla ishte e madhe. Vetëm tre nxënës i jepnin shpirt asaj. Por Mëhillit e Markut iu duk plot, sikur të gjitha bangat ishin të zëna e për ta nuk kishte mbetur asnjë vend. Prandaj bënë menjëherë prapaktheu.

— Po këta, çfarë i gjeti? — pyeti Nazmiu, pak i habitur.

— Siç duket, e kemi hijen e rëndë për ta! — foli shpejt e shpejt Emini.

— Ka ca ditë që sillen si të çartur, sikur nuk i mban toka, lëvizin sa andej-këndej!

— Mos kërkojnë të kurdisin ndonjë lojë?

Nazmiu e kuptoi se ata ishin «spiunët e mbretit», siç i cilësonte ai. Shoqëria midis tre shokëve u lidh e pathyeshme.

*

* * *

Ata kaluan pranë shtëpive të varfanjakëve. Nazmiu ecte mes shokëve.

— Ne ende duhet të thellohemi në studimin e literaturës marksiste. Dhe këtë literaturë duhet ta propagandojmë, sigurisht, aq sa na lejojnë kushtet. Kështu porosiste vazhdimisht edhe Qemal Stafa, — foli ndër të tjera, Sadiku.

Qemali në verën e vitit 1936 u largua familjarisht nga qyteti i Shkodrës, por në gjimnaz ai kishte lënë gjurmë revolucionare dhe shokë besnikë, me të cilët mbante lidhje.

Ata ecën një copë herë pa folur. Dy «gushëkuqë» u kaluan pranë. Njeri tjetër nuk lëvizte andej. Syri i spiunit i ndiqte.

— Edhe herë të tjera kemi rrahur mendime për shoqërinë «Besa», por tani ka ardhur koha të veprojmë, — kaloi në një çështje tjetër Nazmiu.

Ata bashkë me shokët e tjerë të konviktit «Mallet tona» ishin të gatshëm të bënin çdo sakrificë për hir të drejtësisë së ideve të tyre.

— Ç'do të bëjmë më tej? — kërkoi Emini, ashtu siç kërkonin edhe shumë konviktore të tjerë për të ecur drejt përparimit.

— «Besës shqiptare» t'i japim karakter politik. Atëhere idetë tona do të gjejnë një terren më të favorshëm, — foli i entuziazmuar Hajdari.

— Kryesorja është kalimi në veprime të hapura! — ndërhyri Emini.

— Vallë, a do ta gjejmë plotësisht përkrahjen e «Besës»? — pyeti Hajdari.

— S'ka gjë po nuk e bashkuan zërin të gjithë menjëherë. Kjo është e natyrshme. Me përpjekje të përbashkëta gjithë «Besën» do ta bëjmë tonën, — iu drejtua Nazmiu Hajdarit.

Nata ra. Të katër gjimnazistët vazhdonin diskutimet me zë të ulët.

Në këto rrethana filloi rritja e ndërgjegjes politike revolucionare tek gjimnazistët. Kjo solli që, pas disa muajsh, më 1936, të formohej celula e dytë komuniste, në të cilën në fillim bënë pjesë Sadik Bekteshi, Nazmi Rushiti dhe Emin Duraku. Atë kohë kriza ekonomike, si një murtajë vdekjeprurëse, kishte përfshirë gjithë vendin me zinë e bukës. Atëhere shpërtheu dhe kryengritja antizogiste e Fierit, demonstrata e bukës në Korçë dhe greva e punëtorëve të Kuçovës. Këto ngjarje me rëndësi politike ndihmuan shumë për pjekurinë ideo-politike të shokëve të celulës. Veç kësaj, që në mbledhjen e parë të celulës komuniste, ata shtruan si detyrë të ditës, formimin komunist të tyre, me anën e literaturës marksiste-leniniste. Gjithashtu i vunë detyra vetes për shtimin e radhëve të celulës, shndërrimin e «Besës shqiptare» në një organizatë politike përparimtare dhe domosdoshmërinë e konsipracionit për jetën e celulës.

Studimi ilegal. . .

Nazmiu e mbylli librin, kur shkronjat filluan të mos dukeshin më nga errësira. E rikujtoi edhe njëherë kapitullin, duke e ngulitur mirë në kujtesë.

— Emin, ke edhe shumë?

— Edhe një paragraf dhe mbarova, — dhe përsëri Emin, me dorën e mbështetur mbi ballin e tij, vazhdonte të gërmonte mbi rreshta. — Ku është kapitulli i fundit i librit?

— Çudi është me këto libra, Nazmi, — vazhdoi Emin. — Për herë të dytë po lexoj «Vlerën dhe mbivlerën» dhe tani më duket krejt ndryshe nga leximi i parë.

— Eh, mor Emin, ke ecur përpara ti, ke ndryshuar, je zhvilluar, je rritur. Këto vepra do të të duken të reja, edhe sikur t'i lexosh mbas shumë vitesh... Sa herë që të lexosh Marks, aq gjëra të reja do të gjesh.

Një rropatje këmbësh, që ecnin serbes, u dëgjua nëpër korridorin e shkollës. Ata i fshehën shpejt librat.

Kur dera u hap, në të u duk Sadiku, me trupin e tij si lis. Dy shokëve iu çel fytyra. Ata u përshëndetën me njëri-tjetrin e që të tre u afruan te dritarja e klasës. Shpesh rrinin në atë vend dhe zbraznin ëndërrat dhe zemrat e njëri-tjetrit.

— Ç'kemi ndonjë të re në këtë Shkodër-loce, Sadik?

— Asgjë?

Në këtë kohë Hajdari me Xheladin Hanën e Spason dredhuan rrugën para bashkisë së qytetit dhe u dukën në oborrin e gjimnazit. Ishte errët. U desh një vërshëllimë që të merreshin vesh.

— Mos kanë qenë te Vasili?

— Mundet.

Zëri i Hajdarit dhe Xheladinit, që bënë ballë te dera, i shkëputi nga dritarja.

— Ku jeni bre, shqiponja! — thirrën të dy

njézëri, Sapo dera u puthis, filluan të recitonin vargjet e para të «Internacionales».

— Po melodinë? — u thanë shokët.

— Edhe atë e dimë, — dhe të dy, ia filluan ngadalë, mes errësirës së klasës.

— Ku e morët?

— Atje, ku i marrim të gjitha.

— Vasili na tha që të përshëndesim «djaloshin zemërbutë e me vullnet të çeliktë». Kështu i thoshin me dashuri Nazmiut.

Ato ditë Vasil Shantoja kishte ardhur në Shkodër.

Na njoftoni përfundimin

Prefektit të Shkodrës i dilte avull nga koka. Sytë e tij kishin kohë që ishin mbërthyer mbi shkresën e ministrit të brendshëm Musa Juka, me të cilin kishte biseduar edhe në telefon pak orë më parë. E rilexoi kushedi për të satën herë shkresën:

«10 mars 1938. Tepër sekret».

«Informoheni se disa nxënës të gjimnazit aty, nderojnë njëri-tjetrin në mënyrë bolshevike. Lute mi na dërgoni hetime më të imta dhe të përpikta për këto pika. . .»

Ndërsa sytë i mbante mbi shkresën «tepër sekret», mendja i shkoi te biseda rezervate që kishte bërë me drejtorin e nëndrejtorin e gjimnazit dhe me komandantin e xhandarmërisë.

— Ju të treve u janë mjegulluar sytë dhe nuk e meritoni rrogën e majmur që ju jep lartmadhëria! Dëgjoni? — u kishte folur ashpër në fund të bisedës. — Në Shkodër, bolshevikët bëjnë një propa-

gandë të gjerë kundër monarkisë dhe mbretit! Edhe lartmadhërisë së tij, mbretit, i ka rënë në vesh përsëri një gjë e tillë! Ai është shprehur dhe gjithmonë shprehet se rreziku më i madh për ne është rreziku komunist! Prandaj të përdoret çdo masë e metodë për të shfarrosur këtë farë...»

«Ndërsa kjo ka mbirë dhe po rritet» — foli me vete prefekti, dhe buzët iu paltuan nga një nënqeshje e hidhur.

Të gjithë nëpunësit e lartë të qeverisë reaksionare zogolliane, me gjithë levat e superstrukturës së saj burokratike, bënë çmos që këto ide komuniste t'i ndalonin. Ata ishin në dijeni për veprimet «jo të ligjshme» të nxënësve dhe tani Musa Juka mundohej të stabilizonte turbullirat e brendshme që sillnin «bolshevikët».

«Rebeli» para drejtorit

Sadiku me Hajdar Dushin e kishin futur në mes Nazmiun.

— Kështu, pra, ruaju e mos dil haptazi. Nuk e ke vënë re si shikojnë ata «miqtë» me bishtin e syrit? Të panë shumë mirë kur nderove bolshevik-ge në mes të korridorit të shkollës.

— Ata hiqen si shokë, por janë spiunët më të fëlliqur të mbretit! — vijoi më tej Sadiku.

— Si?! Deri në këtë batak të qelbur të kenë hyrë Ndoci e Marku? — qëndroi në vend Nazmiu, i habitur.

U mendua një hop. Një gjë të tillë ata e kishin diskutuar edhe në celulë.

— Po, po... Kjo nuk duhet të na çudisë, —

shtoi pastaj sikur t'i përgjigjej vetes Nazmiu. — Ata nuk mund të pranojnë rrugën tonë. I përkasin një klase tjetër! E cilët do të mbrojnë ata: mua, ty, shokët tanë të klasës? Ata do të mbrojnë klasën e tyre!

— Ashtu është, klasën e vet, klasën e pasur.

— Po ata në fillim sikur u lidhën me ne! A ju kujtohet mbledhja e «Besës»? Sa shpejt rrëshqitën në duart e spiunëve! — foli Hajdari.

— Mor vëlla, s'ka hajër populli e atdheu prej tyre! Lenini e ka provuar kur thotë se bazën bolshevikët e vërtetë e kanë te proletariati dhe të fshatarët e shtypur, — e mbylli fjalën Sadiku.

Në këto fjalë, Emini doli nga dera e madhe e gjimnazit.

— Nazmi Rushiti!

— Kush e kërkon? — u bë kureshtar Sadiku.

— Drejtori, — u përgjigj portieri i shkollës.

Xhandarmëria kishte informuar me kohë drejtorinë e shkollës që t'i këshillonte e t'i mbante afër këta nxënës «me prirje bolshevike».

Nazmiu u shtrëngoi duart shokëve dhe hyri në ndërtesën e madhe e të ftohtë të gjimnazit. Shtyu derën e zyrës së drejtorit dhe sakaq, u gjend para tij. Edhe këtë herë, ai i përmendi këshillën e tij të «urtë», që i kishte dhënë më parë për t'u shoqëruar vetëm me nxënës që «donin e nderonin mbretin e atdheun».

— Nuk e kuptoj, zoti drejtor, ku rrihni?

— Ku rrah? Pse nuk e kupton ti se sjelljet e tua nuk janë sjellje të mira politike? Së paku, a nuk e kupton se je ende i ri dhe me këto mendime dhe ide që ke në kokë mund të biesh në grackën e disa nxënësve me mendime të gabuara e të dëmshme?

Nazmiu e kuptonte drejtorin, por kërkonte gjuhën e Ezopit.

— Ti ke nderuar bolshevikçe kundër parimeve të qeverisë, — vazhdoi tani i revoltuar drejtori. — «Besën» e keni kthyer në një vatër nga ku propagandoni idetë komuniste!

Drejtori i hodhi një vështrim përbuzës e flakërues.

— Këto veprime nuk lejohen, kupton ti? — dhe ngriti gishtin lart. — Ty të duhen vetëm mësimet. Diskutimet me disa rebelë janë të ndaluara. Këto ngulli mirë në tru! Kupton?

«Po ç'kërkon të thotë me këto fjalë? Kërkon që të më kërcënojë?» — mendoi Nazmiu, dhe pastaj ngriti zërin:

— Vetëm mendimet nuk mund të na i ndaloni, zoti drejtor!

— Unë s'kam ndër mend të humbas kohë me një nxënës të pabindur e kryeneç! Këshillat e mia morën fund!

— Zoti drejtor, faleminderit, por ai që ka spiunuar nuk është vetëm armiku im, por i gjithë popullit dhe i atdheut!

— Nuk të kam thirrur të më bësh moral! — u çua në këmbë drejtori.

— E kam më se të qartë. Morali ynë ju tremb juve, zoti drejtor!

— Si guxoni?! — thirri drejtori me sy të çakërritur dhe sakaq grushti i tij u përplas me forcë mbi tavolinë. — Rebel!

Nazmiu nuk e prishi gjakun. Tek vërejti fytyrën e zbardhur të drejtorit vuri pak buzën në gaz, gjë që e revoltoi edhe më shumë këtë të fundit.

Shokët e përgëzuan për këtë qëndrim burrëror e guximtar.

Te kalaja

Marsi i tridhjetetës po largohej. Në sallën e studimit të konviktit «Malet tona» nuk lëvizte njeri. Vetëm Nazmiu kishte tretur vëmendjen mes radhëve të «Buletinit jeshil» të grupit komunist. Tom Kola trokiti në dritare. Nazmiu lexoi dhe një herë ato tri fraza të buletinit, prej të cilave kishte vendosur tri pikëpyetje dhe doli.

Në oborr e priste Esat Gjyli me Tom Kolën.

— Për ku nxitohesh? — i thanë ata.

— Në Serreq...

— Jo, — i thanë, — në rrugicën e shtëpisë së Ndoc Mazit janë sjellë «gushëkuqët». Sadiku me shokë na pret te kalaja.

Celula komuniste në gjimnaz që në vitin 1937 nuk mbyllej vetëm në guackën intelektuale, por aktiviteti i saj shtrihej edhe tek punëtorët, shëgertët, zanatçinjtë. Komunistët ishin të bindur se pa një lidhje të tillë nuk mund të përhapej teoria revolucionare. Në fillim komunistët u lidhën me ata punëtorë e artizanë që kishin qenë nxënës të gjimnazit dhe, për arsye ekonomike, e kishin lënë shkollën.

— Ç'na thua? Si shkojnë punët?

— Po shëtisja me Tomën. Ca turistë italianë sillen Shkodrës sonë.

— Turistë? — qeshi hidhur Nazmiu. — Ata, vëlla, shiten si turistë. A e kuptoni, vëllezër, se mbreti po na e shet vatanin? — dhe psherëtiu si t'i kishin rënë një e keqe e papritur. — E lakmojnë Shqipërinë tonë, se në gjirin e kësaj toke ka zift, naftë, krom, e ç'nuk ka....

Ata e lanë oborrin e konviktit. Dikush i kaloi

pranë dhe e çiku në bërryl. E njohën shokun e shëndetshëm, ezmer e flokëkaçurrel me një xhaketë punëtori me arna.

— Tungjatjeta! — përshëndeti Naim Gjylbegu me atë natyrë të çelur e të matur.

— A je lodhur? — e pyetën duke i shtrënguar duart e nxira e të trasha nga puna. Ai në mbrëmje linte punën dhe nuk kalonte rrugëve e kafeneve, por takohej me Nazmiun e shokë të tjerë të celulës.

— Shumë, besa. Po jetojmë si qeni, — u ankua ai.

— Nuk duhet të vajtojmë vëlla. Punëtorja duhet të kuptojë përse rrojtja jonë është si e qenit.

Nazmiu nxori ca fletë si të vjetra nga përdorimi i tepërt dhe të zhubravitura dhe ia dha Naimit.

— Ku i ke fletët e fundit?

— I kanë në dorë ca shokë punëtorë.

Kjo broshurë ishte «Zhvillimi i shoqërisë», që celula e qarkullonte jashtë gjimnazit.

Rrugës takuan tre punëtorë. Njëri, i dëshpëruar, pushonte i mbështetur mbi kazmë.

— Është Fahriu ai, Fahri Ramadani. Po i bëj shenjë që të na vijë pas, — tha Esati dhe bëri në një anë.

Buzë liqenit i priste Sadiku me një grup tjetër.

Jovan Thanasi ecte krahas Nazmiut dhe Esatit. Atë e kishte lidhur me Nazminë Vaso Kadija. Jovani ishte autokarrociër. Shpesh nuk e nxirrte bukën e ditës. Tek dëgjonte Sadikun, jetonte me përfytyrimin e së ardhmes së bukur. Por shpirtin ia cimbiste papunësia.

— Punë, a do të ketë? — pyeti Jovani sikur të zgjohej nga një ëndërr e lumtur.

Nazmiu i futi krahun dhe i foli me shpirtbutësi:

— Të drejtën e punës do ta gëzojnë të gjithë, vëlla, të drejtat shoqërore, klasa jonë do t'i nënshkruajë dhe do t'i bëjë ligje. Fëmijët tanë nuk do të ndërprejnë shkollën për bukë, siç u detyrove ta braktisësh ti e shumë të tjerë.

Jovani tha:

— A e di, vëlla, unë i vdekur shtrihem e zotni-ve nuk u nënshtrohem. Servilizmin s'kam për t'ia lejuar vetes!

Në një rrip lëndine, mes mureve të kalasë, pushuan. Bari i butë e njomzak kishte buluar i dendur e kishte jeshiluar muret e trasha. Nazmiu vërente i kënaqur se sa përshtypje u bënte ky takim aktivistëve.

Si dëgjoji përgjegjësën e celulës dhe komunistët e tjerë, Qazim Llazani, i ndezur nga zjarri i diskutimeve, sikur u zotua me ato pak fjalë revoltuese:

— Edhe ne shegertët do t'ua tregojmë gjakpirësve me mbretin në krye se jemi njerëz...

Atë e përkrahën Halit Bajraktari me Esatin.

Mbrëmja po afrohej. Në portën e kalasë hynë fshehtazi tre bij bajraktarësh.

Grupi bëri sikur u shpërnda. Nazmiu eci i vetmuar. Tom Kola i vajti pas. Ai ushqente një dashuri e konsideratë të veçantë për Nazmiun, se ai ishte edukatori i parë i tij dhe i disa shokëve të tjerë. Prej disa ditësh Tomën e mundonte diçka që donte t'ia shfaqte Nazmiut. Tani sikur iu krijua rasti e i tha pa ndrojtje:

— Nazmi, ne idetë dhe qëllimi na lidhën e u bëme shokë të besës...

Nazmiu e pa në dritën e syve me një ngrohtësi e dashuri që s'e kishte parë ndonjëherë. Ai e kuptoi ç'dëshirë i vlonte përbrenda.

— Po, Tom, ashtu. Ty, a ta do zemra, vëlla, të jesh... komunist?

Tomit sikur i buroi nga sytë e zinj e të shkathët një dritë lumtërie.

— Jastë ideve tona nuk e dua jetën, vëlla. Jetën ia fal idealit që ma mbolle ti në zemër! Prandaj zemra më thotë të jem bash në radhë...

Nazmiu i përmendi sakrificat dhe konspiracionin që u diktonin kushtet.

— Sakrifica edhe me jetën, fshehtësia dhe disiplina e çeliktë, janë tiparet e komunistit, Tom. Edhe sikur një ditë njerëzit e mbretit do të të lidhin dhe ta djegin mishin me hekur të skuqur, shokët nuk do t'ia japësh xhelatit, se minohet çështja jonë. Gju-njézimi para armikut është tradhëti, Tom.

Toma e dëgjonte me vëmëndje.

Me ta u bashkuan dhe anëtarët e celulës. Sadiku e pyeti duke lëvizur kokën. Nazmiu e kuptoi dhe i tha:

— Një yll më shumë!

Si ra nata, ata zbritën nga kalaja të gëzuar e kre-narë.

Kështu radhiti Nazmiu me shokë sa e sa të rinj në gardën e revolucionit.

ARRESTIMI

Qarkkomandanti dhe disa xhandarë, me një hije të rëndë ushtarake u futën në konvikt, duke mos ua vënë veshin fjalëve të nxënësve që i ndiqnin nga pas.

«Cilët janë fajtorët? Kush i turbullon ujërat? Cili është iniciatori?» — këto pyetje rrihnin si çekan mbi kokën e qarkkomandantit, ndërsa gjuante me sy ujku atë «dibranin kokëfortë». Erdhën edhe disa xhandarë të tjerë. Qarkkomandantit ia zunë sytë Nazmiun dhe i doli përpara si ndonjë mullar.

— Ku e ke valixhen?

Nazmiu e drejtoi për në dhomë ku mbante valixhen. Një kapter i gjatë e i hollë, me një fytyrë që të kujtonte ndonjë kufomë, hapi valixhen. Vetëm një këmishë dhe ca fletore shënimesh gjetën. Duke kontrolluar me imtësi, sytë e tij ndeshën mbi kapakun e një fletoreje.

— N-ga-Në-na.... — mezi mundi të lexonte me zë të lartë.

Qarkkomandanti e mori fletoren dhe filloi ta shikonte me dyshim. E peshoi mirë e mirë në dorë, sikur nga pesha e saj të varej edhe rreziku. Pastaj filloi ta hapte me kujdes. Në faqet e para ishin shkruar me kujdes paragrafe nga gjyqi i Pavël Vllasovit. Si

lexoi disa rreshta, mbylli fletoren dhe e futi në xhep. Pastaj u mendua një çast. Shikoi nga Nazmiu, i cili gjatë gjithë kësaj kohe mbante një qëndrim të qetë dhe mospërfillës.

— Ku i ke librat?

— Çfarë librash, zoti qarkkomandant! Ju kontrolluat, — u përgjegj Nazmiu.

— Këto fotografi, të kujt i ke?

— Të shokëve.

— Paske shumë shokë ti, kështu?

Nazmiu e kuptoi se ç'kërkonte të nxirrte nga kjo pyetje, prandaj heshti.

Në dhomë sundoi heshtja.

«Kështu, në të parë, duket i padjallëzuar qerratai! — mendoi qarkkomandanti. — Por sidoqoftë, pa atë krimbin e bolshevizmit, nuk është ky dibran... Nuk është pa të, jo!» Fill mbas këtyre mendimeve, u kollit fort, si të desh të provonte zërin nëse e kishite në rregull, shkundi pak trupin e tij që iu duk si i mpirë dhe urdhëroi:

— Jeni i arrestuar! Para!

Në të dalë të konviktit «Malet tona», kur Nazmiut po i vinin hekurat, dy nxënës disfatistë dhe prozogistë, bij bejlerësh e tregtarësh, thirrën me zë të lartë: «Hop, kapteri!». Nazmiu u hodhi një vështrim tërë urrejtje dhe përbuzje. Po atë natë Adil Çarçani, Bardhok Biba, Sul Baholli me shokë, si përgjegje të ndodhive të asaj dite, shkruan në disa fletë: «Shokët tanë do të kthehen», dhe i vunë ato në vendet më të dukshme. Askush nuk mbeti pa i lexuar. Askush nuk guxoi t'i griste.

Nazmiu e disa shokë të tjerë duarlidhur i çuan në burgun e qytetit dhe i mbyllën në një dhomë

përdhese gjithë lagështirë, ku kundërmonte erë e qelbur. Nazmiu dëgjoi zhurmë, të qeshura dhe këngë.

— Shiko, shiko! Paskan zënë edhe Nazmiun!

— Pa shikoni! Emini, Sadiku... edhe të tjerë!

— Mor shokë, po si shumë spiunë paskemi patur në mes tonë! — dëgjoheshin zërat e shokëve të arrestruar para tyre.

Filluan të përqafoheshin me njëri-tjetrin, sikur të mos ishin takuar prej kohësh.

Më tutje, në një qoshe të qelisë, tre-katër nxënës ishin shtrirë të pikëlluar. Ata kishin bërë fjalë se gjoja «ishin marrë më qafë kot» dhe se «kishin gabuar që ishin përzier me politikë».

— Na paçi më qafë! — kishin shfryrë më në fund, kur kishin parë se askush s'kishte çarë kokën për ta, dhe ishin shtrirë përtokë.

*

* * *

— Kështu, mor djalë, duhet t'ia dini mbretit që ju dha shkollën, e jo të ngrini dorën kundër tij e monarkisë! Si thoni?

— ???!!...

— Vetëm pak gjë kërkoj prej teje: cilët janë të tjerët? Kush i organizon? Këto janë në interesin tënd! Hë, si thua? — priste përgjegje qarkkomandanti.

— ???!!...

— Mos kujto se ne nuk e dimë. I dimë të gjitha. Emrat e të gjithëve i kam këtu në dosje.

— Kur i ditkërkeni, ç'kërkoni prej meje, zoti qarkkomandant? — hapi gojë më në fund Nazmiu.

Qarkkomandanti ndjeu se po inatosej. Mbas shumë pyetjesh të tjera, kërkoi:

— Përse nuk rri rehat, mor djalë? Ti dhe shokët e tu, që ende i keni buzët me qumësht, kërkoni të haheni me mbretin?

Nazmiu vazhdoi përsëri të heshte.

— Hajt, folë! Mos më rri si memec këtu! Jeni mësuar të shisni mend ju, nxënësit! Cilët kanë ide komuniste në gjimnaz?! — thirri qarkkomandanti, duke u munduar të bënte presion psikologjik.

— Ata që luftojnë këtë rend, rendin që ruani ju! — foli Nazmiu.

— E pra, kush... cilët janë këta që luftojnë këtë rend? — e sqaroi edhe më tej pyetjen, duke pritur me padurim pohimin e këtij djaloshi kokëfortë.

— Janë komunistët! — ngriti zërin Nazmiu.

Kjo përgjegje e tërboi edhe më qarkkomandantin. Filluan torturat mbi trupin e njomë të Nazmiut. Qarkkomandanti ishte më se i bindur se torturat do të bënin që të hapej goja e këtij djali të dobët e të imët. Por Nazmiu nuk u dha.

*

* *

E përplasën në qeli, tek shokët. Përgëzimet e tyre për qëndrimin e tij, sikur ia lehtësuan dhimbjen e plagëve. Në qeli nuk kishte qetësi. Disa diskutonin probleme shoqërore e politike, të tjerë këndonin. Njëri prej tyre filloi të citonte poezinë e Migjenit «Të bijt' e shekullit të ri» të shkruar në një letër të zhurbatur. Diksioni i tij i pastër dhe zëri gjëmues, bëri që në qeli të vendosej qetësia. Kjo poezi sikur i dha

krahë këngës së «Internacionales», e cila shpërtheu gjithë vrull prej gjokseve rinore:

*«Ngrehuni ju, o të munduar,
Ju të urtë, skllevër anembanë...»*

Pas pak, këngën e ndërpreu ardhja e një «rebeli» tjetër. Ishte Ndoc Mazi.

— Shokë, me ju gjer në fund të botës! — thirri ai me lot në sy që tek dera dhe u fut në qeli, i pritur krahëqafë nga shokët.

— Ç'kemi andej nga konvikti? Ç'bëjnë agjentët e Musa Jukës? Ka arrestime të tjera?

— Ç'flitet nëpër qytet? Vetëm në Shkodër ka shpërthyer kjo valë arrestimesh? — pyeti Branko Kadija.

— Flitet se edhe në shumë qytete të tjera ka mjaft arrestime, — foli i porsaardhuri.

— Gjithë popullin nuk mund ta fusë në burg mbreti, jo! — u ndien dy-tri zëra të fuqishëm.

— Kjo do të thotë se në rrugën tonë marshojnë edhe shokë të tjerë nga të katër anët e atdheut!

— Mundohen të mbyllin nëpër burgje stuhinë! Po a mund të bëhet kjo? — e pasoi Ramizi.

Ata e ndjenin veten krenarë që ishin pjesëtarë të kësaj lëvizjeje, të kësaj çështjeje kaq të lartë e të shenjtë.

Burgosja e gjimnazistëve shkaktoi zemërim të thellë në shkollë dhe në masën përparimtare të qytetit të Shkodrës. Veçanërisht konviktorët e konviktit «Malet tona» u ndanë në dy grupe: njëri përkrahëte nxënësit e arrestuar, kurse tjetri, një pakicë, mbronte tiraninë e regjimit.

I p a p ë r k u l u r

Në janarin e vitit 1939, në atë muzg të thellë dimri, kur murlani kërkëllonte rreptë, maqinat e mbuluara, të mbushura «me njerëz të rrezikshëm» kundër regjimit, bëheshin gati të vraponin drejt Tiranës. Nën at dhe baballarët e dëgjuan këtë lajm të hidhur dy ditë përpara se djemtë e tyre t'i largonin nga burgu i Shkodrës për në atë të Tiranës. Për këtë arsye, rruga që ndante bashkinë nga burgu nuk pushonte nga lëvizja dhe rrëmuja e shumë. Thirrjet e xhandarëve për shpërndarjen e tyre nuk mundën të lëviznin asnjëri nga vendi.

Kamionët dolën nga dera kryesore e burgut, duke shpuar errësirën me dritat e tyre. Njerëzit u turrën pas tyre. Maqinat nuk ndaluan. Një zë i fortë nisi «Internacionalen», e cila si një kor i fuqishëm shpërtheu në atë natë të ftohtë janari. Askush nuk u vinte veshin protestave dhe thirrjeve të mërzhitshme e monotone të xhandarëve. Makina e parë e ndaloi pak shpejtësinë. Kënga pushoi. Një grup njerëzish kishin bllokuar rrugën para makinës. Shoferi filloi t'i binte borisë papushim.

— Mirë u pafshim, shokë!

— Qëndroni të papërkulur! — dëgjoheshin thirrjet e atyre që përcillnin shokët, të nënave që përcillnin bijtë, të motrave që përcillnin vëllezërit... Makinat ndoqën njëra-tjetrën, duke uturitur si vajtueshëm, ndërsa nga karrocëritë e tyre përsëri shpërtheu fuqishëm kënga e «Internacionales»...

Në burgun e Tiranës kënga pushoi. Një atmosferë e rëndë lëshoi krahët e vet, kur dyert e rënda të burgut u hapën me një krismë e fishkëllimë çjerrëse. Kjo nuk i bëri përshtypje Nazmiut, sa i bëri rreshti i gjatë i bajonetave. Përkrah tij ecnin Emini dhe Ndoc Mazi. Para tij shkonin Sadiku, Ramizi, Vojo Kushi dhe shokë të tjerë.

Të burgosurit politikë i grumbulluan në tri salla të mëdha. Më tej ishte dhoma e torturave. Bisedat, të qeshurat dhe këngët që këndonin me zë të ulët të rinjtë i dhanë një gjallëri që s'e kishte jetuar burgu i Tiranës.

— Mjaft! — ulëriti me histerizëm oficeri i xhandarmërisë, Stavri Jaho, dhe i rrëmbeu nga dora kërbacën rreshterit që po shoqëronte të burgosurit. Nazmiu kishte rënë përtokë pa ndjenja. Njëri nga xhandarët shoqërues solli një kovë me ujë të ftohtë dhe ia derdhi mbi kokë. Nazmiu erdhi në vete. Mbas pak u ngrit në këmbë. Të gjitha këto u zhvilluan në një heshtje të thellë, në qelinë e ftohtë.

Kapiten Stavri iu afrua. E pyeti për aktivitetin e tij në gjimnaz, por Nazmiu i priti me përbuzje lajkat dhe dredhitë e oficerit.

— Ti je komunist? — pyeti me sytë gjysmë të mbyllura oficeri dhe u afrua edhe më shumë te Nazmiu.

Nazmiu ndjente frymën e tij tek i përplasej në fytyrë dhe erën e qelbur të rakisë që kishte pirë. Sakaq e mblodhi veten. Fjala e xhelatit sikur i përtëriu fuqitë. «Po, jam komunist», — pëshpëriti lehtë, shtrëngoi grushtet dhe mori frymë thellë.

— Jam komunist, zoti oficer! — kumboi pastaj fort zëri i tij krenar, një zë aq i fuqishëm, saqë ishte e pabesueshme që të kishte dalë nga një trup aq i imët e i dobët.

Oficeri u trondit. Sytë iu egërsuan si ndonjë bishë kur merr një plagë të rëndë. Këtë përgjegje kish-te marrë edhe nga disa të burgosur të tjerë komunistë. «Po, po, komunistë, e dimë këtë», — pëshpëriti oficeri i bërë dyllë në fytyrë, ndërsa kërbaci që rrotullonte nëpër duar u përplas me forcë e me tërsëllëm mbi sipërfaqen e tavolinës.

— Shokët! — thirri. — Trego shokët!

— Komunistë ka rritur mjaft populli, zoti oficer. Unë nuk...

Kërbaci nuk e la të mbaronte. Kapiten Stavri, i tërbuar, qëlloi vetë, duke mos lënë rreshterin të vinte dorë mbi të. Nazmiu shtrëngoi nofullat gjithë urrejtje. Oficeri vazhdonte të qëllonte. Mospërfillja e komunistit e xhindoste edhe më tepër.

— Populli një ditë do të hakmerret, Stavri Jaho!

Kapiteni i hodhi kërbacin rreshterit, i cili vazhdoi të qëllonte ku të mundte mbi trupin e Nazmiut, derisa këmisha e këtij të fundit filloi të skuqej nga njolla gjaku.

— Hiqma sysh! — urdhëroi oficeri.

Dy rojet e mbërthyen për krahësh dhe e nxorën nga dhoma e torturave. Vasil Shantoja me Sadikun e muarën në duar. Kur erdhi në vete, vuri re se ishte mes shokësh. Pranë, mbi kokë, i rrinte Qemali, Vasili, Emini, Ndoci, Vojua, Sadiku e Ramizi.

— Nazmi, vëlla! — shqiptoi Qemali këto dy fjalë me respekt e dhemshuri përzier së bashku. — Ne nuk do të nënshtrohemi! Kështu do të triumfojmë në kauzën tonë!

— Kush na ka tradhtuar? — pyesnin njëri-tjetrin.

— Ne duhet të organizohemi, të vigjëlojmë. Atëhere edhe tradhtarët e provokatorët do t'i zbulojmë! — u tha Qemal Stafa shokëve.

Mbas pak ditësh, ata e kuptuan situatën që ishte krijuar. Krerët tradhtarë të grupit komunist Niko Xoxi dhe Zef Mala ishin dorëzuar përpara torturave. Ata kishin denoncuar shokët më të mirë. Nazmiu me shokë u bashkua me Qemalin dhe Vasil Shanton për demaskimin e krerëve tradhtarë. Zakonisht, në mbrëmje, kur vendosej pak a shumë qetësia dhe kishte pak lëvizje, ata diskutonin dhe rrihnin mendime nga më të ndryshmet. Në burg, celula komuniste, ku bënte pjesë edhe Nazmiu, u organizua përsëri dhe u përgatit për aksionin e gjyqit.

GJYQI ZOGIST

Grupe të rinjsh me jaka xhaketash e pardesysh të ngritura për të mbrojtur veshët nga acari i asaj dite, lëviznin poshtë e lart para bashkisë së Tiranës. Zemërimi dhe urrejtja ishin ngulur në zemrat e tyre. Kur maqinat sollën të shtatëdhjetë e tre të burgosurit, vala e zemërimit shpërtheu. Dëshën të futeshin edhe ata në sallën e gjyqit. Por bajonetat e ftohta e të shndritshme të xhandarëve ruanin «rendin» e bashkisë.

— Ja, i sollën, — u dëgjua një zë nga turma.

— Cili do të jetë ai mbas Qemalit dhe Vasilit?

— Qemal Stafa me Vasil Shanton ishin të lidhur bashkë me një zinxhir.

— Përderisa nuk i ndahen njëri-tjetrit, e kanë emrin e tyre... Janë komunistë, — u përgjegj një tjetër.

Dy të tjerë, që e dëgjuan pyetjen e të panjohurit, u afruan pranë tij dhe sqaruan jo pa njëfarë krenarie:

— Ai mbas Qemalit është dibran!

Këta dy të rinj ishin Irfan Hajrullai dhe Demir Gashi.

Sheshi para bashkisë sa vinte e po mbushej me njerëz. Edhe pse ishin jashtë, në erën e ftohtë që u

rrihte fytyrat, ata prisnin me padurim e gjithë kuresh-tje ndonjë fjalë nga salla e gjyqit. Dy shokët vunë re se mbas nxënësve, punëtorëve dhe zanatçinjeve të arrestuar, u futën një nga një e gjithë kryelartësi, disa oficerë të lartë e zyrtarë të besuar të mbretit. Vargu i gjatë i xhandarëve këputej aty ku bënëin ballë këta funksionarë dhe, sa kalonin ata, lidhej përsëri. Pastaj, anëtarët e trupit gjykues, gjithë delikatesë, thujse po ecnin mbi dërrasa të kalbura, pa këmbyer asnjë fjalë me njëri-tjetrin, me fytyra të ngurtësuara e të errëta, me një hije të rëndë prej ushtarakësh, u futën në derën kryesore të Bashkisë.

Gjatë ditëve që u zhvillua gjyqi, populli nuk u largua nga sheshi para bashkisë. Sa herë që dilnin bijtë e tij nga gjyqi për në burg, populli i pëshëndeste. Disa prej tyre ngrinin edhe grushtet. Një ditë Irfani dhe Demiri qëndruan pranë portës nga do të dilnin shokët. Xhandarët, me trupat e tyre të gjatë të bërë gardh i pengonin ata të shkëmbenin së paku një shikim apo buzëqeshje. Po ja, një ditë, një xhandar para tyre kapi për zverku një nxënës që thirri:

— Vëllezër! Mbroni me guxim bindjet tuaja!

Mes kësaj zhurme, Irfani dhe Demiri ngritën grushtet lart kur panë Nazmiun duke dalë mbas Vasil Shantos e përkrah Emin Durakut dhe shokëve të tjerë. Nazmiu i vuri re dy shokët dhe i përshëndeti me një lëvizje të kokës. Duart i kishte të lidhura me pranga. Dy shokët iu fshehën syve të egër të xhandarëve e spiunëve, në kohën kur këta po merreshin me nxënësin demonstrues.

— Ja burimi i forcës sonë, shokë, populli! — u tha Nazmiu Eminut e Sadikut, kur vuri re turmën që po i shikonte gjithë dashuri e admirim.

— Kjo të bën që të hidhesh në zjarr, Nazmi! —
ia kthyen shokët kur po i ngjiteshin maqinës.

*
* * *

Demiri i merrte të freskëta lajmet për çdo seancë gjyqësore nga një mik i tij punonjës i Ministrisë së Punëve të Brendshme, i cili, ditën e parë të gjyqit hyri në sallë kur po lexohej aktakuza kundër shtatëdhjetë e tre të pandehurve. Zëri i gjyqtarit i shpoi veshët, kur filloi të lexonte: «...Kanë organizuar shoqata me qëllim që të vendosin me forcë diktaturën e një klase shoqërore mbi të tjerat dhe kanë përhapur me shkrim e me gojë... idera dhe teorira komuniste...»

— Shiko, nuk ju bëhet vonë aspak, — foli me qesëndi dhe shtyu me bërryl një oficer madhor gjithë shirita e spaleta ari. Ky i fundit i hodhi një shikim të rëndë dhe nuk i ktheu asnjë përgjegje. Mbas pak, oficeri madhor ndërroi vend e doli në radhën e parë, në radhën e nderit.

Mbas «mikut» të ministrit, një civil dhe një ushtarak jepnin e merrnin me njëri-tjetrin me zë të ulët. Civili diçka shënonte në bllokun e tij.

«Duhet të jetë kalemxhi gazete.» Por ky mendim iu kthjellua kur dëgjoji: «Lartmadhëria kërkon edhe fjalët më të imta e të parëndësishme, e jo më...»

Ky ishte njeriu i afërt i lartmadhërisë, i cili merrte pjesë në të gjitha seancat e gjyqit. Çdo ditë shpinte në pallatin mbretëror të rejat e gjyqit. Aktakuza e gjyqtarit hetues përfundoi me ato frazat e

gjata që krijonin plogështi e mërzi në atë atmosferë të ftohtë. Tani e kishin radhën të pandehurit. Trupi gjykues kishte përpara deponimet e Zef Malës e Niko Xoxit. Në këto deponime të këtyre renegatëve, ata mendonin t'i jepnin tonin e duhur gjithë gjyqit të komunistëve. Prandaj i nxorën të parët.

Edhe gjyqi ishte një aksion i vërtetë, madje shumë i vështirë. Komunistët, nga tribuna e këtij gjyqi famëkeq, do të demaskonin regjimin feudoborgjez. Këtu do të ndesheshin dy ideologji të kundërta.

— Ja qëndrimi i «prijësave» para armiqve tanë!
— u dëgjua zëri i Qemalit.

«Me kohë e kemi ndjerë lëkundjen e tyre!» — mendonte Nazmiu për këta dy «komunistë» pa parime të shëndosha.

— Tradhtarë të poshtër! — luajti dhëmbët Emi-
ni. Kjo urrejtje sikur i buroi nga një diskutim i brendshëm shpirtëror, kur dëgjoi nga goja e tyre se gjo-
ja merreshin vetëm me «studime teorike-filozofike» e
jo kundër regjimit ekzistues mbretëror, se ishin kundër
përmbysjes së rendit shoqëror me forcë... etj.

— «E shpëtuan» organizatën, besa! — tha Ndoc
Mazi sa me indinjatë, aq dhe me ironi.

— Kështu largohen renegatët nga fronti dhe i
dorëzohen armikut! — tha Sadik Staveleci.

Emini kishte marrë një pamje të vrazhdë.

«Gushëkuqi» që u qëndronte mbi kokë, u tër-
hoqi vërejtjen me zë të ulët e u preu bisedën. Zefi
me Nikon mbaruan. Dy renegatët krijuan një gjendje
të rëndë në sallë, një ndjenjë pesimizmi tek një
pjesë e vogël të burgosurish që ishin vetëm me ndje-
nja për komunizmin, por jo me bindje. Por tek pjesa
më e shëndoshë e komunistëve, këta nuk krijuan as-

një iluzion, asnjë zbrapsje. Përkundrazi, duke qenë komunistë në radhë të parë me bindje, morën përgjegjësinë e mbrojtjes së ligjshme të ideve të tyre të vërteta.

Dhe ja, Vasili me energjinë e punëtorit, me kthjelltësinë ideologjike të proletarit të ndërgjegjshëm, doli para trupit gjykues. Kryetari filloi nga pyetjet. Ai ia kthente me burrëri. Kur kryetari e pyeti për rrugën e gabuar, ai mblodhi grushtet e tij punëtores, shtrëngoi fort nofullat, sikur po bëhej gati të përleshej me dikë e u përgjegj me guxim.

— ...Jam i bindur se komunizmi duhet të ekzistojë patjetër në Shqipëri dhe këtë bindje e kam formuar nga vuajtjet e klasës punëtore...

Trupi gjykues lëvizi nga vendi. Kryetari u ngrys në fytyrë. Komunistët u gjallëruan. Nëpunësit e lartë dhe ushtarakët shtangën. Tek-tuk kërciti ndonjë karrige.

Fjala e Vasilit kishte goditur si duhet. Në këtë dyluftim betejën po e fitonin komunistët. Një valë entuziazmi përshkoi të pandehurit. Ndërsa gjyqtarët nuk dinin nga të kapeshin që të shpëtonin nga qorr-sokaku ku i futi Vasili. Qemali, Nazmiu dhe shokët e tjerë vunë buzën në gaz dhe krenarisht panë njëri-tjetrin.

Kështu, megjulla e frikës, pesimizmit dhe e nënshtrimit që tradhtarët Zef Mala e Niko Xoxi sollën në sallën e gjyqit, u zhdukën nga kundërukuza që i bënë komunistët revolucionarë gjyqit mbretëror, duke e vënë me shpatulla për muri qeverinë e feudoborgjezisë, për mjerimin e punëtorëve e fshatarësisë së shtypur shqiptare.

Kryetari përsëri i ra ziles, por pëshpëritjet e të

akuzuarve nuk kishin të mbaruar. Ata bisedonin të qetë dhe ulnin kokat që të fshihnin të qeshurat.

Trupi gjykues, si mbaroi me Vasilin, thirri Qemal Stafën.

Salla sikur e humbi jetën. Asnjë nuk merrte frymë. Vetëm zëri i qartë i Qemalit derdhej nëpër sallë me një tingull të ashpër, akuzues. Gjykatësit kishin ngulur vështrimin dhe vëmendjen mbi Qemalin. Kryetari kërkonte rrugëdalje, por çdo fjalë e Qemalit mbyste mendimin që bluante në kokë kryetari, me qëllim që të hidhte poshtë kundërakuzën e komunistit.

Qemali foli në emër të të gjithë komunistëve. Zëri i tij kumbonte. Heshtja tani ishte bërë më e thellë. Prokurori herë shikonte me kokën ulur Qemalin, herë gjyqtarët që kishin mbetur si të ngurtësuar dhe herë lëvizte gjithë nervozizëm mbi karrige.

Kryetari ndërhyri. I ra ziles, nxori ca fjalë nëpër dhëmbë, por Qemali asqë ia vuri veshin. Dhe ja, u desh një trazim i vogël nga prokurori për të buçitur fjalët e zjarrta historike të Qemalit, ato që shprehnin bindjet e të gjithë komunistëve.

Duke dëgjuar Qemalin, Nazmiu e përfytyronte veten në sallën e gjyqit të Pavël Vllasovit në romanin «Nëna» të Gorkit. Ai e dinte përmendsh kundërakuzën e Pavël Vllasovit në mbrojtjen e ideve dhe të programit të partisë së tij.

— Ky është edhe gjykimi ynë! — mendoi Nazmiu.

Salla përsëri u drodh nga një korent i fortë fjalësh:

— Vetëm bolshevizmi do ta shpëtojë masën e punëtorisë që sot ndodhet e shtypur! — i theksoi Qe-

mali këto fjalë, duke i mëshuar tonit të rreptë, por të qetë.

Kjo e vërtetë u end nëpër sallë me atë gjëhim zëri, me atë dritë të hershme, duke ngritur moralin e shokëve gjatë gjithë seancave gjyqësore.

Në sallë u krijua një atmosferë lufte. Prokurori më kot u mundua që me fraza boshe e me tonin e forcës së pozitës së tij të përkulte bindjet e komunistit. Fjala e prokurorit dobësohej, bëhej anemike dhe e papushtetshme. Këtë situatë të elektrizuar e ngri-tën edhe të tjerët, të cilët iu kundërvunë haptazi kre-rëve kapitullantë të grupit.

Fjalët e komunistëve fluturuan të kuqe jashtë sallës së gjyqit. Gjithë atdheu dëgjoi zërin e së vër-tetës, zërin e botës së re që do të lindte nga revolu-cioni.

Njerëzit e elitës së lartë, që dëgjonin, u plagosën moralisht. I dërguari personal i lartmadhërisë u bë pikë e vrer, aq sa shau me vete gjyqtarin e proku-rorin për pazotësinë që treguan në mosarritjen e që-llimeve të paramenduara kundër komunistëve.

*

* *

Në seancën tjetër, para trupit gjykues doli i pa-ndehuri Nazmi Rushiti. Gjatë kohës që kishte ndë-njur në burg, Nazmiu kishte marrë një pamje më burrërore e më të matur. Vështrimi i tij ishte bërë më i thellë e depërtues. Jehona e djeshme ishte ende e freskët nëpër sallë. Një pjesë zyrtarësh e ushtara-kësh të lartë nuk kishin guxuar të ndiqnin seancat e mëtejshme. Urrejtja ndaj këtyre «të kuqve» sikur

u kishte prerë këmbët për të ardhur në gjyq. Vetëm i dërguari personal i mbretit ishte i detyruar të provonte temperaturën e nxehtë e të ftohtë të të gjitha seancave të gjyqit.

— ...Domethënë, edhe ti, Nazmi Rushiti, e pranon aktakuzën? — vazhdoi më tej kryetari i gjykatës.

— Për ne, çdo gjë e vërtetë që i shërben popullit, është e pranueshme, zoti kryetar.

— Pranon se bën pjesë në organizatën komuniste?

— Po.

— Se ke zhvilluar propagandë me shkrim dhe me gojë, duke përhapur ide të kuqe komuniste kundër rendit tonë monarkik? — e ngriti zërin kryetari, ndërsa herë pas here lëvizte shpatullën e majtë, si të kishte ngarkuar diçka të rëndë mbi kurriz.

— Po, zoti kryetar!

Kryetarit i ngeci fjala në fyt. U mundua të mos e shfaqte zemërimin që i gufonte përbrenda, të ruante autoritetin e tij.

— Po tani kush do ta shpërndajë literaturën e ndaluar, na thuaj? — u kap mbas kësaj pyetjeje kryetari, që lexoi në dosje deponimet e Nazmiut në he-tuesi. — Kush do t'i marrë fshehtëzi valixhet nga Tirana në Shkodër me broshura të ndaluara?

— ?!..

— Nazmi Rushiti është në burg, apo jo?

Kryetari sikur mori zemër. Edhe gjyqtarët sikur u gjallëruan nga pyetja e kryetarit.

— Këtu qëndron tragjikomedia juaj, zotërinj gjyqtarë. Ju nuk e kuptoni urrejtjen e popullit të varfër. Populli sot hesht. Por në gjirin e tij zien dhe

do të shpërthejë shpirti i revoltës. Pastaj, zoti kryetar, mos mendoni se me këtë gjyq do t'i jepni fund komunizmit në Shqipëri?

Gjyqtarët përsëri vështruan njëri-tjetrin. Dëshen t'i prisnin fjalën, por fjala e tij bindëse i detyronte të tkurrehin, i tërhiqte ta dëgjonin. Nazmiu ktheu kokën nga shokët sikur të kërkonte aprovimin e qëndrimit të tij. Ata dëgjonin fjalët e shokut të tyre, ndërsa zemrat u gufonin nga gëzimi.

— Domethënë, bindjet tuaja janë për komunizmin? — u dëgjua zëri i kryetarit.

— Ju po kërkoni një këngë që kaq herë po e këndojmë, zoti kryetar...

Në sallë filloi zhurma. Disa herë tringëlliu zilja e kryetarit për të vendosur qetësinë. Shokët vështronin me dashuri Nazmiun.

— Zotërinj, gjyqi vazhdon! — u dëgjua pastaj zëri i nevrikosur i kryetarit.

*
* *

Për «faje» politike Nazmiu u dënua me një vit burg. Ishte mbasditja e 11 shkurtit. Grumbujt e të rinjve, si në ditën e hapjes së gjyqit, rrinin të heshtur, sikur prisnin të dëgjonin nga «autoparlantët» vendimin. Në hyrjen kryesore, dy xhandarë me bajoneta të kryqëzuara kishin krijuar një postbllok të pakalueshëm. Por ja, populli dëgjoi një këngë të re, himnin e luftës klasore, një thirrje për revolucion. Ajo në fillim erdhi si një gjëmim i lar-

gët dhe i ngadalshëm. Por pastaj kënga e Internacionales jehoi e lirë dhe triumfuese nga gjokset e të rinjve komunistë që filluan të zbrisnin shkallët e bashkisë. Populli u çudit. Irfani dhe Demiri vunë re Nazmiun mes shokësh që bashkonte zërin e së vërtetës me ortekun e madh të ndjenjave e bindjeve për të ardhmen.

Nazmiu gjallërohej nga forca e Internacionales dhe ndjente madhështinë e ideve të këngës, jehonën e së cilës e dëgjonte populli. Të ngjitur njëri pas tjetrit, ata, mes gardhit të bajonetave, kaluan mes rreshtave të gjatë të popullit. Sa të fuqishëm e ndjenin veten tani! Populli i shikonte nga afër bijtë e tij me dashuri e dhimbje. Xhandarët u çmendën nga përpjekjet që të pushonin këngën që kishte marrë udhë.

— Tani jeni të dënuar, pushoni!

— Po ju dëgjon ministri!

Po thirrjet e kërcënimit e xhandarëve i merrte me vete vala e këngës me rrymën e saj të fuqishme e i përplaste tutje të mbytura e të pafuqishme. Nazmiu këndonte e shikonte popullin, të cilin e kishte mbrojtur e për të cilin do të vazhdonte luftën. Makinat u nisën. Nazmiu dhe shokët panë edhe njëherë nga populli, panë bashkinë të mbuluar nga mugëtira e mbrëmjes, ku disa ditë me radhë ishin ndeshur ballë për ballë me ligjet e sistemit shfrytëzues feudo-borgjez. Dritat e lagjes nga kaluan, tek-tuk ishin të ndezura. Komunistët i futën në portën e madhe të burgut, duke lënë pas jehonën e ideve të tyre.

K o n f l i k t

— Na thuaj, përse je kundër? — e vazhdoi polemikën Qemali, kur Niko Xoxi ende ngulte këmbë, së bashku me Zef Malën, në pikëpamjet e tyre të shtrembëra. — Përse në gjyq nuk bëtë propagandë?

— Nuk ka ardhur ende koha për veprime të hapta, — u përgjegj me një zë të dobët Niko Xoxi e nuk e hapi gojën më.

— Demagogë! — shpërtheu me urrejtje Emini. — Ju jeni shprehur se do ta përdornit gjyqin si mjet për të propaganduar komunizmin!

— Kjo është tradhti! — thirri Sadik Staveleci, i cili dënoi haptazi tradhtinë e krerëve të grupit dhe u bë një përkrahës i vendosur i komunistëve.

— Si do t'i përhapim ne idetë e komunizmit? Si vepruan bolshevikët në Rusi? Ata u lidhën me popullin...

— Marksistë të rremë! — e goditën dhe e mbërthyen Nikon nga të katër anët komunistët.

Drejtori i burgut dhe gardianët nuk mundën të vendosnin qetësinë ndër të dënuarit politikë. Burgu herë buçiste nga këngët, herë nga diskutimet shoqërore politike. Për një javë rresht u zhvillua një luftë e vërtetë, një ndeshje flakë për flakë jo vetëm me trupin gjykues, por edhe me elementët me pikëpamje të shtrembëta marksiste, e sidomos kundër Zef Malës e Niko Xoxit.

*

* * *

Nazmiu me kokën të mbështetur mbi supin e Ramizit dëgjonte me vëmendje diskutimin që ishte

ndezur përsëri midis shokëve. Atij nuk i bënë shumë përshtypje këto. Vetëm një zë i mbytur, që erdhi duke u zvarritur nga fundi i dhomës së burgut, trazoi shpirtin e tij.

— Edhe sot në Shqipëri nuk ka proletariat! — foli me indiferentizëm një i ri, dhe, si të bënte një zbulim, shtoi me një ton të sigurt. — Edhe borgjezia mungon!

Nazmiu qeshi. Vështroi nga Emin Duraku dhe lëvizti pak nga vendi duke lëshuar një psherëtimë lodhjeje.

— Sa mirë që gjykoni! — iu drejtua me qesëndi Nazmiu folësit. — Por vallë, kush punon në Kuçovë? A nuk janë punëtorë ata? Miopia juaj nuk arrin të shikojë e të kuptojë grevën e tyre, që bënë qysh në vitin 1935. Teoria juaj është fantastike, e shkëputur nga jeta reale e vendit tonë!

Nazmiut iu ngrit ai damari blu në mes të ballit, gjë që tregonte se ai kishte filluar të nxehej.

— Duhet ta kuptoni se para syve tanë kapitalizmi po rritet dhe, bashkë me të, edhe proletariati!

— Kjo është e pashmangshme! — e përkrahu Emin Duraku.

— Përderisa kapitalizmi është domosdoshmëri historike, përse të ngremë dorë kundër mbretit? — u ndie përsëri zëri i hollë nga qoshja.

— Ja, kjo është teoria që del nga tru të kalbura! Kjo rrugë është e papranueshme. — Nazmiut i hipi gjaku në kokë, por bindjet, qëllimet e qarta e mbanin që të ruante gjakftohtësinë. Në mes këtyre diskutimeve buçiti edhe njëherë kënga. Kënga sikur i çlodhte dhe i ushqente me optimizëm e dashuri.

Te dera e dhomës së errët të burgut u dhanë tre

gardianë. Ata vështronin të habitur këta komunistë që nuk po çlodheshin. Jashtë bënte ftohtë. Mbi Tiranë, bora erdhi si një mikeshë e rrallë atë natë.

Në fshat

Mësuesi nga Dibra e Madhe arriti atë mëngjez të akullt te shtëpia e Nazmiut në Dovalan. Nebijes i bëri përshtypje vrazhdësia e fytyrës së tij.

— Është mësuesi i Nazmiut, që e ka mësuar në shkollën e Kastriotit! — ia paraqiti Nebija Destan Kiles, porsa hyri brenda.

— Po kënaqem shumë! Qofsh me jetë, zoti mësues! — i shtrëngoi dorën Destani burrërisht.

— Të paska mpirë të ftohtit, zoti mësues, afrohu pranë zjarrit, — shtoi pastaj Destani duke fërkuar duart. — Po Rushitin nga e paske, moj Nebije?

— Ka dy ditë që u nis për Tiranë. I dërgoi fjalë një dibran që është shpërngulur nga qyteti e tani bannon atje. Nuk di përse u trazua në këtë dimër të egër, — ia ktheu Nebija e menduar, sikur kërkonte të kapte atë fshehtësi që i dukej se ruante mësuesi.

— Ti vjen nga qyteti, shoku mësues, ke lexuar edhe gazetën, — iu kthye Destani mësuesit, ndërsa trazonte urët e zjarrit me mashë. — A është e vërtetë se mbreti ka burgosur dhe ka bërë një gjyq të madh kundër shkollarëve që duan Moskovin? Këto fjalë m'i zuri veshi në pazarin e Peshkopisë.

Mësuesi me vështirësi vuri buzën në gaz. Nebija hapi sytë. Fjalët e Destanit sikur i dogjën.

— Në Tiranë është hapur ky gjyq? pyeti ajo tërë kureshtje.

— Meqë u hap kjo bisedë, mësuesi s'kishte më se si t'i shmangej, kështu që filloi t'i tregonte se çfarë i kishin thënë Irfan Hajrullai e Demir Gashi mbi gjyqin e komunistëve ku bënte pjesë edhe Nazmiu. Nebija u dëshpërua, ndërsa një ndjenjë urrejtjeje i thettri nëpër krahëror kundër atyre që i kishin burgosur të birin. Kjo e bëri që të burrërohej e të mposhte dhimbjen që i sëmboi zemrën.

— Vetëm nuk qenka. Me shokë nuk ia kam merakun!

Destani mendonte. Atij i doli para syve Nazmiu, kur erdhi në pushimet verore.

«Hej, xha Destan, — i kishte thënë atëhere. — Do të ndryshojnë kohët. Si është sot, nuk do të jetë nesër... Dhe këtë ndryshim nuk do ta bëjë zoti, por njerëzit e varfër, fukaraja, që edhe mbretit, edhe beut e agait do t'u marrë shpirtin...»

«Ç'do gjë mund të bëhet, mor bir, — ia kishte kthyer Destani, — veçse mbretit nuk mund t'i shkulësh kolltukun! Kush tjetër është më i fortë se ai?»

Nazmiu i kishte folur edhe për carin e Rusisë, që, ndonëse kishte qenë shumë i fuqishëm, punëtorët e fshatarët e kishin rrëzuar.

— Përse po mendohesh, xha Destan? — e shkëputi nga këto kujtime mësuesi.

— Jo, jo, hiçgjë, — dhe, si heshti një hop, vijoi. — Është mësuar me vuajtje Nazmiu, o mësues. Mirë thotë një fjalë: «Nuk bie hënë e diell mbi fukaranë». Po ti, Nebije, mos u mërzi. Burgu i mbretit nuk do të mundet të mposhtë kurrë djemtë e këtij vendi!

— Ashtu është, — pohoi mësuesi. — Gjithë Shqi-

përia e ka të qartë se ata janë djemtë e saj, dhe mbreti i dënoi sepse i thonin popullit të vërtetën.

— Ajo rrugë burgjet i ka, litarin e ka, plumbin e ka! — përsëriti Nebija këto fjalë të Rushitit që ia kishte thënë Nazmiut verën e kaluar.

NË MBRESHTAN

Natën e 25 shkurtit Nazmiun me shokë i dërguan në Mbreshtan. Burgu i Mbreshtanit ishte në një fshat shkëmbor e të thatë përballë qytetit të Beratit. Ishte një vend i izoluar dhe i vështirë. Zogu çoi në këtë burg 56 komunistë që të mos lidheshin me njerëzit. Por edhe këtu ata nuk u mposhtën. Duke forcuar shpirtin e solidaritetit përmes kolektivave, ata u lidhën edhe më tepër me njëri-tjetrin dhe me idetë e tyre revolucionare. Nazmiu u vu përkrah Qemalit për t'u çjerrë maskën renegatëve dhe egoistëve të krerëve, sidomos të Niko Xoxit.

Dimri kishte arritur kulmin. Të ftohtit kërcëllonte. Punonin si sklevër gjithë ditën. Hapnin një rrugë automobilistike që do të lidhte Beratin me Ballshin. Lageshin e përlyheshin në shi e në baltë. Fshatarët e varfër i shikonin me dhemshuri këta të rinj, por e kishin të ndaluar të bisedonin me ta. Të burgosurit ruheshin nga vargu i xhandarëve. Një ditë, dy barinj bënë ballë drejt vargut të të burgosurve. Xhandarët menjëherë kthyen pushkët drejt tyre.

— Ndal! Ku shkoni?

— Shkrepe të uruarën e bëje një trimëri, mor xhandar! — thirri një i burgosur.

— Duhet tri pendë që që ta shkrepin!

— Kërkojmë ca dhi që na janë ndarë nga tufa,
— foli njëri nga barinjte, dhe xhandarët i lanë të ka-
lonin. Dy barinjte kaluan përmes të burgosurve. I
përsëndetën.

— Hajde, lërimi llafet, kaloni shpejt! — thirri
një xhandar.

«Dy barinjte» i vështruan fluturimthi fytyrat e
vrenjtura, por optimiste të të burgosurve. Ata kër-
konin dikë. Siç duket, nuk e panë gjëkund. Më posh-
të, në një lok të vogël, ku anohej rruga rrëzë kodrës,
«dy barinjte» vunë re gjashtë të burgosur dhe morën
rrugën drejt tyre. Atje ishin edhe më larg nga sytë e
rojeve. Këtu punonin edhe Nazmiu me Eminin. U
afruan.

— Ja, ky i shkurtëri me sy të shkathët!

— E shikoj. Ende i paska shenjat e torturave.

Hodhën përtokë një pako të vogël. Ngritën gru-
shtin lart dhe u larguan. Ata buzëqeshën. Nazmiu
mbeti i mbështetur mbi lopatë. U habit. Ai i përcolli
me atë ndjenjën më të shtrenjtë të shokut, që i lidh
një qëllim i lartë. Emini e mori pakon e vogël duke e
afruar me kazmë dhe lexoi: «Nazmiut» me një shkrim
të imët. Pastaj hodhi një vështrim pyetës mbi Naz-
miun.

«Shoku ynë ilegal» — pëshpëriti Nazmiu me një
ndjenjë të rrallë krenarie.

Kur u kthyen në darkë, Nazmiu, Emini, Ndoci,
Sadiku e të tjerë lexuan letrën. Ajo u jepte kurajo
shokëve që të qëndronin të patundur si «hakmarrës
të padrejtësisë së regjimit». Pastaj thithën të gjithë
tymën e cigareve që u solli shoku, «bariu» Demir
Gashi.



Xhandari me një nishan në faqe nuk po shqiste sytë nga të burgosurit. Ai i vërente me dhemshuri këta të rinj që po punonin mes shiut që s'kishte ndër mend të pushonte atë ditë marsi. Dy ditë kishte këtu. Më parë kishte shërbyer në Berat. Ai e kishte mësuar nga një kushëri që e kishte nxënë, se këta ishin komunistë që luftonin për lumtërinë e popullit. Kaq dinte ai. Por kur qarkkomandanti e thirri e i tha se «...ata janë kriminelë që kanë organizuar komplot kundër lartmadhërisë...», u habit e nuk diti cilit t'i besonte. Megjithëse kishte dy ditë që rrinte me pushkë në dorë, asnjë prej këtyre të rinjve të burgosur nuk kishte tipare kriminelësh. Atëhere xhandari filloi t'i shikonte me një sy dashamirës. Edhe të burgosurit nuk e trazonin me fjalë, siç bënin me ndonjë xhandar tjetër.

Nazmiu nuk e la të kalonte këtë rast. Një ditë binte shi dhe borë bashkë. Të burgosurit punonin. Xhandari me nishan në faqe sesi u ndodh pranë Nazmiut.

— U lodhe? — e pyeti ai me zë të ulët.

— Hiç fare! — dhe, si u mendua pak, Nazmiu shtoi: — Nuk na lodh puna ne!

— Nga je?

— Nga Dibra.

— Qenkemi komshi! — u habit xhandari.

— Po ti...

— Atyre anëve edhe unë...

Pak më tej u duk komandanti i burgut, Zefi, dhe me kaq u mbyll kjo bisedë. Të nesërmen ata përsëri biseduan. Nazmiu e bëri për vete. Për të mos

rënë në sy, xhandari filloi të sillej ashpër me të burgosurit.

— E Nazmi, e gjete shtegun për të çarë rrethimin? — i tha Emini.

— Edhe midis tyre, që na kanë rrethuar, ka një-rëz të mirë, Emin.

*

* * *

Në kushte shumë të vështira të burgosurit politikë hapën një pjesë të rrugës gjithë shkëmb. Afër drekës, aty nga mesi i marsit, një grup komunistësh i kishin lënë veglat e punës dhe po shkuleshin së qeshuri me shakatë dhe barsoletat që tregonte për xhandarët Ndoc Mazi. Aty pranë, i shqetësuar, u kaloi Zefi, komandanti i burgut.

— Hej, ju, teatro bëni? Prefekti... — dhe u dha këmbëve me të shpejtë.

Nga e majta po afrohej me suitën e tij prefekti i Beratit.

— Në emër të mbretit, vjen hajduti, — tha Emini.

— Ç'kapadai! — tha Myzafer Asqeriu, dhe rrëzoi karron me guraleca mes rrugës, ku do të kalonte prefekti.

Prefekti u afrua. Të burgosurit, për të mos e përfillur, nuk i kapën veglat e punës. Edhe ndonjë tjetër që deri atëhere punonte, u mbështet mbi kazmë apo varë. Prefekti u mundua ta gëlltiste këtë, por nuk mundi. U hodhi një sy të gjithëve me radhë si t'i studjonte dhe thirri i inatosur me një çehre të prishur.

— Hëë, derra të kuq, punoni!

Për një çast gjithë ajo zhurmë dhe e qeshur u shua. Dridhma shpirti e revolta krijoi fjala e prefektit. Nga grupi i të burgosurve një zë i njohur e pri-shi qetësinë.

— Komunistët e kanë për nder punën, zoti prefekt, kurse ju që vidhni djersën e popullit e kenë për turp...

Kjo përgjegje e Qemal Stafës e theri prefektin.

— Litari, ai ta lidh gjuhën ty, derr komunist! — e kërcënoi prefekti i zemëruar e kapadai.

Komandanti Zef lëvizi gishtin në ajër në shenjë kërcënimi.

Prefekti e vuri re Zefin në anë të tij dhe e urdhëroi:

— Bëje gati rebelin! E ka gjetur butë këtu.

Ai kërkonte një dënim tjetër më të rëndë për Qemalin, për të vënë në vend autoritetin e tij.

Turma e të burgosurve, mes të cilëve Vasil Shantoja, Nazmiu, Sadiku, Muzaferi, Sadik Staveleci, Ndoci, Ramizi e të tjerë, e rrethuan prefektin që ishte mënjanuar pak nga suita. Drejt tyre po vinin edhe të burgosur të tjerë e plot xhandarë.

— Merre shtruar, zotni! — tha me ironi Sadiku.

— Hajt, kështu them unë! — nguli këmbë qeveritari i skuqur në fytyrë, duke e vështruar me egërsi atë që foli.

— Ne komunistët nuk e japim shokun! — ia priti me ton të vendosur Nazmiu, duke dalë në ballë të grupit.

Grupi i komunistëve u mblodh duke u ngjitur njëri pas tjetrit.

— Pa provojeni ta merrni, zoti prefekt! — ishte

zëri i Vasil Shantos. Ky ishte vendimi i gjithë komunistëve.

— Provojeni! — thirrën dhe të tjerët me nofulla të shtrënguara e me grushte të mbledhura.

Prefekti u tërhoq nga qëndresa e të burgosurve. Vërejtji nga suita me një shprehje ankuese në fytyrë dhe u kthye me sy në tokë duke përshpëritur: «Këta turbulluan një dynja e...» U mundua t'u buzëqeshte shoqëruesve, por fytyra i mori një çehre të bajatshme.

— E keni parë, vëllezër, qenin që mbledh bishtin, kur i matesh me shkop? — tha tërë gaz Ndoc Mazi.

Shokët qeshën me të madhe, duke parë suitën me prefektin në mes, që u zhduk mbas shkëmbit të minuar.

Provokatorët dhe xhandarët u shtuan. Fishkëllillima e kamxhikëve mundohej të trembte e të përkul-te shpirtin e paepur të komunistëve.

*

* * *

Çdo ditë Nazmiu merrte lajme të reja. Ditët e para të prillit, xhandari me nishan në faqe nuk u duk më andej. Nazmiu dhe shokët dyshuan se mos e kishin zbuluar. Por jo. Ai erdhi përsëri në Mbreshtan dhe e informoi për demonstratat dhe protestat e popullit kundër rrezikut fashist. Nazmiu erdhi tek shokët me zemrën helm. U tregoi gjithë të rejat që i kishte dhënë xhandari me nishan në faqe. Një ndjenjë zemërimi nxori krye në personin e tij dhe thirri me sa kishte fuqi:

— Tradhti, shokë, tradhti!

Zëri i tij u ndoq nga të tjerë të ndezur nga afshi i revoltës:

— Të bëjmë një telegram!

— Të lirohemi nga burgu!

— Të luftojmë bashkë me popullin!

— Duam armë! — dëgjoheshin thirrjet e protestës dhe të kërkesës së ligjshme për t'i ardhur në ndihmë atdheut të tradhtuar. Dhe një grup shokësh, në mes të të cilëve edhe Nazmiu, i bënë një telegram qeverisë. Por mbreti dhe qeveria e tij e kycën gojën. Ata kishin kapitulluar. Zogu i kishte studjuar dhe koordinuar mirë e bukur planet. Ai e dinte se rreziku më i madh vinte nga komunistët. Prandaj, për t'i patur më të sigurtë krahët, të burgosurit politikë të Mbreshtanit i përcolli të lidhur me hekura në burgun e Beratit. Sa të rënda ishin ato ditë! Nazmiu vërtitej nëpër burg me zemër të copëtuar.

— Shokë, nuk na duhet jeta pa liri! — thërriste Nazmiu, duke ndjerë në krahëror një peshë të rëndë urrejtjeje e zemërimi.

Burgu gjëmonte nga thirrjet. Ata kërkonin liri-min e tyre. Kërkonin edhe armë që të shkonin mes popullit e të ndiznin revoltën, për t'i bërë ballë armikut. Një ditë përpara së premtës së zezë të robërisë, bijtë e popullit u radhitën nëpër rrugët e fshatrave, qyteteve dhe kërkonin armë. Por edhe në këtë rast, Zogolli lëshoi mbi ta toga të tëra xhandarësh.

— Kjo është tradhtia më e shëmtuar, shokë! Të kërkosh të luftosh e të mos kesh as pushkë, as barot?! — thirri Nazmiu. Rojet në burg u shumëfishuan. Xhandari me nishan në faqe hynte e dilte pa bërë zë tek të burgosurit. Të tjerët thërrisnin që të shuanin revoltën.

— Kush thërret kështu? — thirri rreptë një oficer me kërbac në dorë.

— Unë!

— Unë!

— Unë! — vinin pohime nga të katër anët e burgut.

Nazmiu doli në krye të shokëve dhe iu drejtua oficerit:

— Një kërbac ta dha mbreti, zoti toger, një tjetër do të ta japë Musolini!

Para fuqisë së bashkuar të zemrave të revoltuara, togeri bëri mbrapsht duke zgurdulluar sytë dhe u struk në zyrën e tij.

A r r a t i s j a

Në qelinë ku ishin mbyllur të burgosurit e Mbreshtanit në Berat, nuk guxonte asnjë roje të hapte derën. Burgu gati kishte mbetur shkretë. Vetëm ca roje, që u bindeshin verbërisht urdhërave, kryenin detyrën.

Komunistët rrihnin mendime si të arratiseshin. Variantet ishin të rrezikshme. Rojet do të qëllonin.

— Të shpojme tavanin e qelisë! — tha njëri duke ngritur gishtin lart. — Hipim në çati dhe, po qe nevoja, i lajmë hesapet me ndonjë xhandar kokëshkretë. Rrugë tjetër nuk ka!

— Të thyejmë binarët përballë, — propozoi Nazmiu.

Kishte kaluar mesi i natës. Po afrohej dita e zezë e 7 prillit. Disa, të prirë nga Sadiku filluan të

shqyenin një nga një binarët. Rojet nuk dëgjuan gjë, pasi të burgosurit e mbytën rropatjen me zhurmë e këngë. Më e rrezikshme ishte dalja në oborr.

Xhandari me nishan në faqe ndjeu krismën e një dërrase. Ai e kuptoi se ç'po ngjiste. Eci disa hapa dhe drita e hënës i lëshoi para këmbëve hijen e Emin Durakut që ndodhej në qoshe të burgut. Drejt tij po vinin roje. Xhandari me nishan në faqe u doli përpara për t'u ndërruar drejtimin.

— Ç'kemi? — pyeti rojen mustaqemadh.

— Qetësi.

— Ç'flet, mor i uruar! Nuk e dëgjon? Po zien i tërë qyteti, — ia priti roja tjetër. — Thonë se mbreti u arratis në Greqi.

— Ahu, dhe ti! Ai ka dalë kaçak! — dhe të tre u kthyen prapa.

Kur tre xhandarët kaluan qoshen e burgut, Emimi doli i pari dhe kapërceu murin. Pas tij u hodhën Nazmiu e Ndoci. Duke u hedhur i katërti, dy roje, u dukën në anën e kundërt. Shokët i bënë she një Vasilit që të shtrihej. Vetë u fshehën në kthesën e murit. Rojet kaluan pranë tyre. Ata u lëshuan mbi ta. Sadiku u erdhi në ndihmë. Rojet deshën të jepnin alarmin me të thirrura, por sakaq gojët e tyre u mbyllën me lecka; ndërsa një tjetër i çarmatosi. Kjo përleshje u bë në qetësinë më të madhe. Të gjithë të burgosurit dolën në oborr. Qyteti ziente.

— Ku i keni armët? — u tha rojeve Vasili.

— A doni t'ua jepni italianëve? — u tha Myzaferi.

— Ne s'kemi urdhër, zotni... na varin! — tha roja i çarmatosur me zë të dredhur.

Xhandari me nishan në faqe mblodhi ca pushkë

nëpër ndërtesën e burgut dhe ua dha komunistëve. Nazmiu mori një pushkë, i lëvizi shulin dhe i tërhoqi këmbëzën. Por ajo nuk shkrehu.

— Politika e mbretit! — tha dhe e hodhi për tokë pushkën, së cilës i kishin vjedhur gjilpërën.

Shokët u mblodhën rreth Vasilit. Zhurma në qytet vinte dallgë-dallgë.

— Duhet armatosur populli që ta luftojmë agresorin! — u tha shokëve Vasili dhe në krye të grupit, si detachment i kuq, shkuan tek prefektura.

— Duam armë, duam armë! — kërkuan ata njëzëri.

Qytetarët u mblodhën rreth tyre.

— Prefekti po ikën! — u dëgjua një zë i dëshpëruar nga turma e popullit.

Komunistët i dolën përpara veturës së prefektit të frikësuar nga demonstruesit. Vetura ndaloi përpara murit të pakapërcyeshëm të komunistëve.

— Ku po e thyen qafën, qen bir qeni! — e shau njëri.

Vasili e nxori nga vetura, të tjerët e kontrolluan.

E dëgjon ç'kërkon populli? — i tha Nazmiu me kërcënim.

— Ku është «shpëtimtari i atdheut?»

— Ku i ka mbreti «opingat e lopës»? Ti the se ai do t'i veshë për të luftuar? — e mbërthyen prefektin me pyetje.

Prefekti heshte. Ai rrinte para tyre si lepur i trembur. Gjithë sheshi para prefekturës gjëmonte: «Duam armë!»

Mëngjezi i 7 prillit e gjeti çetën e arratisur në malin e Tomorricës. Nuk u bënte përshtypje ai mëngjez që natyra e kishte qendisur me ngjyrat më të bukura. Çdo gjë dukej e errët dhe kobshme. Ata ecnin drejt detit. Në krye printe Vasili. Në majë të një kodre, ku afrohej xhadeja, ata u ndalën, duke vështruar të heshtur një shirit të murmë ushtarësh me kapele me pupla, hipur mbi karro ushtarake, motocikleta të panumërta e tankse që vraponin gjithë zhurmë e rrapëllimë drejt qyteteve të tjera të atdheut. Ata lanë pas rropatjen e rrotave të hekurta dhe re të dendura pluhuri. Shokët heshtnin, shikonin me dhemshuri njëri-tjetrin. Dielli edhe pak do të mblidhte rrezet e tij. Nga perëndimi vinte ndonjë gjëmim i mbytur topi.

Nazmiu, i raskapitur nga lodhja e mundimet e burgut, i dëshpëruar e i vrarë shpirtërisht, bashkë me shokët, qëndroi disa ditë ilegal në malësi të Elbasanit, derisa fashizmi për demagogji shpalli amnistinë. Ndërsa Vasili, me ca shokë, kaloi kufirin dhe shkoi në Jugosllavi, që të organizonte rezistencën.

PËRSËRI NË GJIMNAZ

Pas amnistisë, disa nga të burgosurit u kthyen në gjimnaz. Nxënësit e mësuesit mbanin një qëndrim të hapur armiqësor kundër regjimit. Ata jetonin përditë e më thellë planet grabitqare e skllavëruese të fashizmit. Pushtuesit u munduan ta kthenin shkollën në një armë të robërimit shpirtëror që «të pregatiste të rinjtë e Shqipërisë së nesërme me ndërgjegjen dhe kryelartësinë e qytetarëve të perandorisë fashiste». Por në gjimnaz vepronin rreth 100 komunistë e simpatizantë.

Klasa e Nazmiut, Eminit, Sadikut e të tjerëve, që nën regjimin e Zogut ziente nga debatet politike, tani sikur heshtte. Edhe oborri, edhe korridoret e shkollës, nuk zienin më si më parë. Vetëm spiunët bridhnin shpesh andej, për të siguruar një copë pozitë nga padroni i ri.

Por një mëngjez, përsëri, zjarri që digjej nën vete, filloi të nxirrte flakët e kuqe të revoltës dhe urrejtjes. Qysh në orën e mësimit të edukatës morale, fashistët ndeshën në ndërgjegjen kombëtare.

—Italia sikur e «dënon» politikën antikomuniste të Zogut. Kjo është demagogji e fashizmit, — tha Nazmiu. Debatet i hapën komunistët.

— Mjaft! — thirri me sa fuqi kishte mësuesi i

edukatës morale, i cili në fillim nuk iu dha rëndësi pëshpëritjeve e diskutimeve nga mesi i bankave në klasën e gjashtë.

Nxënësit filluan të qeshnin.

— Përsëri po shfaqni prirje të rrezikshme politike, por...

E gjithë klasa hodhi sytë nga Nazmiu që rrinte në këmbë, pranë Eminit e Sadikut.

— Ne nuk na duhet morali fashist, zoti mësues! Me këtë moral ju kërkoni të helmoni shpirtin e rinisë sonë! Ne na duhet morali proletar...

Si për inat, zilja nuk po binte. Mësuesi kur pa se diskutimi «mori rrugë të shtrembër», u mundua të shmangte këtë situatë proteste ndaj kulturës fashiste.

Tingulli i parë i ziles e gjeti mësuesin jashtë dërrës, me kokën ulur dhe të ofenduar, sepse përsëri, kundërshtimi i Nazmiut dhe i shokëve të tij krijoi zhurmë, sa që arriti deri në zyrën e drejtorit italian, Aldo Onetit. «Qorri», siç i thoshin nxënësit rojes së shkollës, si i ra ziles për mbarimin e orës së fundit, pa Nazmiun tek po zbriste shkallëve dhe i foli me vrazhdësi, pa e vështruar ndër sy:

— Pasdite, në orën katër, në këshillin e mësuesve, dhe me zile në dorë u kthye prapa, për të hyrë në barrakën e vet.

Nazmiu qeshi me vete.

— Në raport tek ju? — u tall me të.

«Polici» i gjimnazit e vështroi egër.

Në të dalë të gjimnazit e priste Esat Gjyli me një punëtor tjetër. Esati diçka i dha. Nazmiu i futi fletët shuk në xhepin e brendshëm. Ishte një pjesë e raportit të J.V. Stalinit në Kongresin XVIII të PK (b) të Bashkimit Sovjetik.

— Keni më?

— Edhe ca. Mbrëmë m'u mbarua vajguri, — u përgjegj Esati si të shfajësohej.

*
* *
*

Mësuesi i filizofisë hyri në klasë dhe vështroi bankat, ku rrinin ata «të drejtimit të shtrembët». Hapi çantën dhe nxori fletët e provimit. I kaloi nëpër duar me buzë në gaz fletët e provimit të Nazmiut, Eminit, Adilit, Sadikut duke i ngulur sytë mbi shkronjat «Poshtë teoria idealiste reaksionare e Bergsonit!»

Në klasën VI mësuesi kishte bërë një provim kontrolli për teorinë e Bergsonit. Të katër shokët dhe ca të tjerë e kishin zërthyer shumë mirë Bergsonin. Këtë e bënë sa për notë. Por në fund të fletës kishin shkruar dhe pikëpamjet e tyre materialiste, duke mbajtur qëndrim kritik ndaj filozofisë idealiste të Bergsonit.

Mësuesi i njihte nxënësit e tij, prirjet dhe dëshirat e tyre. Ai nuk u kishte rënë asnjëherë në sy për keq.

— Të paktën mos i shfaqni me shkrim! — tha me zë të ulët mësuesi duke u kaluar pranë bankave të katër shokëve.

— Gënjeshttrat filozofike të idealistëve na mbetën në fyt, zotni, — vazhdoi Nazmiu.

Mësuesi vuri dorën tek goja për t'u dhënë të kuptojnë që të pushonin. Ai donte të largohej nga diskutimet që në këtë klasë ishin bërë aq të zakonshme.

— Mbani ekuilibër! — tha nëpër dhëmbë mësuesi.

Shokët panë njëri-tjetrin e qeshën me vete.

— Zoti mësues, më lejoni t'ju pyes? — u dëgjua një zë nga fundi i klasës.

— Na kaluan minutat, — tha mësuesi, — ç'kërkoni?

— Çdo të thotë «mbani ekuilibër»?

Klasa ia plasi së qeshurës. Edhe mësuesi qeshi me ta, duke parë herë pas here nga dera... Por kjo pyetje, që kërkonte shpjegimin dhe qëndrimin e mësuesit, e hutoi atë. Ai hipi në podiumin e tavolinës me një çehre të zymtë. Zilja donte edhe pak minuta të binte. Ai filloi temën e re filozofike. Një zhurmë plasi në bankat e fundit. Zilja ra me një tingull të gëzuar. Atë e çuan këmbët deri tek dera e drejtorisë, por mori kthesë me nervozizëm dhe hyri në këshillin e mësuesve. Nuk trokiti në drejtori. Zhurma në klasën VI vazhdonte.

*
* *
*

— Po vjen «Gjeografia»! — thirri njëri që kishte zënë prakun e derës. Kështu i thërrisnin mësuesit të kësaj lënde.

«Gjeografia» i donte nxënësit me drejtim përparimtar, shpesh i këshillonte e i ndihmonte. Prandaj edhe nxënësit i respektonin e i donin mësuesit e tillë.

Atë orë «Gjeografia» ishte i porositur nga drejtori të pyeste tre nxënës.

Në shtyllën e regjistrit shënoi 23 maj 1939.

— Për Rusinë do të na flasë Rushiti.

Nazmiu u ngrit i kënaqur. Ai mbeti pak pa folur sa rikujtoi dhe një herë «mësimin».

Shokët e celulës e dinin si do të përgjigjej. Nazmiu nuk foli fare për Rusinë cariste, por për Bashkimin Sovjetik. Gjithë klasa e dëgjoi kur citoi përmendsh pjesë nga raporti i Josif Stalinit në Kongresin XVIII të PK(b):

«...Në kohën tonë nuk është aq lehtë të këputësh menjëherë zinxhirët dhe të hidhesh drejtpërdrejt në luftë, pa marrë parasysh opinionin publik. Këtë e dinë fare mirë politikanët borgjezë. Këtë e dinë edhe krerët e fashizmit. Prandaj krerët e fashizmit përpara se të hidhen në luftë vendosën disi ta pregatisin opinionin publik, d.m.th. ta gënjejnë, ta mashtrojnë...»

— Mirë, mirë, Rushiti. Pyetja është për Rusinë... për Rusinë e Carit, — ndërhyri «Gjeografia». — Kështu është? — iu drejtua klasës. Por klasa heshte.

— Kjo është delikate... — foli prapë «Gjeografia». — Unë ua kam thënë këto? Apo...

— Jo, zotni, i kemi mësuar nga një «mësues» tjetër.

— Uluni! — i tha me ton të ëmbël Nazmiut dhe diçka shënoi në fletoren e tij.

Në katrorin tjetër të regjistrit, bri një emri, shënoi një pikë.

— Bekteshi! — thirri mësuesi. — Tregoni, ç'dini ju për Italinë.

Ai shikoi anash dhe foli me gjallëri edhe ky për raportin e Josif Stalinit në Kongresin XVIII.

— Mirë, — e ndërpreu «Gjeografia». Dhe, si u mendua pak, pyeti: — Unë ua kam thënë këto? — Ai sikur kërkonte mbështetje nga klasa për t'u shfaqësuar.

— Jo, zotni, i kemi...

— Uluni, uluni! — ia preu fjalën Sadikut duke lëvizur kokën.

Të tretin pyeti Eminin për Gjermaninë. Edhe ky foli për raportin e Gjergj Dimitrovit në Komintern, për dënimin e fashizmit.

— Unë s'i kam thënë këto! — tha mësuesi duke formuar një mimikë qesharake.

— Jo, mësues! — u përgjegjën disa njëherësh.

— Këta janë zërat që kërkojnë ta fitojnë lumtërinë», — tha nëpër dhëmbë «Gjeografia» dhe doli jashtë duke i përshëndetur.

*

*

*

Qazim Llazani e hodhi çekiçin mbi tavolinën e punës, mes ca këpucëve të vjetra dhe i dha Nazmiut ca fletë të shkruara me shaptilograf, të mbledhura me kapakë jeshil.

— Numri pesë. Bardhoku, — tha, duke u shtrirë përpara «Buletinit jeshil» dhe mbylli nga prapa derën e dyqanit të këpucëve. Tre shokët i gozhduan sytë mbi buletin. Edhe Qazimi hoqi mënjanë kullën e hekurt të këpucëve dhe zgjati trupin mbi fletët e shaptilografuara. I kaluan një nga një faqet e para. Nënvizuan ca fraza që nuk ishin dokort me artikullshkruesit.

— Lexo, këtu kanë derdhur më tepër helm, — tha Adili dhe futi në kllapa një paragraf të tërë, kur kapërcyen në faqen e tetë të «Buletinit jeshil».

Mbi faqen e tetë ndejtën gjatë. Ata kujtonin gjithë teoritë e mësuarë mbi revolucionin dhe çuditeshin me autorin se si e shtronte idenë e tij për fashizmin dhe shtimin e proletariatit në Shqipëri.

— Pikëpamje reaksionare! — tha njëri prej tyre.

Sytë u kalonin mbi rreshta ngadalë e të menduar.

— Ç'marrëzi! Pushtimin fashist e quajnë të nevojshëm e të dobishëm, — tha me zë të ulur e me indinjatë Nazmiu.

Dy të tjerët qeshën të hidhëruar.

— Sipas «jeshilëve», komunistët duhet ta përkrahin ardhjen e fashizmit, se ky do të krijoka proletariatin, — shtoi Adili.

— Autorët kanë pikëpamje trockiste, — tha Nazmiu. — Tani po i shfaqin hapur, me shkrim.

— Këtë qarkulloje! — i tha Nazmiu këpucarit për «Buletinin jeshil», ndërsa një kopje e morën me vete.

Zilja e «dritares» së pushimit i gjeti të tre shokët në oborrin e gjimnazit. Kishin dhe një orë mësim atë ditë.

*

* * *

Mësuesi italian, që jepte gjuhën italishte, e që në të njëjtën kohë ishte edhe spiun i fashizmit, kishte hyrë në brendësi të lëvizjes së komunistëve në radhët e nxënësve të gjimnazit. I njihte pothuajse një për një. Italianit i erdhi çudi kur një shoku i tij vuri

gishtin edhe nën emrin e Nazmi Rushitit në regjistrin e klasës, kur ndodheshin në këshillin e mësuesve.

Nuk shkoi shumë dhe, aty nga fillimi i qershorit të vitit 1939, gjeti rastin që të bisedonte me Nazmiun, i cili sa u kthye nga dyqani i këpucarit.

— Ti, djalë, ke qenë i dënuar nga mbreti Zog, prandaj besoj se do të na jesh mirënjohës që erdhëm e të çliroam nga burgu! — dhe i doli parasysht drapëri dhe çekani të vizatuar nga komunistët në tabelën e zezë të klasës dy ditë më parë.

— Po, zoti mësues, unë kam qenë në burg, por tani, me ardhjen tuaj, të fashizmit italian, është në burg i gjithë-populli shqiptar!

Mësuesi pa andej-këndej i shqetësuar. Sikur s'po e mbante vendi. Bëri një lëvizje që të largohej, por fjala e Nazmiut, që nuk kishte mbaruar ende, e frenoi:

— Unë kam luftuar regjimin e Zogut, veç të tjerash, edhe për faktin se ai përgatiti terrenin e pushtesit fashist në vendin tonë!

Italiani u bind mirë për mendimet e këtij «nxënësi të rrezikshëm komunist» dhe seç shënoi në bllokun sekret, të cilin e hapte vetëm në zyrat e kuesturës. Ai u sugjeroi drejtorisë dhe organeve kompetente që në gjimnaz të bëhej një «spastrim rrënjësor» i mësuesve «nxitës të turbullirave.»

Në mbarim të atij viti shkollor, gjatë pushimeve të verës, Nazmiu nuk mundi të shkonte në Dibër. Ai hyri në punë si punëtor krahu, me qëllim që të vazhonte aktivitetin revolucionar në Tiranë e të lidhej me shokët e vjetër. Për këtë, edhe sekretari federal i Shkodrës u tregua i gatshëm që ta largonte nga Shkodra, duke e pajisur edhe me një shkresë për ndërmarrjen «Federiçi», ku e rekomandonte për punëtor.

Në Tiranë përmes takimeve të shpeshta me shokun e vjetër Vasil Shanto e të tjerë u kalit më tepër si revolucionar dhe mësoi rrugë të reja lufte. Nazmiu në Tiranë u bë shpirti i shtëpisë së «Bretkocave», një kalibe qerpiçi në periferi të qytetit, buzë lumit, në lagjet e varfëra, ku banonin një tog të rinjsh, nxënës revolucionarë e punëtorë, të cilët ditën punonin për të shuar urinë, ndërsa natën zhvillonin aktivitetet revolucionar kundër fashizmit.

Mbas pushimeve Nazmiu u ul në bankat e klases VII të Gjimnazit të Shkodrës. Komunistët vitin shkollor 1939-1940 e filluan më të vendosur e më të mobilizuar në propagandimin e ideve komuniste dhe në praktikën revolucionare të këtyre ideve.

D e m o s t r a t a

Muzgu i mbrëmjes u shtri mbi qytet. Ishte mesi i nëntorit të tridhjetenëntës. Në njërën nga bazat e celulës, u bë mbledhja e saj.

Kjo mbledhje e fshehtë dhe urgjente u bë posa u kthye nga Tirana përgjegjësi i celulës, Sadiku. Ai ishte ngarkuar nga Komiteti Qarkor i Grupit Komunist të Shkodrës që të bisedonte e të këshillohej me shokët e Tiranës për zhvillimin e demonstratës së 28 nëntorit.

- A i takove shokët?
- Si ishte Vasili?
- Janë dakord për demonstratën? — e pyetnin shokët përgjegjësin me zë të ulët.

Ai u foli shkurt për gjendjen:

..— Pushtuesi mundohet të grumbullojë fëmijë, rininë e punëtorët në organizatat e tyre fashiste që nga «Figlio di lupo» e deri në «Dopo Lavoro» për të shuar çdo ndjenjë lirie, për të fashistizuar rininë...

Pastaj u tregoi si kishte biseduar dy net rresht në «Shtëpinë e Bretkocave» me Vasil Shanton, si e kishte pëlqyer e pranuar vendimin për demonstratën etj.

Në mbledhje u drejtuan shumë pyetje e u dhanë disa mendime për organizimin e demonstratës.

— Ne na shqetësojnë ca gjimnazistë, pak janë, që rrinë indiferentë, ata të pispillosurit. Kohët e fundit sikur janë afruar. Si do të veprohet? Ta shohim së bashku, — kërkoi shpjegim një anëtar celule.

Shokët vërejtën njëri-tjetrin.

— Kur formohet një front, pa përçarje, në gjithë masën e nxënësve, kjo është gjë e mirë. Por këta mos kërkojnë çastin për të na dëmtuar? — arsyetoi përgjegjësi.

— Me bijtë e bejlerëve e të tregëtarëve, që janë rritur në pupla, nuk kemi asgjë të përbashkët. Edhe këta janë të tipit Mark-Mhill! — sqaroi njëri.

— Edhe unë jam kundër, — u bashkua me të Nazmiu, — por dua të shtoj që këta elementë t'i bojkotojmë, të mos u flasim, as të shoqërohemi me ta...

— Të mbështetemi tek punëtorët, shëgertët, — tha përgjegjësi.

— Ka ardhur koha që dhe shkolla «Donika Kas-

trioti» të hidhet në veprime të hapta. Atje ka vajza përparimtare... — foli një anëtar i celulës.

Si diskutuan dhe ca të tjerë, celula e dytë e gjimnazit vendosi për përgatitjen e demonstratës.

*
* *
*

Në krahun e majtë të gjimnazit ishte palestra. Anëtarët e celulës e morën vesh që fashistët donin ta hapnin me ceremoni fushatën e mbjelljes së pemëve për Musolinin.

— Të bëjmë çmos që të dështojë manifestimi fashist, — tha njëri nga shokët.

— Ta shfrytëzojmë mitingun për qëllimet tona, — u tha Nazmiu shokëve, duke hyrë në sallën e palestrës, që ishte mbushur plot e përplot me gjimnazistë.

— Ja dhe gjimnazistet «Donika Kastrioti», — tha përgjegjësi i celulës me zë të vrazhdë dhe u tha shokëve të shpërndareshin mes gjimnazistëve.

Vajzat u radhitën pranë podiumit në krye të palestrës, ku sapo hipën njëri pas tjetrit korbat fashistë plot pompozitet. Menjëherë filloi himni fashist me ca zëra të dizakorduar. Por, për çudi, buçiti madhërishtëm himni i flamurit nga djemtë e vajzat. Shokët e celulës, të shpërndarë në masën e gjimnazistëve, ndiznin entuziazmin dhe jepnin kurajo.

Nazmiu me shokët e celulës entuziazmoheshin kur shikonin Shejnaze Jukën, Qeriba Kokën e shoqetë tjera, që bashkonin zërin e tyre me të djemve.

— «Silencio, silencio!» — dëgjohej thirrja dëshpëruese për të pushuar këngët e gjimnazistëve.

— Largohu italian, këtu s'ke ç'bën! — thirri një grup nga mesi i turmës.

Në radhët e demonstruesve hynë spiunët. Ata kërkonin «shkaktarët e turbullirës» për arrestimin e tyre.

Vesh më vesh qarkulloi parulla «shpërndahuni», e dhënë nga celula. Për pak sekonda, nga dritaret e palestrës, dolën djem e vajza. Salla u boshatis. Spiunët dhe instruktori i partisë fashiste Severino Rikotini mbetën të vetëm në mes të sallës.

Fashistët u larguan me gisht në gojë.

Mitingu fashist dështoi.

*

*

*

Një mbrëmje, ndërsa po ktheheshin nga Shiroka, duke kënduar këngët e mësuara sipas udhëzimeve të celulës, mësuesit, në vend që t'i ndalonin si zakonisht në oborrin e gjimnazit, prej ku do të shpërndaheshin, i drejtuan të rinjtë nga ndërtesa e fashios. Rreshti i dendur prej rreth 700 gjimnazistësh filloi të përzihej.

— Po na kurdisin ndonjë kurth, — tha Sadiku.

— Të lidhemi me shokët, — u përgjegj Adili.

Komunistët ishin të shpërndarë mes turmës së nxënësve. Nazmiu u sinjalizua i pari. Ai njoftoi Eminin, Tomën, Hakiun, Mazllumin, Qemalin, Merimanin e shokë të tjerë komunistë.

— Kujdes, vëllezër! Fashistët, si duket, duan të shlyejnë disfatën e palestrës. Prandaj vigjilentë! Edhe këtu t'ua thyejmë hundët! — porositi shokët përgjegjësi i celulës.

Dhe, me të vërtetë, fashistët, për të vënë në vend «nderin» që humbën në palestër para pak ditësh, kishin vendosur që para ndërtesës së fashios të mbanin një fjalim tjetër, duke menduar se para zyrove të fashios gjimnazistët nuk do të guxonin të shkaktonin turbullirë. Por komunistët kishin punuar shumë më ato ditë me gjimnazistët, punëtorët, shegertët, e zanatçinjtë, rreth të cilëve ishte grumbulluar një masë e ndërgegjegjshme për të vepruar.

Sa arritën para fashios, nga radhët e para doli një zë i dobët duke kënduar: «com'e delizioso andar sulla corrazzella». Emini, që doli në fillim të rreshtit, i hodhi një vështrim të egër dhe e shtrëngoi për fyti këngëtarin. Kënga italiane u ndërpre.

Ndërkohë, një grup të rinjsh ia mori në fillim lehtë, pastaj me vrull «Himnit të flamurit» shqiptar. Nga mesi i turmës buçiti kënga «Eja mblidhuni këtu».

— Largohu sulltan, këtu s'ke ç'bën! — hidhte parullën mes këngëve Hilmi Seiti.

— Largohu italian, këtu s'ke ç'bën! — e korrigjonin të tjerët, ku shquhej zëri i bashkuar i Nazmiut, Eminit, e të tjerëve.

Në këtë gjendje të acaruar fashistët nuk patën kurajo të mbanin fjalime. Turma entuziazte, me në krye komunistët, u drejtua përsëri në oborrin e gjimnazit me këngë në gojë.

Edhe këtë provë e kaluan me sukses.

*

* * *

— Ndonjë të re? — e priti drejtori Mëhill Markun, i cili u fut me vrull në zyrë.

— Po, zoti drejtor! Nazmi Rushiti flet kundër fashizmit mes turmës së nxënësve. Nuk është hera e parë. Ne...

— Mirë, mirë. Tjetër?

Dera trokiti përsëri. Hyri brenda M. Lulashi.

— Zoti drejtor, nxënësit kanë kënduar «Internacionalen». I pari ia mori Nazmi Rushiti!

— Cilët ishin të tjerët? — tha tërë zemërim drejtori.

— Të gjithë, zoti drejtor, të gjithë!

— Të gjithë?! Domethënë të gjithë janë komunistë!

— Si urdhëroni!

Drejtori lëvizi kokën.

— Po këta, zoti Mark, a nuk e kuptojnë vallë që ne e shpëtuam popullin shqiptar nga zgjedha e Zogut?

Marku heshti. U bë gati t'i thoshte se ata kishin luftuar edhe kundër regjimit të Zogut, por nuk e çoi më tej. Aldo Oneti i përgëzoi për këtë «patriotizëm» dhe i lejoi të largoheshin. Mëhillin e porositi t'i dërgonte nxënësin Markagjoni dhe mori kuesturën në telefon. Bisedoi gjatë për «incidentet e paligjshme» në gjimnaze. Drejtor Oneti i thirri demonstruesit një e nga një. Ai nuk donte t'i acaronte punët menjëherë, megjithëse kishte prova bindëse për aktivitetin e tyre antifashist. Por përsëri ai u detyrua të tundte degën e ullirit për «më kryekëcymët e këqij».

— Nazmi Rushiti?

— Po.

— E ndjej për detyrë t'ju këshilloj.

— Faleminderit, — buzëqeshi me ironi Nazmiu. Drejtori i kujtoi aktet e kundërligjshme ndaj regjimit, duke lexuar shënimet e bëra në dosjen e tij. Veçanërisht i theksoi kundërshtimin për të mos thirrur «Viva il Duçe» e «Viva il re», siç i porosiste mësuesi i fiskulturës Alush Leshanaku.

— I pranoni? — dhe ngriti sytë nga dosja. — Kjo është veprimtari kriminale!

— Nuk keni asnjë të drejtë ta quani veprimtarinë tonë kriminale!

— Mjaft, — thirri drejtori.

Nazmiu i qeshnin sytë nga tërbimi i drejtorit italian. Një nënqeshje e hollë iu end buzëve kur mbylli derën e zyrës.

«Edhe fjala vret. Madje nganjëherë është edhe më e fortë se plumbi», — mendoi dhe vrapoi poshtë shkallëve për në oborr ku e prisnin shokët.

*

*

*

Vargu i gjatë i nxënësve bëri ballë drejt sheshit të prefekturës, ku do të zhvillohej mitingu.

— Ndoshta nuk duhet vepruar... A ia vlen? Do të na përjashtojnë..., — u dëgjua mes vargut një zë i mbytur.

Nazmiu, i zënë krah për krah me shokët, u kthye dhe i hodhi një vështrim të rëndë e kërcënues.

Në shesh u rreshtuan gjimnazistët dhe vajzat e shkollës «Donika Kastrioti», paraushtarakët dhe, më tutje, nxënës të shkollave të tjera e popull. As

këngë, as zhurmë nuk dëgjohej. Autoritetet fashiste, gjerarkët dhe, krah tyre, njerëzit e shitur, nxinin tribunën e ngritur në sheshin e prefekturës. Përballë tyre rreshtoheshin dhjetëra ushtarë italianë me helmëta të hekurta mbi kokë. Pas tyre, vinin milicët, balilat si korba, të cilët i jepnin sheshit një atmosferë të trishtuar.

Autoritetet u kënaqën për rregullin e disiplinën e vendosur. Sipas programit, filluan të këndonin «Xhiovinecën». Gjerarkët në tribunë, si dirigjentë prisnin të këndonte e gjithë turma. Inspektori i partisë fashiste Rikotini i kërcënoi nxënësit të këndonin. Por pas disa sekondash sheshi filloi Himnin e flamurit shqiptar, që doli nga gjokset e ngrohta si vlagë dheu. Pas pak një gjerark fashist filloi të fliste. Në këtë çast, shokët e caktuar dhanë sinjalin me këngën «O trima luftëtarë...» Nxënësit e pasuan duke krijuar një gjëndje sa qesharake, aq dhe tragjike për gjerarkët fashistë. Oratori pushoi. Shikoi mesin e turmës, nga ku buronte ai kor vërshëllimash si sirena alarmi. Me gjimnazistët u bashkuan dhe shegertët e punëtorët.

— Forca shokë, të gjithë njëzëri: Poshtë fashizmi! — thirri Nazmiu.

— Poshtë tradhtarët! — e pasoi Esat Gjyli me Qazim Lllazanin, dy shegertë të lidhur krah për krah me Nazmiun.

— Poshtë flamuri me sopatën e Liktorit!

Parullat e Nazmiut, Eminit dhe shokëve të tjerë pasoheshin nga turma entuziazte e nxënësve që u lëshuan si dallgë e kuqe. Toka dridhej nën rropatjen e këmbëve që shoqëronin parullat «Poshtë fashizmi!» Turma gjithnjë e më tepër mblidhej si një grusht. Zëri i Nazmiut bashkohej me buçimën e turmës. Atij

i dukej vetja shumë i fortë. Karabinierët sa vinin e ngushtonin rrethin e tyre. Nazmiu me shokë, me grushtet lart, dolën në ballë të turmës.

Përsëri oratori, me gjithë fuqinë e zërit mudohej të bënte zap turmën. Por ajo nisi këngën që gjëmoi furishëm, sikur po këndonte e gjithë Shqipëria:

*«O trima luftëtarë,
O bijt' e Skënderbeut,*

— Rroftë liria! — hodhi parullën një gjimnazist mbas Nazmiut. Nazmiu i futi krahun dhe e mori pranë vetes. Ishte «Erzeni».

— Rroftë! — jehonte e përplasej në të katër anët zëri i turmës.

Pas brohoritjesh kënga vijonte:

«Se mjaft në robëri...»

Turma, të rinj punëtorë, zejtarë, çirakë, nxënës e mësues të revoltuar, u gjallërua edhe më tepër. Gjerrakët u zverdhën në fytyrë. I përshkoi një hije e rëndë dëshpërimi. Turma gjallërohej më shumë, duke marrë flakë nga parullat e komunistëve.

Shkëlqimi i bajonetave, futja e ushtarëve dhe xhandarëve në veprim, e lëkundti disi turmën. Një pjesë çanë unazën e bajonetave dhe u larguan nga sheshi.

— Mbahuni, shokë! Shtrëngoni radhët! — u dëgjua zëri i Adilit.

Tani, kur mitingu u kthye në një demonstratë të vërtetë, buçiti si thirrje vargu: «Ngrihuni ju, o të munduar», që gufoi nga gjokset e komunistëve. De-

mostruesit u ngjitën njëri pas tjetrit. U bënë një barrikadë zemrash. Edhe popullin e rrëmbeu një valë zjarri kur shikonte bijtë trima me fytyra entuziazte e me sy të zjarrtë përballë armiqve të armatosur.

Pastaj, turma entuziazte dhe e revoltuar e la sheshin dhe bëri për nga rruga kryesore e qytetit, duke mos e ndërprerë demonstratën. Megjithëse shoqëroheshin nga një numër i madh karabinierësh e milicësh, me në krye kapiten Antikon vrulli i tyre vinte gjithnjë duke u rritur. Nga kalonin mostruesit, hapeshin dritaret e dyert e shtëpive dhe banorët me lot ndër sy përshëndetnin bijtë e bijat e tyre. Ata shkuan deri tek SESA. Bajonetat e çelikta nuk mundën ta shpërndanin menjëherë turmën e revoltuar. Ajo e vazhdoi demonstratën deri mbasdite vonë.

D ë n i m i

Prefektin e qytetit të Shkodrës e kishte mbërthyer një krizë nervash mbi ngjarjen «skandaloze» të asaj dite të «mallëngjyer» të 28 Nëntorit 1939. Ishte mbyllur në zyrën e tij e po mendohej të hartonte telegrame e shkresa për veprimet e «papëlqyera të nxënësve e punëtorëve», të cilat i kërkonte me përpikmëri dhe urgjentisht Ministria e Punëve të Brendshme.

Të nesërmen kapiteni i zyrës politike Anxhelo Antiko i paraqiti prefektit listën e mostruesve më të rrezikshëm duke shënuar emrat e Nazmi Rushitit, Emin Durakut, Tom Kolës e të tjerëve «...të cilët ishin gjithnjë në krye të çdo demonstrate kundrejt regjimit...» dhe «...u kishin prirë të tjerëve për të

bërtitur në mënyrë tallëse kundër federalit e kundër flamurit të ri...»

Prefekti, nga ana e tij, urdhëroi drejtorinë e gjimnazit të shtetit të merrte «masa të pavarura».

Atëhere drejtori i shkollës, Aldo Oneti, duke parë se rreziku më i madh vinte nga konviktorët, propozoi të pakësohej numri i tyre, duke përjashtuar disa dhjetëra nxënës konviktorë, që ishin dalluar në aktivitetet revolucionare komuniste, dhe konvikti të shpërngulej në kazermën «Drini», ku konviktorët do të jetonin si në një kamp përqëndrimi, të rrethuar me tela me gjemba, me qëllim që t'i kontrollonin më mirë dhe të mos infektonin nxënësit e jashtëm. Me gjithë këto projekte e masa paraprake, përsëri natën e 4 dhjetorit 1939, një grup nxënësish konviktorë, të udhëhequr nga Nazmi Rushiti, Emin Duraku e të tjerë bënë një demonstratë tjetër, duke thirrur kundër flamurit me shenjën e Liktorit dhe duke lëshuar parulla: «Nuk duam që armiku barbar vendin të na e pushtojë!», «Rroftë bashkimi!», «Rroftë drejtësia!» etj.

Kjo situatë e re alarmoi drejtorin e gjimnazit, i cili më datë 6.XII.1939 bëri mbledhjen e këshillit të mësuesve dhe përjashtoi nga internati për një muaj nxënësit Nazmi Rushiti, Emin Duraku, Tom Kola, Sadik Bekteshi etj. si «elementë turbullues, mbasi kanë shtyrë të tjerët të bëjnë demonstrata në konvikt kundër regjimit...» Ndërsa prefekti kërkoi që këta nxënës «të largohen nga ky qytet...» Gjithashtu drejtori urdhëroi që të qëndisnin në krah numrin e amzës, me qëllim që agjentët fashistë të ndiqnin më lehtë inisiatorët, lëvizjet nëpër qytet, rrugica e shtëpia ku mund të takoheshin.

Siç duket, ministri fashist, Maliq Bushati, nuk

u kënaq nga një dënim i lehtë. Prandaj ministri i arsimit, për të lartpërmendurit, «për fajin e bërë» urdhëroi që «... t'u pritet bursa dhe të përjashtohen nga institutet e mesme të mbretërisë për një vit».

Zyrat hetimore fashiste vazhdonin ndjekjet ndaj nxënësve kryesorë.

Disa minuta para arrestimit, Nazmiun me shokë i thirri drejtori :

— ...Kështu, pra, veprimet tuaja na detyruan të marrim vendimin që dëgjuat, — foli drejtori.

— Pikërisht këtu qëndron frika juaj, zoti drejtor! — ia ktheu Emini.

— Atëhere, për ju ka burgje, ka hekura!

— Aq na bën, zotni, kjo është logjika e armikut!
Por idetë e lirisë nuk ka asnjë prangë që t'i bëjë zap!
— foli Nazmiu i vendosur.

Atëhere drejtori nuk e zgjati më:

— Ty, Nazmi Rushiti, të privohet e drejta që të takohesh e të bisedosh me nxënësit e tjerë, kupton?

— Ju, zoti drejtor, mund të më përjashtoni nga konvikti e nga shkolla, edhe mund të më burgosni, por mendimet e mia, s'jeni të zotët të m'i frenoni, as të m'i ndaloni.

Kështu u nda ai nga drejtori fashist. Duke parë rrezikshmërinë e «organizatorit të demonstratave», këshilltari i përhershëm italian i policisë në Shqipëri, Xhuzepe Gueli, njoftoi se «...komisioni kompetent në mbledhjen e tij të datës 6 të muajit në vazhdim (fruer, 1940) ka dënuar me internim për dy vjet, për t'i vuajtur në Itali, të quajturin Nazmi Rushiti... vjeç 18...» Vuajtja e dënimit me internim fillonte nga data 17 dhjetor 1939.

Kështu nisën burgjet dhe internimet për Nazmi Rushitin me shokë.

Rreth dy javë i mbajtën në qelitë e burgut të Shkodrës. Pastaj i dërguan në burgun e Tiranës. Po ata gardianë që u hapën portën e burgut zogist, po ata hapën edhe dyert e burgut musolinian. Po ata oficerë dhe nënoficerë. Vetëm me një ndryshim: në uniformat e tyre të zeza, zbardhnin sopatat e Liktorit. Po ato qeli, po ajo e ftohtë. Veçse kishte kuestorë e plot italianë.

Në burgun e Tiranës i mbajtën 50 ditë. Këtu kaluan prova të reja të metodave fashiste.

...— Lëreni kokëfortësinë, djalosh. Me ju sillemi ndryshe. Ju jeni nga ata që mund të kuptohemi, — e merrte me të mirë kuestori.

Por Nazmiu nuk fliste. Ishte mësuar me këto. Të gjitha metodat kishin përdorur mbi trupin dhe shpirtin e tij. Nazmiut tani i dukej vetja më i madh, më i fortë, më i vendosur.

— Burgu do t'ju kalbë... Më vjen keq, kaq i ri.

Në sytë flakë të Nazmiut, dukej mirë e qartë këmbëngulja e komunistit. Vetullat e nofullat i shtrëngoi fort:

— E cili burg mund të mposhtë komunistin, zoti kuestor? — ndërsa grushtet i mbetën mbledhur, derisa dy karabinierë e tërhoqën dhe e përplasën në qelinë e akullt.

Vatra mbeti e ndezur

Kumbimj i mërzitshëm e i rëndë i këmbanave të kishave sikur thërrisnin për «paqe» mbi tokë. Ora e katërt e mësimit mbaroi. Nxënësit u grumbulluan në oborr të gjimnazit. Ata ishin bërë gati për aksionin. Shumë nxënës, të zemëruar nga arrestimi i Nazmiut

me shokë, për disa ditë nuk morën pjesë në mësim. Gjithë dhjetori i 39-ës kaloi me revolta.

— Të ngrihemi kundër krimeve të fashistëve. Të solidarizohemi me shokët tanë që torturohen nëpër burgje... — u tha Adili tre shokëve në hyrje të gjimnazit. Ata sa ishin kthyer nga burgu, ku kishin dërguar ndihmat me mësuesin Sulo Halili.

— Po vjen mësuesi! — thirri njëri me sa fuqi kishte nga dera e shkollës. Për një çast oborrin e mbuloi qetësia.

— Xhandari i gjimnazit, thuaj! — u dëgjua zëri tjetër.

— Spiuni i fashistëve! — tjetri.

Mësues Banda ishte bërë i padurueshëm për gjimnazistët. Një grup të rinjsh u derdh drejt tij.

— Mësues Banda e paraqet partinë e fashios si mbrojtëse të lirisë. Përse atëhere i burgos shokët tanë? — foli Bardhok Biba në krye të gjimnazistëve.

Mësuesi fashist doli në derë të shkollës.

— U ka plasur cipa nga marrëzitë! — tha nëpër dhëmbë mësuesi tërë inat, duke iu dridhur buza, pas debatit në klasën e 4-të në orën e mësimin. — Unë i njoh turbulluesit...

— Buf pulash! — thirri njëri që bëri të qeshnin disa nga turma.

— Doni të shkoni te shokët! — tha me qesëndi duke u munduar të fshihte kërcënimin.

— Spiun! — e kërcënoi njëri nga të rinjtë.

Nga mesi i nxënësve dolën Adili, Bardhoku e Sulo Halili.

— Na lironi shokët! — thirrën menjëherë Birçe Sinemati me «Erzenin», që çanë turmën e dolën dhe ata në ballë të protestës.

— Duam shokët! — e pasoi turma e nxënësve të zemëruar.

Mësuesit i buluan pika djerse në ballin e zverdhur.

Ishte 30 janari i vitit dyzet.

Adil Çarçani shtrëngoi grushtat dhe u sul përpara: «Duam shokët!» Pas tij u nis «Erzeni» dhe gjithë turma si dallgë: «Na lironi shokët!». Sytë u qenë ndezur nga urrejtja. Sakaq një heshtje e ftohtë mbretëroi në oborr. Papritur turma iu lëshua mësuesit dhe e gjakosi. Banda i tmerruar me zor u çlirua nga grushtat.

Shkodra ishte me demonstruesit. Ajo kishte dalë të shikonte rininë e vet.

— Zjarrin e lanë të ndezur! — tha njëri nga populli, duke kujtuar komunistët e burgosur.

Fashistët u grumbulluan me alarm. Milicë e karabinierë rrethuan turmën. Nëndrejtori i gjimnazit, Larja, zbriti në oborr për të qetësuar revoltën, por u largua si mi i lagur, duke mërmëritur:

— Rebelat do ta paguajnë sjelljen e paturpshme!

Mbas tij, i siguruar nga rojet, doli drejtori Aldo Oneti. Tri skuadra të tjera karabinierësh hynë në oborr. Turma e të revoltuarve u mblodh si një grup i vetëm.

— Ne do të luftojmë e do të mbrohemi! — hodhi parullën një komunist.

— Kështu do ta bëjmë! — buçitën dhjetëra zëra nga turma që lëvizte si valë e kuqe.

— Dua të bisedoj me ju, — tha Oneti.

Qetësia u vendos. Drejtori i hodhi një sy turmës. Dukej se ishte i lodhur nga nervat. Ai u bë gati të fliste, por një zë i ashpër e i fuqishëm e detyroi të mos hapte gojë.

— Përse, zoti drejtor, i burgosët shokët tanë?

— Ata nuk kanë bërë krime!

Drejtori dëgjoi shumë pyetje kërcënuese. Ai e kuptoi vendosmërinë e atyre zërave.

— Të arsyeshmit nuk kërkojnë rrugën e forcës!
— këshilloi ai me zë të mekur.

Papritur një nga demostruesit teshtiu fort. Demonstruesit u shkulën së qeshuri. Drejtori italian uli kokën e bëri mbrapsht i ofenduar.

Syri i spiunit kapi 100 nxënës, të cilët i burgosën. 25 më «të rrezikshmit» i dënuan. 70 konviktorëve të konviktit «Malet tona» iu pre bursa. 20 spiunë të SIMI-it të veshur civilë u futën në konviktin «Malet tona» dhe kontrollonin jetën e nxënësve brenda dhe jashtë konviktit.

Kjo masë e autoriteteve e rriti në kulm valën e zemërimit. E dinin se dhe këta i kërcënonte burgu, por pa frikë e me besim mbanin të ndezur vatrën revolucionare që lanë shokët e burgosur.

Të nesërmen zilja në «Malet tona» thërriste për të ngrënë, por asnjë nuk lëvizte. Tavolinat e mensës mbetën të shtruara me bukë. Asnjë nuk u afrua të shuante urinë.

Trazirat vazhdonin.

NË BURGJET E ITALISË

Në ditët e fundit të marsit të vitit 1940, vapori «Santa Luçia» çau valët e egërsuara të detit Adriatik. Nuk e dinin ku po i çonin. Shikonin njëri-tjetrin sikur pyesnin: «Ku do të na internojnë?» Një zë i njohur tingëlloi: «Ç'është kjo zi?» Nazmiu u çel në fytyrë.

«Mos të na lëshojë zemra, vëllezër!» — thirri ai. Dhe të lidhur siç ishin, kënga e tyre shpoi errësirën e natës.

— Le të na dërgojnë ku të duan! Ne nuk mposhemi, jo! — u ndie një e thirrur, ndërsa të tjerët këndonin.

— Shpejt do të kthehemi të luftojmë bashkë me popullin! — e pasoi Nazmiu dhe kënga buçiti edhe më entuziazte.

Në Bari arritën në të aguar. I futën në një makinë si qeli dhe i mbyllën në burg. I kontrolluan, u shkulën kopsat, u hoqën rripat e mesit dhe lidhëset e këpucëve. Një muaj e ca ditë provuan jetën e rëndë e të vështirë të burgut.

Një ditë në drekë, një gjerark fashist ndenji aty që të shikonte nëse të burgosurit nderonin alla romanente. Nazmiu me shokët e tij nuk përshëndeti. Atëhere gjerarku, gjithë pompozitet e cinizëm,

urdhëroi të vuanin dënimin. Dy gardianë u nisën për në qeli.

— Zhvishu! — e urdhëroi gardiani i burgut me brutalitet, duke dashur ta kontrollonte imtësisht.

Nazmiu e shikoi me urrejtje e përbuzje. Pas gardianit qëndronte hetuesi i burgut.

— Kupton? Zhvishu! — thirri fort hetuesi.

— Shporruni këtej! — u revoltua Nazmiu.

— Ky është hetuesi! — ndërhyri gardiani.

Nazmiu e vështroi me mospërfillje.

— Unë jam i burgosur politik. Qartë? Ç'kërkoni?

Gardiani e goditi me grusht. Hetuesi e pyeti:

— Komunist?

Nazmiu u mendua pak. E kuptoi rrezikshmërinë e pyetjes së tij. Pastaj ia ktheu qetë:

— Komunist!

Grushti i gardianit u përplas përsëri me forcë mbi fytyrën e tij. Ky ishte prologu i torturave në burgjet e Italisë, në strofkën e fashizmit.

Nazmiu dhe shokët e tij vuajtën në burgun e Barit, që ishte një nga më të tmerrshmit. Aty mbaheshin të mbyllur e torturoheshin antifashistët italianë dhe të kombësive të ndryshme. Disa ditë e mbajtën të izoluar nga shokët, të vetëm, në errësirën e qelisë pa shtroje. Çdo gjë, çdo orendi, si stola, tavolina e të tjera ishin të bëra prej çimentoje, qëllimisht që të dënuarit të vuanin sa më shumë. Në rast se dilnin nga burgu, të ishin të sakatuar fizikisht.

Vetëm një dritare të kryqëzuar me hekura kishin qelia. Përmes saj shikonte qiellin e copëtuar. Syri i gardianit nga dritarja «spion» e derës gjuante çdo lëvizje. Fryma i zihej në birrucën si arkivol. Hesh-tjen e qelisë e prishte vetëm tingulli i hekurave, kur

i nxirrnin të burgosurit në oborr për të bërë shëtitjen. Mundoheshin të këmbenin ndonjë fjalë, por rreth tyre kishte gardianë me armë, hekura qelish dhe zinxhirë. Këta u kishin rrëmbyer gjithshka, vetëm fuqinë morale jo.

Nazmiu, megjithëse të shumtën e kohës qëndronte në këmbë që të mbrohej nga lagështira dhe të ftohtit e çimentos, prapë u sëmur nga zemra.

Në Ventotene

Më 17 prill 1940, të rrethuar nga bajonetat fashiste, Nazmiun me shokë i nisën për në ishullin Gaeta dhe prej këndej, në Ventotene. Ishte natë, një natë e egërsuar me rrebeshe shiu, mes detit të trazuar.

Mëngjezi zbardhi. Të burgosurit dolën në kuvertë të anijes së vogël.

— Ja ishulli Shën Stefano.

— Ku e di ti?

— Dëgjova një roje tek po fliste me shokun e tij, — tha Tom Kola me gjysmë zëri.

— Po ai tjetri, më në thellësi? — pyeti një tjetër me kureshtje.

— Ventotene, — u përgjegj një italian që ndodhej pranë. Si Ventoteneja, edhe Shën Stefanoja dukeshin të errët, si të ishin dy përbindsha që kishin nxjerrë kurrizin e murmë nga thellësitë e detit.

Agimi i zyrtë, me re, që silleshin si kalorës të zinj nëpër qiellin e pafund, i gjeti pranë ishullit të vuajtjeve, ishullit të thatë, me emrin famëkeq: Ventotene. Këtu fashistët kishin ndërtuar kampin «CON-

FINATO POLITICA» shumë kilometra larg, në përrëndim të Napolit.

Anija iu afrua Ventotenes. Ca barka u shkëputën me shpejtësi nga bregu i ishullit dhe iu afruan anijes. Ata lëshuan shkallët, dhe të internuarit shkëlën në tokën e shkretuar.

Natyra e thatë krijoi tek të internuarit mërzhitinë, ndonëse pa shkelur ende të gjithë në ishull. Nazmiu njohu plot shokë, shumica e të cilëve ishin të rinj. Kishte edhe të moshuar, me mjekra të zeza e të parruara.

Rreth tyre u grumbulluan mjaft të internuar. Një i internuar flokëverdhtë me sy të kaltër plot gjallëri, i hollë e i gjatë, i foli i pari Nazmiut. Ishte Skënder Çaçi.

Ata u shtrëngonin duart të porsaardhurve me buzëqeshje e dashmirësi. Rreth tyre silleshin plot milicë këmishëzinj.

Në brigjet e ishullit të afërt Shën Stefano nxinte kështjella e ndërtuar që në kohën e Jul Qezarit për kundërshtarët e tij. Ajo fshihte në muret e saj të errëta, të burgosurit politikë. Rrotull kështjellës, si pjellë e mëvonshme e saj, shtriheshin kazermat. Era frynte dhe ulërinte vazhdimisht, saqë ngrinte lart, si masa resh, rërën e thatë të ishullit dhe guralecët e tij.

* * *

Federali fashist, së bashku me kuestorin e kampit, qysh në muajin e parë donin t'i njihnin këta komunistë shqiptarë. Veçanërisht kuestorit i kishte

bërë përshtypje miqësia që kishte Nazmiu me komunistët italianë. Prandaj bënte plane që të minonte e të përcante këtë miqësi.

Nga stiva e dosjes, ndau në një rënë anë dosjen e Nazmi Rushitit, Emin Durakut, Xhezmi Dellit. Skënder Çaçit etj. Federali dhe kuestori hapën postën që erdhi. Një rënë prej dosjeve filloi ta lexonte me kujdes. Ishte ajo e Emin Durakut. Federali, duke ngulur sytë e tij mbi dosje, e duke parë fytyrën burrërore të komunistit, që ende nuk i kishte mbushur 22 pranverat, por që dukej si dyzetvjeçar nga vuajtjet e torturat, solli ndër mend dialogun që zhvilloi me Eminin dy ditë më parë, bisedë e cila u bë shkaku që ky i fundit të mbyllej në një nga qelitë e kazermës.

— E doni vendin tuaj? — pyeti federali, duke picërruar sytë.

— Për këtë na mbani të internuar!

— Ne të lëmë të lirë... po ti të heqësh dorë nga idetë e tua komuniste.

— Nuk e dua atë liri, zoti drejtor! Njëqind vjet më mbani të internuar! Me bindjet dhe idetë komuniste do të jetoj gjithmonë! — iu përgjegj Emini dhe shikoi federalin si shqiponjë, me ca sy që shprehnin një botë, të cilën federali nuk kishte fuqi ta kuptonte. Pastaj kuestori u kthye të shikonte dosjen e Nazmi Rushitit, «komunistit të rrezikshëm». Në fund të dosjes pa shënimin nga «Zëri i të internuarve» dhe ia dha federalit, i cili lexoi me zë: «Nazmi Rushiti, stude. Fanatico seguace di doctrina estremiste. Elemento perturbatore!»¹⁾

Të nesërmen, ashtu si e kishte zakon këmishë-

1) Fanatik konsekuent i doktrinës ekstremiste. Element turbullues.

ziu, bashkë me federalin, e thirrën Nazmiun në zyrë. Në fillim federali bëri politikë duke i folur për fashizmin, për qëllimet e mira që kishte fashizmi në Shqipëri, e të tjera si këto. Por Nazmiut nuk iu prit sa të mbaronte ai ligjëratën e vet demagoge, por iu përgjegj me një buzëqeshje sarkastike:

— Ju faleminderit shumë, zoti federal, që më dhatë mundësinë të vi e ta njoh fashizmin në vendin e vet, pasi në vendin tim e kam njohur me kohë!

— E ke të qartë se për ç'fajje je dënuar?

— Sepse jam i pafajshëm...

— Si i pafajshëm? Edhe i dënuar politik, edhe komunist, edhe... edhe i pafajshëm?!

— Po, zoti kuestor, mos u habitni, ne komunistët jemi të pafajshëm!

Dera e qelisë u hap në orët e vona të natës, si në mesnatë kur inkuizicioni dënonte kundërshtarët e kishës.

Bashkë me dy rojet e shoqëroi në qeli dhe kuestori.

— Pendohesh? — i tha kuestori me djallëzi.

— Kështu do ta nisja jetën po ta filloja dhe njëherë, zoti kuestor!

Kuestori bëri mbrapsht. Pas tij rojet i futën llozin e hekurt derës.

Federali me kuestorin u bindën për «drejtësinë» e opinionit të shokëve të tyre në Shqipëri mbi Nazmi Rushitin. Prandaj, jo më kot, në çdo hap, Nazmiun e ndiqte syri tinzar i spiunëve ushtarakë e civilë.

Pas apelit

Të internuarit u shpërndanë, sheshi i apelit u bo-shatis. Katër vetë zunë qoshen e kazermës. Tom Kola ruante në anën tjetër. Pas pak erdhi dhe Emini. Ata e vështronin të menduar shokun me mjekër që ishte 20 vjeç e dukej i plakur, i tretur, me pamje herë të butë e herë të egër e të zyrtë, që kthjellohej vetëm kur ishte duke biseduar me shokët. Balli i tij tërë rrudha të thella vuajtjeje dukej nervoz. Shokët, duke parë atë, shikonin veten. Por ata as burgu nuk i theu.

— Ka grindje në grupin edukativ? — iu drejtua Abdyli Sadikut, i cili kishte organizuar ilegalisht në kamp kursin e filozofisë.

— Sigurisht. Ka mendime të kundërta që ndezin konfliktin.

Nazmiu i dëgjonte në heshtje.

Pranë shokëve erdhi dhe Skënder Çaçi. Nazmiu e gjeti në kamp këtë komunist. Skënderi me shokë ishte në akademinë ushtarake të Torinos. Kur u push-tua Shqipëria nga fashizmi italian, donin të kthehe-shin në atdhe. Por fashistët kërkonin që këta të kthe-heshin oficerë të italianizuar që të mbështetnin po-litikën koloniale fashiste. Fashistët i sollën në Romë për të bërë betimin për mbretin perandor. Atë kohë Skënderi u bëri thirrje shokëve:

«Vëllezër, ne nuk patëm fatin ta mbrojmë at-dheun me pushkë. Lufta jonë është të mos betohemi për perandorin edhe para çdo kërcënimi!» Dhe thi-rrja e tij u bë vendim.

Kur komandanti i shkollës ushtarake të Romës lexoi tekstin e betimit, në vend të përgjegjes «beto-hemi», sundoi heshtja e varrit.

Pikërisht për këto arsye Nazmiu mbante shoqëri të ngushtë me Skënderin dhe shokët e tij.

— Është mirë të ketë zënka midis të internuarve për çështje politike? — vazhdoi Skënderi.

— Në ideologji ka dhe do të ketë, — foli Nazmiu.

— Patjetër. Oportunizëm jo, — ndërhyri shoku i Nazmiut.

Nazmiu pohoi me kokë. Pastaj, kur kujtoi grindjen me trockistin, u hodh:

— Ja tradhtari, Zai Fundo, ky këlysh trockist, u kishte thënë Tomit e Haki Fejzos, duke shpifur me paturpësi se «...në Bashkimin Sovjetik ka mbivlerë...»

— Ata i thanë: «Provokator, maskara intelektual!»

— Dhe ti me Eminin i dhatë një dackë të fortë. Të gjithë qeshën.

— Të mos biem në kurthet e tij. Ata që tradhtojnë klasën punëtore, t'i luftojmë. I kishte mbetur peng qenit pse e kishit quajtur «tradhtar të Kominternit e të lëvizjes komuniste në Shqipëri.» Dëgjoni, vëllezër, këtu jemi pak komunistë. Në kamp ka lloj-lloj njerëzish me mendime e ide të ndryshme. Edhe armiq ka plot, — dhe vështroi shokët me radhë.

Shokët kishin një varg provash. Të internuarit politikë i zbulonin provokatorët dhe spiunët. Ndoshta i vinin gishtin dhe ndonjërit që nuk ishte i tillë. Prandaj komunistët e kampit i shoshitnin mirë punët.

Ndërkaq Tomi njoftoi se tre të internuar shqiptarë i thirri kuestori. «Si duket incident nga spiunët» — u tha ai. Biseda u ndërpre. Pas kazermës tjetër u dukën dy provokatorë. Ata u shpërndanë. Këto ishin të zakonshme në kamp. Të internuarit e tjerë nëpër

kazerma po luanin bixhoz, ca lexonin ose komentonin gazetën.

Në orët e lira, sidomos pas apelit të mbrëmjes, Nazmiu me shokët shkonin nëpër bujtinat e kampit, bisedonin me të internuar të ndryshëm. Ai tani kishte një përvojë të mirë revolucionare.

Me forcën e idealit, ata mposhtën çdo vështirësi, edhe urinë e shtruar në kamp, ku jepej vetëm një racion i vogël buke. Supa prej barishtesh e makaronash me krimba ishte ushqimi i përditshëm. Kjo bëri që disa të internuar të katandiseshin keq, të dobësoheshin nga uria.

Për këtë, Skënder Çaçi, i ndihmuar nga Nazmiu me shokë, organizuan ndihma për të internuarit e uritur, që s'kishin të ardhura. Ata u kujdesuan që të përmirësonin ushqimin për të sëmuret dhe për të dobët fizikisht.

Një pjesë të internuarish, sidomos italianë silleshin rrotull kuzhinës me pamje të mjerë e të dëshpëruar për të mbledhur e për të ngrënë mbeturina që hidhte kuzhina. Si rrjedhim, sëmundje të ndryshme binin herë pas here në kamp dhe rrezikonin jetën.

Iniciatori numër 51

Nazmiu sapo mbaroi së lexuari thirrjen e Gjergj Dimitrovit drejtuar në emër të Kominternit proletarëve të të gjitha vendeve të botës, për luftë kundër fashizmit. Era pushoi. Koha sikur u ngroh pak. Qëndroi, me shikimin tretur larg në horizont. Qëndroi aty ku ishin futur themelet e kështjellës famëkeqe të Ventotenes. Vështronte shkumën e bardhë të valëve që përplaseshin me forcë mbi masat e mëdha të

gurëve gjithë myshk të kështjellës. Tej, në sfondin e përhimtë dimëror të shkurtit 1941, një aeroplan dukej se kërkonte të ulej mbi ishull. Pastaj mori vrull përsëri drejt qiellit, me një zhurmë çjerrëse, derisa më në fund u shndërrua në një pikë të vogël e të zezë. Edhe kjo zhurmë nuk i trazoi mendimet e Nazmiut. Mendja e tij, edhe këtë herë ishte arratisur, larg, drejt atdheut.

«Po mbush vitin. Edhe për gurët e drurët më mori malli!» — sikur i thoshte valës që ngrihej trape-trape e shtrihej deri te këmbët e tij. Ca zëra u përzien me zhurmën e valëve. Nazmiu ktheu kokën. Shokët po vinin. Midis tyre shquajti komunistin italian dhe napoletanin Nelko, me kitarrën krahëqafë. Komunisti italian vinte i shkurtër me trup, me sy të kaltër e të rreptë, gjithmonë të menduar.

— Gjithmonë i arratisur, ti Nazmi! — i foli me të qeshur komunisti italian, ndërsa po zinte vend pranë tij.

Pak më tej u shqua trupi i Tom Kolës.

— Hej, vëllezër! Erdhën libra të Marksit, Leninit, Gorkit..., — lajmëroi ai.

— Kush i solli?

— Nga Napoli. Një kovaç që banon në ishull. Kjo është puna e komunistit italian.

Sado të sigurtë që qenë telat rrethues të kampit fashist, karabinierët nuk mundën të ndalonin çdo liri. Idetë e disa autorëve të librave shpuan muret e burgut. Nazmiu, si dhe shokët e tjerë, edhe në burg nuk pushonin së punuari për çështjen e lirisë të popullit. Ai u shkruante shokëve letra me këshilla, udhëzime e thirrje për luftë. Këto i shkruante në mënyrë figurative, me gjuhën e Ezopit. Në internim ai stud-

joi filozofinë materialiste, ekonominë politike, Manifestin Komunist, Anti-Dyringun etj.

Pranë tyre kaluan rëndë-rëndë dy milicë, njëri prej të cilëve shtrëngonte një kërbac-gërshet në dorë. Ata u larguan bregut të detit. Milicët i ndiqnin kudo hapur e të maskuar komunistët e deklaruar. Po në këtë cak, para ca muajsh, Nazmiu dhe komunisti italian i kishin hapur zemrat njëri-tjetrit. Që atë ditë u lidhën me një shoqëri të ngushtë, bazë e së cilës ishin idetë përparimtare komuniste. Mes të tjerash, Nazmiu i kishte folur për rritjen e lëvizjes punëtore në Shqipëri, për grupet komuniste, për Ali Kelmendin, Halim Xhelon. I kishte folur edhe për luftën ideologjike, që zhvillohej brenda grupeve komuniste, kundër elementëve fraksionistë, oportunistë e trockistë. Komunisti italian kishte ndjekur me interes edhe kontributin e dhënë nga shqiptarët në Luftën e Spanjës. Prandaj ky shoqërohej e bisedonte me komunistët shqiptarë për çështje të ndryshme shoqërore dhe politike.

Dielli po perëndonte. Një nga një, bashkë me shqiptarët, u mblodhën të internuar nga të gjitha kombësitë. Shqiptarët ia morën këngës «O moj Shqipëri, e mjera Shqipëri...» Kitarristi Nelko mendohej t'i shoqëronte me kitarë.

Sapo mbaroi kënga, Nazmiu hodhi parullën:

— Rroftë liria!

— Poshtë prangat mizore! — e ndoqën edhe të tjerët. Këto thirrje hynë nëpër oborrin mes kazermeve. Drejt bregut shkëmbor ecnin të burgosurit me numra të bardhë në jakat e xhaketave. Me dy të huaj u afrua edhe provokatori Zai Fundo. Pa ata që këndonin e hidhnin parulla dhe, si qen i lagur, u kthye mbrapsht. Pas tij u ngjitën edhe tre shqiptarë.

Zai, duke u larguar, shikonte karabinierët që po vraponin drejt të internuarve. Më tutje, kuestori e përshëndeti me një «buona sera» të shpejtë e të shqetësuar. Zai nuk pati kohë për shpjegime. Ai vetëm i pëshpëriti në ecje:

— Iniciatori numër 51, sinjor kuestore!

Nazmiu po u fliste të internuarve:

— Fashizmi dhe nazizmi gjerman nuk do ta kenë jetën të gjatë. Prandaj të mbahemi, të mos dëshpërohemi, vëllezër! Shqipëria është jona, ne do ta gëzojmë! Armiku, përkohësisht është shtruar nëpër vatrat tona. A mund ta pengojë njeri lindjen e Diellit? Jo! Prandaj, sadoqë fashistët të mundohen për errësirën, liria do të lindë...»

Të internuarit e ndiqnin me vëmendje. Disa ishin ulur, të tjerë qëndronin më këmbë, me trupat e mbështetur te njëri-tjetri. Kuestori, me njëren dorë mbante kërbacin, ndërsa dorën tjetër e mbante te revolveri që kishte mbërthyer për brezi. Ai vraponte me të katra andej nga vinte zëri. Nazmiu tani po fliste italisht:

— Ne jemi vëllezër! Interesi ynë i përbashkët është që të luftojmë kundër padronëve dhe tiranëve fashistë...

Qindra sy kureshtarë ndiqnin komunistin shqiptar. Ca italianë e morën dhe e ngritën në krahet e tyre. Napoletani Nelko thirri me sa i hante zëri:

— Viva l'Albania!¹⁾

Të tjerët përsëritën njëzëri.

— Viva il popolo albaneze!²⁾

1) Rroftë Shqipëria!

2) Rroftë populli shqiptar!

Kuestori dhe milicët sapo mbërrinë kur të inter-
nuarit filluan «Internacionalen». Ata i kërcënuan, u
futën mes tyre me bajoneta, por këngën nuk mun-
dën ta ndalonin. Teksti kumbonte në gjuhë të ndry-
shme, por përmbajtja ishte e njëjlojtë dhe shtrihej
në një mënyrë harmonike.

Kuestori e njihte tanimë mirë numrin 51, ndësh-
kimet e të cilit i kishte në rendin e ditës.

A g r e s i o n i

Vinçenco Kalabrezi arriti me një frymë në she-
shin e apelit. Kontrollloi me sy andej-këtej dhe iu
afrua numrit 51.

— Vëlla Nazmi, nazistët kapërcyen kufirin so-
vjetik, — kaq i tha dhe u largua.

Nazmiut iu duk se diçka e rëndë e goditi papri-
tur në kokë. Atdheu i sovjetëve, i Leninit dhe i
Stalinit, ishte sulmuar nga hordhitë hitleriane. E
priste këtë agresion, megjithatë ky lajm e tronditi
shumë. Nuk deshi ta besonte. Emini e kuptoi nga
ngrysja e fytyrës së tij, se diçka e madhe dhe e rën-
dësishme do të kishte ngjarë.

— Plasi, Emin! — i foli i dëshpëruar dhe në fy-
tyrën e tij u gdhend një pamje edhe më e ashpër,
por e vendosur. — Lajmëro gjithë shokët e grupit.
Sot filloi lufta në vendin e sovjetëve.

— Ndoshta është nga ato gënjeshttrat që përha-
pin vetë fashistët! — tha Emini.

— Jo, vëlla, është e vërtetë! E dëgjoi në radio
Vinçencoja. Shokët nuk duhet të krijojnë iluzione

ndaj gënjeshtreve të fashistëve. Dhe, në veçanti, të kemi kujdes të lëkundurit.

Emini s'mundi të hapte gojë më tej, ai mbeti si i topitur me sytë të këmbët, kur dhe autoritetet fashiste me anën e altoparlanteve dhanë lajmin e agresionit.

— Po, Nazmi. Kampi ka të internuar me pikëpamje të ndryshme politike. Komunistë të vërtetë janë pak. Tani, më shumë se kurrë, duhet bashkimi.

Sirena ra për apelin e datës 22 qershor të vitit 1941.

«A v o k a t i»

«Avokat» — kështu i mbeti kjo nofkë këtij të internuari, se hynte në polemikë me komunistët për probleme të ndryshme, saqë të internuarit ia harruan edhe emrin e vërtetë. Ishte intelektual nacionalist, pa ide të përcaktuara.

— Si do të vejë puna në Lindje? — pyeti ai Nazmiun.

— Si do të vejë? Ju gjykonit se nuk do të kishte luftë në Lindje! — qeshi Nazmiu.

— Interessant! Si e parashikoni ju, komunistët, këtë luftë? Dhe cili do të jetë fundi, vallë?

Për çdo problem, atë e shqetësonte fundi. Por kërkonte përgjegje për një fund që i pëlqente atij.

— Fundi? — qeshi përsëri Nazmiu. — Ju, zoti «avokat», mendoni se Italia fashiste dhe nazizmi gjerman do ta fitojnë këtë luftë? Fitoret e fashistëve dhe nazistëve, janë të përkohshme. Popujt do të

kundërsulmojnë. Kjo luftë do të lindë një botë të re! Edhe Shqipëria do të jetë e re, komuniste! — foli plot optimizëm Nazmiu, duke i rrahur shpatullat.

«Avokati» mori një pamje të trembur. Nëpër fytyrën e tij të dobët, u dukën edhe më shumë shenjat e urisë.

— Po, po, mund të keni të drejtë! — belbëzoi dhe mori frymë thellë si i mundur nga kjo bisedë.

— Komunistët janë të mirë, por nuk mund t'i kuptoj, mor djalë! — tha «avokati» në fund të bisedës, duke iu afruar edhe më Nazmiut.

Sirena, që u dëgjua, alarmoi gjithë kampin. Të internuarit vrapuan në rresht. Bëhej apeli. Tri herë në ditë bëhej apeli. Rrinin në këmbë. Edhe orët e lira, të internuarit, në këmbë i kalonin. Të uleshe ishte e ndaluar. Kështu thoshte rregullorja e kampit. Po të vihej re se mungonte një i internuar, të tjerët do të prisnin në rresht derisa të gjendej ai. Fashisti thërriste numrat e të burgosurve ngadalë dhe në mënyrë monotone. Dielli digjte si saç i nxehtë. Të internuarve po u binte të fikët. Nga njëra anë e turmës, njëri shau rëndë nëpër dhëmbë. Nazmiu ktheu kokën dhe, i gëzuar, vështroi njeriun që lëshoi atë të sharë. Ishte «avokati».

Iu duk se pikërisht atë çast «avokati» hodhi hapin e parë në botën e re. Pas apelit, «avokati», i shoqëruar nga roja, u mbyll në dhomën e izolimit.

«Avokati», që një ndër të shumtët, të cilëve Nazmi Rushiti dhe komunistët e tjerë u tregonin rrugën e luftës e të jetës.

N d ë s h k i m i

— Osmani, Nazmi, — lajmëroi Toma.

— Po dy të tjerët, që ecin me kokën ulur?

— Ndueja dhe Xhemali. Kalabrezi Vinçenco më porositi që të kemi kujdes prej tyre, — sqaroi Toma. — I kishte parë me sytë e tij ata duke hyrë në kuesturë. E ç'punë do të kishin në kuesturë ata, veç punës së ndyrë?

— I bashkon një rrugë...

Vinçençoja ishte me origjinë shqiptare. Katragjyshërit e tij ishin shpërngulur nga atdheu pas vdekjes së Skënderbeut. Ai ruante për atdheun e largët atë dashuri, të mburjtur nga prindërit e tij mes legjendash, dokesh e zakonesh.

Shokët prisnin rastin të ndëshkonin spiunët. Kështu vendosën.

Tom Kola e rroku Nduen pa rënë në sy të kuestorit. Nazmiu me shokë ia bënë kurrizin më të butë se barkun. Vinçenco Kalabrezi nuk kishte gabuar. Ndueja e pohoi vetë kur u ndodh në duart e hekurta të komunistëve.

— Kjo që hëngre është pak, qen! Nesër ne do të kthehemi në atdhe, kurse ty do të të hanë peshqit e detit Tirren, në qoftë se do të vazhdosh këtë rrugë të fëlliqur! — i tha Nazmiu spiunit.

Sadiku ishte dobësuar shumë nga uria dhe torturat. Nazmiu dhe Emini bënë të gjitha përpjekjet që ta ndihmonin shokun e tyre. Edhe Tom Kola e të gjithë shokët e tjerë ishin të alarmuar. Si mund të shpëtohej shoku? Kishte vetëm një mundësi. Me anën e rojeve të burgut.

— Si u bë natë, dy shokë iu afruan rojes që do të merrte shërbimin e natës dhe e kapën për krahu.

— Dëgjo, Vinçenco. Një shok e kemi në birra-cë. A do të na ndihmosh? — i foli Emini.

— E di. Është ai kokëshkëmbi. Kuestori është bërë si i çmendur, — foli Vinçençoja dhe u fut në qoshen e kazermës për të mos u dukur. Kalabrezi ishte frikësuar shumë ato ditë. Madje komandanti i kampit e kishte kërcënuar me burg nëse do të bisedonte me të internuarit.

— Ti duhet të na ndihmosh, Vinçenco! Ai është keq, shumë keq, kupton? — i foli shpejt e shpejt Emini.

Roja e vështroi si me frikë Eminin e parruar dhe foli:

— Epo çfarë të bëj? Po koka ime? Budalla jam unë? — tha me një zë të përvajshëm, sikur të kërkonte mëshirë prej tyre.

Të dy shokët ngulën këmbë në kërkesën e tyre.

— Vinçenço, ti je shqiptar! A mund të qëndrosh duarlidhur kur ai po vdes urie? — i foli këtë herë Nazmiu, dhe zgjati drejt tij një pako me ushqime.

Kalabrezi e pa njëherë pakon dhe, pasi hezitoi një çast, ia rrëmbeu nga dora, e futi nën xhaketë dhe u largua pa folur asnjë fjalë. As vetë nuk e kuptonte se çfarë fuqie e tërhiqte që të ndihmonte komunistët shqiptarë. Ishte ajo dashuria e mërgimtarit, apo ajo që i mbollën në shpirt këta komunistë?

*

* *

— Kalabrez, si është koha? — e pyetën Nazmiu dhe Emini (ishte fjala për Sadikun).

— Retë janë grumbulluar për furtunë, — u përgjegj Vinçençoja, i cili ecte i plogët e i ngrysur.

Një anije priste e ndezur, gati për udhëtim, në lindje të ishullit, me ballin drejt Napolit. Nazmiu e kuptoi lojën e fashistëve. Ata donin ta ndanin Sadikun nga shokët. Si ecën dhe pak e u fshehën pas një grumbulli me rërë të grumbulluar nga era, Nazmiu iu drejtua Vinçencos:

— E vërtetë, kalabrez?

— Do të vuajë në burgun e Napolit.

Të gjithë e morën vesh. Sadikun po e ndanin nga shokët. Bregu i ishullit, sakaq u bë një pazar i vërtetë nga të internuarit. Ata përshëndesnin shokun e tyre të vuajtjeve. Nazmiu dhe Sadiku u përqaftuan, u puthën. Këta dy komunistë kishin provuar burgje e tortura nga më të ndryshmet e nuk ishin tronditur asnjëherë, kurse tani sytë e tyre u skuqën. Ata e përshëndetën njëri-tjetrin derisa anija e la ishullin prapa dhe humbi tutje, mes ujërave të trazuarra. Gjashtë muaj vuajti Sadiku në burgun e Napolit.

Që atëhere u nda nga celula komuniste shoku i shkollës dhe i armës dhe nuk u panë më, derisa një ditë u kthyen në atdhe e dëgjuan oshëtimën e armëve të njëri-tjetrit nga Dibra në Kosovë e në Malësinë e Madhe. Edhe Vinçenco Kalabrezi «humbi» një natë në një drejtim të paditur.

KTHIMI

Federali i kampit të Ventotenesë, si u komunkoi me fjalë pompoze e me keqardhje amnistinë për të burgosurit politikë, i kërcënoi që të rrinin urtë në shtëpitë e tyre, në Shqipëri, të mos merreshin më me politikë, se përndryshe kyçet e hekurta do të vargëzonin përsëri duart e tyre...

Turma e madhe e të internuarve, që kishte mbushur sheshin, filloi të lëvizte duke kthyer kokat nga mesi. Po fliste Nazmiu.

— Sikur edhe të gjitha prangat e hekurat e botës të përdorësh mbi ne dhe mbi popullin shqiptar, prapëseprapë do t'i këpusim ato e do të çajmë përpara, — thirri Nazmiu, si përgjegje ndaj kërcënimeve të federalit kapadai. — Liria nuk mbërthehet me pranga!

Dhe sakaq, kënga shpërtheu si ndonjë bombë e fuqishme nga gjokset entuziazte të turmës:

*«Mirëmbërëma të burgosur,
Erdhi dita e çlirimit,
Se fashizmi është plagosur...»*

— Hej, ç'taksirat! Për nder, po të vazhdojmë kështu, do të na anulohet falja e do të na shtohet afati, — pëshpëriti një zë i frikshëm. — Pse i fryni

zjarrit kotsëkoti? Federali për të mirën tonë po flet. Mirë tha ai shoqë dje, se gjithë të këqiat nga komunistët na vijnë!

Nazmiut ia zuri veshi këtë pëshpëritje të lehtë të Hazizit, me të cilin ishte thikë e brisk.

— Mor ti, mos ki frikë, se fashistët ta kanë ruajtur një koskë për ta lëpirë! Liria nuk pranon gjakun e helmatisur të tradhtarëve! — iu lëshua Nazmiu, ndërsa Hazizi u mbloodh sa një grusht në mes të turmës së madhe të të internuarve. Pastaj filloi të mënjanohej, t'u largohej e t'u shmangej shikimeve përbuzëse dhe fjalëve fyese të shumicës që aprovuan fjalët e Nazmiut. Disa ia mbyllën gojën nëpërmjet kërcënimesh:

— Shko e përrulju federalit, i shitur!

— Lëre të lehë, qenin!

Në vjeshtën e vitit 1941, pa mbushur dy vjet, Nazmi Rushiti u kthye në Shqipëri.

* *

Dy vetë u ndalën rrëzë Qenokut: Nazmiu me Tolin. Nuk po ju shuhej malli tek shihnin rrethin e lartë të maleve me kokën tek retë, që vargëzoheshin krah njëri-tjetrit. Nën ta shtriheshin kodrat e luginat e pastaj fushat shumëgjyreshe, përmes të cilave, Drini plak, me shtratin e zgjeruar, ecte me përtaci.

Nata ra e qetë. Ata rrëshqitën në luginë. Sa kujtime të ëmbla e të hidhura kishte nga Dovolani! Një fresk i hollë vraponte kodrave e brigjeve të Drinit, ku aq herë në fëmijëri ishte hedhur e kish-

te larë trupin e tij të hajthëm. Ecte pas Tolit. Mendja i vajti tek Nebija. Kur ja, në mes të rrugës, një hije u kaloi pranë, me ca enë të mbushura tek çezma e fshatit. Toli e njohu shumë mirë atë, por nuk bëri zë.

— Cila është kjo?

— ???!!..

Nebija e njohu këtë zë. Një avull i nxehtë sikur i përshkoi krejt trupin. Zemra sa nuk i gufoi prej krahërorit. Këmbët nuk ecnin më përpara. Kusia, si u drodh dy-tri herë në duart e saj, u rrokullis me një zhurmë të mbytur përtokë. Me zor u kthye dhe pa dy hije pranë saj.

— Nazmiu?! — shqiptoi me zor. Një gulçimë ia zuri frymën. — Ti je, bir?

Nënë e bir përzien lotët e tyre, të mallëngjyer. Tri vjet pa u parë një herë me sy!

Shtëpia e tyre asaj nate në Dovolana, ndriti, mori një hije gazmore dhe drite. Lotët mallëngjyes të Nebijes, shikimet e dhimbshme të Rushitit, lutjet e së motrës që të mos largohesh më nga shtëpia dhe përqafimet e të vëllezërve e mallëngjyen Nazmiun.

Ventoteneja, qelitë e burgjeve, torturat, kishin lënë vulën e vuajtjeve mbi trupin e tij. Nazmiu qe dobësuar shumë. Në mollëzat e faqeve i kishte mbetur vetëm lëkura. Ishte zverdhur edhe më, por dukej më i burrëruar dhe qeshte rrallë.

— Jo, ne nuk do të të lëmë të largohesh më nga shtëpia, — i pëshpëriste me lot ndër faqe Nebija. — E kam shpirtin të djegur dhe sytë nuk u ngopën kurrë me ty, o bir!

Të gjithë e kishin rrethuar dhe e përqafonin me radhë, për të shuar mallin që i kishte zhuritur.

— Mbaju, nënë, mos u ligështo! Prej armiqve nuk pritet e mira.

Më vonë, shtëpia u mbush me miq. Nazmiu u tregonte atyre për Italinë, për Ventotenenë, për popullin e për fashistët. Ata dëgjonin gojëhapur.

Musli Uka, një dovalanas plak, kënaqej kur Nazmiu u fliste dhe, nganjëherë, me qëllim që t'i jepte flakë bisedës, bënte sikur kundërshtonte:

— Heu, bre Nazmi, e ku kemi kryqe ne shqip-tarët t'i bëjmë ballë një goxha Italie? Po ajo veç me frymë na mbyt ne, e jo më... Apo jo, bre Rus-hit! — i kthehej pastaj të atit të Nazmiut, sikur të kërkonte mbështetje. Por Rushiti dëgjonte me kujdes. Të tjerët nuk dinin t'u jepnin rrugë fjalëve të Musliut dhe shikonin nga Nazmiu.

— Ashtu duket Italia, siç thua ti, xha Musli! Por mushkëritë e saj janë të kalbura dhe shpejt do t'i shikojmë fundin. Edhe në Itali populli vuan për bukën e gojës. Të varfërit nuk e duan Duçen. Edhe atje, si këtu, sundojnë ata që e kanë barkun plot e që fryhen me gjakun e fukarasë! Këta nuk janë të ndershëm. Ja, për shembull, bejlerët dhe agallarët dibranë!

— Epo, iu shtofshin pushkët këtij vendi, mor bir, se hasmi në vatër është edhe më keq se gjar-përi në gj, — u hodh Xhemë Dani.

— Zembrën ta kemi të fortë e trimëreshë, se sa për pushkë, kjo rini do t'ua heqë prej krahësh fa-shistëve, e me pushkët e tyre do t'i qërojmë nga këto male!

'Ata ndenjën duke biseduar deri pas mesnatës, duke kërkuar të gjenin fjalët e zembrës.

Tek prefekti

Ishte shtatori i vitit 1941. Prefekti i Dibrës, Vehip Runa, sapo kishte mbaruar bisedën me spiu-nin e SIM-it, Jakovelin. Si e thithi thellë dhe e çoi gjer në fund të mushkërive tymin e duhanit, u ul dhe shënoi në një fletë të pastër «Të dyshimtët e kuq», për të cilët kishte biseduar edhe me federalin fashist. Por ndërkohë, telefoni e ndërpreu, për të filluar një bisedë tjetër, krejt të papritur.

— Alo? Po, unë, prefekti i Dibrës, zoti Vehip! Aaa, ju gjeneral Agostinuçi?! Si, si..., — dhe poshtë letrës së të «dyshimtëve të kuq» shtoi edhe porositë e gjeneralit, komandantit të përgjithshëm të karabinierisë: «Në fshatin Dovalan të Dibrës është kthyer nga internimi në Ventotene të Italisë një nxënës me ide të kuqe të rrezikshme komuniste. Të survejohet në çdo hap, me qëllim që të mos infektojë të rinjtë e tjerë...»

Si fshiu me pëllëmbë ballin e djersitur, një shkëndijë gëzimi i përshkoi zemrën prefektit:

«Agostinuçi bisedoi personalisht me mua dhe më besoi një mision të madh e të lartë. Të ndjek dhe të zhduk të pafetë, ata që duan të sjellin moskovin në vendin tonë!»

Pasi rrudhi ballin e mori një qëndrim serioz, duke drejtuar trupin mbi karrige, kërkoi në telefon postën e karabinierisë së Maqellarës dhe urdhëroi paraqitjen e menjëhershme pranë prefektiurës të Nazmi Rushitit nga Dovalani...

...Të nesërmen, i shoqëruar nga dy xhandarë, Nazmiu u fut në zyrën e prefektit të Dibrës.

— Hë, mor djalë, vure mend andej nga «shë-tite», apo jo? — i foli butë Vehipi.

— Po, zoti prefekt! Në burgjet e Italisë u binda, pasi e pashë armikun në strofkullën e vet. Tani, këtë armik që ka pushtuar vendin tonë, do ta luftoj derisa të mos i mbetet asnjë shenjë...

— Unë të këshilloj që të heqësh dorë prej kësaj rruge të rrezikshme e pa krye... Prandaj edhe të kam thirrur.

— Ju, zoti prefekt, i shërbeni fashizmit. Populli shqiptar nuk do t'i harrojë miqtë dhe armiqtë e tij!

Prefekti, i alarmuar, u ngrit një here nga vendi dhe u ul përsëri.

— Unë i shërbej atdheut, i cili nuk mund të shkojë përpara pa Italinë e fuqishme dhe të përparuar, — u mburr prefekti, sikur po fliste për familjen e tij.

— Edhe një herë po jua them: bijtë dhe bijat e këtij trualli po shënojnë në kujtesën e tyre të gjithë ata që janë kacavjerrur pas flamurit fashist! Mbajeni mend se populli po pregatitet për hakmarrjen e madhe!

Zëri i Nazmiut e tronditi prefektin, ndërsa trupi i tij i gjatë përkulej vazhdimisht, sikur ta ndjente peshën e atyre fjalëve. Fjalët e Nazmiut ia trazuan nervat. Gjaku po i vërshonte në kokë, kurse faqet verdhacuke iu bënë pulla-pulla të kuqe. Megjithatë, e mbajti veten. Udhëzimet nga lart duheshin zbatuar.

— Kaq kisha unë! Megjithëse i ke provuar hekurat, ti ende i rri kaluar këtij kali.

— Kjo rrugë është për të gjithë shqiptarët e ndershëm, dhe hekurat e burgjet nuk na bëjnë aspak përshtypje, sepse luftojmë për popullin e vendin tonë.

— Pusho, rebel! Për njerëzit si ti, burgu dhe hekurat janë pak! Ti duhesh varur në litar! — i shpërthyen më në fund nervat prefektit.

— Gjithë popullin nuk e varni dot, zoti prefekt!

Me këto fjalë Nazmiu u largua.

*
*
*

Zilja e telefonit tringëlliti kërcënueshëm. Prefekti kapi receptorin me përtesë. Dëgjoi zërin e major Verdit, i cili e solli pak në vete. Verdi ishte kureshtar të mësonte bisedën mes prefektit dhe komunistit. Dëgjoi me kujdes shpjegimet e prefektit dhe u çudit se si Ventoteneja nuk e kishte mposhtur atë komunist. Major Verdit nuk i vinte aspak mirë që ta linin t'u ikte nga duart ai komunist i rrezikshëm.

— Atëhere, sinjor prefekt, ai paska mbrojtur dhe manifestuar haptazi qëllimet e tij të errëta? Po ai do të fillojë të mbjellë urrejtjen në popull, për t'i ngritur masat kundër nesh! Prandaj, sa më shpejt të jetë e mundur, t'ia gozhdojmë gjuhën! Duhet të veprojmë shpejt sa nuk është marrë vesh me Haxhi Lleshin e shokë të tij.

— Po kështu do t'i zemëronim më tepër dibranët! Ju nuk i njihni ende se si ngjiten njëri pas tjetrit këta malësorë të mallëkuar!

— Kjo është e keqja më e vogël. Më mirë të ndodhë kjo, se sa të lëmë të lirë një element të tillë.

Të nesërmen, karabinierët dhe xhandarët shkëlën në Dovalan, por Nazmi Rushiti e kishte nuhatur ardhjen e armikut. Ishte larguar nga Dovalani për në Tiranë, pa u çmallur ende mirë me njerëzit e tij.

NË DIBËR ME MISION PARTIE

Nga mesi i nëntorit të vitit 1941, autobusi «Fiat», i mbushur me pasagjerë, la Tiranën dhe u nis për në Dibër. Nazmiu, vetë i katërti u shpërnda mes udhëtarëve të tjerë. Ishte formuar Partia Komuniste Shqiptare! Ishte takuar me «Tarasin» dhe tani, i ngarkuar nga partia, shkonte që të punonte në Dibër. Duke udhëtuar mendonte se si kishte kaluar nga Korça, ç'shokë të devotshëm e besnikë kishin edukuar atje Ali Kelmendi dhe «Tarasi».

Nuk i shqiteshin nga kujtesa ato minuta të paharruara të takimit me «Tarasin» e udhëzimet e tij.

Thëllimi i natës kishte rënë, por tek shtylla sikur kishte diell. Nazmiu e ndjente ngrohtësinë dhe dritën e tij. «Tarasi» bisedoi gjatë me të, aty rrëzë shtyllës, pranë murit. Shokët në dy krahët e rrugës vigjëlonin. Nazmiu dëgjonte udhëzimet e partisë... Tërë qënien e kishte tek «Tarasi». Ai e mbajti në kujtesë zërin dhe frymëmarrjen e tij.

Si mbaroi, udhëheqësi i shtrëngoi dorën dhe e porositi se sot na duhen agjitorë të urtë partie... Revolucionin nuk e bën një njeri i vetëm, as njëqind, sikur të jenë dhe trima të padëgjuar. Këtë e bën vetëm forca e bashkuar e popullit. Prandaj, kur lufton për lumtërinë e popullit, ai të mban në zemër e të ruan. Atëhere ke fituar shpirtin e madh të tij dhe mposht çdo gjë.

Në çastin e fundit të ndarjes Nazmiu deshi t'i shprehte diçka. Donte ta shikonte me sy dhe një herë fytyrën e dashur të udhëheqësit. «Tarasi» e kuptoi. Cigare nuk kishin në duar. Ai shkrepri çakmakun. Nën dritën e tij panë njëri-tjetrin. U ndanë.

Kudo Nazmiu e pati pranë udhëheqësin në mbledhjen e komunistëve e të ilegalëve, pranë pushkës, në pritat partizane, në mal, fshat e qytet. Ai pati energjinë e partisë, forcën e ideve të saj.

'Autobusi shpejtonte, merrte ato kthesa të forta, duke lënë pas një vazhdë të dendur pluhuri dhe zhurmën e motorit. Edhe Irfan Hajrullait i kishte mbetur në sy ai entuziazëm i Nazmiut natën e 8 Nëntorit. Atë natë, Nazmiu sapo ishte kthyer nga detyra. Kishte kryer detyrën e rojes, për të siguruar shokët që formuan partinë.

— Shokë, një lajm i gëzuar: u formua Partia Komuniste Shqiptare! Dhe në ç'ditë të bukur! Pikërisht të nesërmen e ditës së përvjetorit të fitores së Revolucionit Socialist të Tetorit! Partia Komuniste, Partia jonë, do të ecë në gjurmët e partisë së Leninit dhe të Stalinit!

— Ta marrë vesh i gjithë atdheu se partia jonë, ëndërra e ligjshme e ideve tona, u realizua! Shekuj do të kalojnë, por ne shqiptarët kurrë nuk do ta harrojmë datën e 8 Nëntorit të vitit 1941! Me Partinë tonë, do t'i këputim zinxhirët!

Dy shokët ranë të flinin, por sytë nuk u mbylleshin nga gëzimi. Të shtrirë mbi dyshekë, biseduan gjatë gjithë asaj nate...

Këta ishin dy, nga të dyqind pishtarët e parë.

Autobusit i ra goma e pasme pa hyrë në Klos. Pasagjerët dolën të merrnin pak ajër të pastër. Nazmiu ndezi një cigare.

— Demir, traktet i sigurove mirë?

— Po, shoku Nazmi. Bashkë me Lisin, ia dhamë asaj nënës që është në fund të autobusit, asaj me veshje Zerqani. I thamë se janë bomba.

— Pranoi?

— Në fillim u tremb, por kur i shpjguam se çfarë ishin, se po të na i gjenin italianët na fushin në burg u përgjegj: «Na u bëfshin kurban italianët!» — dhe i futi traktet në mes të thesit të saj me plaçka.

— Plakë trime, — tha Nazmiu.

Një karabinier që hipi në autobus te ura e Burrelit, nuk po ua ndante sytë katër shokëve. Kur hynë në qytetin e vogël të Klosit, pesë karabinierë të tjerë italianë ia prenë rrugën autobusit. Shokët nuk u tronditën. Materialet ishin në duar të sigurtat. Karabinierët i kontrolluan me imtësi që të katër, pasi kishin sinjalizime nga Tirana se «mund të kenë material propagandistik». Autobusi mori udhë përsëri. Nëna shikoi nga shokët. Zemra ende i rrihte me shpejtësi. E ndjente veten të çliruar, të gëzuar e krenare që u kishte ndihmuar këtyre djemve. Te kthesa e madhe drejt Zerqanit, nëna e Rrahmi Shkëmbit zbriti nga autobusi. Zbriti edhe Nazmiu që ta përshëndeste.

— Edhe unë kam një djalë, di të lexojë... Di edhe të shpërthejë «bomba», — i tha ajo, ndërsa po e përqafonte.

Nazmiu mbeti i habitur. Ai i kuptoi fjalët e nënës. Por si t'ia jepte traktin e partisë? Karabinieri ecte hap pas hapi me ta. Por a mund të mos e kënaqte Nazmiu nënën trimëreshë? Nxori nga xhepi një letër të hollë të palosur disa herë.

— Urdhëro, nënë, — i pëshpëriti. — Këtu është zëri i partisë.

Nëna e Rrahmiut e shtrëngoi dhe e fshehu fort përmes gishtrinjve atë letër të çmuar dhe pastaj e futi në gji. Ajo e ndoqi me sy autobusin, derisa kaloi bërryllin e xhadesë.

— Udhë e mbarë, bijtë e nënës! — ngriti dorën duke i përshëndetur.

Thirrja e partisë

Ata ishin katër. Mbledhja e grupit kishte filluar.

«Dibra ka djem trima, besnikë e me sedër të lartë shqiptare! Atyre, po t'u hedhim dritën e ideve tona, nuk do t'ia dinë as për feudalët e egër dibranë, dhe as për fashistët. Edhe dibranët e varfër presin kushtrimin tonë. Të varfërit do të luftojnë. Ti, me atë grusht të vogël shokësh, do të nderësh ilakën e madhe në zemrat e malësorëve dibranë!» — u thoshte Nazmiu shokëve porositë që kishte marrë në Tiranë. Ata e dëgjonin. Takimi i Nazmiut me «Tarasin» pas themelimit të Partisë, i kishte kthjelluar horizontin dhe e kishte mbushur me besim të patundur në fitore. Këshillat e tij qenë program pune dhe pishtarë për ndriçimin e ideve të luftës së madhe.

Në dhomë kishte hyrë edhe nënë Aisheja. Ajo ishte bërë merak se djemtë kishin kohë që po flisnin me zë të ulët. Darka po ju ftohej... Edhe ajo u tërhoq pas fjalëve të Nazmiut dhe harroi t'i kujtonte për të grënë.

— Kështu, pra, — vazhdoi Nazmiu dhe ktheu kokën nga nënë Aisheja. Kjo kujtoi se e qortoi me shikimin e tij të rreptë dhe bëri të dilte.

— Rri, rri, nënë Aishe. Jo vetëm të rinjtë, por edhe të rejat, gratë, duhet të hidhen në luftën kundër pushtuesit.

Aisheja u ul në minder dhe qëndroi si e trembur. Por shpejt filloi të gjallërohej, duke dëgjuar ato fjalë që po i ngrohnin zemrën.

— Edhe aty në Dibër, me gjithë demagogjinë e bejlerëve, agallarëve, që janë kapur pas flamurit italian, vlon kazani i urrejtjes, — përsëriste porositë e Partisë Nazmiu. — Me këto valë zemrash malësore të shtypur, duhet të përvëlojmë të gjallë fashistët italianë e pseudopatriotët. Po, malësorët e shtypur që jetojnë zbathur e zhveshur, ata sot presin kushtrimin. Ata e kanë në gjak urrejtjen kundër pushtuesit dhe tradhtarëve.

Nënë Aisheja dëgjonte me vëmendje. Disa fjalë nuk para i kuptonte mirë. Nazmiu ndalohej që t'i shpjegonte më qartë, dhe ajo, që të mos e lodhte, bënte sikur i merrte vesh fare mirë të gjitha. Të tjerët buzëqeshnin. Zëri i Nazmiut, sa vinte e bëhej më burrëror, tingëllonte më i vendosur e optimist. Mblodhi grushtin fort, dhe:

— ...Po, shokë, tani ne jemi më të shëndoshë e më të pathyeshëm, se kemi Partinë tonë. Kjo do ta mobilizojë popullin në luftën e drejtë!

Shokëve u ndriti fytyra. Nënë Aisheja i shikonte përsëri si me dyshim. Por edhe ajo gëzohej kur gëzoheshin djemtë, rrudhte vetullat kur ata bëheshin seriozë. Ky takim kishte fjalë të kuqe ziarri që grumbullonte brenda parti, atdhe, popull. Me kushtrimin e Partisë, vegjelia e Dibrës, ashtu si në

të gjithë vendin, do të ngjeshte armët e do të ndër-
tonte llogoret, nga ku do të shpërndahej era e lirisë.
Pastaj Nazmiu lexoi thirrjen e parë të Partisë Ko-
muniste Shqiptare.

— Në çdo rrugicë të qytetit ta ngjitim, në çdo
fshat ta dërgojmë, që të mos mbetet dibran pa më-
suar sihariqin e madh, — tha Nazmiu duke e ngri-
tur traktin lart, si ndonjë flamur.

— Emrin e Partisë do ta shkruajmë me zjarrin
e aksioneve! Mëdhe edhe me gjakun tonë!

Ky ishte betimi i të katërve.

Qetësia u prish

Si u larguan anëtarët e njësitit, dy komunistët
mbetën një copë herë pa folur. Nata e 23 nëntorit
erdhi me shi e bubullima.

— Ndize një herë! — i tha Nazmiu, duke i
shtrirë paqetën e cigareve. — Biseduam dhe dje për
aksionin.

— Për 28-ën?

Nazmiu lëvizi kokën.

— Çast i favorshëm për të vepruar. T'i de-
maskojmë publikisht armiqtë, që fusin farën e grind-
jeve, — tha Nazmiu dhe përmendi disa emra.

Ata e diskutuan gjatë planin e aksionit. Koha
e festës së 28 Nëntorit ishte e afërt.

— E takove Visarin¹⁾? Si i shkojnë provat e
teatrit? — pyeti Nazmiu, duke kujtuar bërthamën
e arsimitarëve dhe të rinjve aktivistë, të cilët po

1) Visar Troku, pseudonim i një të riu aktivist.

pregatisnin dramën «Lulja e kujtimit» për ta shfaqur më 28 Nëntor.

— Sot s'më doli koha. Ishim me Agronin në Ballancë, tek mësuesi.

— Shumë mirë, shok. Edhe inteligjencia i duhet revolucionit... Por është e domosdoshme që në bërthamën e aktivistëve të ketë punëtorë, çirakë, zanatçinj, fshatarë..

Nata u thye. Llamba mbeti e ndezur. Dy komunistët mbi një fletë shënonin emra aktivistësh, detyrat për vete dhe për shokët që të lidheshin me masat e popullit. Këtu do të varej edhe sukseesi i aksionit.

Shkolla «Liria» po përgatitej për festën. Një mësues po varte në një shtizë të gjatë flamurin shqiptar me dy sopatat e Liktorit. Nazmiu e vërejti egër dhe nuk e përshëndeti. Njëri nga shokët ia kapi mësuesit nga duart flamurin dhe ia hodhi me forcë në qoshe të korridorit. Një tjetër vuri shtizën në gjunjë dhe e bëri dy copash. Qetësia u prish. Mësuesi doli nga shkolla i përcjellë me përbuzje.

Oborri u mbush me nxënës e të rinj. Dy të rinj iu afruan Nazmiut. Ishin Eshrefi me Qeramin.

— Këtu e keni? — e pyeti ai.

— Po, — thanë ata dhe njëri nxori nga gjiri një flamur të përdorur.

Nazmiu e kapi flamurin dhe e mbajti një copë herë në duar. Rreth tyre u mbledhën plot të rinj të tjerë.

Ora po i afrohej dhjetës.

— Shokë, sot zëri i tokës nënë na thërret. Zë-

ri i Ramiz Varvaricës, Urfi Agollit¹⁾ na thërret të ngrihemi, — foli Nazmiu mes turmës së ngjeshur në oborr të «Lirisë». Fashistët dhe tradhëtarët duan që festën e pavarësisë ta përdorin për qëllimet e tyre skllavëruese. Por 28 Nëntori është i shqiptarëve patriotë e lirisdashës. Kjo festë do t'i bashkojë në luftë kundër armiqve dhe tradhëtarëve. Kush nga ne mund të tradhëtojë atdheun... — përfundoi Nazmiu duke mdezur valën e entuziazmit dhe të revoltës.

— Vetëm armiqtë! — ia priti dikush.

— Hakmarrja e popullit i pret ata që duan të nxijnë 28 Nëntorin me këmishën fashiste, — tha njeri nga të rinjtë.

'Aty erdhi dhe Aisheja. Ajo ndjente një frikë të pashpjegueshme.

— Ç'të bëjmë? — pyeti i riu që solli flamurin.

— Të demostrojmë! — u përgjegj një farkëtar pranë Nazmiut.

— Kanë armët e divizionit «Firenze». Je në këtë mbretëri ti? — ndërhyri një i moshuar me një ton të plogët e të frikshëm.

— Ne kemi zemrat, — tha Lis Korabi.

Porta e «Lirisë» u hap dhe turma eci para në sheshin e pazarit, përballë federatës fashiste.

— Jaçe spiuni! — thirri njëri me urrejtje, kur pa Jaçe Topallin që u printe disa elementëve shovinistë duke i nxitur.

— Pop Spirja! — tha tjetri, kur të dy këta shovinistë nxorën në krye të turmës flamurin bullgar.

1) Ramiz Varvarica, Urfi Agolli — dëshmorë dibranë të rënë në Luftën e Spanjës.

— Fashistët po ringjallin politikën «përça e su-
ndo», — tha Nazmiu në krye të të rinjve.

— Rroftë bashkimi i popujve! — hodhi paru-
llën Lisi.

— Përpara, shokë! — thirri Irfani.

Demonstrata mori zjarr. Turma e demonstruesve
doli përballë tjetrës. Dy të rinjtë ngritën lart fla-
murin shqiptar. Kënga patriotike «Sot lypset me
flamur...» gufoi e vullshme nga gjokset e të rinjve.

Aisheia me ca gra e të reja u afruan. Një rrë-
qethje kaloi nëpër trupin e saj. I dukej se dhe
ajo e bashkonte zërin me djemtë. Ata ecnin me
hap të vendosur. Turma po rritej. Populli doli
jashtë.

Shovinistët Jaçe Topalli e Pop Spirja humbën
mes dallgëve të zemëruara të të rinjve. Sheshi i
pazarit para federatës ziente nga parullat dhe kë-
ngët. Pastaj turma u nis drejt bashkisë së qytetit.

Rreth demonstruesve u radhitën karabinierë,
milicë dhe ushtarë. Flamuri shqiptar valvitej në
ballë të demonstruesve. Kapiteni fashist Mario Ruso
dhe regjenti Mato Murati urdhëruan të shpërnda-
hej demonstrata. Por ajo ndizej më tepër.

— Poshtë fashizmi! — thirri Agroni.

— Poshtë! — bërtiti njëzëri turma e zemëruar.

— Rroftë Shqipëria e lirë! — thirri Guti.

— Rroftë! — e përcolli turma.

Populli u radhit krah demonstruesve.

— Kush është ai në krye?

— ?

— Po ai tjetri që i nxit? — pyesnin zëra nga
populli.

— Janë tanët! Janë djemtë tanë! — përgjigjeshin të tjerët krenarë.

Ca karabinierë me kapitenin Ruso dolën në krye para turmës. Dy të rinjve ua kapën flamurin për shtize. Ata nuk e lëshuan. Shtiza u përkul dhe u thye. Komunistët ngritën grushtet. Një dorë e fuqishme e kapi karabinierin për jake. Por ai mbeti në rrethin e pushkëve e të bajonetave fashiste. Flamuri nuk u prek. Turma filloi të rrallohej.

Demostruesit shkuan pas të arrestuarit në kuesturë, duke thirrur: «Duam shokun».

D e t y r a t

Kishin kaluar disa ditë nga dita e demonstratës. Nënë Aisheja i futi ca vajguri llambës dhe pas-taj i dha të birit traktet. Irfani mbushi revolverin me fishekë dhe doli duke vështruar nënën me ëmbëlsi. Akrepi i orës po kalonte dymbëdhjetë e natës. Era idhnake përplaste mbi dritaren e dhomës borën. Të ftohtit e shkurtit kërcëllonte. Nënë Aisheja vështronte kthesën e rrugicës. Ajo përgjonte djemtë, të cilët qysh në janar kishin vajtur në Tiranë dhe sonte duhej të ktheheshin. Ca këmbë krrup-krrup mbi borë. Ajo fiku dritën. Pas pak dera trokiti.

— Djemtë! — u ngrit nëna.

— Jam unë... — dëgjoji zërin e Nazmiut.

'Ai ishte kthyer nga Tirana.

Edhe Irfani u kthye si ngjiti traktin ne mur të federatës fashiste, ndërsa të tjerat i shpërndau nga kazermat ushtarake.

Nazmiu u tregoi se ç'udhëzime i kishin dhënë shokët e Komitetit Qendror të Partisë. Aisheja i la vetëm. Ajo e kuptonte se, kur bisedonin dy komunistë, nuk duhej t'i dëgjonte.

— Për celulën dhanë mendimin shokët e Qendrorit? — pyeti Irfani.

— Po. E dinin që në Dibër vepronjë vetëm dy komunistë. Me dy komunistë nuk formohet celulë... — Si u mendua pak, vazhdoi duke i rënë krahëve: — Ne do ta kryejmë punën e partisë, derisa të formojmë celulën. Shokët më porositën që të vazhdojmë veprimtarinë antifashiste. Madje më tërhoqën veshin se nuk kemi bërë përpjekje për t'u lidhur me njësitin antifashist të Haxhi Lleshit.

— Duhet takuar me Kep Drenin, — tha Irfani. — Ai duhet të jetë nyja e lidhjes.

Kepi ishte një fshatar që mbante lidhje të vazhdueshme me Haxhi Lleshin. Për këtë ishin informuar dy komunistët. Madje ata kishin dëgjuar se Haxhiu me një grup patriotësh antifashistë si Mustafa Kaçaçi, Hamid Shijaku e të tjerë, shtypnin trakte kundër fashizmit që më 1939 dhe Kepi i çonte deri në Elbasan.

Irfani shënonte direktivat e Komitetit Qendror të Partisë: «Të propagandojmë qëllimet e Lëvizjes Nacionalçlirimtare, grumbullimin e popullit rreth kësaj Lëvizjeje, krijimin e bazave në qytet dhe në fshat, ngritjen e njësiteve partizane dhe armatosjen e tyre.

Gjithashtu Partia udhëzon bashkimin e popullit pa dallim feje, krahine, ideje dhe kombësie.

Nënë Aisheja trokiti lehtë në derë. Kështu i qërtonte ajo, kur harronin të pushonin.

— Ja, mbaruam, nënë, — i foli Irfani, dhe ajo u largua lehtë.

— Tani kemi çështjen e fundit: ndarjen e detyrave. Unë mendoj që të mbledhim shokët e grupit dhe të vendosim bashkarisht. Si mendon ti? Të mos mbyllemi në vetëvete. Frymën e diskutimit në grupin tonë ta bëjmë praktikë pune. Ky është edhe mendimi i shokëve të Qendrorit.

— E drejtë.

Bënë ndarjen e detyrave dhe problemet që do të ngrinin në mbledhje.

— Dakord!

— Abstenim s'ka, kundër s'ka! — qeshën të dy me zë.

Binte borë. Jashtë patrullonin fashistët. Nënë Aisheja në dritare ruante rrugicën.

*
*
*

Pas dy ditësh, më 25 shkurt të dyzetedyshit, në bazën e Varoshit hynë ilegalisht anëtarët e grupit. Të gjashtë raportuan për shpërndarjen e traktit të PKSH në pjesën më të madhe të Dibrës dhe të fshatrave të Rodostushës.

— Ta ngremë lart emrin e nderuar të komunistit! — fliste Nazmiu, duke i parë shokët me radhë në dritën e syve.

— Aksioni është edhe sabotazh, duke djegur e dëmtuar objekte ushtarake të fashistëve...

— Shoku Nazmi na njohu edhe me udhëzimet e Komitetit Qendror, — vazhdoi Lisi. — Unë mendoj të na caktohen detyrat tona konkrete.

Nazmiu lëvizi kokën dhe filloi të shfletonte bllokun.

— 'Atëhere kalojmë tek detyrat. Unë do të merrem me sigurimin e armëve dhe të bazave. Me Lis Korabin do të kemi si zonë veprimi për propagandë e agjitacion fshatrat nën rrugën automobilistike Dibër-Peshkopi. Ka ndonjë vërejtje?

Diskutimet vazhduan rreth detyrave konkrete, për organizimin e rinisë, për njerëzit e thjeshtë, për konspiracionin.

Kur shokët ende po diskutonin, u hap me forcë porta e fqinjtit. Nënë Aisheja dha sinjalin. Shokët dolën një nga një nëpërmjet derës së vogël të avllisë, duke iu shmangur rrezikut. Spiunët ishin vënë në lëvizje.

Shtohen radhët

Ai djalë simpatik, i imët në trup e fytyrë, po i zgjuar, me një çantë librash, sa mbaronte mësimin, ulej me fshatarët e varfër në oborr të shkollës dhe në shtëpinë e tyre, duke qarë hallet e jetës me ta, prandaj ai u bë aq i dashur për atë krahinë. Kush nuk e njihte Spiron në Gollobordë?

Mësuesi i Radoveshit, Spiroja, ishte i ri, me tendenca përparimtare, prandaj Nazmiu mendohej të lidhej me të që, edhe në zonën e Gollobordës, të përhapeshin edhe më shumë idetë e luftës.

Shkurti i vitit 1942. Qytetin e Dibrës e kërcëllonte të ftohtit. Qytetarët ecnin me shpejtësi, të mbledhur grusht nga acarri. U err. Njerëzit u rra-

luan. Vetëm ushtarët italianë kishin mbushur pijetoret e pakta të qytetit dhe shkriheshin duke kënduar këngën e tyre më të pëlqyer «Sinjorina bela!».

Mbledhja me të rinjtë në bazën e Varoshit kishte filluar. Numri i tyre këtë radhë ishte shtuar. Dymbëdhjetë të rinj dhe tri vajza qytetare dibrane. Nazmiu po fliste. Mësuesi i Radoshevit e gjeti derën me numrin 41. Trokiti lehtë dy-tri herë. Një komshi i nënë Aishesë, plak 60 vjeç, që bënte roje te dera, sinjalizoi... I bënë shenjë ta hapte derën. Plaku e hapi ngadalë derën dhe, përballë tij, u duk mes errësirës mësuesi trupimët.

— Ç'kërkon në këtë orë në derën time, mor djalë? — foli plaku.

— Pikërisht në këtë shtëpi kam punë, xhaxho, — nguli këmbë mësuesi.

Në këto fjalë, Nazmiu u afrua në dritare me revolver në dorë.

— Lere të hyjë brenda, — foli Nazmiu dhe i doli vetë përpara të panjohurit.

Sapo u ndodhën përballë njëri-tjetrit, mësuesi i tha:

— «Ai» më tha se këtu është «Ylli».

— Ç'kërkoni prej tij?

— Dua atë librin që më ka marrë «Ylli», — iu përgjegj parullës mësuesi.

— Po, ai është libri i tij. Meqenëse ke dëshirë të mësosh, eja me mua..., — i dha kundërparullën Nazmiu.

Mësuesi e kuptoi se pseudonimin «Ylli» e kishte vetë Nazmiu. Deshi t'i hidhej, ta shtrëngonte, ta puthte në buzë.

— Ky është mësuesi i Radoveshit, Spiro Vel-

koja, — ua bëri të njohur shokëve Nazmiu, sapo hy-
në në dhomë. — E njihni?

— E njohim, — u dëgjuan zëra nga të katër
anët e dhomës.

Ata, me të vërtetë, e njihnin mësuesin prej Ra-
doveshi, kishin dëgjuar edhe më parë për mësuesin
revolucionar. Mësuesi gjithë vëmendje dëgjonte
«Yllin».

Ai fliste për punën propagandistike që duhej
bërë me të rinjtë në fshat dhe në qytet, tek masat
e popullit, dhe, në veçanti, për zgjimin e bashki-
min e masës maqedonase në qytetin e Dibrës, me
shqiptarët.

Mësuesi i Radoveshit nuk i harroi kurrë ato
minuta, kur «Ylli» i tha të nesërmen në agim:

— Dëgjo, Spiro, ne tani jemi të pamposhtur,
se kemi Partinë tonë, por duhen sakrifica. Ja, në
ato male ku ti shpërndan dritën e diturisë, duhet
punuar me të rinjtë e thjeshtë malësorë. Ky duhet
të jetë qëllimi ynë. Dhe mos mendo, shoku mësues,
se do të ngrihen të gjithë menjëherë. Sot del malit
një, nesër do të dalin dhjetë e kështu me radhë...
Do të shikosh ti se si revolucioni do të mbledhë
rreth vetes rininë dhe mbarë vegjëlinë!

Mësuesi doli nga baza 41 me besim në fitore.

Nazmiu dhe Irfani po pastronin revolverët. Ag-
roni po skiconte pozicionin e kazermave të divizio-

nit «Firenze», ndërsa Lisi diçka po shënonte në bllokun e tij.

— Punët po na shkojnë mirë, përderisa fashistët po tërbohen. Grupi edukativ është duke u shtuar me të rinj. Por përsëri, keq jemi me vajzat, — fliste Nazmiu dhe vazhdonte të pastronte armën. — Dhe me vajzat duhet patur durim. Është forcë zakoni, i cili duhet thyer.

Në këto fjalë Drina u fut brenda.

— Vdekje fashizmit!

— Liri popullit! — ia kthyen njëzëri të gjithë shokët.

Ajo vështroi pushkët e mbështetura rrzëzë murit, dhe Nazmiun, që rrotullonte revolverin nëpër duar.

— Edhe errësira do të largohet!

— Ku e keni fjalën shoku Nazmi?

— Duhet edhe pjesëmarrja e femrës në luftën kundër fashizmit.

— E drejtë. Porosinë e Partisë e vëmë mbi jetën tonë, shoku Nazmi. Ne e formuam grupin e të rejave! — foli Drina me krenari.

Nazmiu e ngriti revolverin lart, dhe e «shprazi» në heshtje për këtë sukses.

— Pastroja tytën njëherë, u bëftë kiameti! — thirri Destan Kilja, i cili sapo hyri me një thes në dorë.

— Xha Destan, — foli Nazmiu. — I siguruat të gjitha armët?

— Një pjesë i lamë në Dovalan, — ia ktheu Destani, dhe filloi t'i shpjegonte hollësisht për transportimin dhe sigurimin e armëve.

Pastaj Nazmiut iu kujtua se me Drinën e kish-
te lënë punën në rrugë.

— Më fal Drina, e kisha fjalën se në qytetin
e Dibrës ka shumë vajza fanatike. Ky nuk është
faji i tyre... Ti e ke vështirë me këto, por do t'ia
dalësh. Me Hibe Palikuqin, ç'rezultate kemi?

— Ah, shoku Nazmi, ajo është një vajzë e mre-
kullueshme! Në fillim u duk e ndrojtur, por pastaj
u çel. — foli gjithë entuziazëm Drina. — 'Ajo ka
për të kryer shumë punë në shërbim të Partisë.

— E shikon, pra, sqarimi, bindja? Lufta jonë,
drita e Partisë, do t'i çlirojë nga errësira shekullo-
re. Ato do të hidhen me armë kundër fashistëve.

N d j e k j e

Regjenti i kuesturës në Dibër të Madhe, Mato
Murati, e gdhui atë natë në zyrë. Ai e hante veten
për të gjetur ata komunistë që kishin ngjitur trak-
te nëpër dyert e shtëpive të shqiptarëve dhe ma-
cedonasve dhe në vendet e dukshme të qytetit të
Dibrës. Një gjë i kishte bërë përshtypje atij:
në lagjen Varosh kishte më pak trakte, vetëm dy.
Ai tani kishte përpara traktet, por nga urrejtja
nuk i lëshonte sytë mbi to.

Togerit të milicisë, që ndodhej pranë regjentit,
i bëri përshtypje kjo qetësi dëshpëruese.

— Patrullat tona nuk kanë ndjerë asnjë lë-
vizje... Edhe te dera e kuesturës: «Partia Komu-
niste Shqiptare». Mbiu edhe këtu fara e mallëku-
ar e të pafeve bolshevikë, por këta, zoti regjent, do
t'i fusim në dorë.

Regjenti nuk i dha përgjegje.

Të nesërmen, afër drekës, ai hapi zarfin «Të për sekret», që i dorëzoi mbi tavolinë toger Mala. Pa ngritur sytë, lexoi:

«...Arma juaj lokale me çdo kusht, duke përdorur të gjitha mjetet, të kapë elementët që propagandojnë luftën kundër Italisë së madhe...»

Regjenti e shkëputi vështrimin nga letra e porosaardhur dhe, me sytë që i përshkënditën nga një fije shprese, pyeti togerin:

— Ajo që më the në mëngjez është serioze... Je 'i bindur? — dhe mori nëpër duar informacionin e kapitenit Mario Ruso me disa emra të dyshimtësh. Pastaj lexoi shënimin:

«...Nuk ka asnjë bazë për t'i besuar shumë këta njerëz».

Nënë Aisheja tek «Dragonin»

Toka kullonte nga lagështia e atij marsi të 1942-shit. Nënë Aisheja, në pikë të mesditës, la qytetin e Dibrës dhe arriti në Maqellarë.

«Të takohesh me «Dragonin» që punon në postë-telegrafën e Maqellarës», — e kishte porositur Nazmiu.

Si u afrua pranë zyrës së postës, mori të rregullonte shportën, me qëllim që t'u linte kohë nja dy karabinierëve që të dilnin nga dera e postë-telegrafës.

— Urdhëro telegramin! — i zgjati një letër nënë Aisheja, të cilën e nxori nga mënga e xhaketës së zezë.

«Dragoni» u ngrit nga karrigia. U afrua te sporteli dhe i tha me zë të ulët:

— Kini prush për të ndezur zjarrin?

Nënë Aisheja qeshi me këtë nëpunës të ri, kur ai nisi të fliste me shifrat e parullës.

— Po, kemi. Veç i fryni që mos të fiket, — hyri në bisedë ajo, kur në sallonin e telegrafës nuk pati më njeri.

— Si është «Ylli», si janë shokët?

— Të fortë si malet! Po ju këtej? Mësuesi i Kërçishtit ka ditë që s'është takuar me «Yllin». Si i ka punët?

— Mirë fare. Po Irfani përse nuk u duk këndeje? E prita dje.

— Mbrëmë u larguan nga baza. Kanë kapërcyer Radikën me të gjithë shokët. Mua më ngarkuan të të sjell këto, — dhe i zgjati një pako me letra. — Këto dy ditë erdhën nga Tirana. Edhe atje kemi dibranë, dhe dibranë shumë të mirë. Takohu me Tol Drinin dhe mësues Himën dhe shpërndaje zjarrin që të ngrohet fukaraja.

Ra telefoni. «Dragoni» mori receptorin.

— Alo?... Po... Ju Peshkopia?... Dibrën e Madhe? Siurdhëron!

«Dragoni» nuk e mbylli telefonin.

— Alo, sinjor Mato... të gjithë nga qyteti i Dibrës.

«Dragoni» mblodhi vetullat. Nëna e pyeti se ç'thoshin. Ai ia bëri me dorë të heshte. Por biseda telefonike u pre.

— Fashistët, nënë Aishe, lehin nëpër telefona ka tre muaj. Kërkojnë gjurmët tona.

— Unë po shkoj te mulliri i Xhemës. «Ylli» të pret pasnesër në «Likçiçë».

Fjalët ishin të shkurtëra. «Dragoni» nuk e përcolli as deri te dera e telegrafës, se nga dritarja pa përsëri ata dy karabinierët italianë që po afroheshin me dy letra në duar.

S q a r i m i

— ...Tjetër keni në shtëpi? — e pyeti Nazmiu pas një heshtjeje të shkurtër.

— Kam edhe vajzën, Zana e quajnë. Burri më kalbet nën dhé. Më ka mbetur merak që nuk e dërgova nëpër doktorë. Para nuk kisha... — i shpjegonte Netja, e zonja e bazës në rrugën e Dacit.

Nazmiu psherëtiu lehtë.

— Me Drinën ke biseduar?

— Si me time bijë.

— Do ta kesh vështirë...

— Përse ta kem vështirë? Ju për këtë Shqipëri keni vënë kokën në rrezik. Unë përse të mos e vë në shërbim tuaj shtëpinë? Ç'është shtëpia para jetës suaj?

— Jo. Netë, edhe kjo është luftë, madje luftë më e vështirë. Ti vë në shërbim të Partisë shtëpinë dhe rrezikon jetën tënde dhe të fëmijëve. Apo jo, Drina?

— Ashtu është, shoku «Ylli». Por desha të them se Netja është jona, është e Partisë.

Netës i lëvizi ai damari i kaltër që lëshohej afër syrit të majtë. Një zë gruaje thirri pas portës. E kërkonte komshia.

— Grua e çuditshme, shoku «Ylli». Kur ishim me nënë Aishenë bëmë një bisedë shumë interesante. Unë i fola se do t'i zhdukim fashistët dhe njerëzit e tyre që punojnë njëmijë të zeza mbi popullin fukara, ndërsa ajo më pyeti: «Si në kohën e mbretit do të jemi, edhe si të mbarojë lufta?» U zura ngushtë. Solla ndër mend bisedat tona, librat e broshurat që na keni dhënë ju. I shpjegova: «Jeta jote dhe e shoqeve tona do të jetë ndryshe, Netë! Ku të punojë burri, do të punojë edhe gruaja, në zyra, në ara, fabrika, do të mësojë në shkollë, do ta ndërtojë vetë jetën familjare, sipas dëshirës... e shumë gjëra të mira». Kaq i thashë se nuk dija të futesha më thellë.

Nazmiu qeshi i kënaqur.

— Të lumtë, Drina! Shumë mirë i ke thënë.

— Ti na ke mësuar edhe më, «Ylli», po unë nuk i mbaj mend të gjitha, — u skuq ajo.

— Mjafton që kryesoren di t'ua thuash grave dhe vajzave, Drina. Ndryshe nuk do të të vinin pas, — i foli Nazmiu me sinqeritet.

Netja u fut brenda bashkë me Irfanin, Gutin dhe Lis Korabin. Shokët vinin nga baza 41, ku u kishte ardhur një letër nga Demiri, me anën e një njeriu të panjohur nga Gryka e Madhe.

Nazmiu lexoi:

«I dashur «Ylli»,
Rashë në gjurmë. Haxhi Lleshi me disa patriotë besnikë këto ditë ka qarkulluar Grykës së Madhe. Atë e presin me dashuri e respekt. Në nëntë malet

e Dibrës fukarenjtë ia dëgjojnë fjalën dhe i hapin derën»

Vdekje fashizmit!
Demiri».

Nazmiu e dinte se Haxhi Lleshi që më 6 prill të dyzet e njëshit, kur Italia fashiste sulmoi Jugosllavinë, u arratis në mal për të luftuar pushtuesin fashist. Prandaj, që kur Partia e ngarkoi me mision në Dibër, ai u mundua që të lidhej me Haxhiun për të koordinuar veprimet.

— Pushkët për vatanin po shtohen! — thirri Nazmiu i entuziazmuar. Kjo është dëshira e popullit për liri.

Ai mendonte tani si të lidhej sa më parë me shokun Haxhi Lleshi, me këtë patriot revolucionar, që të plotësonte porosinë e Partisë.

T a k i m i

Me hapa të lehta, pranvera zbriti në Dibër, duke derdhur mbi malet e luginat puhinë e ëmbël e të ngrohtë. Maleve e luginave ua çeli fytyrën e ashpër. Veç Korabi e kreshtat e Lurës mbanin ende mbi supe borën e bardhë.

Haxhi Lleshi, me njësitin u kthve nga Peza. Atje ishte takuar me shokët e vjetër, Myslim Pezën e Kajo Karafilin, me të cilët e lidhte një miqësi patriotike, me pikëpamje antizogiste e antifashiste.

Haxhi Lleshi u takua edhe me shokët Enver Hoxha e Qemal Stafa. Shoku Enver i dha porosinë e nevojshme për luftën në Dibër. Tani Haxhi Lleshi plot energji ngjitej malit të Kërçinit.

— Ende nuk paskan mbërritur, Çlirim, — iu drejtua Haxhiu komunistit Çlirim Shtina, i cili ishte anëtar partie që me themelimin e Partisë dhe që me porosinë e saj ishte inkuadruar në njësitin qysh në Pezë.

— Mos kemi mënjeluar vendin? — foli ai, po përsëri e korrigjoi. — Ju i njihni me pëllëmbë këto male.

Një krismë revolveri jehoi, duke zgjuar pyllin me shushurimën e lehtë.

— Po vijnë, — u hodh një partizan. — Ja shih, atje, në brinjë të asaj kodre si këputen një nga një.

— Ata janë, — foli Haxhiu. Nxori revolverin dhe u përgjegj me krismë.

Ata ecnin. Përpara printe Lisi. Nazmiu shpërtheu xhakëtën nga djersa. Një partizan i armatosur rrezë dushkut, i ndali e i pyeti se ku venin.

— Te shoku Haxhi, — tha Lisi.

— Kush jeni ju? — pyeti roja.

— Tuajët jemi, partizanë, — tha Agroni.

— Atje, në kodër! — bëri me dorë roja.

Nazmiu e njohu nga larg Haxhiun, rreth të cilit ishin ulur ca fshatarë të armatosur, ndërsa dy të tjerë, disa metra më larg, me pushkë ndër duar.

Ata u takuan për të luftuar deri në fund si shokë të pandarë armësh. Haxhiu fliste. Ai shprehte urrejtjen ndaj pushtuesit. Nazmiu me shokë e dëgjonin, duke u bërë përshtypje çdo fjalë e tij

e pjekur dhe e matur. Ai pa tek shoku Haxhi njeriun e vendosur, vullnetin e papërkulur për të luftuar maleve, pa gjakftohtësinë, drejtësinë, dashurinë, besnikërinë, trimërinë e guximin, por edhe zemërimin e papërmbajtur që i shpërthente kundër padrejtësisë. Nazmiu e shokët e tij dëshironin të dëgjonin edhe më, nuk ngopeshin me ëmbëlsinë e fjalës dhe urtësinë e tij. Ndonëse i ri, ishte i shtruar në gjykime, i urtë dhe i butë sa të bënte për vete që në fjalët e para.

«Të gjithë janë djem të mirë, — mendonte Haxhiu. — Kanë shpirt të pastër dhe e duan këtë tokë e këtë popull».

— Me këta shokë të bashkuar, do të çajmë edhe malet. Apo jo, Nazmi?

Nazmiu lëvizi kokën i entuziazmuar.

— Po, shoku Haxhi, me Partinë tonë Komuniste në krye çfarë nuk do të bëjnë shqiptarët patriotë.

Ata biseduan për luftën, për shtimin e njësiteve me elementë të ri, për qëndrimin që duhej të mbanin ndaj reaksionit.

Nazmiut nuk i dolën nga mendja ato fjalë të Haxhiut: «Unë mendoj se fuqia jonë i ka rrënjët në popull. Populli shemb edhe malet».

Nën udhëheqjen e Partisë, këta të rinj dibranë lidhën zemrat me idealet, drejt një qëllimi të përbashkët.

Kënga e re

Duke u varur «Bregut të Bicës», Shaqir Grykamadhasi, me lopatë krahëve, nuk mundte ta përmbante atë gëzim që i kishte sjellë «ai komunisti», «Ylli».

— Hej-heeeeej! — i bëri zë shokut të vet në zallë të Sopotit dhe ia nisi një këngë të vjetër trimash: «Krisi pushka».

Për Shaqirin nuk ishte hera e parë që ngrohej me traktin e Partisë. Atij, Rrahmi Shkëmbi i kishte dhënë një të tillë dy javë më parë. Por, dje, ai e pa dhe e ndjeu nga afër komunistin. Prandaj sot ndjehej kaq i gëzuar. Një pucallar që lëshoi bagëtinë zabelit, i joshur nga kënga, i doli përpara.

— Të qenka kulluar zëri, pushkë e paske sot, o Shaqir!

Shaqiri ishte mjaft i zgjuar. Ai e vështroi fytyrën e çelur të pucallarit. Një fjalë i kishte rënë vjedhurazi në vesh për këta pucallarët zallorë. «Ata u hapin dyert komunistëve. Haxhi Lleshin e kanë mik të vjetër...»

— Po ti, a di ndonjë këngë të re? — desh të kërkonte me këtë pyetje Shaqiri, gjurmën e dëshiruar.

Pucallarit i dogji kjo. Ai atë natë kishte patur në shtëpi Haxhi Lleshin me njësitin e vet. Një këngë të re e të bukur kishte kënduar Haxhiu me shokët. Disa fjalë ia mbante mend pucallari, por jo të gjitha. «Dreqi vetë është ky Shaqiri!» — mendoj me vete.

— A këngë dashurie? — ia ktheu.

— Ahaaa, unë malit e ti zallit, or pucallar! — dhe e kapi nga krahu me përkëdhelje.

— Shaqir, kam dëgjuar një këngë. Kur ta mësoj vetë mirë, do vij të ta mësoj edhe ty. Më duket se edhe ti i do këngët e reja...

Shaqiri e zuri për mesi, e shtrëngoi fort dhe e ngriti dy-tri herë lart. Pastaj u munduan ta rrëzonin krah për krah njëri-tjetrin nga gëzimi, në atë brinjë kodre. U ndanë duke qeshur si fën ijët. Kështu e bashkuan vetë gjuhën e zemrës dy grykamadhasit.

Pucallari e dinte se grykamadhasit ia donte shpirti komunistët. Madje ai kishte dëgjuar nga një bari zerqanas, se Rrahmi Shkëmbi u kishte folur çiltas të rinjve për Partinë Komuniste, për Enverin, për luftën e për Stalinin, kur kishte ardhur tri javë të shkuara për pushimet dimërore, nga shkolla teknike e Korçës.

Trakti tek çezma e Melanit

Destan Kilja kishte qenë varr e gropë atë muaj nga ethet. Një doktor për fukara ishte në Peshkopi. Prandaj, si e mori pak veten, u nis tek ai.

— Nga je, xhaxha? — e pyeti doktori duke parë fytyrën e verdhë të Destanit, që ishte shtrirë mbi krevatin e vizitave.

Doktori i dha ilaçe. Xhepat plot ia mbushi, madje pa lekë. Destanit i bëri shumë përshtypje kur ai e pyeti për njerëzit, për hallet e tyre, për sëmundjet e për ushqimin. Por, kur e gërmoi pak thellë për çështjen e Italisë, madje dinte edhe emrin e Tolit, atëhere i lëvizi zemra.

— Po kjo ç'është, or doktor? — pyeti xha Destani.

— Merre, o xhajë, barnat të shërojnë trupin, kurse kjo të shëron shpirtin... — due i zgjati komunikatën e Partisë Komuniste.

Destanit i qeshi nuri. Pa se mos dera ishte e hapur. Tani e kuptoi cili ishte doktori. Prej Nazmiut vetëm një herë ia kishte dëgjuar emrin.

— Mos vdeksh ti, or doktor. Po xhajës ky shpirt ka filluar t'i përmirësohet... S'ka dy net që ai çuni ynë te mulliri i Xhemës na e ka lexuar e na e ka futur mirë në tru. Por po e marr edhe këtë prej dorës tënde, se më duhet...

— Hej, bela, sa nuk më doli mendsh, — iu kthye prapë doktorit. — Ai çuni ynë më ka lënë një porosi për doktorin nga Korça...

— Stefan Luarasin? — ia kujtoi tjetri.

Po, qofsh me jetë! — dhe i dha një zarf për Stefanin, doktorin nga Korça.

— Ku nuk po i fut rrezet e Partisë «Ylli», — foli doktori kur me xha Destanin shtrënguan duart për t'u ndarë...

...Në përrua, tek çezma e Melanit, u ul të çlodhej. Nxori nga gjoksi traktin dhe e vështroi me kujdes. «Njëloj qenkan. Po ato shkronja!» — dhe i trokiti në kokë porosia e Nazmiut: «Këndoje, shpërndaje e mos ia dorëzo armikut!»

Shikoi rreth e rrotull. Asnjë lëvizje. E hapi mirë traktin dhe e ngjiti në ballë të çezmës.

«Hajt, për hajër! E kanë brenda flakën këto shkronja...» — dhe u ra shkurt zabeleve e doli në Dovalan.

Të nesërmen ishte e enjte, ditë pazari. Me qi-

ndra fshatarë e panë traktin. Edhe ata të shumtë, që nuk dinin ta lexonin, e dëgjonin nga ndonjë shkollar. Çezmja te gështenjat e Melanit u bë vend mbledhjeje, që e organizoi vetë trakti. Kjo ishte një nga të shtënat e para të Destan Kiles kundër armikut.

* *

Togeri Male Aga vinte nga Dibra e Madhe, i hipur mbi një kamionçinë. U ndalua te çezmja e Melanit, ku vërejti tre të rinj të përkulur kokë për kokë, që po lexonin traktin. E mori me mend se ç'ishte. Ai ishte bërë milici i rrugëve e skutave. Nuk mundi të qëndronte i qetë në një vend, por bridhte sa më një rrugë në tjetrën, vërente çdo njeri me kureshtje e dyshim. Tani që pa traktin, u kënaq, se do t'i shkonte me diçka në dorë major Verdit dhe do t'i mburrej regjentit të kuesturës, Mato Muratit, për aftësitë e zbuluesit.

Zbriti nga kamionçina dhe priti që të rinjtë të largoheshin. Por vetëm njëri bëri dy-tre metra mbrapsht. Atëhere e kapi komunikatën harbutçe. Dy të rinjtë e zunë nga dora.

— Hej, italian, përse e gris?

Por Male Aga e qepi gojën. Futi komunikatën në xhep dhe hyri në kamionçinë, duke iu dridhur leqet e këmbëve. Ai erdhi në Peshkopi.

— Urdhëroni, zoti major, — dhe ia hodhi dy copat e komunikatës para në tavolinë.

Major Verdi lexoi: «Komiteti Qendror i Partisë Komuniste Shqiptare», — dhe nënqeshi me ironi.

— Ju vraponi pas këtyre fletushkave, por ne na duhen njerëzit që i shpërndajnë... Duhet komunisti Haxhi Lleshi, kupton? Ja, ky! — dhe i tregoi fotografinë. — Ja edhe ky tjetri, — i tregoi edhe fotografinë e Nazmi Rushitit.

Male Aga e ndjente veten të pafuqishëm për atë detyrë që mendonte t'i ngarkonte majori. Por nuk guxonte t'i thoshte «jo». Nëpër mend i kaloi ai Driza. «Me të vërtetë milic është, po talentin e tij nuk e njohin këta», — mendoi.

N ë D o v a l a n

Pas ca ditësh, Nazmiu u kthye në shtëpinë e tij me shokët. Nebija ishte tronditur nga fjalët që ishin përhapur nëpër fshat për djemtë.

— Po ti, nënë, sa herë ke uruar «Ardhëshin ditë të bardha!». Ditët e bardha nuk vijnë nga hasmi e zoti. Ato vijnë me plumb! — dhe Irfani i rrahu shpatullat Nebijes.

— Ç'po bisedoje me ata shokët ashtu? Mirë thonë, kush e trazon gjithë këtë Itali prej këndej, mor bir? — iu drejtua Nazmiut.

Nazmiu e përqafoi të ëmën me dashuri. E kapi nga duart dhe i tha:

— Ne sot jemi pak, nënë. Ti je bujkeshë e mirë. E ke vënë re arën? Kur e mbjell, në fillim mbijnë disa kallinj. Pastaj, dalëngadalë, ajo bëhet pyll nga misrat e njomë... Kështu është edhe me ne... Ti më rrite për këtë popull, nënë!

Nebijes i ndritën sytë. Ajo e përcolli të birin

dhe shokët deri matanë mullirit të Xhemës, ku shpesh bënte mbledhje me partizanët e grupit.

— Armët u ndritshin! — uroi ajo tek i shikonte shokët që u lëshuan buzës së Drinit. Vështirë e kishte ajo, kur i largohej i biri, se në vogëli nuk e kishte ngopur as me bukë e as me përkëdhelitë e dashurinë e nënës.

Dielli çau retë duke i dhënë një shkëlqim reflektues gurëve të përroit të Dovalanit, që, në këtë mëngjez, zbriste i turbulluar, nga rrebeshi i shiut që kishte rënë para agimit.

* * *

Xha Xhema nuk e ndante nga djali i tij Nazmiun, aq shumë e donte. Ai ishte i rrafshtë, trim e bujar. Nazmiu dëgjonte historitë e vjetra për luftërat që kanë bërë dibranët kundër Hajredin Pashës, trimëritë e Mahmut Dacit, të lurakëve, dhe për luftën kundër serbomëdhenjve.

— Kështu janë sjellur hasmit me ne, mor bir. Njëri më i egër e më barbar se tjetri. Po kjo Italia e Duçes, më duket krajl i madh, sikur na i ka gozhduar shpatullat e nuk mund të lëvizim lehtë.

Ky vend, e the edhe vetë, nuk ka pyetur për krajla të mëdhenj. Të vegjël kemi qenë, por kokulur s'kemi qëndruar, apo jo, xhajë Xhema? Edhe ky bajloz që na ka ardhur nga deti, s'ka për ta parë as rrugën nga ka për të ikur!

— Epo ty të lumtë ajo gojë! Po vetëm me atë patllaken tënde...

Nazmiu qeshi.

— Eh, mor xha Xhemë. Ti vetë e the se di-branët kanë luftuar edhe kundër pashës me sokere. Luftën e bëjnë njerëzit dhe jo armët!

— Po paria, çfarë krahu do të mbajë?

— Ç'pret prej tyre, xha Xhemë? Ata me të gjithë hasmit janë bërë byrazerë. Myftar Kaloshi ka pirë gjak e është bërë byrazer me majorin e karabinierisë italiane. Ndërsa beu i fushës, Fiqiriu, lëpin në një sahan me gjeneralin në Dibër të Madhe. Ata vrapojnë si qentë pas parasë! Pastaj, kur kanë luftuar bejlerët ndonjëherë? Vetëm njerëzit që i ka tretur vuajtja, uria e shtypja, i kanë lidhur zemrat dhe i kanë thirrur pushkës, xha Xhemë!

— Të pastë xhaja, mor Nazmi, ashtu ka qenë. Desha të drejtën. Më kanë lënë pa mend e ma kanë ndarë shpirtin më dysh ca fjalë që bredhin këndeje, për ty dhe shokët e tu....

Nazmiu e nuhati se ku e kishte plaku.

— Na thonë «rusë të kuq»... — i tha e qeshi me të madhe.

Xha Xhemës iu errësua fytyra.

— Mor, mirë të kuq... nuk ma duron goja ta them... — u përtyp plaku. Pastaj i tregoi Nazmiut gjithë atë skenë të turpshme që kishte kurdisur beu në mes të fshatarëve: «... Po, po. Ai që, kur flet me ju, e lyen gjuhën me mjaltin e gënjeshtërs. I biri i Rushitit është këlysh i Ruisë! Si mor, do ta mbani atë turp, që të martohet motra me vëllanë? Tybes-tarfkurullah! Mor, po edhe në sheher të Dibrës, po i biri i Rushitit na kishte mbledhur ca vajza e djem bashkë, e se çfarë bënte me ta, një zot e di! — ia mori nëpër gojë beut, një qytetar barkmadh që kishte ardhur mysafir nga Dibra e Madhe.

— Kështu, o Nazmi djali, njëri e fillonte, tjetri e mbaronte fjalën. Edhe shumë fjalë të tjera thanë, po këto nuk më harrohen. Sytë na u errën e dynjaja sikur na vinte rrotull! — mbaroi i menduar fjalën, duke pritur të vërtetën nga Nazmiu

— Xha Xhemë, është mirë kur të urren hasmi!
Plaku hapi sytë.

— Kur të urren hasmi, do të thotë se jemi në rrugë të drejtë dhe atëhere ai e ndjen në palcë hakmarrjen dhe përbuzjen tonë! Ata shpifin me qëllim që ta largojnë popullin e varfër nga Partia dhe ta bëjnë mish për top, në interes të tyre. Por Partia nuk do ta lejojë!

Xha Xhemës sikur i ndriti fytyra. Ai nuk i harroi këto fjalë të Nazmiut dhe në çdo kuvend i përmendte si vjersha

Tek nënë Sibja

Sa zbardhëlloi pak drita, «Kaçatori» veshi opingat dhe ra si shigjetë tek mulliri i Xhemës. Si e lau mirë vendin me sy, doli pas mullirit, futi dorën në murin e spërkatur, hoqi një gur dhe nxori gëzhojën, në grykën e së cilës zbardhte një letër e bardhë sa një cigare.

Sa herë e kishte marrë «Kaçatori» këtë gëzhojë postare me dy-tri fjalë të Partisë të shkruara nga «Ylli»! E fuste gëzhojën në palë të teshave, kapërcente zaje e male, shkonte përmes Dibrës së Madhe e Peshkopisë, kalonte dhe deri në Ohër e Gostivar, përshkonte fshatra e stane që të ndërlihd-

te shokët me «Yllin». Sa herë ishte hedhur mes dallgëve të Drinit me gëzhojën në gojë që të mos i llogej letra!

Ai e kaloi Drinin dhe e gjeti Xhafer Shahinin me dy fshatarë në një kasolle në fund të Hoteshit. Gëzhojën ia dha në dorë. Ai lexoi «Nesër në mbrëmje tek baza ku piqen dy zajat. «Ylli».

Vetëm kaq shënonte Nazmiu. Xhaferi ia kapi veshin me përkëdhelje «Kaçatorit» dhe i futi në dorë gëzhojën postare. Ai ngriti grushtin lart dhe fluturoi plumb në zabel, drejt Drinit.

Të nesërmen Xhaferi priste të zbriste mirë nata mbi dy zajat. Maqinat u rralluan dhe ai ra nën rrugën automobilistike; kaloi dy zajat dhe, ashtu i bërë qull, u afrua tek xhami i dritares së vogël të kasolles së vetmuar, në anë të Çerenecit, rrëzëkodrave. Një dritë e vogël kandili shquante fytyrat e dy jetimëve, të cilët Sibe Gjura mundohej t'i vinte në gjumë. Në dhomën përdhese zjarri bubullonte.

Xhaferi kishte dëgjuar që heret se ç'i pat ndodhur kësaj malësoreje trime me Iljaz Demën e Drizë Gramën. Të dy këta «trima» qenë nisur në pikë të natës me nga tridhjetë milicë me vete. I thyen derën kasolles, e kontrolluan skutë më skutë dhe ia vunë pushkën në kraharor Sibes.

Por ajo nuk ishte përrulur e s'i kishte bërë tërt syri.

— ...Çfarë sokolësh! A vërtet e ke, bre Iljaz Dema, se po më tremb me këto pushkë? Po Sibes a s'ke fuqi t'ia vësh kokën gur nën gur e t'ia bësh petë? Ky vend na paska edhe ujq edhe gjarpërinj...

— I lë fëmijët edhe pa nënë, merr vesh ç'të themi? Mos u bë e zeza e fëmijëve, — thërriste Driza si i çmendur.

Iljazi u tërhoq. Sibja ia largoi pushkën Drizës dhe mori dy fëmijët pranë vetes.

Iljazi nxori nga xhepi një dorë me napolona flori, i lëvizi mbi pëllëmbë të dorës, duke menduar së Sibes së varfër vetëm me shkëlqimin e tyre do t'ia thyente mendjen.

— Për ty, Sibe, vetëm...

— Jo, bre Iljaz. Ku jemi mësuar ne me alltan? Ata janë për zotnitë.

— Mendo për fëmijët.

— Fëmijët e mi nuk dinë t'i prishin ato para alltani dhe kam frikë se më bëhen fëmijë rrugësh e jo njerëz të punës e të djersës së vet. Të fale-minderit që po shtihesh kaq dashamirës për ne.

Këto i kaluan rrëmbimthi nëpër mend Xhaferit, pranë dritares.

For ja, nga zabeli lëvizën fësh-fësh shkurret. Ca sokëllima erdhën deri tek dritarja.

— Mbërritën të gjithë?

— Fo, shoku Nazmi.

— Spiroja përse mbeti prapa?

— La një porosi në Viçisht për Ahmetin. Është me Lis Korabin.

Xhaferi i njohu nga zëri. Ai u foli i pari. Ata bënë gati armët. Pastaj u muarën vesh. Edhe Spiroja me Lisin arritën.

* * *

Nazmiu deshi të trokiste në dritare, por zëri lutes e i përvareshëm i Sibes e ndaloi.

— ...Madje nëna nesër do të shkojë në sheher t'u shesë zonjave botë për të larë kokën, se farishte nuk blejnë më. Me këto para nëna do t'u blejë edhe opinga.

Vocrrakët e puthën Siben e u shtrinë mbi postiqe. Edhe ajo u shtri pranë tyre.

Sibja zgjati trupin të fikte kandilin mbi oxhak, por xhami trokiti tri herë me ndërprerje të zgjatura. Flaka e kandilit u lëkund nga fryma e nuk u shua.

«Haxhi Lleshi, — pëshpëriti Sibja dhe mbeti si e ngrirë, mbështetur mbi bërryl. — Ai duhej të vinte qysh javën e kaluar. Po sikur të jenë «gjarpërinjtë»? Futi dorën nën jastëk dhe kapi dorezën e nagantit që ia kishte lënë Haxhi Lleshi.

Xhami trokiti përsëri tri herë.

— U fëlliqkam! — dhe u ngrit.

— Sibe, hape derën! — dëgjoji ajo zërin e Nazmiut.

Ajo vetëm një natë e kishte parë atë, kur kishte ardhur me Haxhi Lleshin dhe e kishte nuhatur mirë se ishte shok për kokë. Asaj i kishte mbetur në mendje zëri i ëmbël dhe zjarri i fjalëve të tij:

Pas pak ajo dhomë e vogël u mbush plot. Xhaferi u tregoi për aktivitetin në zonën e Maqellarës, për panikun që i kishte kapur fashistët dhe parinë. Shokët u gëzuan kur Nazmiu u tregoi se në nëntë malet e Dibrës fjala e Partisë kishte hyrë në zemrat e njerëzve.

Ishte java e dytë e muajit maj të vitit 1942. Destan Kilja, si të kishte adresë të sigurtë, arriti nga Tirana dhe ia vuri komunikatat përpara Nazmiut.

— Qenke bërë vetëtimë, Destan! Shoku «Ylli», ky pardje u nis nga Bllaca.

— Ne e bëjmë luftën, po edhe ajo na bën ne të fortë e të sakrificës. Apo jo, nënë Sibe?

— Kjo që kam në dorë, është futur në zjarr një herë, dhe pastaj është bërë thikë për të prerë! — foli Sibe Gjura, e cila po mendohej të pjesëtonte bukën e porsapjekur.

Po Destan Kilja e kishte zemrën helm. Që në Tiranë «Erzeni» mezi ia kishte lexuar komunikatën e Partisë Komuniste dhe e kishte porositur:

«Bëju veri, xha Destan, dhe jepja sa më parë shokëve në Dibër. Ti e mësove se ç'komunist u nda prej nesh, ç'komunist humbi Partia, çfarë shok armësh humbëm... Gjaku i tij, tani, më tepër se kurrë, na fton për hakmarrje...»

— Po ti, nga je, mor djalë?

— Xha Destan, të Partisë e të vatanit jemi!
— ia ktheu Erzeni.

Dhe Destani u bë si era. Kapërceu malet natën dhe u gjend mes shokëve. Nazmiu mori një trakt në dorë dhe filloi ta lexonte. Tavani i dhomës së vogël sikur po i binte në kokë. E ndërpreu njëherë leximin, vështroi shokët dhe heshti. Mori frymë thellë dhe lexoi përsëri:

«...Shoku Qemal Stafa ra dëshmor...»

«Ç'thotë ajo letër, vallë?» — pyeste veten nënë Sibja. — A thua mos ka ndonjë lajm të hidhur brenda? Përse u errën në fytyrë trimat?»

Heshtje. Edhe frymë sikur nuk merrnin shokët. Ata e shikonin që Nazmiut i mbeti trakti në dorë dhe nuk po lexonte. Sytë e pikëlluar i mbe-tën në një vend. Ato rreshta me shkronja, derdh-nin lajmin e kobshëm.

Të tjerët lëvizën nga vendi, si të qenë mpirë nga ajo heshtje e gjatë dhe e rëndë. Spiro Velko-ja vështroi Nazmiun. Ai filloi të lexonte. Sibja mbe-ti me duar në faqe. Nazmiu e shikonte që ajo vuante për komunistin e vrarë, si gjithë shokët e tjerë. Ai deshi ta sundonte veten, po nuk arriti.

— Po, shokë, — foli mbas ca minutash hesht-jeje e zije. — U vra, siç vriten burrat! Por ne, sho-kët e tij të armëve, flamurin për të cilin ra Qe-mali, do ta mbajmë, do ta ngrejmë edhe më lart...

Gjumi nuk i mori. Pa dalë drita, ata u përshë-ndetën me nënë Siben. Në prak të derës, ajo tha:

— Nazmi, komunisti i nënës, dhe ju o trima partizanë! Luftëtarët e gjejnë ngushëllimin kur e marrin gjakun me gjak për hatër të këtij vatani! Kur Haxhiu i dëgjoj këto nga Nazmiu, luajti kokën i gëzuar:

— Sibja trime! Ajo edhe na ruan, edhe na frymëzon!

NË KONAKUN E BEUT

Konaku i beut ishte mbushur plot me besnikë të armatosur, mercenarë koskalëpirës, që ishin gënjyer e kishin shitur ndërgjegjen e tyre të ulët tek beu. Mes tyre kishte edhe bujq e pleq të mosshuar.

Fiqri beu ishte tërbuar fare kur i kishte rënë në dorë trakti i parë i Partisë Komuniste Shqiptare. E kishte lexuar deri në mes dhe shpirti i kishte rënë për tokë. Me trakt në dorë ishte mbyllur në një rën nga dhomat e tij. Edhe duhani i dukej zehër. Fliste vetëm me vete. S'donte të shihte asnjeri. Me orë të tëra s'e hapi derën.

Në derë u dha Sabriu.

— Fiqri bej, Nazmi Rushiti...

— E vranë?! — dhe sytë i ndritën.

— Jo, ai ka ardhur në mexhelis. U pret ju!

— Si?!..

*

*

*

Beu mundohej që atë që kishte në shpirt, të mos ia thoshte goja e të mos ia shprehte fytyra. Megjithëse ishte i rrahur në këto shtigje, prapë tra-

dhtohet nga një urrejtje që i mbledhet në zemër e shpërthente vrullshëm, duke iu endur fytyrës pulla-pulla të verdha.

Si u hëngrën me rromuze, të cilave Nazmiu ua dinte mirë filozofinë e dyfishtë popullore, ranë në gjuhën e thjeshtë.

— Pse t'i bësh bisht fjalës, zoti Fiqri bej, e vërteta gjendet te gryka e pushkës. Kjo i zhduk poshtërsitë.

Beu nuk iu përgjegj menjëherë. Ai thithte çibukun, me sytë e mbërthyera mbi minaretë e xhamive të sixhadeve të shtruara, sikur të kërkonte ndihmë prej tyre.

— Po pushka të plas edhe ndër duar, nganjëherë, — foli pastaj, duke mos guxuar ta shikonte në sy kundërshtarin. — I duhet parë fundi kësaj fjale. Duhet tjerur dhe endur hollë ky hesap... Italia është mal i madh... Duhet të sillemi butë me të... Pastaj ne... një dorë njerëz, dhe jemi derdhur e shpërndarë si drithi i ujkut, — iu duk se e gjeti fjalën beu.

Vetëm Nazmiu e beu flisnin, ndërsa njerëzit e armatosur të këtij të fundit qëndronin tërë sy e veshë. Disa shtrembëronin turinjtë, të tjerë merrnin një pamje habie.

Beu lëvizi nga vendi, kur kujtoi që Nazmiu u kishte thënë dovalanasve: «Shqipërinë do ta ketë në dorë populli i thjeshtë, ai do ta qeverisë vendin. Ndërsa bejlerët dhe agallarët do ta gjejnë vendin e tyre!»

— Po ti e ke lëshuar si tepër gojën, — foli beu, — duke kujtuar edhe ankesat e Hysni Demës e krerëve të tjerë të parisë.

— Edhe do të vazhdoj ta lëshoj, që ta dijë populli se kush i del zot këtij vatani. Që të dalë buka e mirë, duhet situr mielli, Fiqri bej, — foli i matur Nazmiu.

— Edhe ne për këtë Shqipëri i kemi përveshur llërët...

— Po besa, i keni përveshur për të rrjepur e për ta shitur. Tregoje me vepra se je patriot, e jo të rrish gojë më gojë e vesh më vesh me fashistët.

Beu nuk dinte si t'i bënte bisht fjalës dhe ra aty, ku binte gjithë klasa e tij:

— Është e madhe dhe e fortë Italia. Do ta përvejojë popullin. Mos u sillni ashpër me të. Duhet gjetur një rrugë tjetër...

— Rrugën e kemi gjetur, Fiqri bej! — Nazmiu nxori revolverin dhe e ngriti lart. — Ja, kjo është rruga jonë! Fati i popullit tonë është varur vetëm te gryka e pushkës!

Njerëzit përreth lëvizën të habitur. Beu heshti dhe uli kokën. Kjo kërkonte përgjegje.

— Po, po. Unë them që ta marrim ngadalë, pse ta lëvizim gjarpërin? Kur t'i bien dhëmbët e të mos ketë fuqi për të kafshuar, atëhere t'i shtypim kokën, — dhe vështroi përreth.

— Ne nuk presim as edhe një orë që mbi shpatullat e atdheut të rëndojë robëria fashiste. Ne do t'ua shkulim dhëmbët gjarpërinjve një nga një, edhe pa ju! Do t'ua shkulim dhëmbët edhe atyre që janë kundër nesh! — e ngriti zërin Nazmiu.

— A thua do t'ia arrini ju, komunistët? — pyeti beu duke qeshur me ironi.

— E çfarë nuk arrin populli, Fiqri bej? Ai do

të fitojë, sepse po ngjesh armët dhe po mëson se nga duhen drejtuar plumbat.

— Ha-ha-ha! — qeshi beu me inat. — Populli? E ç'është ky popull? Ne jemi populli... 'A nuk i shikon këta skiftera! — u mburr beu dhe tregoi me dorë mercenarët dhe të gënjyerit e tij, të cilët u krekosën si gjela.

— Jo, Fiqri bej, gabohesh! Ju nuk jeni populli. Populli është fukaraja që vuan për një kafshatë bukë misri, që vuan nga gënjeshttrat dhe mashtrimet e parisë dhe hoxhallarëve. Por fukaraja, Fiqri bej, do të zgjohet shumë shpejt e nuk do të kenë më fuqi të drejtoni ku të dojë paria!

Disa armëmbajtës filluan të shikonin njëri-tjetrin, duke dashur të kërkonin ku ishte e drejta. Beut iu qep goja si t'i kishte rënë pika. Ai nuk kishte fuqi t'i dilte përpara që të ndalonte të vërtetën.

— Unë them edhe një herë, — vazhdoi Nazmiu, — që, para se populli të detyrohet të drejtojë pushkët kundër jush, bashkohuni me ne kundër pushtuesit të huaj.

— Me ju? Me komunistët? — foli me urrejtje e përçmim beu, duke u ngërdheshur e duke marrë një çehre bajate në fytyrë.

— Ju deri tani e keni tërhequr popullin pas vetes, po ai ka qenë i paditur, i lënë me qëllim në errësirë. Ja, kjo e vërtetë ndodhet këtu rreth nesh.

— Mor, për nur të allahut, t'i derdh trutë për tokë! — thirri një armëmbajtës dhe i drejtoi pushkën Nazmiut. — Mos hap gojë për beun e për ne!

— Butë, trim, butë, — i foli shoku pranë dhe i uli për dyshemeje grykën e pushkës. Në konak a bë zhurmë. Një pjesë e mirë flisnin në dobi të

Nazmiut. Ekuilibri i beut u lëkund. Nja dy fshatarë nga fundi i dhomës guxuan:

— Veç mos na daltë në shteg ky!

— I lumtë komunistit!

— Po ky, kapadaiu?...

— Lëre, mor atë! Ia ka mbushur legenin me koska beu.

— I poshtri!

Nazmiu qeshi me hidhërim kur njeriu i beut i drejtoi pushkën.

«Ka të drejtë, — mendoj. — E kanë verbuar. Tani e përdorin në vend të kërbaçit.»

Në mes kësaj turbullire, Nazmiu iu afrua «trimit» të beut dhe i tha:

— Këtë pushkë, lum miku, ruaje për të mbrojtur atdheun, familjen, përdore kundër fashistëve italianë dhe njerëzve të shitur!

— «Dëgjoni, or burra, — e mori fjalën beu, — komunizmit po i shkulen rrënjët atje ku ka mbirë, në Rusi. Ushtria gjermane po futet në Moskë, kurse i biri i Rushitit kërkon të na mbjellë komunizmin në kepat e Dibrës!» — foli beu e i mori zjarr fytyra e trupi.

Pleqtë dhe njerëzit e tij e kthyen shikimin nga Nazmiu. Qetësia sundoi përsëri në konak.

— Ashtu është, bej, po ta shpjegosh politikën sipas gazetave të fashizmit, se nga ai të vjen hallva dhe kafeja. Por ne luftën do ta fitojmë, do ta fitojmë që kur kemi kapur armët dhe që kur kemi mësuar se nga duhet t'i drejtojmë plumbat... Dhe komunizmi do të rritet e do të fitojë jo vetëm në nëntë kepat e Dibrës, por në gjithë Shqipërinë e në të gjithë botën! — thirri fort Nazmiu.

Zhurma nisi përsëri. Beu u trondit.

Pastaj Nazmiu u ngrit, i vështroi të gjithë me radhë dhe çoi grushtin lart:

— Vdekje fashizmit! — dhe doli i ndjekur, sa me urrejtje, sa me admirim. Ca njerëz me armë e pa armë dolën nga konaku dhe e ndoqën pas komunistin. Fjalët e tij kishin ngrohur zemrat e fshatarëve.

P ë r p j e k j e

— Vdekje fashizmit!

— Liri popullit! — përshëndetën njëri-tjetrin dy ilegalët, kur dolën nga shtëpia e Gani Lleshit, në Banishtë. Aty dy komunistët biseduan për organizimin e rinisë të qytetit të Dibrës dhe për armatimin e njësimit.

Ishte maji i vitit 1942. Irfani u nis për në Dibër të Madhe, ndërsa Nazmiu mori rrugën drejt Sollëkiçit. Shokët e prisnin në Dovalan tek mulliri i Xhemës. Ecte serbes, i veshur dibrance, me tirqe, xhoke, brez të kuq, qeleshe dhe opinga, në shpinë mbante trajsën varur me një shkop. Pesëqind metra larg Banishtit, dy karabinierë italianë të armatosur i prenë rrugën harbutçe, pa e ditur se ishte ilegal. Nazmiu qëndroi.

— Pasaportën! — thirri me kërcënim njëri prej tyre, kurse tjetri uli pushkën nga supi dhe i hoqi siguresën. Nazmiu u kap ngushtë.

— Pasaportën! — kërkoi me këmbëngulje përsëri karabinieri, duke marrë edhe ai revolverin në dorë.

Nazmiu bëri sikur u bind. Pa e humbur gjak-

ftohtësinë, hodhi dorën në brez, gjoja për të paraqitur dokumentin, dhe me shpejtësi të rrufeshme nxori një bombë.

— Kjo është pasaporta e popullit tonë! — thirri sa mundi, duke e mbajtur gati për zjarr bombën e kuqe. Nxori revolverin dhe e ktheu grykën drejt tyre.

Dy karabinierëve iu ngrinë armët në duar nga kjo e papritur. Dyllë të verdhë, bënë dy-tri hapa mbrapsht. U mënjanuan që t'ua mbathnin këmbëve, por zëri urdhërues i Nazmiut, i gozhdoi në vend.

— Dorëzoni armët! — dhe qëlloi tri herë lart.

Ata, me kokat varur, vendosën revolverët dhe pushkët mbi gurët e vegjël të rrugës.

«Sa shumë u dhëmbet lëkura, qenve» — mendoj Nazmiu. Dielli të përvëlonte. Disa bujq aty pranë, lanë punën dhe po shikonin të habitur. Jo shumë larg ndodhej edhe mareshalli Xim Asperi, i shoqëruar nga tre karabinierë. Kur dëgjuan armën e Nazmiut, u vunë menjëherë në ndjekje. Pa u ndjerë i qenë afruar vendit të ngjarjes. Ata dëgjonin dy karabinierët e dorëzuar tek i luteshin komunistit që t'u falte jetën. Mareshallit iu ndez gjaku dhe hapi zjarr. Karabinierët e çarmatosur e me duar lart u hutuan. Nuk kuptonin ç'po ndodhte. Nazmiu, i kthjellët e gjakftohtë, hodhi bombën si përgjegje, kapi rrufeshëm armët e dorëzuara nga dy karabinierët dhe u largua duke u mbrojtur. Plumbat e ndiqnin. Kapërceu një gardh ferrash dhe zuri pozicion. Pushkët ndiheshin gjer në thellësi të Fushës së Maqellarës. Edhe Kep Dreni i dëgjoi pushkët. Hodhi shatin, hyri në shtëpi, nxori armën dhe, si dre i vërtetë, duke u përulur rrëzë

gjerdheve e duke u bërë rrafsh me tokën, u zvarrit dhe iu afrua Nazmiut. Kepit i shkuan në mend fjalët që kishte thënë komunisti mes bujqëve të fushës, një javë më parë:

«Kujt i duhet pushka e fshehur vrimave, Kep Dreni? Lërjani tokën djerr beut, kapini pushkët, burra, që të mos dëgjohet vetëm një krismë e thate alltije në gjithë këtë fushë! Kështu thotë Partia, vëllezër!»

— Hajde, të lumtë pushka! — i tha Nazmiu, kur Kepi, me të qëlluarën e parë, ia gjakosi kra-hun njërit karabinier.

Pushkët vazhdonin. Nazmiut dhe Kepit po iu mbaroheshin fishekët. Një fërshëllimë e paprerë u përzie me krismat. Nga posta e Maqellarës po vraponin përforcime të tjera karabinierësh. Një plumb i rrëzoi Nazmiut qelshen e bardhë, duke e shpuar tejpertej.

— Po na marrin krahët, — foli Kepi kur pa qelshen e biruar nga predha.

U tërhoqën mes plumbave duke i shpëtuar syrit të karabinierëve.

N j e r i u y n ë

Usta Huta arriti i pari te «Varret e Vrame». Si nuk pa njeri rreth e rrotull, thirri:

— Heheeeeej!

Zëri i tij mori pyllit, u përplas shkëmbit të fshehur në ahishtë, duke jehuar, dhe e ktheu thirrjen e ustait, si t'i përgjigjej goja e madhe e malit. Te lisi, dy hije të gjata i dolën përpara. E njohu Naz-

miun. Duke iu afruar i erdhi në mend takimi i parë me të në shtëpinë e Haxhi Hykës në Tiranë, ku ndodheshin edhe Nexhmije Xhuglini me Skënder Kosturin.

— Heu, për bukën, e mbajtet fjalën, o trima!
— kërcëu si dre ustai dhe u gjend në këmbë. —
Po ky shoku?

— Është njeriu ynë, usta Huta, — gjegji Nazmiu dhe i ra shpatullave të tij si të divit.

Demiri e studjonte mirë ustanë, tek bisedonte me Nazmiun. Ai çuditej kur i kuptonte drejt disa gjëra dhe jepte, madje, gjykime të guximshme. Me të vërtetë pa shkollë, por kishte fituar mjaft nga jeta, nga vuajtjet me sharrë e sqepar për brezi. Duke vështruar ustanë, Demiri kujtonte atë histori të jetuar të këtij malësori trim.

— Dëgjo, usta Huta, — i kishte thënë një udhëheqës i njësitit guerril në Tiranë. — Ne do ta krijojmë situatën që ti të rregullosh shtëpinë e prefektit, Qazim Mulletit... E kupton qëllimin tonë?

Ustai kishte ngritur supet e kishte nënqeshur.

— Na duhet një leje qarkullimi nga prefekti, — e kishte sqaruar udhëheqësi i njësitit guerril.

— Tani më hyri në tru, — ishte përgjegjur Huta.

Dhe një ditë, me naivitetin e tij prej malësori, u gjet duke rregulluar shtëpinë e prefektit. Ç'ndodhi? Atë javë nëpër muret e shtëpisë së tij, u ngjiten traktet e Partisë. I tillë ishte plani.

Nga qoshja e shtëpisë së përtejme u dukën ca xhandarë që vraponin me sa u hanin këmbët në drejtim të shtëpisë së prefektit.

Ustai i priti gjakftohtë karabinierët. Ata e ka-

pën, e shkundën fort nga krahët dhe e kontrolluan. Pastaj e mbështetën për muri.

— Trego kush i ngjiti, se të gozhduam, si këtë dërrasë!

Nuk më kanë parë gjë sytë. Vetëm pak minuta para jush, dy burra, me veshjen tuaj, erdhën këndeje me disa letra në duar. Ndoshta ata..., — foli ustai pa e prishur gjakun, për të humbur gjurmët.

Karabinierët u shastisën. Disa vazhdonin të kontrollonin, disa hynë rrugicave.

— Gënjen! Hiqesh si ëngjëll, por je një djall me brirë ti! — i thirri oficeri.

Usta Huta qeshi me djallëzi.

— Çfarë thonë ato letra?

— Koka jote dashka të mësojë edhe çfarë thonë? I pastruat muret? — iu kthye pastaj një karabinieri.

— Tas i bëmë, zoti toger!

Ata u larguan. Usta Huta qeshi sa mbajti brinjët me dorë kur lëshoi sytë në tezgën ku punonte dërrasa me zdrukth. Ai nuk gjeti vend më të sigurtë në shtëpinë e hallakatur se sa «podrumin» e tezgjahut të tij. Nën të kishte maskuar me mjesh-tëri «cucën» që ngjiti traktet dhe e kishte siguruar aq mirë me lëvoret e zdrukthit. «Cuca» u shkul së qeshuri me ustanë e zgjuar e të shkathët.

— Urdhëro këto robe e vishi. Bëju edhe ti usta njëherë, — i foli Huta, dhe i dha vajzës një palë rroba punëtori që të maskohej.

— 'A më kanë hije, usta Huta? — iu kthye ajo duke qeshur, si veshi rrobat.

— Më thuaj ti, çfarë nuk u ka hije cucave të Partisë? Të pushkës janë, të punës janë!

— Vdekje fashizmit!

— Liri popullit! — ngriti sqeparin lart ustai.

Vajza doli e qetë me një kovë gëlqereje në dorë dhe u përzie me turmën e njerëzve. Ustai e shikonte i gëzuar.

«Rrofsh, moj bijë, për Parti e për Shqipëri!»
— e uroi ai me gjithë zemër.

Pas pak, hundë e buzë, doli nga vetura prefekti dhe filloi të vizitonte shtëpinë e re. Ai e kishte të freskët lajmin se ç'kishte ngjarë në konakun e tij.

— Duhet të jesh edhe usta, edhe xhandar! Kështu i do Qazimi punëtorët e vet! — i tha prefekti. — A nuk e pe se ç'bënë kopukët?

— Nuk kam shkelur unë atij fshati, zoti prefekt. Ta dish se unë ta lashë shtëpinë lakuriq.

— Si mor, e hëngërshin shtatëqind dreqërit, e hëngërshin, — mallëkoi prefekti, duke përplasar bastunin për dysHEMEJE.

— Ju e gëzofshi shtëpinë, zoti prefekt, me gjithë njerëzit e barkut tënd, po unë nuk rri këtu të më shajnë e të venë dorë mbi mua sa karabinierë e xhandarë ka! Aq më tepër, në ustanë e zotërisë suaj. Kështu nuk punoj unë! Hatër të kam te allahu, por...

Prefekti u mendua një çast. Vështroi tavanin e punuar me një mjeshtëri të rrallë që kishte mbetur përgjysmë.

— Mirë, mor usta, ç'kërkon prej Qazimit, që e hëngërshin shtatëqind dreqërit, e hëngërshin?

— Vetëm një leje qarkullimi, zoti prefekt, që të mos vejë më dorë i huaji mbi mua, mbi ustanë tënd. Nuk mban më kjo fytyrë.

Prefekti ia lëshoi lejen usta Hutës. Misioni

u krye. Kjo e gëzoi udhëheqësin e njësitit guerril. Me këtë leje ata do të kishin mundësinë të qarkullonin ngado nëpër Tiranë. Ai atë muaj u takua edhe me Nazmiun.

«Me të tillë njerëz na mëson Partia që të lidhemi», — mendonte Demiri, duke u shpëputur nga kujtimet dhe duke kapur tani bisedën e dy shokëve që i kishte kaluar për pak minuta.

— ...Kështu, usta Huta, do dynden malet e Dibrës dhe të gjithë Shqipërisë dhe kurrë nuk do të ndalojë marshimi ynë, se rrugën na e ndriçon Partia!

Ustai shikoi nga Demiri. Ky lëvizi kokën në shenjë aprovimi.

— Italia është lidhur me bejlerët, Nazmi. Në Tiranë, ajo vajza nga qyteti m'i futi në tru disa gjëra. Por ne jemi si në dru të pagdhendur, o komunist. A kanë fuqi kasollet tona që të luftojnë kundër sarajeve? Ato vetëm me hije na mbulojnë.

— Gjithmonë fukaraja është matur me hasmin, usta Huta, kurse njerëzit e sarajeve e kanë shkelur gjakun, i kanë vjedhur fitoret, — foli urtë e butë Demiri.

Ustai heshti një copë herë, duke i peshuar me logjikën e tij ato fjalë të mënçura.

— Po, po, kasollet tona... — përshpëriti. — Edhe kjo historia e dhimbshme që më tregove e ka burimin tek lufta e kasolleve kundër sarajeve. Ai sopotasi donte bukë për fëmijët. Në vend të saj, mori plumbin. Kush i bënte këto? Bajraktari i kurdiste, usta Huta. Por kur të çlirohet vatani, Partia nuk do t'i lëjë sopotasit, tërhovasisit, martaneshasisit që të vriten për bukë. Toka do të jetë e fuka-

rasë, njerëzit do të punojnë e do të qeshin së bashku! Ty të duket larg kjo ditë. Por ne, shpejt, shumë shpejt, do ta krijojmë këtë lumtëri për fukaranë, usta Huta!

— Këto i kam dëgjuar edhe në Tiranë, o komunist. Tamam siç thua ti është. Edhe ne, vegjëlinë, mbrapa na keni...

Pushuan edhe ca «dy shtegëtarët» me ustanë dhe pastaj të tre ranë në Gollobordë, morën mësuesin Spiro Velko dhe kaluan stan më stan.

Kapiteni me mision të veçantë

— Urdhëroni, urdhëroni, sinjor. Vetë ministri u shqetësua për vonesën tuaj! — e priti major Verdi kapitenin fashist, Stavri Jahon, në zyrën e tij, atë mëngjez të dyzetedyshit, dhe i zgjati paketën e cigareve. — Nga Tirana, si është «klima», sinjor kapiten?

Kapiten Stavri lëvizi mbi karrige, sikur ta shponte diçka.

— Eh, sinjor major! Me frikë shkon njeriu, si në xhiro, edhe në zyrë. Kur nuk e pret, dalin komunistët dhe qëllojnë me plumba. Qysh kur u formua ajo partia e tyre, edhe më të lënurit ecin dhe flasin serbes...

Majori e sodiste. Atij i kishte thënë vetë ministri i brendshëm në telefon, se kapiteni ishte specialist në zbulimin dhe në kapjen e komunistëve. Por, nga biseda e shkurtër, nuhati se këtij «specialisti» i qenkan kanosur plumbat, dhe, s'ishte çu-

di që ministri ta kishte nisur këndeј për të humbur gjurmët.

— Terror i kuq! — qeshi majori me qesëndi. Kapiteni, si i mërзitur, pohoi me kokë.

— Po juve, si u venë punët këtej?

— Në fillim u kënaqa, po kohët e fundit njerëzit janë bërë të egër, të egër e të paduruar.

— Kështu e kanë natyrën këta, sinjor. Edhe ministri, sipas një bisede që bëra me të, nuk është i kënaqur... Por ne do t'i zbusim. Ndryshe...

Ra telefoni. Macanti, komandanti i postës së karabinierisë së Zerqanit, njoftonte se në të gjitha fshatrat rreth nënprefekturës, ishin gjetur fletë që propagandonin luftën kundër fashizmit...

— Porka mizerja! — shau majori nëpër dhembë dhe përplasi receptorin mbi aparatın telefonik. — Ja pra, edhe këtu «klimë» jo e shëndetshme, kapiten! Nuk ka ditë që informatorët tanë mos na sjellin njoftime për veprimet e komunistëve! Prit kur të lajmërojnë edhe postat e tjera tani. — dhe e hodhi stilografin «Pelikan» mbi tavolinë. — Haxhi Lleshi, Nazmi Rushiti... Të tjerët janë këmbët e tyre...

Stavri Jahos iu kthjellua në kujtesë «dibrani» në burgun zogist të Tiranës, që e ndanë nga Qemal Stafa.

— Pritja është vdekje! — sikur u zgjua nga një ëndërr kapiteni. Në gojë i ngriu edhe një mendim tjetër i pashprehur, se në derë u dha Drizë Grama. I zgjati një letër majorit, i cili e lexoi me një frymë.

— Nuk vlejнë asnjë sold këto! Ka kaluar këtë lumë, ka zbritur këtë mal! Edhe ministri na tërho-

qi vëmendjen se nuk po tregojmë aftësitë tona për zhdukjen e një komunisti!

Driza uli kokën dhe doli.

— Nuk duhet kursyer gjë për kapjen e këtij komunisti me influencë, — vërejti kapiteni dhe i zgjati majorit një zarf të vulosur me dyllë.

Major Verdi e hapi dhe lexoi:

«Të veprojnë në Zerqan, ku, sipas informatave tuaja, në këtë krahinë malore, veprojnë më shumë komunistët...»

*
* *

Të nesërmen, të gjithë ushtarakët dhe nëpunësit e pritën me nderime dhe përulje fashistin Stavri Jaho. Vetëm sekretari i nënprefekturës i ndenji ftohtë.

Zerqani, me ujin e ftohtë, me aromën e këndshme të pemëve, e joshën kapitenin. Por në këtë qytet të vogël, diçka e dyshimtë dhe e frikshme i dukej se lëvizte në lagjet e periferisë, madje edhe në kërthizë të tij. Malet e Temlës dhe të Ftohosinës sikur i afroreshin dhe i përfaleshin qytetit çdo mëngjez, ndërsa kodrat përreth dhe Zabeli i Madh me drunj shekullorë, ruanin njerëzit që thanin barotin dhe pastronin armët.

Kapiteni ishte qejfli pas pokerit. Qysh ditën e parë, e quajti qytetin një «Monte Karlo» të vogël...

Për herë të parë Shaqir Grykamadhasi u fut në qelinë e ngushtë e të errët të kazermës.

— I shikon këto duar? — i tha kapiteni kur iu sos durimi për të mposhtur Grykamadhasin.

— ???!!...

— A i shikon këto duar?! — u çorr kësaj here kapiteni.

— Kullojnë, kullojnë gjak, zoti kapiten! — tha qetë-qetë Shaqiri, sikur të ishte duke thënë «kullojnë vaj».

— Do të vazhdojnë të kullojnë, more vesh? — iu afrua edhe më kapiteni.

Përsëri u hap dera dhe karabinierët sollën edhe tre malësorë. Stavri Jahoja i vështroi si ujë i uritur tre të porsaardhurit.

— Ju i dini gjurmët e Haxhi Lleshit, Nazmi Rushitit... kuptuat?

— Në do ta marrësh vesh, mor kapiten, këta fukarenjtë që ke lidhur, as emrat nuk ia kanë dëgjuar komunistëve. Unë po, jam takuar me ta! — foli pa leje usta Huta, ashtu babaxhançe, pa e prishur gjakun.

Kapiteni kërcëlloi dhëmbët. Tre malësorët u habitën dhe e dënuan në heshtje qëndrimin e Hutës.

«Tani rashë në gjahun që kërkoja!» — mendoi kapiteni dhe iu kthye ustait:

— Ti, usta Huta, je patriot... Ne kemi konsideratë. Më fal, mos të ndërpreva, ku u takuat?

— Bleva në Zerqan një dorë kripë. U nisa për në fshat. Dita po mbyllej. Në qafë të zabelit, pesë

vetë më dolën ballë për ballë. Që të mos e zgjas, më pyetën nëse e njihja njëfarë kapiten Stavri...

Kapiteni qëndronte në këmbë, gjysmë i përkulur. Kur i tregoi usta Huta këtë të fundit, iu kërcënua me revolver përpara fytyrës:

— Gënjën!

— Më butë, bre kapiten. Merre shtruar. A friket burri mes gjithë kësaj ushtrie prej katër a pesë komunistësh?

Stavri u lëshua si thes në karrige.

A r r e s t i m e

Komunistët e caktuan të shtunën ditë aksioni. Shokët e njësitit hynë në Dibër natën dhe zunë të gjitha rrugët në dalje dhe në periferi të qytetit. Lis Korabi me Gutin zunë rrugën që pret shkurt për Kojnarë e del përmes Drinit në Gjoricë. Ata së bashku me shokët e tjerë, kur u kthyen pasdite pazarllinjte nga qyteti, u dhanë traktin me vete. Të nesërmen dy shokët e vazhduan aksionin. Ata me njëzet e gjashtë punëtorët e mirëmbajtjes së rrugës së Çerenecit, lexuan dhe komentuan traktin e Partisë. Por ç'u ndodhi?

Nga zyra e agjentit të kuesturës së Dibrës së Madhe, tetar Pandi me dy karabinierë italianë të armatosur, sollën të arrestuar Gutin. Pak para tij ishte arrestuar edhe anëtari i grupit, Agron Shpata. Guti e pa Agronin që nga dera e zyrës, kur doli i lidhur.

«Na paskan diktuar të gjithëve», — mendoi Guti. Vështruan në mënyrë burrërore njëri-tjetrin.

— Shtrëngoja hekurat sa t'i kërcasin koskat!
— dëgjoji zërin e regjentit.

Pranë regjentit Mato, me sy si të hardhucës, me kokën që i bënte hije mbi gjoks, thithte duhan Musa Dema. Atëhere Guti e kuptoi rrjedhën e ngjarjes.

'Ai ishte nisur që me natë nga Homeshi për në Dibër për t'u prerë rrugën «kopukëve». Në fillim Musai takoi mareshallin e karabinierisë e ky i fundit, si e miratoi në gjuhën e vet, i tregoi zyrën e regjentit Mato. Pa e dëgjuar deri në fund informatorin e zellshëm, thirri tetar Pandin, i cili mori të dhënat karakteristike të «bolshevikëve» që kishin folur kundër rendit, në mes të punëtorëve.

Në gjithë rrugët e lagjeve të qytetit u shpërndanë patrulla karabinierësh. Tetar Pandi me dy karabinierë italianë ruajtën rrugën e Dacit të qytetit. Në këtë rrugë, në pikë të drekës, Lisi me Gutin ecnin përkrah njëri-tjetrit të shkujdesur e të çliruar nga çdo dyshim. Ata bisedonin për kryerjen e aksionit, për shpërndarjen e traktit të dytë të Partisë, në të gjitha zonat e Dibrës, sipas planit të Nazmiut. Guti u bind kur tetar Pandi dhe dy karabinierët thirrën: «Ndal!» Ndërsa Lis Korabi humbi me marifet pa bërë as përshtypjen më të vogël. Guti, nuk mund të lëvizte, ndryshe plumbi do ta ndalonte. Kurse Agronin e arrestuan në pazar.

Në zyrën e kuesturës, mareshalli i mori leje regjentit dhe e pyeti:

— E njihni këtë?

Musai mblodhi supet. «U tregua i ndershëm!»
— mendoi Guti. Por Guti kishte veshur rrobe të tjera. Agai nuk po i binte hilesë. Sidoqoftë, dy-

shimi mbeti dyshim dhe Guti vuajti një muaj në burg, ndërsa Agronin e nisën të vuante në burgjet e Tiranës dhe të Elbasanit.

D y s h i m i

Në pazarin e Homeshit, xha Xhema i kishte dëgjuar açik dy grykëmëdhenjtë, aty ku derdhte ujët mulliri, në krye të pazarit.

— Këto dy sy m'i panë flakët e pushkëve të karabinierëve, që rrëzuan dy komita mbi Zerqan.

— Mbetën vdekur? — pyeti tjetri me dhembshuri.

— Po, bre! Pastaj i vendosën mbi një mushkë dhe i nisën për nga kazermat, — dhe nxori edhe një herë kutinë që të dridhte një cigare.

— E gjeçin prej allahut, e gjeçin!

— Por një gjë më ka lënë pa mend, ajo plaka e Rahmiut... Kishte qenë burrëreshë, bija e shqiponjës. Sa e dëgjoi, me vrap, pa shami në kokë, shkoi mes karabinierëve. U zbuloi fytyrat dy të vrarëve dhe iu lëshoi flokët. Ai mareshalli i trashë italian e zuri nga krahët dhe e largoi.

— Derra të zinj, vrasës! — i shau ajo, ndërsa lotët i shkonin si krua poshtë faqeve.

— Thonë se njërin e njihte. Për një komunist dibran është hapur fjala.

— Mos, bre!

Dy grykamëdhenjtë u ngritën dhe hodhën trajsat me misër mbi kurriz. Ecnin të lodhur e të topitur, si të kishin një kuintal peshë.

Xhemës i ra shkopi nga dora. Këmbët iu mpi-

në dhe sytë mbetën te dy grykamëdhenjtë që po largoheshin.

«Heu, bre, vëllezër! Morët një torbë misër dhe më lëshuat gjithë këtë gjëmë në shpirt! A është e vërtetë, bre burra!» — fliste me vete Xhema i brengosur, por nuk i besohej. Ai e mbylli në zemër këtë gjëmë dhe askujt nuk ia çeli për të ndarë hidhërimin. Kur Toli i kërkoi me këmbëngulje që t'i tregonte se përse e kishte çehrenë e vrrarë, i tha vetëm kaq:

— Nazmiu..., bir...

Toli, sakaq, fluturoi për në Dibër të Madhe. Ishte natë.

— Sa më trembe gjakun, bre Tol! Po janë shëndohë si molla të gjithë, mor vëlla. Ai dje ishte këtu dhe mori një palë ndërresa të lara, — mundohej Netja t'ia hiqte atë avull brengje, që e kishte hedhur si vetëtimë në qytetin plot rreziqe.

— Ia di drejtimin?

— Nuk më tha gjë. Po la fjalë se do të kthehet shpejt.

Tolit ende nuk i hiqej brenga. Diçka kishte këtu.

*

* * *

Një heshtje e shqetësuar dhe e zemëruar mbërtheu qytetin e Dibrës. Çapet e rënda të patrullave armike përgjonin frymëmarrjen e tij. Qarkullimi ishte ndaluar.

Netja doli në dritare duke gjuajtur në errësirë ardhjen e Nazmiut. Zëri i ushtarëve të patrullimit

vinte deri te ajo, duke u përzier me zhurmën e këpucëve alpine që lëshonin ato mbi kalldrëm.

Një hije vrapoi shpejt dhe u zhduk në errësirë. Patrulla që kaloi aty pranë bëri gati armët për zjarr. Netja përgjonte me ankth. Përsëri qetësi. Një patrullë tjetër erdhi pas saj, me një hap të përmortshëm. Një derë u rrah me të fortë. Ca zëra të thellë, si të dalë nga pusi, arrinin deri te Netja.

— Alt, alt!

Ca pushkë u përzenë me britmën e frikshme:
— Alarm!

Nazmiu me dy shokë shqiptarë dhe Mitkon, nuk mundën të kalonin në Varosh, te baza 41, afër kishës; patrulla i priti me zjarr. Edhe ata provuan beretat e tyre. Pushkë të tjera plasën në periferi të qytetit sikur të donin t'i nxirrnin patrullës frikën që i kishte kapur.

Ja tani, katër hije njëra pas tjetrës, me re- vole në duar, hynë në rrugicën e errët. Netja i njohu çapat e tyre të lehta. Ajo fluturimthi u gjend te dera. Aty gjeti Tolin, të cilin dhimbja e zemrës nuk e kishte lënë të flinte. Nazmiu dhe shokët e tjerë u futën brenda. Vinin nga afërsitë e Gostivarit. Toli sikur u çlirua. Mori frymë i qetë. Dyshimi iu qartësua. Komitetë e vrarë kishin qenë dy ushtarë shqiptarë që kishin dezertuar nga fronti italo-grek.

Rreziku

— «Visar Troku»! Bukur ta kanë sajuar këtë pseudonim. Mos të shket goja dhe e përmend në kuësturë padashur...

— Eh, mor Bardh vëllai, si ma mori zemrën ai komunisti që i thonin shokët «Ylli»! Tani më vjen turp t'i mbaj këto rroba të zeza...

— Ahuuu, edhe ti, «Visar»! Se mos je veshur se t'u dogj xhani për Italinë? Jo, bre vëlla, halli... Po dëgjo këtu. «Ylli» tha se edhe me këto rroba i duhet shërbyer atdheut. Rrobja nuk prish punë, vetëm zemrën ta kesh të pastër e të fortë. Pastaj duhet fshehtësi e madhe që mos të të pikasë syri tinzar i gjarpërit...

... Plot energji rinie, me ato ëndërra të thjesh-ta, «Visari» rroptohet me një copë tokë të vogël. Duhej mbajtur shtëpia me bukë. Po si? Toka e paktë që çahet nga thatësira, u linte barkun thatë shumë fshatarëve, të cilët merrnin rrugën e pazarit me nga një thes në krahë për të blerë misër. I gjen-dur përballë vështirësish në jetë, Visari gjeti rrugën më të lehtë: veshi rrobat e milicit.

— Kush t'i dha këto rrobe, bir? — e kishte pyetur e ëma, kur, pasi ishte bërë milic, kishte vaj-tur një natë në shtëpi.

— Italia, nënë, Duçja.

Udhës kishte menduar se ëma do ta priste me duar në qafë e do të kënaqej kur ta shikonte të birin veshur e mbathur si korb i zi. Por jo. E ëma e Visarit ishte dëshpëruar dhe i kishte humbur sytë në gjuhët e flakëve të zjarrit. Përsëri s'e kishte lënë zemra e plasur pa e gërmuar fjalën:

— Po Italia është hasëm, mor bir! A bëhet mik hasmi? Do të të marrë inat i gjithë fshati!

Visarit i qe kyçur goja. Gjithë atë natë kishte mbetur kokëvarur. Por Nazmiu e bëri Visarin par-tizan në mes armiqve...

Errësirë. Një hije me hap hajduti u fut në kues-turë. Visari iu ngjit pas. Heshtje. Dera e regjentit u përplas me forcë. Visari nga vrima e çelësit dalloi regjentin dhe Malën që po bisedonin në gjysmë-errësirë.

— Tani hynë në shtëpinë me numër 41...

— Edhe herë të tjera ke raportuar, por... duar-bosh.

— Në mes tonë mund të ketë ndonjë komunist. Ndryshe, s'ka si na shpëtojnë.

«Visari» e la truprojen. Me një frymë u gjet tek baza e Agollajve. Para saj u dha një patrullë italia-ne. Drodhi rrugën dhe doli në lagjen Inçar. Në lag-jen Varosh dy komunistët po bënë një mbledhje ilegale me rëndësi.

Me rrëmbim trokiti tek porta.

— Kush është? — u dëgjua zëri i trembur i Hibe Palikuqit, e cila lante me të ëmën, Nijen, ca rroba të grupit ilegal.

— Unë «Visari»... moj cucë, ku e ke Nijen.

Hibja mbeti pa lëvizur.

— Hej bela, po unë jam, «Visari», milici...

Hibja u kujtua.

Visari vetëm një herë kishte hyrë në atë shtëpi, kur i kishte dhënë Nijes një peshqir të mbështjellë. Nija e kishte futur në raft e kishte dalë të psoniste në pazar.

Hibja kureshtare e kishte hapur pakon dhe ishte trembur kur kishte parë dy revolverë e ca fishekë. Kishte bërë mbrapsht. Ndërsa tani ajo ishte mësuar

me revolvera e pushkë. Ajo i pastronte, madje kish-
te qejf ta mbante me vete një beretë.

— Ç'ka ndodhur vëlla, «Visar»? — doli Hibja
në derë. — Futu brenda...

— Ku e ke vëllanë?

— Në Varosh.

U dëgjuan rrap-rrupet e këpucëve tërë thumba
të një patrulle italiane. Hibja e tërhoqi «Visarin»
dhe e mbylli derën pa zhurmë. Patrulla u largua.

— Dëgjoni, vajzë. «Ylli» me shokë janë në
rrezik. Vrapo në Varosh. Unë nuk mund të bëj as
edhe një hap më tutje. Jam roje në kuesturë.

«Visari» u zhduk në errësirë. Hibja hyri bren-
da, mori beretën dhe fluturoi drejt Varoshit. Ajo
kishte frikë të kalonte në ato rrugica të ngushta di-
tën e jo më natën. Por sonte as që i mendonte hijet
e natës, ajo kishte shoqe beretën. Afër bazës iu
duk sikur dëgjoi zëra...

«Paskan arritur karabinierët», — mendoi e
zemra i rrahu fort. Djersë të ftohta i mbuluan ba-
llin. Iu afrua derës. Përsëri u dëgjuan zëra. Por tani
jo brenda në shtëpi, por nga mesi i qytetit.

«Tani po vijnë!» — pëshpëriti Hibja dhe u fut
brenda. Ajo e dinte të fshehtë të hapjes së derës.
Deshi të thërriste qysh në oborr po zëri i njohur
i «Yllit» që vinte i qetë dhe i ëmbël, e mundi fri-
kën dhe e harroi për një çast misionin.

Hapat e karabinierëve u dëgjuan edhe më afër.
Hibja hapi derën. Fjala u pre. Të gjithë i trembi
ardhja e saj në atë orë.

Dhoma ndriçohet nga një qiri, nën dritën e të
cilit, Hibja dalloi fytyra të reja që s'i njihje. «Yllin»
e gjeti në këmbë, me fjalë në gojë. Ajo foli shpejt:
Nisuni, po afrohen armiqtë!

— Shokë, — thirri Nazmiu. — Të gjitha materialet propagandistike: armë, fishekë, në bazën te lagjia Daci!

Ata u armatosën dhe dolën një nga një pa u ndjerë.

— Nënë Aishe, po ti? — dhe Nazmiu e kapi për duarsh.

— Jo, bijtë e nënës, këtë shtëpi të Partisë nuk do ta lë vetëm!

Këto fjalë të thjeshta e të singerta e prekën Nazmiun. Këpucët e armiqve ndiheshin afër.

— Bir, ç'pret?

Nazmiu ia shtrëngoi fort duart nënë Aishesë.

Ai ndjeu në duart e tij si dy-tri pika ujë. Ishin pikat e lotit të nënës së ilegalëve.

*
* *
*

Kjo është shtëpia, — dhe toger Mala dredhoi tek qoshja e murit. Dera u rropat. Karabinierët e milicët e thyen derën me qytat e pushkëve. Kontrolluan çdo skutë me elektrikë nëpër duar. Regjenti Mato, me revolverin në njëren dorë, me elektrikun në tjetrën, hapi derën e dhomës së fundit. Pas e ndoqën edhe karabinierë e milicë të tjerë. Në oxhak, flaka e mekur e qiriut u drodh. Rrezet elektrike, si shirita të bardhë, u kryqëzuan mureve, tavanit, dyshemesë. Vetëm heshtje. Në derë, një grumbull kapelash të zeza dhe ngjyrë kaki të murme. Një dridhje frike ndillte kjo shtëpi për armiqtë. Shiriti i bardhë verbues i elektrikut të regjentit u

fiksua mbi tavolinë, ku nxirrnin tym kokë më kokë tri cigare të mbështetura në tavllat e duhanit.

«Gjurmë e freskët», — pëshpëriti regjenti.

Shiriti tjetër mbeti duke u luhatur në qoshe të murit mbi nënë Aishenë, e cila qëndronte atje e mbështetur me një qëndrim burrëror e urrejtës. Pranë këmbëve të saj, dy vajzat e vogla, vështronin si të trishtuara.

Regjenti Mato si fantazmë u afrua tek tavolina, mbi të cilën cigaret vazhdonin ende të nxirrnin tym. Për atë u bë e qartë çdo gjë.

«Përsëri dështim, toger idiot! — foli me vete dhe shikoi egër nënë Aishenë.

Heshtja në këto çaste ka gjuhën e vet. Toger Mala zgjati kokën dhe prapë iu humb vështrimit të Aishesë.

— Kontrollojeni! — thirri regjenti.

Milicët e karabinierët lëvizën, por nuk patën guxim t'i afroreshin Aishesë.

«Po sikur të më kontrollojnë? — mendonte Aishesja. — Atëhere vetëm një rrugë ka: do t'ia ndez gënjën kobures mbi këta lugetër!»

— Zbatoni urdhërin, kafshë! — u çorr regjenti dhe ajo faqja e djegur i lëvizi tri herë nga një nerv i keq.

Nga balli i karabinierëve e milicëve vetëm tatar Pandi u shkëput drejt Aishesë.

— Mos u afro! — thirri ajo. — Turpi i dheut! Sa shpejt u paska bërë për vete fashizmi.

Dy vajzat filluan të qanin. Ato iu ngjeshën së ëmës edhe më fort pas trupit. Aishesja i përkëdhelte të voglat. Regjenti u step. Tetari nuk guxoi.

— Do të të përvëlojmë me plaçka e fëmijë, kupton? Do t'ju varim! — u çorr duke bërtitur regjenti Mato.

— Uh, jalla! — qeshi me ironi Aisheja. — Mos e mundo veten, mor italian, zjarri e litari nuk na trembin. Po ti...

— Pusho! — dhe regjenti i drejtoi revolverin. Vajzat qanin me të madhe.

— Tërhiqe, or trim, sa hije të paska! — e për-qeshi Aisheja.

Një zhurmë u ndie nga oborri. Pastaj këtë e mbuluan disa krisma revolverësh. Mato Murati, bashkë me skuadrën që ishte brenda, vrapoi jashtë. Aisheja doli në oborr. Pa në errësirë derën e copë-tuar. Ca krisma revolverësh vinin të largëta e shu-heshin në gjirin e natës.

Ajo u fut brenda. Në shtëpi ra qetësia. Qiriu vazhdonte të digjej.

* * *

Drita zbardhi kur Destan Kilja, me një thes në krah, shkarkoi te baza në Inçar të qytetit të Dibrës.

— Përse na i përzutë çunat nga qyteti?

— Se na bezdisën! — u tall Nije Palikuqi.

Destani qeshi. Drinës e Hibes u doli gjumi dhe hynë në dhomë.

Destani nuk i dha përgjegje. Në vend të saj, ai këndoi, duke tundur gishtin, dy vargje të një kënge të re partizane që kishte mësuar.

Nija u shkri gazit nga entuziazmi i Destanit. Kështu nuk e kishte parë ndonjëherë atë.

Destani i shtriu dorën Drinës e i dha një copë letër. Ajo lexoi:

«Shoqja Drina,

Shqiponjat janë në fole shëndoshë e mirë. Tani folenë e kemi në mal. Edhe në qytet shpejt do të kthehemi. Vazhdoni punën të vendosura. Fitorja na pret. Përsëherë gjithë të rinjtë e të rejtat, në veçanti nënë Aishenë dhe Netën. Vdekje fashizmit!

«Ylli» dhe shokët».

— Nënë Aisheja është në merak. Duhet lajmëruar, — tha Drina.

— Do të shkoj unë, — u ngrit Hibja. Mori letërën dhe, duke çarë mes patrullave, doli në Varosh...

DIBËR-ZOGAJ, 20 QERSHOR 1942

Ajo luginë e vogël e gjelbëruar nga pemët dhe jeshili i livadheve, e futur si një gojë e stërmadhe maleve të Bllacës e që pritet nga një përrua i rrëmbyeshëm i kristaltë, mban mbi brinjët e veta fshatin Zogaj të Dibrës, që fshihet pas kodrave të shumta të veshura me dushk. Këtu komunistët kishin vendosur të formonin celulën e partisë dhe çetën partizane, sipas direktivave të Komitetit Qendror Provizor të Partisë. Zbrisnin partizanët maleve, në atë agim të freskët qershori. Që me natë marshonin drejt Zogajt, me pushkë të markave të ndrvshme, armë që gjyshërit e tyre u kishin zënë armiqve, që patën shkelur vendin tonë.

Haxhi Lleshi, me njësitin e tij partizan, arriti në Zogaj më heret. Vendosi roje rreth e rrotull zabeleve dhe bashkë me luftëtarët u ul që të pushonte në lëndinë.

— Pushoni, — u tha shokëve, — e merrni një sy gjumë.

Por, partizanët, megjithëse kishin ecur orë të tëra, se atë natë ishin nisur nga Selishta, filluan të pastronin armët. Disa të tjerë filluan të bisedonin përmallshëm të shtrirë mbi jeshilin e butë. Ndërsa

nja pesë partizanë po lexonin një komunikatë të Partisë.

— Të lumtë ajo gojë! — i thanë atij që lexonte, dy partizanë analfabetë. — Ne të shkretët, pushkë kemi, por kalem s'kemi!

— Mos u mërzisni. Siç ju tha shoku Haxhi e shoku Nazmi, atë natë te zalli i Strikçanit, te Gjo-kajt, «Partia ju dha pushkët, Partia do t'ju mësojë edhe shkrim e këndim!»

— Ndal! — ushtoi një zë i fortë nga maja e kodrës.

Pas pak bëri ballë Nazmiu me shokët, duke u futur arave e verrinjve. Ja edhe i deleguari i Partisë, «Baca», bashkë me Çlirim Shtinën dhe tre të tjerë tek u shkëputën nga maja e kodrës e mbërrinë në lëndinë. Sheshi i vogël u mbush plot me partizanë. Haxhi Lleshi po bisedonte shtruar, me atë natyrën e tij të qetë, të butë e të mençur, këmbëkryq, me ca malësorë të atyre anëve.

— Vdekje fashizmit! — tingëlloi zëri i fortë i Nazmiut.

— Liri popullit! — buçiti zëri i partizanëve dhe të gjithë u ngritën në këmbë, me armë në duar. Haxhiu u përçafua me «Bacën», Nazmiun dhe Çlirimin. Të gjithë i pushtoi një ndjenjë gazi e hareje.

*

*

*

Nazmiu, si bisedoi me «Bacën», u bëri me shenjë komunistëve të shpërndarë mes luftëtarëve e fshatarëve, dhe ata, pa u ndjerë e pa rënë në sy, u ngjitën kodrës mbi lëndinë e u futën një nga një

në mes zabelit të dendur të dushkut. Thirrjet dhe këngët e partizanëve arrinin deri aty.

— Vetëm kaç komunistë? — pyeti i deleguari, kur pa të ulur tre komunistë, dhe vështroi edhe një herë nga shtegu se mos kishte të tjerë që po vinin.

— Na mungojnë shokët e Slllovës, — foli Çlirim Shtina.

— Edhe Irfani ishte kthyer tri orë pas «Kaçatorit». Këtë nuk e dinin, prandaj u shkoi mendja edhe për keq.

Pas mesnate, Irfani ishte kthyer prej Radostushi. Sapo kishte vënë këmbët në prakun e derës, nënë Aisheja i kishte thënë: «Bir, nesër me të lindur të diellit, shokët të presin në Zogaj. Atje do të bëjnë një kuvend të madh». Dhe ai, pa futur gjumë në sy, kapërceu Drinin, dhe ashtu, komitçe, po u afrohej zabeleve të Zogajt. Por roja partizane, një roje që vigjëlonte majë kodrës së gjelbëruar, e mori për njeri me qëllime të këqia, tek e pa që ecte i kërrusur, me pushkë në dorë, duke kapërcyer dushqet e shkurtëra si kaproll. Bëri gati pushkën, e futi në shinjestër dhe i thirri me zë të fortë: «Mos luaj!»

— Ore grykamadhas, edhe njerëzit e vet i shpon kjo «turçelia» jote! — qeshi Irfani me rojen, kur njohën njëri-tjetrin.

— Eh, more shehërli, kjo e shkretë shpon edhe atë që e ka kurdisur. Hekur është, tru nuk ka. Por, kur e ka partizani në duar, di t'ia djegë barotin turçelisë së shkretë!

Irfani e qëlloi krahëve me dashuri. Partizani i fshiu me pëllëmbë ballin e djersitur nga rruga e gjatë dhe e vështirë. Pastaj e drejtoi për te vendi ku ishin mbledhur komunistët.

— Vdekje fashizmit, shokë!

— Liri popullit! — ia kthyen të pestë njëzëri dhe e përçafuan përmallshëm.

— Kujtuam se mos «të pickoi ndonjë grenxë», — qeshën me të shokët, ndërsa Irfani u ul mbi trungun e një lisi të prerë, pranë Nazmiut.

— Ora erdhi. Fillojmë, shokë? — foli Çlirim Shtina, duke kërkuar aprovimin e shokëve.

— Fillojmë! — thanë të tjerët. Kur ja, sapo filloi të fliste i deleguari, shkurret lëvizën dhe u duk roja tek po i printe një komunisti tjetër.

— Në betejë edhe minuta përcakton fitoren, — tha Nazmiu.

Komunisti i sapoardhur nuk foli. Ai, si i zënë në faj, nuk u ul, por u mbështet pas trungut të një peme.

— T'i lëmë këto, shokë. Fillojmë.

Nazmiu shkruajti me një laps të cunguar në bllokun e tij: Dibër-Zogaj, 20 qershor 1942.

Çlirimi foli shkurt mbi situatën e brendshme dhe të jashtme, duke u zgjatur më shumë për çështjen e nevojës së ngutshme historike dhe rolin e madh që kishte organizimi i celulës komuniste në Dibër. Pastaj, i deleguari i Komitetit Qendror kërkoi që të gjithë komunistët të raportnin për aktivitetin e tyre. Ata raportuan. I deleguari, i kënaqur, veçanërisht nga puna e komunistëve, i përgëzoi e vazhdoi të fliste për detyrat që u delnin. Nazmiut dhe shokëve të tjerë u dukej se merrnin fuqi të reja

nga fjalët që dëgjonin. Një dritë më e fortë depër-
tonte në zemrën e tij.

Poshtë në lëndinë, ku rrinin partizanët, u
shkrehën ca pushkë. Luftëtarët provonin armët du-
ke bërë qitje. Celula e partisë vazhdonte punën.

— Kush ka tjetër për të diskutuar? — foli i
deleguari, ndërsa hetonte fytyrën gazmore të Naz-
miut që diçka shënonte në një bllok.

— Me leje? — ngriti dorën Nazmiu. — Ne do
t'i kapërcejmë të gjitha pengesat që do të na kri-
jojnë armiqtë, se tani do të udhëheqë celula e par-
tisë, se me ne është populli. Por tani celulën tonë
e pret një punë më e madhe, më e vështirë dhe
më e guximshme, — vijoi ai me një ton më të
vendosur. — Radhët tona po shtohen. Fashizmi po
e ndjen, se edhe këtu, partia po pregatit një grusht
të çeliktë.

Përsëri krisma pushkësh në krahun tjetër të
kodrës, dhe një thirrje e fortë «Ndal!» arriti deri
te ata. Patrulla partizane kishte ndaluar një ndër-
lidhës që Visar Troku kishte nisur nga qyteti i
Dibrës për të lajmëruar partizanët se «drejt Zogajt
po marshonin forca ushtarake dhe të milicisë.»

— Po, shokë, — vazhdoi Nazmiu, — pas agji-
tacionit e propagandës duhet aksioni. Formimin e
celulës së partisë dhe të çetës mendoj ta inauguroj-
më me aksion, duke derdhur plumba mbi fashistët!
Armikut t'i tregojmë trimërinë partizane dhe par-
tisë — gatishmërinë tonë për aksione.

— Dakord! — u gjegjën njëzëri komunistët.

Njëri shok i mbështetur mbi pushkë, që nuk i
kishte prerë mustaqet qysh kur kishte ardhur nga
Peza me Haxhi Lleshin, gjatë mbledhjes nuk foli
asnjë fjalë. Ai vetëm se fërkonte grykën e pushkës

me pëllëmbë, shenjë se i pëlqenin diskutimet e shokëve.

— Armë, na duhen armë, — ndërhyri ai.

Çlirimi tundi kokën dhe, si pa se partizani s'kishte ndër mend të fliste më tej, foli:

— Është e vërtetë, armë kemi pak, por ato do t'ua rrëmbejmë vetë fashistëve.

Diskutimet mbaruan. Celula u caktoi të gjithëve detyra të veçanta.

Pastaj u kalua në çështjen e fundit të rendit të ditës. Zgjidhën sekretarin e celulës së partisë dhe njëzëri komandantin e çetës, shokun Haxhi Lleshi.

Dielli kishte hipur në zenit, kur sekretari i celulës u zotua në emër të komunistëve të Dibrës se do t'i kryenin me nder detyrat e partisë. Kështu u organizua celula e komunistëve të Dibrës, pranë arave me misër, aty ku rrjedh uji i kristaltë i maleve, mes fëshfëritjes freskuese të pyllit. Ajo vepronte disa muaj më parë, por atë ditë, anëtarët e saj bënë betimin e madh:

«Për ideal të komunizmit, për popullin e varfër!»

Procesverbal nuk mbajtën. Letra e penda nuk kishin. Kishin vetëm malin, pushkët dhe zemrat barot.

*

*

*

Ashtu thjesht, pa ceremoni të madhe u shpall formimi i çetës, me komandant Haxhi Lleshin. U betuan të gjithë, duke nderuar me grusht. Në fillim komandanti e komisari, pastaj të gjithë luftëtarët.

Posa mbaroi betimi, partizanët, të entuziazmuar, u përçafuan, ngritën pushkët lart. Në mes të «urrave» të shumta, gjëmuan në atë luginë të heshtur dhjetëra krisma armësh dhe, sikur t'iu mbanin ison, buçitën edhe dhjetëra këngë partizane. Edhe grykamadhasi ia nxori flakën prej gryke «turçelisë» së tij të gjatë. Ca të rinj entuziaztë, me qeleshe të bardha mbi kokë, këndonin këngën e bukur që u kishte mësuar Nazmiu para pak ditësh në Zogaj. U dëgjuan në të katër anët këngët dhe krismat, dhe nëntë malet filluan të pastronin armët, nëntë malet filluan të thanin barotin:

*«Kokë-daulle Musolini,
Kërkon mish e kërkon lesh...»*

Partizanët këndonin. Kështu e kishin ata. Edhe këndonin, edhe luftonin. Shekujt e hershëm zbritën në këto çaste në mendimet e Nazmiut, në oshëtimën e luftërave e përpjekjeve për liri të dibranëve.

Buçiti kënga: «Bashkoi shok me ne në çetë...», e cila tingëlloi si epilogu i asaj dite të shënuar. Të gjithë këndonin. Edhe ata që nuk i kishin mësuar ende mirë fjalët e këngës, i ndiqnin pas shokët e tyre. Ata herë pas here hidhnin sytë e shikonin me dashuri Haxhi Lleshin, që ishte ulur pranë Nazmi Rushitit e flisnin ngadalë. «Nuk gjenden askund këta malësorët shqiptarë! Me grusht e hanë barutin!» — i fliste Nazmiu komandantit të çetës, Haxhiut. Ndërsa ky i fundit pohonte me buzën në gaz.

Ca yje të rrallë u ndezën në hapësirë. Çeta e

sapoformuar partizane nisi marshimin drejt maleve. Komandanti dhe Nazmiu herë ecnin njëri pas tjetrit e ndërronin në ndonjë fjalë dhe herë ecnin krah për krah të tjerëve. Ata u bënë e mbetën përjetë një shpirt, një gjuhë, një pushkë. Malet ndjenin mbi shpatullat e tyre më shumë këngë, më shumë pushkë.

Shoku Enver Hoxha shkruante që atëhere për këtë çetë partizane dhe për komandantin e saj:

«Bjeshkët e Shqipërisë së Veriut po buçasin; shkëmb mbi shkëmb, luginë mbi luginë, fshat më fshat, zëri i kushtrimit po buçet dhe flamuri i lirisë po valvitet me krenari, se atë e mbajnë lart të përkulur Haxhi Lleshi me shokët e tij trima...»

P r i t a

— Këtu është vendi më i përshtatshëm, shokë, për t'i «përshtëndetur» fashistët, — i foli komandanti i çetës së vogël. — Zini pozicione pas shkëmbinjve dhe maskohuni. Tani është ora dymbëdhjetë. Ata duhet të duken.

Vetë zuri një vend në ballë të çetës, rregulloi mitralozin dhe e bëri gati për zjarr. Në këto kreshta e lugina, në këto rrugë të vështira, kishin zhvilluar beteja me armiqtë edhe gjyshërit trima, edhe Skënderbeu kundër taborreve të sulltanëve grabitqarë. Prandaj këtyre shkëmbinjve u kishte mbetur edhe emri: «Gurët e Skënderbeut». Komandanti i çetës e kishte zgjedhur me zgjuarësi këtë vend strategjik, aty ku bën hark rruga automobilistike në la-

gjen Allmetaj të Bulqizës, pak pa hyrë në minierën e sotme.

Ishin ditët e fundit të qershorit të vitit 1942. Vetëm pak ditë kishte që ishte formuar çeta. Në «Qafën e Buallit» nxiu një makinë, e cila rrëshqiti drejt luginës së Bulqizës. Ajo po afrohej me shpejtësi, duke gulçuar dhe duke lënë mbrapa një re pluhuri të përhimtë.

— Shoku komandant, ky është kamioni i postës ushtarake! Ja, shikojeni si reflektojnë helmetat e hekurta të italianëve, — i foli Nazmiu mengadalë.

— Edhe dy të tjera!

Një veturë katran e zezë po afrohej drejt pritës.

— A t'i qërojmë?

Nazmiu po dëgjonte dy partizanët. Vetura po afrohej. Dyshimi rritej. «Mos është ndonjë oficer madhor?» — mendoi.

Prita partizane mori vesh se në atë veturë, kishte qenë edhe Stavri Jahoja, i cili po kthehej nga Tirana me porosi të reja kundër lëvizjes partizane.

— Shoku komandant, «t'i ndezim» armët?

— Prisni sinjalin, tregohuni gjakftohtë.

Mbi çdo shkrep të rrëzuar në fund të malit, dukej gryka e ftohtë e një pushke.

— Shoku komandant, ato janë shumë, — foli një partizan i ri.

Nazmiut, për një çast, i erdhi ndër mend ajo këshilla e një bulqizaku, një natë më parë: «Lëre italianin të afrohet sa t'i shohësh fytyrën mirë, dhe atëhere lëshoi batarenë e plumbave».

Makina e parë u afrua. U dha urdhëri për zjarr. Armët jehuan. Gryka e Bulqizës oshëtiu, duke përcjellë këtë oshëtimë armësh në të gjitha malet e Dibrës. Këto ishin krismat e para të lirisë, alarmi i parë i çetës.

*
* *
*

Azi, gjenerali i Divizionit italian në Dibër të Madhe, sapo kishte lexuar një informacion mbi shtimin e lëvizjes partizane. Ai qetë-qetë ishte shtrirë mbi kolltuk duke u habitur me alarmin e atyre të SIM-it për komunistët. Kur ja, në këtë çast hyri majori në dhomë dhe raportoi me një frymë:

— Sinjor gjeneral, më lejoni t'ju raportoj se çeta partizane e banditit Haxhi Lleshi, goditi me armë postën tonë, posa shkeli në Bulqizë.

— E pastaj? — foli gjenerali gjakftohtë.

— Disa ushtarë nga tanët janë vrarë dhe janë plagosur, — foli shpejt e shpejt majori me qëndrim gatitu.

Gjeneral Azi nuk foli. Mendoi porositë e qendrës dhe takimin me Fiqri beun. U ngrit me rrëmbim nga kolltuku, bëri dy-tri lëvizje nëpër zyrë dhe përsëri kërkoi të reja.

— Ja edhe fletushka jonë si është sakatuar nga plumbat e atyre banditëve, sinjor gjeneral!

Gjenerali vërejti me kujdes gazetën e «plagosur» dhe ngrysi më tej fytyrën.

— E keni lejuar të vihet në qarkullim nëpër qytet? — pyeti.

— Si çdo herë...

— Bah, ç'idiotë! Ç'prisni? Menjëherë të ndalohet! Si nuk e kuptoni se kështu ulet morali i ushtarëve tanë, ndërsa gëzohen qytetarët? Vallë nuk e keni menduar dhe vlerësuar këtë, major?

Majori doli kokëvarur. Gjeneral Azi kërkoi Tiranën urgjentisht në telefon. «Vend djalli!» — tha me vete.

Pas tri orësh, në vendin e ngjarjes, u dukën shumë milicë e karabinierë të motorizuar nga Dibra e Madhe dhe Burreli. Çeta i priti me syrin në shënjestër. Por ata nuk guxuan të futeshin në rrezen e qitjes partizane.

*

*

*

Drina u hodh përpjetë nga gëzimi dhe e kapi Zanën e vogël për mesin, e ngriti hopa në duar, kur Netja i tregoi për aksionin e çetës, dhe i lëshoi të këmbët gazetën fashiste.

— Gazetë e plagosur, fashistë të vrarë. Djemtë ia filluan mbarë. Hallall u qoftë! — dhe e puthi Drinën dhe dy motrat e saj që ato ditë kishin ardhur nga Shijaku në Dibër si aktiviste partie.

Drina i dha gazetën Zanës. Ajo si flutur vrapoi në Varosh të nënë Aisheja. Irfani në dhomën tjetër po shtypte një trakt me maqinë. Dy djem të rinj nga qyteti dhe Bardhi po e ndihmonin. Ai kishte ardhur dje nga çeta.

— Po kjo? — i foli nënë Aisheja Zanës, duke mos e kuptuar se çfarë ishte. — Mos ta dhanë fashistët? Folë, Zanë e nënës, ç'është kjo?

Zanës vetëm i qeshnin sytë. Ajo nuk dinte si t'ia shpjegonte, vetëm i tha:

— Është plagosur nga plumbat partizane...

Irfani i dëgjoi dhe u gjend menjëherë pranë tyre.

— Nënë, aksioni i çetës paska përfunduar me sukses!

Ajo e puthi të birin në ballë dhe e uroi:

— U shtofshin fitoret!

Aty për aty, Irfani shkroi këtë letër dhe ia dha Zanës:

«Shoqja Drina,

Çeta trime, nën udhëheqjen e celulës së Partisë, nisi rrugën e luftës me pushkë. Morali i fashistëve është plagosur. Kjo është sa e thjeshtë, aq edhe e rëndësishme... Njofto gjithë të rejtat. Unë sonte do të merrem me shtypjen e një trakti, kush-tuar këtij aksioni. Nesër duhet të nisem patjetër për në çetë. Ky është edhe udhëzimi i celulës.

Vdekje fashizmit!»

Aksioni i telave

Komandanti shpalosi edhe një herë udhëzimin e Komitetit Qendror dhe lexoi në heshtje: «Prisni telat, shtyllat telefonike e telegrafike në të gjithë qarkun tuaj, goditeni armikun aty ku e dëmtoni më shumë».

Më 21 korrik, «Erzeni» kishte mbërritur në çetë me mision të posaçëm partie. Në mënyrë operative u mblodh celula, ku «Erzeni» i njohu komunistët me aksionin e telave. «Më 24 korrik asnjë urdhër i fashizmit dhe asnjë vendim me vdekje për bijtë

e bijat e popullit të mos transmetohet nëpërmjet linjave telefonike». Me këtë zotim dolën nga konsulta e shkurtër të gjithë komunistët.

— Dënim me vdekje për imperatorinë e «pattyeshme!» — pëshpëriti komandanti, duke kujtuar vendimin e Partisë dhe, si lëshoi sytë nga çeta e mbledhur si një hark i kuq buzë zabelit të heshur, bëri drejt saj.

— Partia ka vendosur që të kryhet një aksion i menjëhershëm në të gjitha krahinat e vendit tonë, — iu drejtua ai partizanëve me zërin e urtë, po rrëmbyes. — Do të priten të gjitha linjat telefonike dhe telegrafike. Kjo do ta shtojë prestigjin e çetës ndër dibranët patriotë dhe ata patjetër do të na përkrahin. Por të mos harrojmë se armiku nuk fle. Spiunët janë derdhur në të katër anët. Pra, duhet konspiracion dhe shkathtësi në veprime!

Celula e Partisë e kishte studjuar me kujdes këtë aksion të rëndësishëm. Këtë e kuptonte shumë mirë edhe komandanti i çetës. Prandaj hartoi një plan të hollësishëm. Si ndau çetën në njësite dhe caktoi orën e veprimit, e mori fjalën përsëri:

— Po e përsëris. Ky nuk është një aksion lokal, por në shkallë kombëtare, që udhëhiqet drejtpërdrejt nga Komiteti Qendror. Tani dua edhe mendimin tuaj.

— Kështu do të bëhet! — u ngrit Nazmiu. — Fjala e Partisë është vepra jonë.

Të gjithë e aprovuan planin e komandantit. «Fjala e Partisë është edhe fjala jonë», — thanë të gjithë njëzëri.

Ndërkohë arritën disa simpatizantë të çetës, vullnetarë, dhe lanë mënjanë ca sharra, sopata dhe darë.

— Armët e aksionit, — foli i kënaqur Demiri.

Pastaj komandanti caktoi pikat strategjike, ku do të vepronin partizanët e çetës: «Erzeni» me një grup shokësh u nis për në zonën Dovalan-Maqellarë.

Nata e 24 korrikut erdhi. Rrëzë një shkurreje në Qafë të Qenokut, Nazmiu me një grup shokësh prisnin orën 24. Nata ishte e kthjellët, por e freskët. Një makinë lëshoi dritat e saj verbuese kodrave të Qenokut. Pastaj duke gulçuar u ngjiti në qafë dhe humbi tutje, nga përroi i Melanit.

Sinjali i fillimit të aksionit u dha. Sharrat, me lëvizjet e shpejta dhe përplasjet e shtyllave për tokë, e prishën qetësinë e asaj nate korriku. Duart e shkathëta, me darë e sopata, prenë telat që mbetën shtrirë nëpër kodrinat dhe luginat e Dibrës. Pas pak çdo gjë heshti. Ulërima e telave e kyçi gojën. Krerët e fashizmit nuk i dëgjonte më askush. Mesnata e 24 korrikut shuajti në gjirin e vet gjithë zhurmat e armiqve. Mes kësaj heshtjeje gërmdhash jehoi zëri i fuqishëm i Partisë, duke shpërndarë në male dhe qytete përshëndetjen partizane: «Vdekje fashizmit! — Liri popullit!»

Pas mesit të natës në radhët e fashistëve shpërtheu alarmi. Major Verdi u habit për «prishjen e receptorit të telefonit». Rendi tek telefoni tjetër që të lajmëronte për fatkeqësinë në Zerqan që kishte shkaktuar njësitë partizan.

— Alo, Dibra! — filloi të çirrej majori gjithë zemërim e frikë me receptorin te goja, por qyteti i Dibrës nuk përgjigjej.

— Zerqani, alo, Zerqani! — u çor edhe më majori.

Edhe Zerqani heshtte. Gjithë Dibra heshtte, gjithë atdheu heshtte. Kjo heshtje sikur grumbu-

llonte forca të habitshme që do të sulmonin e do të zhduknin këmishëzinjtë dhe njerëzit me medalionet e imperatorisë. Një dridhje i përshkoi trupin majorit dhe u lëshua mbi kolltukun pranë, duke sharë nëpër dhëmbë: «Po, kjo është punë e komunistëve... Nesër ndoshta do të na hyjnë edhe në zyrë... Ne do të na duhet të ngremë duart përpjetë përpara guximit të tyre. Nuk kishte faj kapiten Stavri, as edhe regjenti Mato... ata e njohin natyrën e këtyre njerëzve të egër». Sa të vetmuar e të pafuqishëm e ndjeu veten fashisti! Ai e shihte se ndodhej buzë një gremine, ku e priste zhdukja dhe heshtja e përjetshme.

Të nesërmen gjithë fashizmi brenda në Shqipëri e deri në selinë e tij, në Romë, ishte në gjendje alarmi. Si në gjithë vendin edhe në Peshkopi, Dibër të Madhe, Strugë, Zerqan e Gostivar, fashistët e shërbëtorët e tyre, të hipur mbi vetura, kamiona e motoçikleta, qarkullonin rrugë e pa rrugë me skuadrat e vdekjes, ndërsa nga ana tjetër njoftonin Romën se «...nuk i ndjejnë shpatullat të sigurta...»

Gjaku i parë i çetës

Korieri partizan, i nisur nga Tirana, e gjeti çetën në Luzni. Ai nxori me kujdes nga pala e kthyer e xhakëtës një copë letër dhe ia dorëzoi komandantit. Haxhiu e lexoi. Fytyra i ndriti. Ishte ftesa për në Konferencën e Pezës, që do të zhvillohej më 16 shtator 1942.

Para se të niseshin shokët për në Pezë, do të shkonin në malin e Kërçishtit, në lindje të Dibrës,

për t'u takuar me disa shokë partizanë. Por armiku nuk flinte, kishte marrë masa serioze. Kishte organizuar një numër të madh xhandarësh e karabinierësh, kishte shtuar posta ushtarake. Në shtigjet kryesore kishte vendosur roje e patrulla milicësh. Megjithatë, çeta lëvizte e lirë, sepse atë e ruante populli. Ura e Topojanit ishte pika më delikate dhe më e dyshimtë për armikun, nga mund të kalonte çeta. Prandaj në atë vend kishte vendosur edhe roje të shumta. Komandanti, në krye të çetës, së bashku me Nazmiun, lëvizi drejt urës. Ishte natë. 26 gusht 1942. Nga kodra e Mazhicës çeta kaloi Topojanin e ra mbi urë. Sapo vuri këmbët në hyrje të urës, pararoja u diktua nga patrulla armike dhe një batore pushkësh e mitralozësh gjëmoi drejt grykës së Drinit. Milicët dhe karabinierët që u futën në llogore në krahun tjetër të urës, nën shkëmb, gjithë plumbat dhe bombat i derdhën mbi partizanët dhe urën e hequr. Çlirim Shtina, në krye të pararojës, kaloi Drinin pa u dëmtuar. Ata hapën zjarr në ndihmë të krahut tjetër.

— Shtrihu barkas, Nazmi, dëgjon? Do të të kapë ndonjë plumb, — e këshillonte komandanti.

— Shoku Haxhi, pushkët e krahut të majtë pushuan. Po shoh si qëndron puna.

— Kujdes në zvarritje!

Nazmiu u largua mes vërshëllimës së plumbave. U afrua pranë shokëve. Demiri dhe Irfani lanë pozicionet dhe u afruan duke hedhur bombën te ura, në ndihmë të pararojës, që ta mbulonte atë me zjarr. Pranë tyre u afrua edhe Nazmiu.

— Thua kaloi pararoja pa u dëmtuar?

— Besoj se janë mirë të gjithë, — u përgjegi

ulët Irfani. Shokët e kaluan urën. Ndërkohë, tri bomba gjermane e bënë ditë cepin e urës. Zjarri i armëve s'kishte të pushuar. Plumbat kryqëzohe-shin flakë për flakë. Gryka e Drinit ushtonte.

— Demir, mitralozi! — foli si me frikë Nazmiu.
...Komandanti ndjeu një therrje të fortë në këmbë.

— Bjeruni kryq! — foli ai dhe çoi dorën te këmba. Dora iu lag nga diçka e ngrohtë. Por përsëri mitralozi filloi të dridhej nga duart e komandantit.

— Shokë, Nazmi... ko... man... danti... — u ndie një zë i fortë.

Shokët e dëgjjuan zërin e Çlirim Shtinës që kishte zënë pozicion pranë komandantit.

— Dëgjuat! Komandanti... Ruani pozicionet! — dhe Nazmiu, si ai dreri që vrapon fluturimthi në për shkëmbinjte, u afrua dhe thirri duke ngritur zërin:

— Shoku Haxhi! — por nuk mori përgjegje. Mitralozi vazhdonte këngën. U afrua edhe më. Ishte errësirë, gjë nuk shihte, veç mitralozit që villte flakë të kuqe nga gryka.

— Shoku Haxhi! — dhe i kërkoi trupin me dorë.

— Asgjë, Nazmi, mos u trondit.

Nazmiut iu qull dora nga gjaku që i ecte nëpër pantallona.

— Shoku Haxhi, tërhiqu! — përsëriste Nazmiu, por komandanti nuk shqitej nga pozicioni. Nazmiu hoqi këmbishën, preu disa rripa dhe i lidhi plagën. Dhimbja sikur iu lehtësua.

Gojë më gojë kaloi lajmi i plagosjes së komandantit. Fuqitë e partizanëve dhe pushkët sikur u

prenë për një çast. Por jo, ato dukej se kërcisnin më fort, se qëllonin më drejt kundër armiqve, duke shprehur kështu urrejtjen dhe hakmarrjen.

— Gjaku i parë i çetës po rrjedh! — Dhe si të gjithë, dhimbjen e plagës së shokut, e mbante edhe Nazmiu. — Para partizanë! — thirri fort, dhe i pari mes shokëve, u derdh mbi armikun.

Mitralozi dridhej si ndër ethe e bënte flakë duke ndritur vendin mes dushqeve. Gjaku ecte. Bartaretë e pushkëve nuk pushonin. Toka buzë Drinit punohej nga plumbat dhe bombat. Këtë zjarr armësh e dëgjoi edhe Azi, komandanti i divizionit italian në Dibër të Madhe, i cili nisi dhjetëra makina që gumëzhnin fushës së Dibrës. Nazmiu me shokë nuk e vinin re autokolonën e gjatë, koka e së cilës ishte në dalje të Maqellarës, kurse bishitj ende nuk ishte shkëputur nga qyteti i Dibrës. Zhurma dhe rreshti i dritave verbuese alarmuan gjithë Dibrën e përgjumur. Gjenerali italian e kishte vendosur këtë herë. Ai, veç makinave të shumta me ushtarë, nisi edhe autoblanda kundër çetës trime. Që në orët e para, çeta e lirisë ishte bërë tmerr për armikun.

— Shoku komandant, pepinot po na afrohen nga Dibra, — sinjalizoi Nazmiu, kur pa vargun e gjatë të dritave që tani arrinin deri në pozicionet e tyre.

Komandantit i kishte rrjedhur shumë gjak, por nuk e bënte veten. Nazmiu krenohej me një gjak të tillë. «Kështu e kanë trimat! Ky të bën të hidhesh edhe në flakë!» — mendoi Nazmiu dhe, i ndihmuar nga shokët, e tërhoqi duke e mbajtur për krahu me kujdes, me gjithë vështirësitë e errë-

sirës dhe të terrenit të keq. E dërguan komandan-
tin në shtëpinë e Skarajve, në fshatin Shpukth. Pas
pak ditësh, pa iu shëruar mirë plaga, komandanti
i çetës, Haxhi Lleshi me disa shokë, u nis që të
mernte pjesë në Konferencën e Pezës.

Në udhëheqje të aksionit

— Unë dhe ca shokë po nisemi për në Pezë.
Ju e keni të qartë rëndësinë e madhe të Konferen-
cës së Pezës, prandaj duhet ta përsërisim me
një aksion të guximshëm. Kështu ka vendosur edhe
celula e Partisë. Unë mendoj se zhdukja e italianëve
nga miniera e Bulqizës, ka rëndësi të madhe poli-
tike dhe ushtarake. Drejtoje aksionin vetë, Nazmi,
— i dha porosinë e fundit komandanti Haxhi Lleshi,
ndërsa po nisej drejt Pezës.

Më 15 shtator, Nazmiu në krye të çetës, iu
afrua vendit të aksionit, aty ku italianët me anë
të shoqërisë AMMI shfrytëzonin në shpatullat e
malit të Duriçit, mineralin e kromit. Armiku pak
a shumë e ndjente veten të sigurtë në këtë shpat
të hapur. Sapo agoi dielli i 16 shtatorit, italianët
vërejtën grykat e armëve partizane që i kishin rre-
thuar. Rojet u çarmatosën në befasi, pa zhurmë.
Mbetej për t'u marrë fortesa.

— Dorëzohuni! Jeni të rrethuar! S'keni asnjë
rrugë shpëtimi.

— Mos derdhni gjak në tokë të huaj, dorëzo-
huni! — thërrisnin shqip e gjysmë italisht disa par-
tizanë.

Italianëve u hyri frika në palcë, kur panë gry-

kat e zjarrit rreth tyre. Asnjë nuk guxonte të nxirrite kokën jashtë fortesës së gurtë të rrethuar gjithë tela e gjemba. Kur e panë veten se nuk kishin nga të dilnin, ngritën me përtim duart dhe një flamur të bardhë që filloi të lëvizte mbi fortesën e zymtë e të heshtur.

Nazmiu dhe disa partizanë u futën në fortesë, dhe i detyruan italianët të dorëzoheshin.

— Mor, gjithë këto pushkë! — i qeshi fytyra një partizani të ri dhe numëroi me sy armët që ishin rreshtuar si jetime, të mbështetura pas murit.

— Dyzet pushkë, dyzet robër! — dhe grykamadhasit i zuri syri «austriakun» e vjetër lidhur me gjalmë, të partizanit të ri.

Dy-tri pushkë u rrëzuan përtokë e bënë zhurmë. Grykamadhasi vështronte i gëzuar partizanin e ri që po i provonte armët një e nga një.

— Hajde, zgjidhe një «italiane», por të re ama, që t'ia lash ti i pari grykën kundër armiqve.

Nazmiu qeshi i kënaqur me partizanët.

Dy partizanët u futën në një kthinë të errët. Ndezën një elektrik dore që e gjetën te pushkët dhe panë stiva të tëra arkash.

— Po këto arka? — foli grykamadhasi dhe qëllloi njërën prej tyre me majën e opingës prej llastiku.

— Kushedi ç'dreqin kanë futur brenda!

E nxorën njërën arkë nga stiva dhe e hapën me bajoneta.

— Heu, «vezë të kuqe»! — thirri partizani i ri kur pa bombat e radhitura në arkë.

— Mirë i tha shoku Nazmi atij bulqizakut mbrëmë: «Me barotin e vet janë djegur gjithë armiqtë tanë!»

— Shiko, shiko, kjo tjetra qenka me... si u thonë këtyre?

— Këtyre? Peksime, u thonë. Italianët i ruajnë për ditë të keqe.

Ushtarët dhe punëtorët italianë, me fytyra të trishtuara e të turpëruara, rrinin kokulur, të zhytur në heshtjen e thellë të dëshpërimit. Nazmiu e theu këtë heshtje. Filloi t'u fliste italianëve:

— ...Njerëz të vuajtur jemi ne që po luftojmë, njerëz të vuajtur jeni edhe ju... Jeni punëtorë me kallo në duar, që u shfrytëzon një padron, që ju ka mpirë ndërgjegjen fashizmi. Ne jemi miq me ju. Punëtorët, dhe armiq me të pasurit, padronët tuaj. Populli italian ka dhënë shembull të shkëlqyer në historinë e luftërave revolucionare! A nuk ju frymëzon shembulli i heroit tuaj Antonio Gramshi?

Punëtorët italianë filluan të lëviznin.

— Ju na thatë të vërtetën! — iu drejtua Nazmiut një punëtor italian, me lot në sy.

— E vërteta e punëtorëve gjendet vetëm me luftë, — ia ktheu Nazmiu me vendosmëri duke buzëqeshur.

Pastaj çeta mori udhën drejt Qafës së Buallit dhe ktheu majtas për të dalë në Martanesh, ku e priste Baba Faja. Aty e kishin lënë takimin me shokët që do të ktheheshin nga konferenca.

Edhe punëtorët e ushtarët italianë pas pak ditësh u larguan. Në minierë erdhën qindra ushtarë e oficerë, besnikë të Musolinit, me qëllim që të shfrytëzonin mineralin e kromit. Nga ana tjetër, kjo fortesë kishte edhe rëndësi strategjike për italianët. Ata e rrethuan edhe një herë me tela gjithë gjemba të pakapërcyeshëm, që të mbroheshin nga sulmet partizane.

Me zemër të hapur

Mbi malin e Peladhisë, një masë e murme resh nxirrte nga barku i saj shigjeta vetëtimash. Nuk vonoi dhe, bashkë me gjëhimet, rrebeshi i papërmbajtur i shiut lëshoi rrëketë, duke marrë me vete gurë e dhé, e duke i derdhur në Drin. U bë natë. Nazmiu vetë i tretë ishte bërë qull nga shiu. Me zor kaluan zallin e Zerqanit. Në fund të një zabeli, buzë zallit, gjendej shtëpia e Cenit.

— Ceni është besnik, njeri i ndershëm, më ka thënë komandanti, prandaj atje mendoj të shkojmë, — propozoi Nazmiu. — Qysh në vitin 1941 kam dëgjuar se aty është strehuar Haxhiu me njësitin e tij.

— Njerëzit e këtyre viseve i njeh mirë komandanti.

Agroni ato ditë ishte liruar nga burgu i Elbasanit, ku e kishin mbajtur pesë muaj. Ai u bashkua me dy shokë në Dovolën për të shkuar në çetën që ndodhej në Martanesh.

Partizanët u afruan dhe trokitën lehtë në portën e madhe.

— Bujrëm! — u dëgjua një zë i thellë, që dukej sikur vinte nga thellësitë e një pusi. — Kush është?

— Jemi ne... shokët e Haxhi Lleshit, — foli me kujdes Nazmiu, kur ndjeu hapat e të zotit të shtëpisë pranë derës.

— Ç'po flet, mor i paudhë? Kush është ky Haxhi Lleshi? Çfarë pune kam unë me të? — foli Ceni, duke menduar se kishte të bënte me ndonjë kurth të armikut.

— Jemi partizanët e Haxhiut, Cen, mos na merr për të tjerë!

Ceni, ashtu me dyshim, e hapi pak portën, ndërsa në brez me dorën tjetër, shtrëngonte fort dorezën e ftohtë të nagantës.

Ceni i njohu dhe i futi të tre shokët brenda. I puthi me radhë.

— Po ju po më ndrisni shtëpinë, mor trimat e Cenit, ma ngrohët këtë shtëpi! — fliste Ceni me gjithë zemër.

Vendi nuk e zinte nga gëzimi i madh, që në shtëpinë e tij kishte tre partizanë të lirisë. U hapi partizanëve kanatet e zemrës, ndërsa Nazmiu dhe shokët e tij e ndjenin veten të qetë e të sigurtë në atë shtëpi të Pucajve.

— Më falni, mor djem, se nuk e mban zakoni që t'i bëjmë mikut fjalë te dera, por nuk i besohet këtij hasmi. Është shumë i poshtër ky! — foli pastaj Ceni, që t'i jepte udhë muhabetit në një krah tjetër.

— Përse, mor shoku Cen?

— Si përse? Një mesnatë, vajtën ca njerëz e trokitën te dera e një shokut tonë. I thirrën: «Hape se jemi partizanë të çetës së Dibrës». Ai i shkreti, kur dëgjoi fjalën partizanë, prej gëzimit kërceu menjëherë dhe hapi portën në dy kanata. Kur ç'të shihte? Kishin qenë milicët e Halil Ketës! E lidhën të varfërin dhe sot e kësaj dite ndodhet në birrucë. Kapiten Stavri Jahoja...

— Ashtu? Po kapitenin, a e njeh ti, shoku Cen?

— Si kallëp e njoh, se e kam parë në kafenenë e Zerqanit duke luajtur bixhoz, por kam marrë vesh se është katil i madh. Është betuar se do t'i

rrjepë të gjallë komunistët. Ju ia njihni edhe zorrët e barkut, xhanëm. Një mik më tha se ka ardhur këtej nga anët tona si mjeshtër për zhdukjen e komunistëve, por mua më duket se ka ardhur të shpëtojë lëkurën, se andej nga Tirana e kishte mbushur kupën.

— Drejt e ke, shoku Cen. Populli i di të gjitha, — foli Nazmiu.

Po atë darkë, në Sopot, u bë plani i hollësishëm për vrasjen e spiunit fashist, kapitenit Stavro Jaho, sipas vendimit të marrë nga celula e Partisë dhe çeta. Nazmiu dhe Demir Gashi ishin ngarkuar nga celula që të kryenin vendimin e saj. Agroni u nis në Martanesh për t'u bashkuar me çetën.

ATENTATI

Hëna i mbuloi malet e Zerqanit me një dritë të hirtë. Në kaliben e kashtës u strehuan dy shokët, në të dalë të fshatit. Këtë kalibe xha Sula e përdorte për të ruajtur misrat nga derrat. Vend më të sigurt nuk mundi të gjente për dy shokët. Nga larg dëgjohej e thirrura e ndonjë fshatari apo rrahja e një teneqeje për të trembur egërsirat që mos hynin në arat me misër.

— Me shokët e tjerë ke biseduar për aksionin?
— e theu heshtjen Demiri.

Nazmiu u kap pas dy drurëve të çatisë së kalibes dhe foli:

— Demir, për çdo gjë vendos Partia.

Ca kashtra misri lëvizën. Dy shokët, me kujdes, dolën nga kalibja, me revole në duar.

— Heu, për besë nuk ju njoha! Qenkeni bërë tamam martaneshas me këto rrobe! — u foli xha Sula, sapo i pa në dritën e hënës. — Mos ju ka marrë uria? — dhe, si tha këto fjalë, nxori nga trasta një misërnike të bardhë dhe pak gjizë. Pastaj, po nga ajo trastë, nxori edhe një dorë fishekë revolveri. — A mjaftojnë? Këmishëziu u kthye nga Dibra e Madhe, — dhe ia hodhi Nazmiut fishekët në dorë.

— Vrite natën fashistin, mor bir, se i fshihesh më mirë hasmit!

— Jo, do ta vras me ditë, që të ma shikojë fytyrën fashisti. Komunistët e kanë zakon të mos e fshehin fytyrën para armiqve! — dhe i ra shpatullave xha Sulës me dashuri.

Të nesërmen morën udhën e aksionit. U futën në «Luginën e Muçjeve». Aty i prisnin dy zerqanasit. Nuk vonoi dhe u duk në fund të arës me misër edhe shoku nga Valikardha.

Detyrat i kishin të qarta: I riu nga Zerqani do të lajmëronte nëse ishte spiuni në Zerqan. Demiri do të qëndronte te çezmja e «Istrefit». Nazmiu do të kryente atentatin, ndërsa një shok nga lagjia «Gurri» do të shtinte me kobure, me qëllim që të çorientonte armiqtë për të siguruar tërheqjen e Nazmiut. Secili u nis për të kryer aksionin e vësh-tirë. Ata u lëshuan drejt rrjedhës së «Përroit të Dishajt».

— Nazmi...

— Folë.

— Nuk do të të lutem kurrë...

— Për çfarë?

Ecnin njëri pas tjetrit dhe flisnin me zë të ulët. Uji i përroit gurgullonte. Era e asaj pasditeje të bukur tundte degët e arrave të shumta.

— Jeta jote nuk të takon vetëm ty. T'i dal unë para fashistit! — doli aty ku desh Demir Gashi.

Nazmiu u ndal në rrëpirën e përroit me këmbë në ujë. E përqafoi shokun dhe i tha:

— Demir, shok, kjo është vepra e të gjithë shokëve në emër të popullit, në emër të Partisë! Rëndësi ka të jetojë ideali ynë.

Këto ishin fjalët e fundit që shkëmbyen dy shokët në rrugën e luftës. Të dy pushuan të qetë e pinë nga një ujë e nga një kafe te lokali i Aliut Nazmiu shënoi në bllokun e tij: «26 shtator — para atentatit». Pastaj u ngjitën te kafeja e Myftarit. Plot nëpunës po luanin bixhoz. Kapitenin fashist nuk ua zuri syri. Filluan të studjonin mirë vendin brenda dhe jashtë. U afruan pranë banakierit që po i vështronte me dashamirësi këta «martaneshas». Të dy blenë nga një paketë cigare. Me cigare në gojë zbritën përsëri në qendër të qytetit të vogël.

Në të majtë të kafesë, ku kthehet rruga për në qendër të Zerqanit, gjendej ndërtesa e karabinierisë italiane, prandaj Nazmiu dhe Demiri prej saj po prisnin të dilte gjahu i kërkuar për shpagim. Dhe ja, ai doli duke u krekosur me gradat e kapitenit fashist, me sopatat e Liktorit mbi këmbëshën pis të zezë. Nazmiu vështroi Demirin me buzëqeshje. Shoku e kuptoi vështrimin e tij. Spiuni, i shoqëruar nga tre xhandarë, dy karabinierë dhe nënprefekti, kaloi pranë dy «fshatarëve martaneshas» duke i vështruar me dyshim, por gjithmonë duke e ndjerë veten të sigurtë në mes rojeve.

Ndërsa spiuni Stavri Jaho po ngjitej ngadalë, duke thithur atë fresk mbrëmjeje, dy shokët i dolën dhjetë metra përpara. Nazmiu ndaloi, gjoja se po rregullonte gjalmën e opingës, kurse Demiri vazhdoi rrugën drejt çezmës së «Istrefit». Stavri filloi ta ngadalësonte hapin, derisa qëndroi në vend. I gozhdoi sytë mbi «martaneshasin që po lidhte opingat».

«Mos është ai... komunisti?» — mendoi. Kërbaç i doli si gjarpër përpara syve, shtizat e nxehta, fytyra e gjakosur e atij dibrani të papërkulur që

ngriti grushtin përperjetë, dhe veshët sikur i buçitën mes burgut: «Copëtoje trupin tim, o gjakpirës! Ne nuk shuhemi nga asnjë lloj vdekjeje! Mbage mend, xhelat, se hakmarrja e popullit do t'u djegë me plumb e barot!»

Kapiteni erdhi në vete. Gjithshka fliste qartë. Sytë e tij nuk mund të gabonin.

«Tamam, ai është, Nazmi Rushiti, është tamam, si fotografia që mbaj prej kushedi sa kohësh në sirtarin e tavolinës...»

«Të afrohet edhe pak... mendonte Nazmiu. Mos vras ndonjë xhandar», dhe në mend iu radhitën fjalët: «Ti, bukurosh, ke ardhur në Dibër me mision të caktuar, ë! Të zhdukësh komunistët, të shkatërrësh Lëvizjen Nacionalçlirimtare në Dibër, ë? Të caktuan Zerqanin si vend strategjik dhe menduan se këtu do t'i shpëtoje hakmarrjes së komunistëve? Ne nuk e harrojmë gjakun e shokëve, qen!»

Ishin veçse disa metra larg njëri-tjetrit. Tani e kishte fjalën gryka e revolverit. Vetëm një fije floku e ndante jetën nga vdekja. Këtë fije e mori guximin ta këpuste Nazmiu. Nxori me shpejtësi revolverin:

— Në emër të popullit, zoti kapiten!

Dhe para se të zbrazte mbi trupin e kapitenit plumbat e vdekjes, shtoi:

— Spiun i ndyrë, ja cilët janë komunistët!

Dhe bashkë me fjalën e fundit, me një shpejtësi të rrufeshme, këndoi edhe «bereta» këngën e plumbave të vdekjes mbi gjoksin e fashistit. Kjo ndodhi brenda pak sekondave.

Stavri i goditur u përdrodh e ra buzë vijës së ujit.

Shoqëruesit u tërhoqën pas qosheve të shtëpive

që ndodheshin aty pranë dhe hapën zjarr kundër atij «martaneshasi kokëkrisur». Demiri lëshoi dy bomba. Xhandarët e karabinierët u mbrojtën. Një xhandar i preu rrugën. Nazmiu e njohu. Ishte Mahmut Lala.

«Edhe ti egërsirë, qenke bërë xhandar?» -- mendoj Nazmiu dhe qëlloi mbi të. Plumbi e zuri në krah xhandarin, dhe ai u tërhoq i plagosur në qoshen e kafesë. Ndërkohë, hodhi edhe një bombë dhe i çorientoi fashistët, bashkë me zjarrin që hapte pa pushim Demiri.

Vendimi u zbatua. Kapiteni, i plagosur për vdekje rënkonte me kokën e futur mes ujit të kanalit. Këto ishin ndër krismat e para partizane në atë qytet të vogël dibran, që u radhitën si vazhdim i një kënge, të cilën e kishte marrë vendçe e gjithë çeta.

Në dorë të armiqve

«Si u bë kjo punë kështu? A thua ky ta ketë vrrarë kapitenin tradhtar?» — pyeste veten Hasë Brisku, me një keqardhje që i buronte nga mushkëritë, kur ca karabinierë me marshall Macantin po tërhiqnin zvarrë atentatorin nga rruga e Valikardhës. Hasa nuk e ndjeu veten mirë. Atë s'po e mbante dheu nga një helm që i solli ajo skenë. Italianët kishin zënë një partizan! Si vallë kishte ndodhur kjo?

...Nazmiu, si shkundi revolverin kapërceu murin prej guri, nëpër të cilin kishin mbirë ferra të shumta, dhe u hodh në arën me misër. Mirëpo një gardh xhandarësh i preu rrugën nga ku do të shkon-

te të bashkohej me Demirin. Përmes plumbash, me një shpejtësi të rrufeshme, nuk mundi t'i shmangej një lartësie prej njëzet metrash, që përfundonte thikë në një kalldrëm. Në shpejtësi e sipër u rrokullis e ra në rrugën me kalldrëm, ku iu dëmtuan dy këmbët, ndërsa një dhimbje edhe më therrëse ndjeu në brinjë. Ra në agoni... Pemët iu rrotulluan, malet sikur u kapën krahëqafë e nisën vallen...

Këtë gjumë të ëmbël ndjenjash, këtë agoni, ia trazuan shqelmat e italianëve dhe krisma e një pushke që lajmëronte italianët e tjerë për kapjen e «komunistit guximtar». Nazmiu e kuptoi se kishte rënë në thonjtë e bishave. Mblodhi gjithë fuqitë që të mposhte krahët e dy fashistëve që e kishin mbërthyer, u përlësh me ta, u rrokullis disa herë me dy italianët nëpër gurë, nëpër ujët e përroit, midis ferrave e gjembave. Fuqitë iu prenë. Trupin e ndjente të dërmuar. Këmbët sikur nuk po i ndjente më. I dukej se i kishte të këputura dhe se po rrinte pezull mbi tokë. Edhe një herë mblodhi fuqitë gjithë urrejtje dhe qëlloi njërin nga fashistët me grusht në bark. Revolveri i fashistit fluturoi matanë. Një shkëndijë shprese... U lëshua të kapte revolverin...: Ja, edhe pak dhe do t'i lante hesapet me të dy... Por në ndihmë të dy armiqve po vraponin si njolla të murme karabinierë të shumtë me pushkë në duar. Atëhere Nazmiu hëngri veten nga zemërimi. Ai ndodhej në kthetrat e armiqve, i çarmatosur! Si e lidhën me pranga, fashistët e tërhoqën zvarrë deri te kazermat e karabinierisë dhe e përplasën pa ndjenja në çimenton e akullt të qelisë. Ai nuk e dëgjoi llozin e hekurt dhe fishkëllimën çjerrëse të derës së rëndë. Vetëm vonë ndjeu hapat e rëndë, të mërzitshëm dhe monotonë të karabinierit që lë-

vizte ecë e jakë korridorit të gjatë e të ngushtë të kazermës, duke shtrënguar pushkën në duar.

Dhimbje e shqetësim

Dielli sapo perëndonte. Nëna e Rahmiut po zbriste «Lugut të Shkallës» mbi Zerqan me mendjen te i biri. Ajo nuk arriti ta takonte të birin te Baba Faja. Rahmiu, një orë para se të arrinte e ëma, ishte nisur për në Mokër. Detyrën me Babën e kishte kryer.

Ca krisma revolveri jehuan «Lugut të Shkallës». Ajo qëndroi. Përsëri të shtëna revolveri, bombash. Pastaj u dëgjua një batore pushkësh.

— Po këto?.. — pëshpëriti dhe mbeti pa lëvizur. Ishte ende ditë. Barinjte po mblidhnin bagëtinë. Deshi t'i thërriste atij bariut që Nazmiu i kishte folur për punë lufte, por e kishte larg. Duke hyrë brenda, i kapën sytë Hasë Briskun që ecte si i tërbuar.

— Hasë, po këto pushkë?

— Kapiteni i zi na i mori të ligat!

— Po ti... se si më dukesh... i vrarë në shpirt.

— Komunisti, nënë, ai që njeh ti, është në dorë të karabinierëve!

Nëna shtangu te dera. Fuqitë iu prenë. Qëndroi ashtu pa lëvizur një copë herë të mirë. Edhe Hasa mbeti me sytë në një vend.

— Pushka më e lehtë, mor Brisk! Më mirë një grusht plumbash të më kishin rënë...

Tre karabinierë vrapuan pranë portës, me armë në duar. Nëna e Rahmiut u fut brenda me një brenge të madhe në shpirt.

*
* *
*

«Ç'do t'i ketë ndodhur? A mos e zuri ndonjë plumb? Po sikur?..» — Vetëm këtë nuk donte ta mendonte Demir Gashi. Por ai nuk po dukej. Tëmthat e kokës i rrihnin me forcë. Ikte nga maja e Shkozës, nëpër ato të tatëpjeta gjithë gurë dhe dilte te «Zabeli i madh» në fund të kodrës, e përsëri kthehej prapë. Megjithëse gjithë ditën nuk ishte ulur, nuk ndjente lodhje fare. Një ankth i madh i kishte pushtuar tërë qenien. Kishte humbur shokun e armës, shokun e çetës, kishte humbur një komunist!

Nata ra e zezë dhe e shqetësuar. Një bilbil s'pushonte së kënduari, ndërsa krismat e një revolveri jehonin grykave dhe shuheshin në thellësinë e heshtur të natës. Ato thërrisnin, jepnin alarmin, që arrinin deri te prangat e hekurta të qelisë ku ishte mbërthyer komunisti.

Një orë më parë, në zyrën e regjent Matos hyri fshehtas një spiun.

— Milic shqiptar është, «Visar Troku» e quaj në foli shpejt e shpejt spiuni.

— Vetëm kaq i tha të panjohurit?

— Zura edhe këtë shprehje: «Ylli» të pret në çetë!»

— Kush do të jetë vallë «Ylli»? — ra në mendime regjenti. Dhe pastaj shtoi: — Zbulo cili është «Ylli»!

Spiuni u largua.

«Cili do të jetë ky «Ylli»? — vazhdonte t'i

bënte këtë pyetje vetes regjenti. — Po ky «Visar Troku»? Ç'fije të ngatërruara!»

Milic «Visari», me një letër postare në dorë, u ngjit shkallëve të kuesturës që t'ia dorëzonte regjentit.

— Urdhëroni, zoti regjent! — u fut brenda milici.

— Mirë që erdhe. Cili nga milicët tanë është «Visar Troku»?

«Visari» nuk e humbi. U mendua një çast dhe foli:

— Më falni, zoti regjent. Në armën tonë nuk ekziston një emër i tillë. Do të jetë ndonjë gënjeshërë.

Telefoni tringëlliti gjatë e kërcënueshëm. Regjenti vuri menjëherë receptorin në vesh. «Visari» vuri re se regjentit herë i vinte e herë i ikte fytyra. I mbetën sytë te ai lugu i djegur ngjyrë vishnje të hapur, që i errej e i skuqej. «Diku u këputën telat!» — mendoi dhe i vuri veshin fjalës së regjentit:

— Çfarë flisni, marshall Macanti? Është e vërtetë? Unë qysh tani po marr masat e duhura! Forcojeni mirë kazermën! Ashtu? Përdorni metodat më moderne mbi banditin... ëhë... shumë mirë, vazhdoni!

— Nën urdhërat tuaja, zoti regjent! Çfarë i ka ndodhur armës sonë? — foli «Visari» i habitur.

Regjenti e vështrroi i lodhur. Por për çudi u çel dhe në çast u ngrit. Hapi dritaren e zyrës dhe vështrroi tutje, nga humbisnin në muzgun e natës malet e Zerqanit.

— Milic, mor derr, përse nuk qesh? — iu kthye pastaj «Visarit», duke picëruar sytë i kënaqur.

— Përse të qesh, zoti regjent?

— Komunisti Nazmi Rushiti u kap! — foli re-
gjenti dhe u lëshua mbi kolltuk që të deshifronte
telin shifër.

Por nuk e pati të gjatë gëzimin. U trondit së
tepërmi, kur lexoi: «Vranë kapitenin» dhe iu ha-
kërrua «Visarit»:

— Shporru!

Milici u largua.

Edhe monoplat telegrafike në Zerqan, Dibër të
Madhe e Peshkopi, e zilet e telefonëve nuk u prenë,
duke dërguar nëpërmjet telave në drejtim të Ti-
ranës, shifrat alarmuese:

«...U qëllua kapiten Stavri Jaho... u kap gu-
ximtari... Komunisti Nazmi Rushiti... akuzohet edhe
për faje të tjera...»

Prefekti i Peshkopisë menjëherë mori në tele-
fon zëvendësministrin e punëve të brendshme dhe
e lajmëroi për ngjarjen.

— Tani sa nisëm dhe telin me shifër urgjent
lidhur me vendimin, — u përgjegj zëvendësministri.
— Dënimi i tij duhet të bëhet shembull për ato
anë... paralajmërim për gjithë ata komunistë.

Të dy dukeshin të gëzuar, po gëzimi i tyre për-
zihej me një frikë të brendshme të pakuptueshme.

* * *

Nëpër qytetin e Dibrës, patrullat e ushtarëve
e të karabinierëve, prishnin qetësinë e asaj mesnate
të errët e të frikshme. Vetëm Aisheja dhe Drina
nuk flinin. Si fshehën fishekët dhe tri pushkë në
bodrum, u ulën. Njëra qëndiste yje, kurse tjetra po
thurte çorape për partizanët e çetës.

— Të tha gjë Bardhi për shokun Haxhi?

— Nga Peza është nisur. Informohemi se do të qëndrojë ca në Martanesh. Një miqësi e ngushtë luftarake e lidh me Baba Fajë Martaneshin.

Drina, me grip në dorë, këndonte me zë të ulët.

«Visari» mbeti pak i mbështetur mbi derën e bazës. E ndjente këngën e Drinës dhe nuk i bënte zemra t'ia prishte. Një hije njeriu iu afrua shumë afër, sa nuk pati kohë të nxirrte as revolverin. Hi-ja shtriu duart pa zë dhe e zuri për fyti «Visarin».

— Mos luaj, spiun! Ç'kërkon në dyert e botës?

— Aaa, Bardhi! Ti je, vëlla? — mezi foli «Visari», i mbërthyer nga ato duar të forta si darë.

— Po ti këtu? Unë mendova se mos është ndonjë i zi që kërkon të përgjojë ndonjë fjalë apo lëvizje nga baza!

— Eh, mor Bardhi, po mundohem t'i bie derës, por zemrën e kam të ligë e s'ma thotë! Si t'u them nënë Aishesë dhe Drinës?

— Ç'ka ndodhur, vëlla? — e shkundi Bardhi fort nga krahët.

— «Ylli»... në gojë të ujqërve..., — mezi e nxori këtë mandatë nga goja.

Bardhit iu duk se errësira u shtua edhe më shumë nga ç'ishte. Të dy mbetën pa lëvizur te praku i derës.

— Edhe kapitenit ia skuqi këmishën e zezë..., — theu ngadalë «Visari» atë heshtje të kobshme.

Por Bardhi nuk e dëgjoi. Mendjen e kishte te Nazmiu. Mendonte si ta shpëtonte. Si e mori veten, i tha:

— Vëlla «Visar», «Ylli» është komunist. Dhe komunisti edhe në gojë të vdekjes bëhet i pavdekshëm.

Kupton? Hajde, vëlla, mundohu të largosh pikë-
lilimin! Vdekje fashizmit!

— Liri popullit. Bardh partizani!

Bardhi ilegal, të nesërmen do të nisej për në
çetë, pasi puna e tij ishte nuhatur nga kuestura.

Regjenti Mato Murati, vetëm kur milici i tij u
arratis në çetë, e kuptoi se cili ishte «Visar Troku».

*

* *

Ylli që po qëndiste, i mbeti në dorë Drinës.
Aishesë i iku gjaku. Çorapi gjysmë i thurur i ra mbi
prehër. Fuqia i la të dyja. Mbetën pa hapur gojë,
me sytë e mbërthyer mbi Bardhin, i cili nuk gu-
xonte t'i shikonte në fytyrë. Mendja u rrinte te
Nazmiu, te burgu, te torturat. Bardhi u ngrit. Rre-
gulloi kollanin e fishekëve dhe mori pushkën që
të nisej për në çetë. Aisheja i foli:

— Bardhi i nënës, ti nuk ke qenë në mbledhjen
e parë që bëri «Ylli», kur erdhi nga Tirana. Ti tani
po del malit, prandaj mos i harro fjalët e tij: «Ne,
shokë, malin e kemi patur, pushkën e kemi patur.
Por Partinë nuk e kemi patur. Tani e kemi. Kush
na del ne, kush matet me ne? Partia dhe «Tarasi»,
po gatuanë fuqitë tona, fuqitë e vegjëlisë, për fla-
kën e luftës! Ne, si bij të Partisë, do të qëndrojmë
në ballë të lirisë...»

Drina e Bardhi shikonin nënën që citonte fja-
lët, si t'i kishte të shkruara gjëkund. Ajo kujtoi
ato çaste kur Nazmiu u fliste atyre katër a pesë
shokëve në nëntor të dyzetënjëshit, në shtëpinë
e saj.

— Po, «Ylli» i nënës, komunisti i nënës, gjithmonë i Partisë! Edhe muret e burgjeve nuk do të të përkulin! — foli Aisheja e vendosur.

Bardhi u përshëndet me të dyja dhe doli.

— Edhe Bardhi, nga brumi që gatoi «Ylli» është, nënë, — foli Drina.

— Po moj bijë, po! E ku nuk ka lënë gjurmë «Ylli»...

Drina hapi dritaren. Agimi i njëzeteshtatë shtatorit po kthjellonte sadopak honin e pamatur të horizontit.

Q ë n d r e s a

Ishte ora 22 e natës. Nazmiu erdhi pak në vete. Koka i ziente. U ngrit në këmbë. Ra përsëri. Përsëri u ngrit. Filloi të mbahej me mundim pas murit tërë lagështirë. Megjithëse duart i kishte në pranga, shkoi pranë derës. Përsëri nuk e mbajtën këmbët dhe ra. Trupi i tij dridhej nga plagët. Megjithëse ishte shtator, në qeli ishte një të ftohtë që të kujtonte janarin. Një vijë gjaku, si shirit, i kalonte nga fytyra dhe humbiste mes rrobave të copëtuara. Në mollëzat e faqeve, rreth syve, nga të rrahurit e fashistëve, i ishin krijuar pulla të nxira. Komandanti i karabinierisë, Macanti, si pa se me torturat më moderne nuk po ia dilte, ia filloi me lajka e premtime. Të gjitha këto Nazmiu i hodhi poshtë me neveri.

U bë ndërrimi i rojeve. Te dera e qelisë ruante karabinier Masha. Hapat e rëndë të rojes kureshtar u ndaluan te dritarja e kryqëzuar me hekura. «Kush do të jetë ky? Ç'ka hequr, i varfëri!» pëshpëriti

roja dhe futi kokën te hekurat, duke shpuar me sy errësirën e qelisë. «T'i flas? Po sikur të më dëgjojë ndonjë italian? Jo, mor, kush do m'i mbajë me bukë kalamajtë pastaj? Si e kanë katandisur të shkretin!» Ktheu edhe njëherë kokën anash.

Ndërkohë një zhurmë e madhe prishi qetësinë e natës. Dy makina dhe një autobлиндë, të nisura nga Dibra e Madhe, arritën pranë kazermës. Në çast Jakoveli dhe Macanti, të shoqëruar nga disa karabinierë, u drejtuan nga qelia.

Karabinier Masha mbeti si hije, e mbështetur pranë derës së qelisë. Ai e pa mirë qëndrimin heroik të Nazmiut. Shikonte dhe mendonte: «T'ia kishte hequr hekurat nga duart, të paktën. Pse, keq do të kisha bërë sikur edhe derën t'ia kisha hapur? Do të shpëtonte një shqiptar nga duart e këtyre bishave. Ç'po them? Po fëmijët e mi? Tani s'ka më, mbaroi kjo punë! Kur s'e bëra dot më parë...»

Dera e qelisë, përsëri u hap. Dy italianët u habitën kur e panë Nazmiun të mbështetur për muri, me një qëndrim krenar e mospërfillës.

«Partia më ka dhënë forca që të duroj dhe t'ju tregoj kriminelëve se ç'do të thotë zemër komunisti!» — mendoi Nazmiu kur pa fytyrat e urrejtura të atyre që hynë.

* * *

Nga ora 3 pasmesnate, Jakoveli dhe Macanti mbaruan hetimet e dyta pa asnjë rezultat.

— Ç'metoda të tjera të përdorim kundër këtij banditi? — shtrëngoi dhëmbët Macanti dhe ndezi një cigare.

— Ka kohë që jemi munduar për zhdukjen e këtij komunisti të rrezikshëm. Paguam njerëz me napolona. . . Dhe e kapëm, por e kapëm kur na vrau njeriun më të besuar. Por sidoqoftë, ti mos u merakos, se ka rënë në dorë të ustait! — e siguroi Jakoveli.

— A nuk e dëgjove se si u përgjegj kur ne i kërkuam të tregonte për komandantin e çetës partizane?

— Po, po. . . — ia preu fjalën Jakoveli, duke i kumbuar në vesh ende zëri i Nazmiut. «Ju e dini, o fashistë, se komandanti është në zemër të popullit, kudo është ai! Dhe do ta njihni së shpejti!»

— Jeta jonë vihet në rrezik prej këtyre banditëve të mallëkuar! — foli Macanti me një zë të çjerrë e të frikshëm. — Njëri na ra në duar, po të tjerët? Komunistët flasin vetëm me plumb.

Roja lajmëroi se automjetet ishin gati për udhëtim. Nazmiu, i lidhur duar e këmbë me hekura, ishte mbyllur në kamion me disa roje italiane. Maqina u nis nga Zerqani. Përpara ecte autobllinda, mbrapa një kamion me ushtarë me helmata të hekurta. Mëngjezi po zbardhëllonte. Nga lindja, majë maleve, tej Drinit, po ngrihej një sfond i kuq resh, si të ishin lyer me gjak që drejtoheshin drejt Dibrës.

Sapo makinat hynë në Shupenzë, një patrullë italiane u doli përpara dhe i raportoi Jakovelit diçka me zë të ulët. Ky, menjëherë dha sinjal me dorë dhe makinat u kthyen mbrapsht, duke kaluar urën e Çerenecit për në Dibër të Madhe. Major Verdi ishte njoftuar se te ura e Topojanit qenë dukur disa partizanë të çetës, dhe me urgjencë, lajmëroi që të dredhohej rruga.

Gjerarkët fashistë në Dibër të Madhe, mes tyre

edhe gjeneral Azi, po prisnin në hyrje të federatës. Ata e dinin se «banditi komunist», Nazmi Rushiti, do të kalonte andej. Dielli sapo ishte përshëndetur me qytetin e përgjumur. Qytetarët u bënë kureshtarë për prishjen e gjumit që me natë nga fashistët gjerarkë. Filluan të pyesnin ngadalë njëri-tjetrin, por asnjëri nuk mund të jepte shpjegime, përveç bazës numër 41 në lagjen Varosh.

Makinat, duke ndjekur njëra-tjetrën, ulën shpejtësinë para ndërtesës së federatës. Gjerarkët bënë shenjë që të ndalonin te kazermat ushtarake, në të dalë të qytetit. Ata donin t'ua tregonin qytetarëve dibranë komunistin që t'u fushnin panikun, por gjeneral Azi që kishte përvojë në punë të tillë, nuk lejoi.

— Nuk duhet ta shikojë asnjë qytetar këtë komunist. Sipas të dhënave, ai ka punuar këtu. Populli e njeh. Me një veprim të pamatur, djegim veten tonë! — foli prerë ushtaraku i lartë. Pastaj, të gjithë hipën në veturën «Fiat» dhe u dolën përpara tri makinave.

...Nga makina nxorën Nazmiun. Megjithëse i dërmuar nga plagët ai e mbante ballin lart e çau krenar në zyrat hetimore të SIM-it. Një «Fiat» tjetër sapo arriti nga Peshkopia. Që andej doli major Verdi duke përplasur me forcë derën e makinës, dhe u ngjit me shpejtësi te shoku i tij.

— Uluni, uluni dhe qetësohuni. Ju ka lodhur rruga e gjatë, — i foli gjenerali gjithë mirësjellje. Nazmiut.

— Ju faleminderit për kujdesin, zoti gjeneral. Kjo është etiketa juaj fashiste.

Gjeneral Azit, një nënqeshje e hidhur iu vizatua në fytyrë.

Gjerarkët e tjerë, major Verdi, Jakoveli dhe renegati i kuesturës, Mato, e vështronin Nazmiun me egërsi. Gjeneralit nuk i ngriheshin shpejt nervat. Bëri sikur nuk i dëgjoi fjalët. U ngrit, e zuri Nazmiun nga bërryli dhe i foli:

— Përse e vratë kapitenin?

Në fjalët e tij, në sipërfaqe të buta e gjithë mirësjellje, fshihej tërbimi dhe urrejtja.

— Mua ka të drejtë vetëm Partia të më kërkojë llogari që nuk munda të vrisja edhe më shumë fashistë e tradhtarë! Unë vrava një kriminel! Edhe ju, fashistët, kriminelë jeni. Ju i keni përlyer duart me gjakun tonë...

Gjenerali lëvizi. Dhe pak e do ta humbiste durimin, por iu kujtua një këshillë: «Zemërimi dhe urrejtja janë këshilltarë të këqinj!»

— Ju jeni komunist?

— Kjo është krenaria dhe lumtëria ime!

— Robi ynë dhe e quan veten komunist? — qeshi me tallje gjenerali dhe vështroi major Verdin.

— Jo, unë nuk jam robi juaj. Edhe tani, para një gjenerali fashist, me pranga në duar, nuk jam robi juaj! Se ju nuk keni forca të tilla për të më lidhur zemrën dhe shpirtin. Komunisti, sinjor gjeneral, është komunist edhe mes prangave, edhe me litar në grykë!

Megjithëse i dërmuar nga torturat, Nazmiut këto fjalë i dhanë gjallëri e kurajo. Gjenerali nuk kishte forca ta duronte më tej. U ngrit në këmbë dhe thirri:

— Mjaft! Mësojeni të flasë derisa të kërkojë mëshirë!

— Përse bini kaq poshtë, zoti gjeneral? Komu-

nistët kurrë nuk do të kërkojnë mëshirë prej armiqve!

Dhe trupi i këtij martiri, provoi gjithë mjetet çnjerëzore. Me orë të tëra mbeti pa ndjenja. Xhelatët i rrinin mbi kokë, duke pritur ndonjë fjalë, por ai nxirrte vetëm gjak nga goja. Kjo i tmerronte edhe më shumë fashistët. Ai edhe para vdekjes, sikur po rilindte. Mbas ca orësh, Nazmiun e nxorën nga kazerma ushtarake, dhe, rrëshqanthi, e futën në makinën e mbyllur, e cila mori udhën për Peshkopi, duke patur përpara dy vetura «Fiat», një autoblindë dhe kamionin me ushtarë, për sigurim.

*

* * *

Burgu i Peshkopisë ishte stacioni i fundit i torturave. Kapiten Karta e kishte siguruar gjeneral Azin se «edhe të vdekur do ta detyronte të fliste».

Mbas disa orësh, major Verdi, xhelati Karta dhe Xhafer Bali e morën Nazmiun në pyetje, duke shpresuar se do t'i ishin dobësuar nervat nga torturat e shumta. Por kërbaci hapte plagë në trup, dhe jo në zemrën e komunistit.

Major Verdi e filloi «provën».

— Mjaft më! Ose flisni, ose... — dhe nxori revolverin.

Majorit po i sosej durimi. Gryka e revolverit takoi fytyrën e dobësuar e të përgjakur të Nazmiut. Nazmiu ndenji drejt. Vështrimet e tyre therrëse dhe urrejtëse u kryqëzuan.

— Kriminelët janë frikacakë! Tërhiqe!

Majorit iu drodh revolveri në dorë.

«Jo, ky nuk duhet të vdesë. Ky di shumë sekrete të komunistëve», — kujtoi porosinë e gjeneralit dhe e futi revolverin në xhep.

— Përse frikësohesh, zoti major? Vdekja nuk më tremb!

Me gjithë këto fjalë të komunistit, fashisti kërkonte ta shpinte deri në fund programin e vet.

— Cilët janë shokët e tu, folë! Kush e ruan komandantin? Ku janë bazat e tij? Përse hesht? — dhe e qëlloi me shuplakë në fytyrë.

Nazmiu heshti për një çast dhe ngriti kokën përsëri.

— Populli, njerëzit e varfër e të ndershëm, këta janë shokët e mi, këta i mbajnë edhe komandantin dhe partizanët e lirisë.

Kapiten Karta, i bërë pleh në fytyrë, i rrëmbeu kërbacin majorit dhe qëlloi sa mundi mbi fytyrën e Nazmiut. Gjaku rrodhi përsëri. Ra pa ndjenja. Fashistët e tërhoqën nga këmbët dhe ashtu e përplasën në qeli.

Trupin ia therrnin plagët. Sytë i erreshin. Ndjente dhimbje të tmerrshme. Por mendjen e kish-te të kulluar. Ai, edhe me vdekjen në sy, donte t'u përgjigjej, të qëndronte si shqiptar e si komunist para tyre. Dhe ashtu, duke u zvarritur, u afrua tek muri me gjysmë shpirti. Deshi të ngrihej në gjunjë, por nuk mundi. Pas një ore, xhelati Karta dhe spiuni Jakovel hynë në qeli, me qëllim që të dëgjonin ndonjë fjalë në kllapi të komunistit. Drita elektrike i verboi sytë. Mposhti dhimbjet, u ngrit në këmbë dhe, me grushtin lart, thirri:

— Rroftë Partia Komuniste Shqiptare! Vdekje fashizmit!

Dy xhelatët u bënë si të tërbuar. U afruan kokë më kokë, të trembur nga ai zë që kumbonte ende i fuqishëm.

— Çfarë shpirti!

— Ende lufton?

— Ende.

Kapiten Karta, si bishë e uritur, kërcëlliti dhëmbët.

— Na, na, na... — e qëlloi në kokë Nazmiun me një shufër çeliku. Heroi mblodhi veten, mposhti të gjitha dhimbjet. Përsëri gjaku filloi t'i binte poshtë fytyrës. I rrodhi nëpër gojë dhe, që andej, filloi të pikonte mbi çimenton e akullit. Përmes vijëzimeve të kuqe të gjakut, fytyra herë i egërsohej, herë i qeshte. Ç'përfytyrime mund të kishte në ato çaste të fundit? Ndoshta iu bë se dëgjoi zërin e shokëve? Pastaj tymi e flaka iu endën para syve. Nga kjo mjegull flake e tym baroti, me pushkë në dorë, pa shokët e çetës me komunistët në ballë, që po vraponin drejt tij. Ja komandanti, Haxhi Lleshi me fytyrën e ashpër e të dashur. Pas tij, si një varg i kuq, vinin shokët e çetës, nënat e motrat.

Burgu sikur u ça nga gjëmimi i një bombe. Një dhimbje e tmerrshme i therri gjoksin. Edhe pak jetë në luftë. Iu bë se po nisej drejt Korabit me flamur e pushkë në duar... Shokët e ndiqnin nga pas. Armiqtë e shumtë qëllonin mbi ta. Ata ngjiteshin drejt malit shkëmbor. Gjaku i rridhte, ai ecte. Plagët i therrnin, ai çante me flamurin përpara. U ngjit mbi majën e Korabit dhe vështroi gjithë atdheun. Malet sikur lëvizën. Prej tyre pa duke zbritur shokët e shkollës: Qemalin, Vasilin, Eminin, Xhezmiun, Hajdarin, Ndocin, Tomën, Sa-

dikun, Adilin, Naimin, Esatin. Ata i thirrën, i thirrën fort: «Mos u përkul, vëlla, ngjite sa më lart flamurin tonë!» Shpalosi flamurin. Shokët luftonin. Ai buzëqeshte me flamurin në dorë. E tundi disa herë flamurin e shpalosur nga maja e Korabit dhe e nguli thellë, thellë mbi majën e gurtë të tij. Por ja, një nga armiqtë sikur çau rrethimin. «Po ky, përsëri i gjallë?» — pëshpëriti, kur iu vizua fytyra e urrejtur e kapiten Stavrit tek zvarritej duke lebetitur me revolver në dorë, drejt flamurit me yllin e kuq. Nazmiu e kapi flamurin. Kapiteni rrëshqiti. Shkëmbi i Korabit, ai shkëmb që mbi shpatullat e tij vigane kishte duruar borën e shumë shekujve, nuk e mbajti trupin e tij. Trupi i kapitenit fashist u përplas poshtë, me forcë, në humnerë. Pas tij u sulën një rrebesh tjetër armiqsh. Në krye të tyre Guido Verdi. Me thika në dhëmbë e revolverë në duar u afruan pranë, fare pranë flamurit. Qëlluan mbi të, drejtuan thikat që ta shqyenin. Por Nazmiu e ngjiste më lart atë. Në këtë luftë, mes valavitjeve të flamurit, iu shfaq «Tarasi». Forcat iu përtërinë. Iu duk vetja sa maja tjetër e malit. Armiqtë, si të tërbuar, u ngritën në këmbë drejt tij. Por ja, barrikada e shokëve e rrethoi si një hekur i skuqur. Ai sikur u tret me flamurin, me shokët. Retë sikur u trazuan. Vetëtimat e bubullimat u bënë më të forta. Korabi u lëkund. Toka u dridh sikur ra një tërmet i fuqishëm. Trupat e armiqve u rrëzuan si gurë të vegjël, duke u munduar të mbaheshin pas fijeve të holla e të thata të barit, por fundi i honit i përpiu pa mëshirë në gojën e vet të frikshme.

... Kjo ëndërr ia çeli pak synë heroit. Zemra s'e kishte lëshuar. Por këtë radhë, kapiteni fashist

e qëlloi me kondakun e pushkës pas koke. Atëhere, ai përsëri u lëkund mbi këmbët e copëtuaara, sikur iu zhdukën dhimbjet e mundimet, dhe ra, i madh e i bukur, siç bie në beteja të përgjakura një flamur i kuq.

*
* *
*

Major Verdi ecte si i çmendur nëpër zyrë. Xhafer Bali diçka shkruante. Koka po i ndahej në dysh nga inati. Duçja i varur në mur, me atë fytyrën e egër e të vrazhdë, e vështronte oficerin e tij dhe dukej se po e hante të gjallë, për pazotësinë e treguar në mposhtjen e një komunisti.

Nga sytë nuk i hiqej figura e komunistit. Qëlloi me pëllëmbë tavolinën, sa llamba me vajguri kërcëu përpjetë dhe u shua. Edhe në errësi, zëri i komunistit i tingëllonte në tru: «Qëlloni edhe më, përse frikësoheni? Merrni vesh mirë ju, o vrasës! Toka jonë nuk duron armiq e tradhtarë! Pyetni historinë dhe ajo ju tregon hakmarrjen e egër shqiptare! Ju dhe tradhtarët do të varroseni me dheun e turpit, si kërmat!»

Kapiten Karta dhe Jakoveli u futën brenda dhe ndriçuan me elektrik dore dhomën e kredhur në errësi.

— Zoti major, ai... — mezi foli Jakoveli.

— Si?! Dhe nuk hapi gojë? E çuditshme... shumë e çuditshme! Çfarë shpirti, vallë, paskan këta komunistët?

Guido Verdi, urdhëroi gardianin e burgut që ta varroste natën trupin e Nazmi Rushitit. Gardiani

vërejtji i tmerruar se thonjtë e gishtave të duarve e të këmbëve, nuk i kishte të gjithë. Në to ishte piksur gjaku, një gjak i trashë, i zi. Trupi, sidomos kurrizi, i ishte bërë vija-vija të zeza. Brinjët e djathta i kishte të thyera, kurse të dyja këmbët të dëmtuar keq në gjunjë. Fytyrën, fashistët, ia kishin dëmtuar keq. Njëra nofull ishte e thyer. Në kokë kishte një plagë të thellë, kurse flokët i ishin ngrirë nga gjaku. Dukej se nga goja i kishte rrjedhur shumë gjak. Edhe i vdekur, duart i mbante grusht, ndërsa në fytyrë i kishte ngrirë një buzëqeshje e lehtë...

B e t i m i

Fjala për vdekjen heroike të Nazmiut mori dhenë. Emrin e tij e përcolli era e kuqe, duke helmuar malet, celulat e partisë, çerdhet partizane, shkollat, duke helmuar zemrat e vegjëlisë dibrane.

Nata po largohet. Në muzgun e atij mëngjezi, grupi i çetës, vazhdonte marshimin. Heshtje. Dhimbja ua kishte mbyllur gojën. Hoqën kapelet. Ngrihën grushtet lart. Një minutë zi? Jo. Krenari.

— Ti, shoku ynë i armëve, luftëtari trim i orës së parë, partizani e komunisti i papërkulur para asnjë vështirësie e padrejtësie, guximtari i aksioneve, Nazmi Rushiti, re në lulen e rinisë, duke i falur Partisë, atdheut dhe popullit tënd që i deshe aq shumë, jetën tënde të njomë. Kjo është një humbje e rëndë. Por ne do ta mposhtim hidhërimin, brengën, e këto do të bëhen zjarr kundër armiqve e tradhtarëve. Ti re flamur me valavitje

të përjetshme! Betohemi, shok, se do ta vazhdojmë luftën në vazhdën e heroizmit tënd!

Zëri i komandantit ishte i rëndë. Fytyra e tij u ngrys edhe më. Vështroi lart, në bardhësinë e hënës. Nuk pati më kohë të shikonte vrazhdësinë e fytyrave të partizanëve që shprehnin një plagë e brengë të madhe. Edhe ai me zor e mbajti veten. Lotët u kishin ngrirë.

— Betohemi, shok! — vetëm kaq mundën të belbëzonin, dhe i mbyti ngashërimi.

— Betohemi se do të hakmerremi! — u dëgjua kori i vendosur i shokëve. Një automatik dhe ca pushkë që u zbrazen njëherësh, shoqëruan këtë betim, duke shpërndarë jehonën e tyre anë e kënd Dibrës dhe Shqipërisë. Kjo ishte simbolika e dëshmorëve, përsëritja dhe vazhdimi i idesë së tyre. Pas betimit pjesëtarët e çetës hodhën pushkën kraheve, duke shtrenguar nofullat nga dhimbja e thellë. Ashtu si pushkët, morën me vete edhe ëndërrat e shokut. Me urrejtjen lëmsh në zemër, nisën marshimet për sulme të reja.

*

*

*

Rushit Shaqiri shtangu në derë të shtëpisë, kur pa se ajo u mbush plot me dovalanas. Ai e kuptoi se ku ishte këputur peri.

— Nazmiu?..

— Po, Rushit... e vranë... — dhe Xhema nuk mundi t'i mbante lotët.

— Mos u ligështoni, burra, se ia zbardhi faqen

dhe armët e këtij vendi! — foli me sytë e skuqur Beqir Dovalani.

Gratë, të veshura me të zeza, filluan të qanin. Nebija nuk i la të vajtonin sipas zakonisht. Asaj i kishte lënë një amanet Nazmiu, kur ishte ndarë, një javë para se të vritej. «Nënë, — i kishte thënë kur ajo po e puthte në ballë, — nëse një ditë unë nuk do të kthehem më, mos u mërzhit e mos derdh lot. Zi të mos ketë në vatrën tonë, se gëzohen armiqët». Nebijes, dy pika të rëndë loti, i kishin rrëshqitur syve. Sa vështirë e kishte ajo që t'i ngrinte lotët!

— Oj Nebije! — i thirri Zarja me shoqet e veta pa e fshehur vrerit sapo hynë brenda. — E vranë komunistin...

— Jo, moj gra! — u burrërua Nebija. — Ç'janë ata lot? Në shtëpinë e komunistit nuk ka lot. — Rrethi i syve sikur iu nxi më tepër nga dhimbja.

Por edhe Nebija nuk qe e zonja të mbante lotët. Gjuha sikur u qe lidhur njerëzve. Ata përcillnin gulçimat e hidhërimit.

— Përse heshtni, mor vëllezër, nënë jam, shpirti fort po më përvëlohet, po kur mendoj se im bir e fali jetën për Parti e vatan, lotët më shterojnë. Hallall ia kam bërë gjirin! — tha Nebija duke iu dridhur buza.

— Të lumtë goja, më gëzove sikur na e ngjalle djalin! — dhe Rushiti nuk mundi të fliste më. Goja nuk qe e zonja të bashkonte fjalë të tjera. Me vështirësi, shtoi: — Po kjo është dasma e Nazmiut, mor burra! — dhe lotët e tradhtuan.

Heshtja i mbërtheu përsëri njerëzit. Vajtimi i shoi fjalët. Ndërkohë, tre partizanë të çetës, u fu-

tën brenda. Njëri me mustaqe, që mbante një automatik krahëqafë, filloi t'u jepte zemër:

— Ai, krahët dhe zemrën, përjashta i ka lënë Ato do të bëhen mina e bajoneta për të vrarë dushmanin!

— Dua të di se si ka luftuar e si ka dhënë shpirt im bir, — iu drejtua Rushiti partizanëve.

— Ashtu si luftojnë bijtë e këtij vendi, ashtu si luftojnë komunistët e kësaj partie!

— I thoni komandantit të çetës dhe gjithë partizanëve, se kjo shtëpi juaja ka qenë. Dyert e saj, gjithmonë hapur do të rrinë për ju, o bij!

Ata ishin shokët e Nazmiut, Irfan Hajrullai, Demir Gashi e Spiro Velkoja, që ishin dërguar nga celula komuniste për të ndarë hidhërimin me nënën. babanë, motrën dhe vëllezërit e Nazmiut.

*
* *

Sadik Bekteshi, atë fillim tetori ishte në malet e Mirditës. Një partizan i solli një letër të shaptilografuar. Ai lexoi:

«Trakt për vdekjen heroike të Nazmi Rushitit...» Nuk mundi të lexonte më tej. Sytë iu errën. Shokët e panë. Ata nuk mund të hynin në brendësi të tronditjes së tij. Si u kthjellua pak, sytë iu tretën mbi ato shkronja të kuqe:

«...Partizani i vijës së parë të luftës. Nazmi Rushiti, ky djalë trim... nuk kurseu as jetën...»

Gulçima të një dhimbjeje të madhe i vinin deri në grykë, i helmonin tërë qenien. Nuk mundi të

qëndronte në buzë të atij shkëmbi. Fërkoji ballin e nxehtë. Por ajo ndjenja e krenarisë për shokun e ngushtë të armëve, e shkundi dhe përsëri lexoi:

«Luftoi me tërbim fashizmin kusar... kudo, në zjarr... ku rreziku ishte më i madh, se kishte bindje të plotë... Emri i këtij partizani shkon gojë më gojë në popullin heroik të Dibrës, i cili është betuar që gjakun e birit të saj trim, të mos e lejë pa e marrë... Para kujtimit të tij, përkulemi dhe betohemi...»

Përsëri Sadiku mbeti si i habitur. Ky lajm e goditi. Si plumb? Jo. E ç'është një plumb? Ai vështronte shokët që e shikonin me dhembshuri.

— Gjaku i derdhur, gjakun kërkon!

Zëri i gjithë shokëve u përzie me zërin e tij: Betohemi! Edhe zëri i Eminit, Hajdarit, sikur u bashkua me jehonën e madhe të maleve: Betohemi! — shtrënguan grushtet dhe u nisën të zinin pozicionet për të filluar aksionin.

*

*

*

Vdekja e këtij biri të madh, zgjoi edhe më tepër vegjëlinë dibrane. Ajo shtoi radhët e çetës partizane, e cila nuk i pushoi aksionet për hakmarrjen e ligjshme popullore, për lirinë e grabitur.

Shoku Enver Hoxha, shkruante:

«...Dhe Haxhiu, me çetën e tij trime, vazhdon misionin e lartë, vazhdon luftën për liri. Reaksioni i pushtesit dhe i Mustafa Krujës po tërbohet në atë anë, dhe veçanërisht, pas vrasjes në Zerqan

të kapitenit Stavri Jaho, armik i njohur i popullit tonë. Pushtuesit dhe tradhtarët përpiqen që ta ndalojnë këtë lëvizje heronjsh, por më kot, se ditë-ditës, zemërimi i popullit po shtohet kundër okupatorit. Populli i Dibrës tanimë i ka të qarta qëllimet e pushtuesit dhe mëria e tij kundër fashizmit dhe tradhtarëve ka arritur kulmin me vrasjen e partizanit, patriotit të ndershëm, studentit Nazmi Rushiti, i cili dy vjet me radhë ka qenë i internuar në ishujt e mallëkuar të Italisë dhe tani vdiq nga torturat shtazarake e barbare, të denja vetëm për fashistët. Por, me gjithë reaksionin e egër, me gjithë torturat shtazarake, lufta jonë për liri po shkon kurdoherë përpara, ajo po forcohet, po bëhet një tmerr për fashizmin, ajo ka rrëmbyer gjithë Shqipërinë dhe flamuri i lirisë po valon në kodra e male, në fusha e lugina, i mbajtur lart prej trimave luftëtarë si Haxhi Lleshi me shokë».

A p e l i

Një lumë i gjatë njerëzish të heshtur e seriozë. Një varg kurorash me lule të freskëta maji u derdhën, ku lartësohet busti i bardhë i heroit, ligjëruetit të përhershëm të lirisë, mes gjelbërimit të këndshëm, bri shkollës së mesme profesionale, që mban emrin e tij të kuq.

Heroi, me profil lirie, shikon i buzëqeshur çdo ditë mëngjezet e kaltëra. Pranë tij qëndroi sekretari i partisë së Dibrës, me ballin gjithë brazda nga vitet e luftës, mbi të cilin janë përplasur stuhitë. Ai sikur dëgjon zërin e zemëruar e rrëmbyes të Heroit.

Një kujtim iu end në ato çaste: «Kep Dreni. Një mëngjez tetori e pa mbi varrin e Heroit me pushkën e gjatë serblie dhe me një dorë lule mali. I derdhi lulet mbi baltën e ëmbël të vatanit, ku prehet komunisti dhe ia ngrohu gushën serblies. Gëzhoja u përzië me lulet. Kështu foli Dreni, kështu foli pushka... Dhe u nisën bashkë të kërkonin ma-
leve gjurmët e çetës. Që prej asaj dite, lulet mbi varr nuk u vyshkën. Çdo mëngjez udhëtarët derdh-
nin lule të freskëta. Fashistët vendosën roje. Po lulet vinin përsëri nga malet.

— Hidhi këto lule, bir, mbi komunistin, që ne-
sër të dish të ecësh pas gjurmëve të tij, — i tha malësori birit të vet, kur kaloi pranë varrit. Gjithë ai dhë i hedhur mbi varr, i rëndonte Kepit në shpirt.

Roja ktheu bajonetën, po lulet ranë të dashura, duke u përfulur me dheun e lagur.

.....

— A vdesin komunistët, or komandant Haxhi Lleshi?

— Komunistët nuk kanë mort, or Kep Dreni!

— Po për t'u qarë, a qahen?

— Jo, or Dre partizani! Për komunistët ka pushkë e këngë.

Partizani uli kokën, kur komandanti hodhi sytë me kuptim. Ai çiftelisë nuk ia kishte dridhur te-
lat. Ato i kishte zënë ndryshku. Nuk i bënte zemra të këndonte. Por në mendje këngën për komunistin, për shpirtin e çetës, kishte nisur ta hartonte».

Sekretarin e zgjoi nga kujtimet shoku i çetës partizane, veterani që fliste për jetën dhe luftën e Heroit. Tani iu kujtua kënga që çeli e kuqe në

zemra, mbi tela e mbi pushkë, kënga që nisi «nga partizani», që mbas ca vitesh u këndua nga malet, nga pavdekësia e tij:

*«Nazmi Rushiti një djalë i ri,
Djalë i ri me Parti,
Ka dalë malit partizan,
Me luftue me Italian.*

*Me ba luftë me bajraktarë,
Me fashista, me tradhtarë,
Që t'çlirohet e gjithë Shqipnia,
Siç dëshiron populli, siç udhzon Partia.*

*Ç'na ka dalun n'at Zerqan,
Nji fashist, nji kapidan,
Për nji palë çizme e shet lirinë,
Për nji këmishë t'zezë e shet Shqipninë.*

*Kapiten, fashist' i qenit,
T'erdh sahati, mos luej vendit,
Se ky popull ka djem me huqe,
Këmishn' e zezë ta ban të kuqe!»*

— Nazmi Rushiti! — bëri apelin «komandanti i çetës», duke thyer përsëri heshtjen e trazuar.

— Ra Hero për çlirimin e atdheut! — përgjigjet «partizani» me shaminë e kuqe të lirisë.

— Gjokë Doçi!

— Ra Hero për çlirimin e atdheut! — një zë tjetër nga mesi i çetës!

— Demir Gashi!

— Ra dëshmor...

Tri breshëri të zgjatura mitralozi. Tri «urra» të zgjatura jehone përcolli «çeta». Sheshi kundërmoi erë baroti.

Sekretari i partisë shikonte çetën e re të kuqe, që u radhit me gjithë popullin për të marshuar nëpër gjurmët e Heroit. Loti i mallëngjyer i mbeti në qepallat, i nxehtë si plumbi në gojë të pushkës. Ai përsëri ndjeu sikur malet zgjuan kujtimet e tyre, në kasollet jehoi fjala e kuqe e Heroit duke u folur zemrave, duke marshuar e duke luftuar me çetën, ndjeu çapin e tij partizan, dëgjoji diskutimin e Heroit në celulën e Partisë. Ndjeu sikur atdheu afroi bashkë me të buzët mbi ballin e komunistit dhe e hodhi mbi lumin e njerëzve, mbi kazmat e pushkët dibrane, që, të radhitura, marshojnë bashkë me Heroin, shtigjeve të lumtura.

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Prindërit dhe «shkolla» e varfërisë	5
Në rrugën e formimit	16
Midis shokëve të klasës	29
Arrestimi	43
Gjyqi zogist	52
Në Mbreshtan	67
Përsëri në gjimnaz	78
Në burgjet e Italisë	102
Kthimi	120
Në Dibër me mision partie	127
Në konakum e beut	164
Dibër-Zogaj, 20 qershor 1942	192
Atentati	216

Redaktorë: *P. Mëzezi, S. Vila*
Kopertina nga: *Z. Shoshi*

Tirazhi 5.000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-72

Shtyp. Drejtoria Qendrore Poligrafike
Shtypshkronja «8 NËNTORI» — Tiranë, 1974.